

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON KRYETARI I KUVENDIT ILIR META

(Seanca filloi në orën 17:30)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 16 korrik.
2. Projektligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
Pyetje
Shprehet komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.
Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin Europian
Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat
Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.
Relatori
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare.):
Koha e votimit

Ilir Meta – Të njoftohen mediet të jenë të pranishme, sepse do të fillojmë seancën.

Po presim emrat e diskutantëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste që të fillojmë.

Ju lutem zini vendet!

Hapim seancën plenare.

Sot në rendin e ditës kemi:

1. Miratimin e procesverbalit të seancës së kaluar, datë 16.07.2015
2. Projektligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institutin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”

Në lidhje me diskutimet nga maxhoranca kanë sjellë emrat për të diskutuar këta deputetë:

Vasilika Hysi, Evis Kushi, Enkelejda Shkreli, Ervin Bushati, Musa Ulqini, Taulant Balla, Blerina Gjylametim, Ilir Pendavinji, Erieta Alhysa, Olta Xhaçka, Esmeralda Shkja, Fatmir Toçi, Adelina Rista, Mira Shehu, Mimoza Hafizi dhe Alfred Peza në emër të grupit.

Nga opozita:

Jorida Tabaku, Eduard Halimi, Albana Vokshi, Myqerem Tafaj, Luçiano Boçi, Sherefedin Shehu, Oerd Bylykbashi, Sali Berisha, Jozefina Topalli, Gjergji Papa, Elena Qirici, Bedri Hoxha, Irma Kopliku, Asllan Dogjani, Liljana Elmazi, Arbiola Halimi, Genc Pollo dhe Fatmir Mediu.

Këto janë emrat e regjistruar për diskutim.
Fillojmë me procesverbalin.

A jeni dakord me procesverbalin e seancës së kaluar? A keni ndonjë vërejtje? Nuk kemi.

Miratohet.

Fillojmë me projektligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”

A ka pyetje për projektligjin?

Nuk ka.

Atëherë, fjalën e ka ministrja e Arsimit dhe e Sporteve, zonja Lindita Nikolla, si nismëtare.

Lindita Nikolla – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Sot Kuvendi i Shqipërisë do të votojë ligjin e arsimit të lartë që është hartuar mbi bazën e një platforme të gjerë, shumë të detajuar, nga një grup profesorësh.

Që prej janarit të vitit 2014 kam pasur fatin dhe nderin të bashkëpunoj me një ekip të shkëlqyer të reformës në arsimin e lartë, profesorë të nderuar të universiteteve tona, por edhe të huaja, publike dhe private, njerëz me integritet dhe qytetarë model që jo pak herë dhe sigurisht aspak për faj të tyre u anatemuan padrejtësisht, por kurdoherë qëndruan në lartësinë e figurës.

Më lejoni, që nga kjo foltore të falënderoj profesorët e nderuar: Arian Gjonçaj, drejtuesin e Komisionit të Reformës, Besnik Aliaj, Myftar Barbullushi, Dhuarata Bozo, Aleksandër Xhuvani, Erben Demo, Adrian Civici, Edmond Hajdëri, Anila Paparistio, Artan Hoxha dhe Elida Rapsi.

Projektligji i arsimit të lartë që po diskutojmë sot është diskutuar gjerësisht në qarqet akademike të vendit dhe grupet e interesuara, si dhe është konsultuar me ekspertë europianë të arsimit të lartë. Ndaj, në emër të kësaj pune të pastër, të sinqertë, kapilare, dëgjimi dhe debati tejet të shëndetshëm nga të gjithë ata, që kontribuuan përmes dakordësisë dhe më shumë përmes kritikës racionale e me të vërteta, më lejoni të pohoj edhe një herë atë që është sipari i të gjithë këtij procesi dhe produkti të dakordësuar në këtë projektligj.

Kjo reformë është e para reformë në arsim, jo reformë e partisë në pushtet, jo reformë e të zgjedhurve të politikës për të ndarë apo shkëmbyer privilegje me të zgjedhurit e

universiteteve, ndaj, falënderoj profesoratin, rektorët, dekanët, pedagogët dhe studentët, gjithashtu, që u bënë pjesë e debatit të shëndetshëm e përmirësues të ligjit, edhe pse jo domosdoshmërisht duke rënë dakord me çdo nen të tij.

Nuk e di se në cilin ligj për arsimin janë realizuar mbi 30 forume publike e pjesëmarrje në debate të mbi 2 mijë pedagogëve; ballafaqime të drejtpërdrejta me titullarë të institucioneve të arsimit të lartë duke marrë në shqyrtim e debatuar çdo vërejtje apo sugjerim; dhjetëra debate e qindra shkrime prej një viti e gjysmë, maratonë debati deri në orët e para të mëngjesit, nen për nen, si në Komisionin e Ligjeve, ashtu edhe në atë të Edukimit dhe Medies. Kur më parë pikëvështrimet u vlerësuan me respekt për të kaluar nga dokumenti i parë në të dytin të Komisionin të Reformës së Arsimit të Lartë, në një dokument më pas përfundimtar politikash që do të udhëhiqte procesin e shkrimit të ligjit? Kur më parë, drafti i parë i ligjit, i shkruar nga grupi teknik, u është shpërndarë universiteteve për të debatuar në çdo departament? Kur më parë janë debatuar në një proces të hapur 800 faqe komente dhe vlerësime nga universitete.

Më lejoni t’ju them vetëm dy fakte: për dokumentin e parë, të përpunuar nga komisioni, vetëm Universiteti i Tiranës dërgoi mbi 200 faqe komente dhe për të dytin 6 faqe komente, nga një për çdo fakultet. Shihni rrugën e kundërshtive, në fakt, për ligjin. Deri para një jave më parë kishte çështje konkrete që adresoheshin, kishte opsione përmirësuese dhe më pas kundërshti, si një sulm total në përgjithësi për ligjin. Pse? Përgjigjja është vetëm një: kishte proces të vërtetë dhe marrje në konsideratë të çdo pikëvështrimi për mësues të ligjit. Ndaj, kjo reformë është pa asnjë dyshim, reforma më e papolitizuar në këta 20 vjet. Ndoshta është në rastet unike që as maxhoranca, por as opozita nuk kanë ndërhyrë në punën e komisionit.

Të nderuar deputetë të opozitës,

Heshtjen për një viti i gjysmë, mosdhënien e një alternative tjetër, braktisjen e çdo ftese nga komisioni për të debatuar, e kam lexuar, por sigurisht, jo vetëm unë, si një lloj miratimi në heshtje. Dhe sot, në fakt, në respektin maksimal të përfaqësimit tuaj, të bindjeve tuaja, nuk mund të kuptoj se cila është shtysa e vërtetë që i bën shumë ndër ju të ndani vijën logjike të

argumentit dhe vlerësimit tuaj real për ligjin me qëndrimin ndryshe, atë që bëni përpara medieve.

Të nderuar deputetë,

Në ka ligj ku llogorja e partizanërisë politike duhet lënë jashtë, është ky ligj. Në ka moment për të treguar me vepra dhe jo me fjalë se realisht politika më e mirë për zhvillimin e vendit është arsimit, është pikërisht sot, tani. Ndaj në respekt të secilit prej jush, modestish, më lejoni t'ju them se ende kemi shansin që këtë ligj ta kalojmë me konsensus edhe pse është zhgënjyese, sa po ndodh, që nga dje në fakt, por ende nuk është vonë.

Ky ligj nuk është thjesht një nevojë për të përmirësuar arsimin e lartë, por është një vizion krejt i ri, sepse neve na duhet të ndryshojmë mënyrën sesi i mësojmë studentët aktualisht. Neve na duhet të mos gënjejmë veten, fëmijët, motrat dhe vëllezërit tanë se universitetet që kemi janë ato që u duhen atyre dhe zhvillimit të vendit. Neve na duhet të themi të vërtetën e plotë të gjithçkaje që është arritur në arsimin e lartë, po aq edhe për masivizimin, por kurrsesi duke bërë "gjasmen" e radhës me retorikën e mbushur me gjithçka, por jo me nevojën klithse, që sot sistemi i arsimit të lartë ka për një reformim të plotë e të thellë.

Vetëm me një inspektim të plotë të kriterëve të ligjshmërisë që ne realizuam me të gjitha institucionet e arsimit të lartë, ranë për tokë 18 institucione piramidë të arsimit të lartë privat, si dhe dy filiale në atë publik. Bëmë publike raportet për këto institucione private, pa thënë se ishin të gjitha institucione të licencuara nga ministrat tuaj. Jo. Morëm përgjegjësitë, edhe pse ligji nuk na i ngarkonte, madje edhe të sistemimit edhe të studentëve, duke dhënë shembullin me vepra, se besojmë te misioni i arsimit të lartë si e mirë dhe përgjegjësi publike. Edhe të 5 institucionet e arsimit të lartë publik i gjetëm në shkelje të ligjit, sigurisht jo në nivelin e shkeljeve të atyre piramidave që u mbyllën. Por nëse u referohem 37 kriterëve ligjore nga 3-22, variojnë kriteret e shkelura te 15 institucionet e arsimit të lartë publik në vend. Edhe këtu, ndoshta ishin sheshit arsytet për t'i etiketuar rektorë, dekanë e pedagogë e ca më shumë për ata që kishin kundërshti nga ligji, por, sigurisht nuk ishte ky qëllimi. Pyetini rektorët se sa e vërtetë është kjo, pasi, besoj, është e tepërt të më pyesni mua, për shembull, sesi jam ndier kur

media apo grupe të tjera interesi kërkonin me insistim pse Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk bënte publike edhe gjetjet e inspektimit në universitetet publike.

Nuk kam besuar kurrë dhe nuk e pëlqej kulturën e dhënies së goditjes tinëzare në kohë, që tërë universitetet dhe ca më shumë pedagogët kryesorë, të nderuar, të universiteteve publike ishin përfshirë në debatin për ligjin, edhe pse, unë i çmoj për vendin dhe shoqërinë si aste tepër të vjera.

E kam deklaruar në çdo takim, kemi instaluar një komunikim të munguar prej vitesh, që e respektoj në të cilin besoj fort se do të bëjmë edhe ndryshimin në arsimin tonë të lartë, ku nuk ka gracka apo rrjeta për të bërë për vete këtë apo atë drejtues, këtë apo atë pedagog apo këta studentë, por të vërteta përgjegjësi dhe, sigurisht, respekt në dëgjimin çdo opinioni.

Janë këto arsytet që nuk do t'i bëj as sot, në fakt, e nuk do të flas me emra të përveçëm, sepse janë vlerat që besoj jo me raste, por në çdo rast, por, sigurisht, nga kjo foltore, si ministre e Arsimit, pasi kam instaluar së bashku me të gjithë stafin tim kulturën e re të dëgjimit dhe analizës me të vërtetat e arsimit të lartë dhe jo të politikës, kam të gjitha arsytet e mendjes dhe zemrës njëherësh t'ju përgjigjem edhe atij grupi edhe pse i vogël, që guxon e shantazhin parlamentin se, nëse sot ky ligj nuk miratohet, atëherë është fundi i arsimit të lartë dhe se vendi do të zhytet thellë e më thellë në errësirën e padijes sipas tyre.

Të nderuar profesorë pedagogë,

Më keq se ç'ka qenë e se ç'e keni bërë arsimin e lartë në vend nuk ka ku të shkojë. Të pranosh duke u dorëzuar dhe duke e quajtur si të shëndetshëm një sistem, ku anarkia, papërgjegjshmëria, ineficenca po shndërrohej në një normë, është tradhtia më e madhe që mund t'i bësh vendit dhe kombit. Fundi i rehatisë akademike, sigurisht, nuk është fundi i arsimit të lartë. Fundi i një sistemi që prodhon diploma pa vlerë, nuk mund të jetë fundi i arsimit të lartë. Fundi i punësimeve nepotike, nuk është fundi i arsimit të lartë. Fundi i drejtuesve të institucionit të arsimit të lartë apo departamenteve, që pjesën më të madhe të vitit e kalojnë jashtë Shqipërisë, sigurisht është fundi i arsimit të lartë. Fundi i rektorëve të tenderëve, nuk është fundi i arsimit të lartë. Fundi i doktoraturave paçavure, nuk

është fundi i arsimit të lartë. Fundi që një pedagog të udhëheqë 41 studentë në doktoraturë, kur ligji thotë jo më shumë se 5, nuk është fundi i arsimit të lartë. Fundi i titujve akademikë për të rritur rrogën e administratës publike, sigurisht nuk është fundi i arsimit të lartë. Fundi i sistemit part-time si një industri parash, por jo dijesh, pa dyshim nuk është fundi i arsimit të lartë. Fundi i diplomave si kartëmonedha të këmbimit të injorancës, nuk është fundi i arsimit të lartë. Ky projektligj, edhe pse nuk është i përsosur, është ligji më i mirë për arsimin e lartë, sepse i jep përgjigje sistematike të gjitha problemeve, por mbi të gjitha është produkt i një procesi model nga njerëz që jetojnë me universitetin çdo ditë; e përsëris: jetojnë me universitetin çdo ditë, nga njerëz që nuk i tremb konkurrenca e ndershme akademike e as dijet e studiuesve të rinj, nga njerëz që zhvillojnë e marrin përgjegjësi, nga zonja dhe zotërinj të botës akademike që nuk e shohin ligjin si rrezikim të autoritetit e të pozitave të tyre. Janë këta pedagogë e profesorë, që fatmirësisht nuk i mungojnë vendit, garancia e suksesit të këtij ligji, i cili ka në qendër studentin dhe pedagogun.

Prandaj, të dashur studentë, koha juaj e studimeve dhe e shpenzimeve të prindërve shqiptarë, me këtë ligj kthehen në kohë dhe financim jo të harxhuar kot; më tej akoma, në një investim strategjik për jetën tuaj e të shoqërisë ku kontribuoni, duke rritur përgjegjshmëritë tuaja, duke fuqizuar mundësitë e financimit të sistemit, duke shtuar maksimalisht atë që qeveria mund të buxhetojë, si dhe duke lejuar forcat e tregut dhe kontributet e tjera që të futen në sistemin e arsimit të lartë të orientuar nga cilësia. Kështu, studentët dhe prindërit do të mund të marrin maksimumin e investimit në kohë dhe buxhete.

Është e sigurt se në sistemin e ri të arsimit të lartë, në radhë të parë ju do të edukoheni me sensin e meritës e të garës, çka është shumë e rëndësishme për formimin dhe jetën tuaj, por sigurisht, do të keni nga qeveria dorën e solidaritetit e të mbështetjes për të ecur përpara. Sepse, në besimin tonë ka një ndryshim të madh. Qëllimi nuk është vetëm te paratë që ne investojmë në arsimin e lartë. Paratë janë të nevojshme, madje të domosdoshme, por paratë nuk janë të mjaftueshme, nëse ne të gjithë, si shoqëri, nuk investohemi në arsimin e lartë.

Prandaj, neni 1 i ligjit të ri “Për arsimin e lartë” thotë: “Arsimi i lartë është e mirë dhe përgjegjësi publike” dhe sfida që reforma jonë e arsimit të lartë ka marrë përsipër, është të mobilizojë të gjitha burimet e shoqërisë në shërbim të këtij vizioni zhvillues.

Së pari, ne duhet të optimizojmë financat publike, paratë e të gjithë taksapaguesve shqiptarë, me arsim të lartë apo jo, të rinj apo të vjetër, persona që mund të përfitojnë ose jo nga universiteti, ndajnë çdo vit fonde mënjane. Asnjë qindarkë nga këto para nuk duhet dhe nuk mund të shkojë dëm, por çka është më e rëndësishmja, duhet të investohen në atë mënyrë, që të kapim mbrapsht maksimumin e vlerës së tyre. Reforma e bën këtë në dy mënyra: financimi për universitetet publike, pra paratë që shteti i jep universitetit, do t’i jepen tani në bazë të treguesve të performancës. Kjo do të thotë që universitetet që tërheqin studentë më të mirë, që i përgatisin më mirë studentët, që kanë nivel më të lartë punësimi të të diplomuarve, që bëjnë më shumë kërkim shkencor, që marrin pjesë në më shumë projekte ndërkombëtare, do të kenë edhe më shumë mbështetje nga fondet publike.

Kjo do t’i shtyjë universitetet që të kenë interes të jenë cilësorë, të kenë staf cilësor, t’i përgatisin mirë studentët e jo thjesht t’i kalojnë. Ky është një mekanizëm vetërregullues i provuar, më efikas se sa kontrolli nga lart, që kemi parë të dështojë.

Mënyra e dytë e optimizimit të financave lidhet me mbështetjen me bursa për studentët. Ligji e bën më të drejtë financimin publik për studentin, duke iu gjetur pranë studentëve në nevojë, duke krijuar një fond të posaçëm bursash për të gjitha kategoritë, të cilat për pamundësi financiare nuk ndjekin dot studimet. Krijon një fond të posaçëm bursash për studentët që ndjekin degët me prioritet kombëtar, dhe mbështet posaçërisht me bursa studentët me rezultate ekselente.

Ndërkohë, unë dua t’ju ftoj për një përgjegjshmëri më të madhe në raport me kohën tuaj, në raport me kohën e pedagogëve dhe burimet publike. Ne do të dekurajojmë mungesën e cilësisë edhe te studenti. Mbështetja kryesore do t’i shkojë studentit të përgjegjshëm që përpiqet të realizojë me sukses studimet e tij. Mbështetja publike përmes fondeve publike, për edukimin tuaj, do të jetë sigurisht një mbështetje

me kushte, në bazë të meritës dhe të nivelit të përpjekjeve.

Sigurisht, ky ligj dekurajon papërgjegjshmërinë. Nuk bëhet fjalë që ne të mos i japim mundësinë të gjithë të rinjve për arsim të lartë përmes këtij ligji të ri. Nuk bëhet fjalë që dikush të përjashtohet nga sistemi. Jo. Çdo i ri duhet të ketë një vend në arsimin tonë të lartë. Çështja është: secili në vendin që i takon, sipas meritës, sipas preferencës, por edhe sipas nevojave dhe prioriteteve që vendi ka, ndryshe nga politika thjesht dhe vetëm e masivizimit, e cila nuk u kujdes për thelbin e formimit të studentit. Ky pakt i madh me studentin shqiptar është një pakt për zhvillimin e shoqërisë shqiptare, është një pakt për solidaritetin, është një pakt për zhvillimin e vendit dhe talenteve e potencialeve të tij.

Ligji i ri rrit ndjeshëm autonominë universitare, duke deleguar drejt universiteteve publike një sërë vendimmarrjesh të rëndësishme, mbi numrin e studentëve të pranuar, kriteret e përzgjedhjes, përzgjedhjen e studentëve, tarifat e studimit, numrin e stafit akademik dhe nivelin e pagave të tyre.

Sfida e dytë, për të realizuar bashkërendimin e burimeve të shoqërisë, lidhet me optimizimin e burimeve njerëzore, e gjithë trupës së profesoriatit dhe stafëve akademikë. Në strukturën ekzistuese të universiteteve, këto burime njerëzore shpeshherë nuk kanë qenë eficiente, ndonjëherë janë keqpërdorur dhe shpeshherë e ashtuquajtura liri akademike është përcudnuar thjesht e vetëm në lirinë për të mbajtur një vend pune. Flitet shumë për lirinë akademike, por në universitetet tona vetëm liri nuk ka, liri në kuptimin e hapësirave të vërteta, të lirisë që sjell progres dhe dije, nuk ka dhe nuk ka ekzistuar në universitetet tona.

Ligji i ri krijon premisat për këtë liri nëpërmjet modernizimit të qeverisjes së brendshme universitare, duke i dhënë autoritet të qartë senatit akademik, mbi qeverisjen akademike të universiteteve dhe duke ua mbështetur punën me një strukturë administrative në shërbim të misionit.

Pra, rritet liria akademike, duke i fokusuar akademikët në detyrat akademike, pa zgjedhën e parave, emërimeve dhe tenderave, e ndërkohë rrisim cilësinë e administrimit, duke e mbështetur me administratorë profesionistë. Së

tretë, reforma synon të mobilizojë gjithë burimet shoqërore e institucionale në shërbim të arsimit si një e mirë publike. Ta bëjmë të qartë e ta ripërsërisim fort një jo të madhe. Jo, ky ligj nuk çon para publike drejt institucioneve private. Përkundrazi, shtyn financimin privat drejt arsimit publik. Reforma nxit rritjen e ofruesve të shërbimit publik ndaj arsimit të lartë. Ne besojmë dhe e kemi shprehur, se arsimi është një e mirë publike, dhe nëpërmjet këtij ligji kemi krijuar mundësitë që institucionet jofitimprurëse të arsimit të lartë të shndërrohen në ofrues publik të arsimit të lartë. Pra, bashkërendojmë institucionet publike të themeluara e të financuara nga shteti, me institucionet publike të financuara nga organizata private, të cilat nuk kanë qëllim fitimin. Krijojmë kështu mundësinë dhe vetëm mundësinë, nëpërmjet institucionit të arsimit të lartë publik të pavarur, të ofrojë më shumë shërbim publik, por edhe liri më të madhe.

Ky ligj sjell standardizim të të gjithë hapësirës dhe të aktorëve, sipas parimit: një kut, një masë, një sistem qeverisës, një set standardesh të trupëzuara në një kod cilësie, një sistem sigurimi cilësie, një sistem të unifikuar të kontrollit të ligjshmërisë, një sistemi të drejtë në konkurrencë të drejtë, që ofron arsim të lartë cilësor.

Modernizojmë kërkimin shkencor në universitete, duke e bërë një tregues të matshëm e të krahasueshëm të cilësisë së universitetit. E bëjmë këtë një kriter të rëndësishëm të financimit në universitet, duke i shtyrë universitetet që të kthehen në qendra të zhvillimit e të inovacionit. Ndajmë qartësisht dhe ridimensionojmë tre rolet e shtetit në arsimin e lartë: rolin rregullator si vendosës i standardeve dhe rregullave të funksionimit, por edhe si garantues i funksionimit të sistemit e të cilësisë, rolin e financuesit të sistemit të arsimit të lartë, duke financuar institucionet ofruese të shërbimit, por edhe duke mbështetur përfituesit, rolin e ofruesit të drejtpërdrejt të shërbimit nëpërmjet institucioneve të arsimit të lartë publik. Ridimensionojmë dhe ristrukturojmë agjencitë ekzistuese, duke i afruar me modelet më të mira evropiane dhe duke modernizuar shërbimet që ato ofrojnë. Krijojmë qendrën e shërbimeve arsimore, si një qendër unike, që ofron në mënyrë të përmbledhur të gjitha shërbimet për

nxënësit dhe studentët, pore dhe për institucionet e arsimore dhe trupat e profesioneve të rregulluara.

Kjo do të jetë një qendër model shërbimi personal, fizik dhe elektronik ndaj qytetarit, duke i dhënë një herë e përgjithmonë fund sagave të qytetarëve që zvarriten dyerve të institucionit për të zgjedhur universitetin apo për t'u regjistruar, për të ekuivalentuar diploma apo për të dhënë provimet e shtetit.

Krijohet agjencia e financimit të arsimit të lartë, si një ent i ri, që në mënyrë profesionale dhe të paanshme të financojë edhe universitetet publike e të mbështesë studentët nëpërmjet bursave të meritës, të nevojës apo të prioriteteve kombëtare. Riorganizojmë Agjencinë Kombëtare të Teknologjisë dhe Inovacionit, si një agjenci moderne të kërkimit shkencor dhe inovacionit, duke e bërë përgjegjëse jo vetëm për financimin e kërkimit shkencor, por edhe për vlerësimin e sasisë e të cilësisë së kërkimit shkencor që gjenerohet nga universitetet tona.

Kjo agjenci, gjithashtu, do të kthehet në një ent përgjegjës për bashkëpunimin ndërkombëtar, në kuadër të programit HORIZON 2020 të Bashkimit European për kërkimin shkencor.

Riorganizojmë agjencinë e akreditimit, duke e kthyer në agjencinë për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, dhe në bashkëpunim me agjencinë britanike të sigurimit të cilësisë, e bëjmë përgjegjëse jo vetëm për akreditimin, por edhe për vlerësimin e treguesve të performancës, nga ku do të varet edhe niveli i financimit të çdo institucioni të arsimit të lartë publik.

Me lejen tuaj, lejomëni ta mbyll këtë fjalë me një ndjesi tejet personale. Në fakt, si sot një vit më parë, kur morëm vendimin për mbylljen e tetëmbëdhjetë universiteteve, për pezullimin e trembëdhjetë të tjerave, dhe sigurisht lënien e detyrave për ato që do të lejonin, nuk qe e lehtë. Madje qe nga ato maloret më të vështira të jetës sime. Nuk lodha as publikun e askënd me kërcënime gjithfarëshe që vinin e vijnë nga qindra interesa të prishura që kishin lidhje me çdo gjë, por jo me arsimin. Besomëni, jam ndier më shumë ligsht dhe i kërcënuar, kur kjo foltore apo foltore të tjera janë përdorur për të gënjer se ne, siç i mbyllëm, i hapëm, apo i transformuam ato universitete. Kjo është një gënjeshtër e madhe. Ministria e Arsimit dhe e Sportit po fiton

gjyqet me këta sharlatanë, dhe ju thoni se i hapët apo i transformuat.

Jo nga këto, po për asnjë tjetër institucion të ri, Ministria e Arsimit dhe e Sporteve nuk ka dhënë asnjë licencë. Këta ish-ministra arsimit që janë këtu, e dinë mirë po aq sa dhe unë se sulmi nuk është mbrojtja më e mirë. Sot, në fakt, ndihem shumë mirë. Ndihem shumë mirë për procesin që ndoqëm, për punën përmirësuese që bëmë, ndërkohë që institucionet e arsimit të lartë ktheheshin në shinat e ligjit, për produktin që është vlerësuar nga pedagogë, po për produktin që është vlerësuar po aq edhe nga Brukseli.

Të dashur studentë e prindër!

Ju do të keni një sistem arsimor të pastër, të drejtpërdrejtë, por dhe të përgjegjshëm. Të tre këto elemente, cilësia, transparenca e përgjegjshmëria, janë investimi më i madh në favorin tuaj. Prindërit shqiptarë që kanë sakrifikuar përjetë për edukimin, kanë shansin që këtë sakrificë të madhe ta bëjnë kundrejt një cilësie krejt të re.

Të nderuar pedagogë!

Pjesë e reformës do të jeni edhe ju. Të gjithë ju. Padyshim, të gjithë ju. Ky ligj mundëson që shoqëria të mobilizojë më shumë burime financiare për edukimin në arsimin e lartë, fuqi dhe resurse nga të gjitha drejtimet, para publike dhe private. Donacione e biznese e kështu me radhë, do të krijojnë kushtet që kapaciteti i burimeve njerëzore të sektorit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor të rritet.

Pra, në këtë kuptim, nuk bëhet fjalë që dikush të dalë jashtë, por thjesht të gjithë duhet të përshtaten me standardet dhe dinamikat që sjellin konkurrencë e përgjegjshmëri.

Shumë ndër ju janë ankuar se jeni mbytur nga nepotizmi, klanizmi, lidhjet e vjetra, por sistemi i ri do ta çmojë përvojën, do t'i hapë rrugë garës në çdo drejtim, në çdo pikëpamje. Të gjithë do të garojnë brenda njësisë së vogël, brenda departamentit, fakultetit. Do të garoni për fondet publike. Do të garoni mes institucionit për t'u përshtatur me një sistem të ri, i cili garanton që më i afti, më i miri, të ecë përpara, të japë më shumë produkte për shoqërinë, për studentin.

Të nderuar partnerë të biznesit!

Qeveria e një republike demokratike nuk është gjë tjetër veç një arbitër mes aktorëve shoqërorë dhe interesave për të gjetur më të mirën e interesit të përgjithshëm. Ne kemi

vlerësuar, edhe me debatin që kemi realizuar bashkarisht, se me anë të kësaj reforme, një sistem më i mirë edukativ, i lidhur dhe në funksion të tregut, është qëllimi parësor.

Fort të nderuar parlamentarë!

Tani që jemi në pikën finale të gjithë këtij procesi dhe kthej kokën pas, jam akoma më shumë e bindur se keni përpara jo thjesht një dokument të ftohtë juridik, jo thjesht një grumbull rregullash normative, por një akt të lartë politik, i cili në çdo germë të tij mbart pasionin, devocionin, profesionalizmin, ndershmërinë, përgjegjshmërinë, këmbënguljen dhe, pa e tepruar aspak, edhe patriotizmin e të gjithë kontributorëve në bërjen e tij. Edhe tuajën, të dashur përfaqësues të opozitës parlamentare. E kam besuar që në fillim, e tani e besoj akoma më shumë, se ky akt do të jetë fillimi historik i përbuzjes së injorancës dhe përqaimit të dijës, si rruga e vetme dhe e detyrueshme për ne dhe popullin shqiptar drejt progresit.

Ndaj, më lejoni, të dashur kolegë, t'ju ftoj që me votën tuaj, të ecim ë bashku në rrugën e transformimit dhe rivendosi së cilësisë në sistemin tonë të arsimit të lartë.

Ju faleminderit!

Ilir Meta – Po. Faleminderit, zonja Ministre!

Atëherë, fjalën e ka deputetja Jorida Tabaku. Përgatitet deputetja Vasilika Hysi. Më pas deputeti Eduard Halimi.

Jorida Tabaku - Të nderuar kolegë deputetë,

Fort të nderuar kolegë pedagogë, që ndodheni sot jashtë sallës së parlamentit,

Të nderuar studentë, që jeni duke protestuar në këto momente,

Po kalojmë sot me shpejtësi një projektligj, që është jashtëzakonisht i kundërshtuar nga të gjithë aktorët kryesorë të tij, sigurisht, përveç porositësve dhe ekzekutuesve të tij.

Sot po diskutojmë një projektligj, i cili, në logjikë, duhet të përmirësojë sistemin e arsimit të lartë dhe duhet të ishte një katalizator në shërbim të komunitetit, një sistem referimi bazë për shoqërinë dhe për brezat që do të vijnë. Por ky bën pikërisht të kundërtën, shkatërron gjithçka të arritur deri më sot me mund e kujdes, pak nga pak.

Nuk mund t'i bëjë mirë një shoqërie një projektligj, i cili nuk reformon, por shformon,

duke qenë se në vetvete nuk reflekton asnjë njohje minimale ndaj situatës reale të gjendjes së arsimit të lartë. Por, në të kundërt, e gjuhëzohet arsimin e lartë përpara një grupi klientelist, anëtarët e të cilit janë edhe hartuesit e vërtetë të këtij projektligji.

Duhet pranuar se, me gjithë të metat tona si ish-maxhorancë, në raport me arsimin e lartë, ne asnjëherë nuk sollëm, mbrojtëm apo angazhuam një ushtri oligarkësh që të hartonte një projektligj për të shkatërruar arsimin e lartë, aq sa nesër në të gjitha supermarketet dhe në dyqanet e qoshkave do të kemi një diplomore. Nuk sollëm në këtë Kuvend asnjëherë një ligj, i cili të ishte antikushetues, jo vetëm në frymë, por thuajse në çdo nen të tij.

Si mund të mos jetë antikushetues një ligj, i cili që në premiset e tij është ndërtuar mbrapsht, madje i mungon filozofia dhe vizioni?! U nis si një draft i fshehtë, u maskua si një projektligj anglosakson dhe, pas presionit studentor e akademik, u shndërrua në një projektligj i ngjashëm me modelet europiane e më pas doli që ishte portugez, megjithëse, në thelb ai ishte, vazhdon dhe do të mbetet vetëm një ligj klientelist, i urdhëruar nga disa oligarkë, të cilët po bëjnë realitet atë që nuk guxuan ta bënin realist dje me ne!

Ky projektligj u nis me themele të gabuara, ndaj edhe bitisja e tij nuk është veçse një shpërfytyrim i autonomisë universitare. Duket që cenimi i autonomive është diçka që ju tërheq si qeveri, e nisët me autonominë e pushtetit vendor, vazhduat me atë të universiteteve, si për të na dëshmuar thënieën “Të gjithë pushtetet t’ia japim Kryeministrit”.

Nuk ka mundësi tjetër që një ligj, i cili në thelb kundërshton Kushtetutën dhe të drejtën për arsim, ta gjykosh si një e mirë publike, ndërkohë që ai, në raport me demokracinë në shoqëri, është deficitar, një ligj që autonominë e universiteteve publike e kontrollon përmes disa agjencive, të cilat askush nuk i kupton se produkt i kujt janë. A janë ato produkt i një drejtorie të Ministrisë së Arsimit, meqë, në fakt, emërohen prej saj, apo janë drejtori tërësisht të pavarura? Nëse janë të pavarura, mos ndoshta do të zgjidhen nga Kuvendi e do të raportojnë në Kuvend? Nëse ato janë drejtori të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, atëherë le të pranojmë që Ministria e Arsimit do të kontrollojë jetën

akademike, jo vetëm të universiteteve publike. Le të pranojmë se janë një dikaster i Ministrisë së Arsimit, me persona të emëruar nga ajo ministri apo dhe nga Kryeministri, pak rëndësi ka, agjenci që do të jenë jo vetëm kontrollues të universiteteve, por, ndër të tjera, edhe se kush, si, në ç'mënyrë dhe çfarë roli do të kenë universitetet. Në cilin vend demokratik të Europës keni parë një ministri që me një sy kontrollon, me një sy vëzhgon dhe me dorën e saj godet një entitet autonom si universiteti? Në cilin vend të botës ju keni parë një ministri që gjykon për procedimin e leksioneve, gjykon për titujt akademikë, gjykon për kurrikulën, gjykon për administrimin, për fondet? Në mos qofshin të tilla këto agjenci, nëse ne po i shpikim këto funksione, atëherë çfarë janë?! Entitete pa një status juridik, për të cilat është e panjohur edhe vetë Kushtetuta?!

Që në këtë moment arrijmë të kuptojmë se kjo reformë e pretenduar nga zotërinjtë qeveritarë nuk është produkt i universiteteve dhe pedagogëve.

Unë e nderuara, zonja Ministre, për një vit e gjysmë kam diskutuar për këtë reformë. Kam ngritur zërin tim. Kam shkruar, kam debatuar edhe në Kuvend, edhe në komisionet parlamentare. Kam takuar edhe ata pedagogë që kanë qenë në komisionin e reformës, të cilët, të zhgënjyer nga ju sot, po përballen me një variant të dytë, i cili është totalisht i ndryshëm nga varianti i parë.

Gjithashtu, kam lexuar me kureshtje të gjitha komentet që kanë dhënë senatet akademike të fakulteteve, të publikuara në faqet e tyre, dhe nuk gjeta një vendim të vetëm që të ishte unanim me të gjitha nenet e këtij ligji. Nuk gjeta asnjë mendim që të mbështeste filozofinë e këtij projektligji dhe të ishte dakord me të.

Si mund të flisni për siguri të autonomisë, kur, në rastin më të mirë, ushtarët e emëruar nga ministria do të përbëjnë shumicën në bordet drejtuese, kur funksionet e senatit akademik tjetërsohen, duke e vendosur këtë të fundit nën thundrën e një bordi, që, siç kuptohet nga ligji, do të jetë i përbërë nga anëtarë të emëruar nga qeveria? Ky kontroll mund të krahasohet, fjala vjen, me një parlament, që është nën varësinë e qeverisë dhe jo anasjellas (neni 37). Gjithashtu, në nenin 48 i jepet më tepër autoritet bordit, i cili, hera-herës, merr më shumë fuqi se senati,

duke u shndërruar kështu në një pushtet më të fortë sesa ekzekutivi.

Ky ligj ka qartësisht për qëllim nënshtrimin e universiteteve publike ndaj vullnetit të qeverisë, një dëshirë qeveritare, e cila ka si qëllim jo vetëm të zhdukë njëherë e mirë autonominë e universiteteve, por të zhdukë lirinë akademike dhe të menduarit lirisht në universitete. Ky është dëmi më i madh që mund t'u bëhet jo vetëm universiteteve, por, në fund të fundit, edhe shoqërisë sonë!

Përmes bordeve famëkeqe, kjo qeveri do të vendosë nën hyqëm lirinë akademike, lirinë financiare, lirinë organizative e vendimmarrëse. Përmes këtyre bordeve dhe përmes rregullave antikushtetuese dhe antieuropiane, kjo qeveri po përpiqet që të instalojë censurën. Sa shanse do të ketë, zonja Ministre, sikur nesër t'ju vijë një punim shkencor, i cili flet për zullumet që sistemi juaj i taksimit ka bërë këta dy vjet? A do ta financoni ju këtë?

Nuk ka asnjë shans që ky të kalojë si një punim shkencor, megjithëse sot ndonjërit prej jush mund t'i duket qesharake, por ju siguroj që kjo do të jetë e vërteta dhe kështu do të përfundojë liria dhe demokracia universitare

Ai ligj që ju keni sot përpara, i jep pushtetin e gjykimit të lirisë akademike ministrisë. E fundja, ç'kishte më shumë Tefta Cami se ministrja e sotme?

Të nderuar kolegë,

Ky është një projektligj që në thelb nuk është vetëm klientelist, megjithëse aktorë të paguar sa nga rrogat qeveritare, ashtu edhe nga honoraret private, e shesin atë si një ligj që do të liberalizojë tregun. E si mund ta quash liberalizim këtë ligj, i cili gjymton me të gjitha mënyrat universitetet publike, duke e përdhosur rregullin numër një të tregut të lirë "Sigurimin e konkurrencës së ndershme", duke u dhënë paratë e taksapaguesve tanë universiteteve private, të cilave u siguron një parajsë në të gjitha drejtimet dhe më pas u jep mundësinë që, përmes parave dhetributeve e statuseve të veçanta, ato të kenë mundësi të blejnë dhe të përdorin, sipas qejfit të tyre, universitetin publik? Ky nuk është liberalizëm, ky është klientelizëm dhe mes liberalizmit dhe klientelizmit është një ndasi shumë e madhe, aq e madhe, sa filozofia që na ndan ne me ju.

A do të ketë më shumë para në dispozicion, që të paktën të mos preken pagat e universiteteve publike?! A na siguron kush se tarifatat e universiteteve publike nuk do të rriten më shumë se shifra stratosferike prej 35 milionë dollarësh në vit, që keni parashikuar në buxhetin e shtetit? A na siguron kush që universitetet publike do të kenë mundësi të ofrojnë ende arsimin universitar si e mirë publike pa e cenuar cilësinë, pa detyruar që të rriten tarifatat, pa i detyruar që të ofrojnë shërbime nga më të ndryshmet për të siguruar të ardhurat, pa i detyruar që t'i nxjerrin asetet dhe aktivitetet e tyre në treg?!

Duhet të keni parasysh, të nderuar kolegë, se projektligji, të cilin qeveria e ka sjellë me kaq nxitim dhe pabesi për diskutim, është shkelëse e barazive qytetare, sepse ai qartësisht diskriminon të varfrit. Është diskriminues, sepse qeveria ka vendosur që, përpara hyrjes në fuqi të ligjit, të rrisë tarifatat e studimit edhe për universitetet publike, dhe këtë gjë e ka vendosur për këtë vit akademik e për dy vjetet e ardhshëm akademikë.

Pikërisht kështu, nuk është vetëm klientelist, por është diskriminues dhe antisocial.

Qeveria, që erdhi në emër të drejtësisë sociale, qeveria që hiqet se ka vendosur një sistem taksimi të ndershëm, ku i pasuri paguan më shumë se i varfëri, ka vendosur që tarifatat e studentëve sot të jenë 30% më të shtrenjta sesa dje dhe me këtë ligj legalizon rritjen e tyre në vijim.

A tyre studentëve apo familjeve që nuk e përballojnë dot koston e lartë të arsimit, qeveria socialiste, qeveria e drejtësisë sociale, e taksimit të drejtë e kështu me radhë, nuk e di sa mbiemra mund t'i vë, u ka bërë gati borxhin studentor, një borxh që citohet në nenin 112, por që askush nuk ka denjuar të sqarojë sesi do të trajtohet. Askush nuk di të thotë sesi do ta shlyejnë nesër studentët pagesën prej 3 mijë e më shumë eurosh për studimet Bachelor?! E kjo ndodh, sepse grupi i punës së këtij projektligji nuk u lodh asnjëherë të bënte analiza për tregun e punës, të studionte se cilat janë nevojat e tregut dhe degët që kanë nevojë për stimulim. Cilët studentë punësohen më shumë?! Cilat degë duhet të kenë prioritet?! Të gjitha këto duhej të ishin baza e këtij projektligji dhe baza e një analize që qeveria duhet të kishte bërë.

Në kulmin e papunësisë, ku vetëm shifrat në fjalimet e ministrave flasin për rritje ekonomike,

qeveria u var në qafë studentëve dhe familjeve të tyre një tjetër tarifë shtesë.

Në kulmin e një buxheti, që do reduktohet fshehtas sërishmi, qeveria, me një grant më të ulët sesa ka premtuar, do të vendosë në konkurrim privatit e forcuar dhe publikun, i cili me këtë ligj e ka sakatuar, një konkurrencë kjo e pandershme dhe aspak liberale.

Një filozofi etatiste, ku shteti kontrollon gjithçka, me njohuri të mangëta e të cekëta për sa i përket mënyrës sesi funksionon sistemi i arsimit të lartë, me një gjuhë të varfër, me varfëri e kundërshti në koncepte, me probleme ligjore, me mangësi në vizion, me shkelje të ligjit e të Kushtetutës e sa e sa probleme të tjera.

Ky është realiteti i këtij projektligji, i cili penalizon mobilitetin e studentëve, që nuk ofron mundësi të barabarta, por dënon të pamundurit me një borxh, që do u duhen breza për ta paguar, që e trajton arsimin publik si një mall tregu çam dhe jo si një vlerë për shoqërinë tonë. Këto janë arsytet pse dje, sot dhe për një vit e gjysmë kam qenë në krah të studentëve dhe pedagogëve, të cilët sot janë jashtë duke protestuar.

Përpara se ta mbyll, dua t'ju kujtoj, dhe nuk dua të harroni, se përballë këtij projektligji, si kundërshtarë të tij nuk keni vetëm opozitën partiake të Partisë Demokratike, keni plot 140 pedagogë, qindra studentë që janë jashtë kësaj sale, duke ju kërkuar llogari për arbitraritetin, për verbërinë tuaj dhe mbi të gjitha për guximin që keni pasur me votat tuaja për të fundosur arsimin publik.

Sot, u kërkoj kolegëve socialistë, që janë pedagogë në universitete, të ngrihen mbi përcaktimet partiake. Nuk do t'ju drejtohesha me këto fjalë, në qoftë se vetë nuk do ta kisha bërë dje, sot dhe nesër, në çdo moment, sa herë që bëhet fjalë për arsimin publik.

Ju mund ta miratoni sot këtë ligj, duke i shkelur me këmbë universitetet publike, por nuk mund të na ndaloni ne të vazhdojmë betejën ligjore, etike dhe morale për një arsim publik të ndershëm, jopartiak, të pavarur e që gjeneron shkencë, një arsim publik të disponueshëm për të gjithë, si një e drejtë dhe jo si privilegj!

Faleminderit!

Ilir Meta - Fjalën e ka kërkuar ministrja Nikolla.

Lindita Nikolla - Faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuara zonja deputete,

Bëtë një pyetje, që për moshën dhe kulturën që pretendoni se keni, nuk është korrekte. Unë nuk do të tregoj se ku ndahem dhe ku ndryshoj nga shumë të tjerë, por dua të tregoj se ku ndahem nga ju personalisht.

Që të kuptoni se sa shumë ndahem nga ju personalisht, është një gjë fare e thjeshtë. Hajdeni këtu para kësaj foltore dhe përfaqësoni brezin tuaj, tregoni edukimin dhe gjithçka tjetër, duke folur me të vërteta.

Fund e krye gënjet. Fund e krye thatë të pavërteta të mëdha, që nuk kanë të bëjnë me këtë projektligj. Por, që të më sfidoni në gjithë këtë që unë thashë për ju, sigurisht, me dhimbje, ju lutem tregojuni shqiptarëve se kush janë klientelistët, kush janë oligarkët e me radhë e me radhë të gjitha etiketimet që ju thatë. Tregojuni dhe më mundni këtu publikisht: kush është Arjan Gjonçaj? Kush është Besnik Aliaj? Kush është Myftar Barbullushi? Kush është Dhurata Bozo? Kush është Ervin Demo e gjithë të tjerët e komisionit që unë i përshëndes dhe i falënderoj përzemërsisht?

Unë nuk e di kush janë klientelistët. Moneja, për shembull, erdhi në Shqipëri, foli, i mbledhi të gjithë rektorët dhe përfaqësuesit e universiteteve për të thënë që ky është një ligj frymëzues, pikërisht për ato që ju gënjet, ndërsa i nënvizoi si një vlerë të Shqipërisë, si një vlerë të kësaj reforme, vizionin, procesin dhe gjithçka tjetër që sjell të autonomi dhe liri akademike.

Kush është klientelist? Profesi i nderuar Onagi, rektori i Universitetit të Milanos? Ai thotë: “Reforma në arsimin e lartë ka, sipas mendimit tim, karakteristika pozitive. Dispozitat janë shkruar me qartësi dhe saktësi. Rruga e zgjedhur, ajo e rinovimit të sistemit universitar, duke parë drejt së ardhmes, është politikisht e vështirë. E di që është politikisht e vështirë, por unë, personalisht, pavarësisht nga vështirësitë, mendoj se kjo rrugë që ka zgjedhur Shqipëria, është rruga më e preferueshme sesa thjesht riorganizimi i sistemit ekzistues. Në qoftë se ju shikoni zhvillimin e mundshëm të Shqipërisë dhe funksionimin e saj evropian, si një pjesë e konsiderueshme e Ballkanit, kjo reformë është e domosdoshme.”

Ky është klientelisti? Ky është sharlatani? Ky i ka të gjitha ato etiketimet?

Ju thatë të pavërteta. Por, në fakt, treguat një të vërtetë tjetër, që ju nuk e keni lexuar fare ligjin, sepse iu referuat nenit 12, nuk është neni 12, zonjë e nderuar, është kapitulli 12.

(Diskutime pa mikrofon.)

Aq më keq, e thelloni gënjeshtren tuaj dhe faktin që nuk e keni lexuar ligjin.

Në qoftë se i referohesh kapitullit 12, ja ç’ka thënë një studiues i nderuar britanik, profesori Stiv Bristoll: “Unë i vlerësoj me shumë pozitivitet dispozitat e bëra në kreun 12 për krijimin e institucioneve publike të pavarura të arsimit të lartë dhe rolin udhëheqës që luan bordi”, ai bordi i administrimit që ju anatemuat aq fort, treguat edhe një herë se gjithçka që thatë jo vetëm nuk janë në mendjen e ministres së Arsimit, të qeverisë shqiptare apo të atyre që hartuan ligjin, por janë vetëm në mendjet tuaja, sepse jeni të gatshëm t’i bëni ato çdo çast dhe çdo minutë.

Të lutem, zonjë e nderuar, kujdes me të vërtetën, sepse aty ndahemi vite drite larg me njëra-tjetrën!

Ilir Meta - Po, zonja Tabaku.

Ju lutem respektoni kohën e replikës!

Jorida Tabaku - Në fakt, nuk më pëlqen të bëj replika personale me ministren, sepse na ndajnë vite drite larg edhe për dashurinë ndaj sistemit publik, të cilin e kam zgjedhur gjatë gjithë arsimit tim, ndërkohë që ministria jo.

Zonja Ministre, ju referova nenit 112 për kredinë studentore, e shkruar e zeza mbi të bardhë: “Kredia studentore për të cilën Ministria përgjegjëse për Arsimin ndërmjetëson kreditimin e studentëve me qëllim mbështetjen financiare për përballimin e kostove të studimeve”. Nuk e di nëse gënjeva kur thashë se ky nen nuk është i detajuar. Nuk e di, nëse gënjeva kur thashë se ju kërkuam të na sqaronit dhe nuk na sqaruat. Nuk e di nëse gënjeva kur thashë që studentët nesër ndoshta mund të marrin edhe kredi me kushte tregtare.

Më lejoni të lexoj disa citime nga profesori shumë i nderuar, zoti Jan de Grof: “Dimensioni evropian është trajtuar shumë dobët në kapitujt e këtij libri. Konceptet bazë të autonomisë universitare dhe të lirisë akademike nuk pasqyrohen drejt. Projektligji është i bazuar në qasje etatiste, pra që është shteti në qendër dhe jo universiteti. Projektligji nuk përputhet me parimet e qeverisjes së mirë. Për sa i përket

teknikës legjislative, dokumenti është shumë i detajuar në disa aspekte dhe në të kundërt mungojnë aspekte vitale. Mungon auditimi dhe llogaridhënia. Paratë publike duhet të shkojnë për universitetet publike”. Këto nuk i kam thënë unë, por i ka thënë një profesor shumë i nderuar, të cilin e cituat edhe ju herën e kaluar, nëse të pëlqen të flasësh për të vërteta, nëse do të lexojmë fjalimet e përgatitura që ju referoheni varianteve të ligjit kohë më parë, sigurisht që është e drejta juaj.

Në fjalën tuaj bëtë edhe një ngatërrim shumë të madh, ndoshta të qëllimshëm, filluat dhe përmendët të gjithë pedagogët e reformës së arsimit të lartë, duke ngatërruar ata që kanë qenë pjesë e këtij grupi dhe duke i përzier me klientelën, ndoshta nuk ishte i qëllimshëm apo i qëllimshëm, këtë e dini ju. Klientela është ajo që përmendët ju herën e kaluar në parlament dhe nuk e përmenda unë. Ju u ngritët këtu dhe deklaruat se cilët janë universitetet që kanë marrë diploma doktore. Ju i përmendët emrat. Meqenëse i dini dhe i mbron, vazhdoni t'i mbron!

Ilir Meta – Po, zonja Ministre!

Lindita Nikolla – Për sa i përket të vërtetës, vetëm në respekt të së vërtetës, për të kuptuar edhe një herë se ku ndahemi në universitetin publik dhe në arsimimin.

Zonjë e nderuar, kam mbaruar Fakultetin e Shkencave të Natyrës në vitin 1989. Nëse i referohesh diçkaje që e kam shkruar personalisht dhe që qeveria jua, ish-Kryeministri Berisha e ka trumbetuar me të madhe si një nga sukseset e asaj qeverie, në fakt ishte një program që drejtohej nga profesorë shumë të nderuar, kur unë drejtoja pushtetin vendor dhe dija mund të merret kudo nga vjen, bëni gabim. Po e përsëris edhe një herë: dashuria është e njëjtë për dijen, ndërkohë që përgjegjësia është e njëjtë për të gjitha institucionet në detyrën e ministres së Arsimit ku studiojnë fëmijët e shqiptarëve.

Zonjë e nderuar, cituat profesorin e nderuar Jan De Grooff, i cili po të njëjtat vërejtje ka bërë për ligjin tuaj: “Reflekton modelin e kontrollit të shtetit mbi sistemin e arsimit të lartë. Shumë nene të projektligjit nuk janë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me parimin e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe me standardet europiane. Po i njëjti person që ju cituat, ka dhënë këto konkluzione

për ligjin tuaj. “Ligji i jep fuqi të tepruar ministrisë dhe Këshillit të Ministrave. Nuk ka kufizime në përcaktimin e të drejtave të ministrisë, nuk ka garanci për pavarësinë e procesit të akreditimit, nuk përmban masat për ndërtimin e besimit. Ligji përmban diskriminimin, shpreh mungesë besimi ndërmjet aktorëve. Ligji përmban standarde të dyfishta, të cilat shkelin hapur parimet e autonomisë universitare dhe lirisë akademike. Ligji shkel parimet e kolegjalitetit mbi të cilat bazohet funksionimi i institucioneve të arsimit të lartë. Dispozitat ligjore nuk kanë koherencë dhe krijojnë problem në zbatimin e tyre. Gjuha e përdorur ligjore lë hapësirë për paqartësi, keqinterpretim, subjektivizëm dhe me radhë”. Pra, është i njëjti profesor që citoni ju në analizën që i bën draftligjit të datës 21.05.2007.

Zonjë, më lejoni në respekt të së vërtetës, por edhe tuajën, për t’ju ndriçuar deri në fund, po citoj një fjali: “Ne po përpiqemi të vendosim një sistem të ri në financimin e arsimit, sipas të cilit para nga ndjek studentin, ndjek performancën e tij, pavarësisht ku ndodhet në universitet publik apo privat”, është fjala e ish- Kryeministrit Berisha më 22 maj të vitit 2010.

Sa për sqarime të tjera ku ju referuat klientelizmin, thuajeni troç: ju shihni si klientelë Universitetin Europian të Tiranës, unë e shikoj si një institucion, të cilin e kam kontrolluar me gjithë detyrat që më nje ligji. Kemi lëmë detyra, disi duke shkelur ligjin, zero studentë të doktoraturës me ardhjen e qeverisë “Rama”.

Bëni kujdes dhe analizoni, gjithçka që thoni, sepse e vërteta ju bie në kokë.

Faleminderit!

Ilir Meta- Zonja Tabaku, 30 sekonda dhe ta mbyllim këtë debat.

Jorida Tabaku – Meqenëse duhet të ndriçohesha, u ndriçova dhe reflektova.

Ministrja, në fakt citoi kritikën në lidhje me ligjin e mëparshëm, por sot kishim ardhur të diskutonim këtë projektligj. A kishte nevojë për përmirësim ligji “Për arsimin e lartë”? Sigurisht që po. Problemi juaj është se vazhdoni të jetoni dhe të krahasoheni me të shkuarën. Krahasoheni ende se çfarë ndodhi në vitin 2005, në vitin 2008. Po ju them diçka, sepse nuk dua ta zgjas diskutimin: kam këtu të gjitha premtimet e Partisë Socialiste për programin e arsimit të nxjerrë nga kapitulli i arsimit për arsimin e lartë,

ku qeveria zotohet se do të rrisë financimin e arsimit të lartë, duke rritur financimet që shkojnë drejt sistemit publik dhe duke mundësuar cilësinë që ai ofron, duke siguruar autonomitë e universiteteve në njësinë bazë, duke rritur kapacitetet e kështu ma radhë. Të gjitha këto sot janë zero.

Ilir Meta – Fjalën e ka deputetja Vasilika Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Sot diskutohet një nga ligjet më të rëndësishme dhe të diskutueshme në publik, ligji i arsimit të lartë dhe i kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë.

Projektligji është hartuar nga një grup ekspertësh. Ai i është nënshtruar një konsultimi të gjerë publik nga qeveria, i është nënshtruar seancave dëgjimore dhe diskutimeve në komisionet parlamentare, përfshirë edhe atë të Ligjeve. Arsimi juridik si pjesë e arsimit të lartë iu nënshtrua diskutimeve dhe konsultimeve nga grupi i ekspertëve të lartë të reformës në drejtësi.

Një sërë çështjesh u diskutuan në Komisionin e Ligjeve lidhur me lirinë akademike, autonominë financiare dhe organizative të institucioneve të arsimit të lartë, si edhe për kapitullin shumë të debatuar për një formë të re të organizimit të institucioneve të arsimit të lartë, që quhen institucione të arsimit të lartë publike të pavarura që mund të krijohen të reja ose si transformim i atyre ekzistuese, por që janë të panjohura në praktikën shqiptare dhe të parregulluara deri më sot nga kuadri ligjor në fuqi.

Kolegia parafolese mund të kishte folur shumë për këtë formë të re organizimi, por jo për ato që përmendi. Të them të drejtën, ato nuk qëndrojnë në projektligjin “Për arsimin e lartë”, pasi ato që tha për arsimin e lartë nuk janë ashtu, por janë komplet ndryshe. Ka një sërë risish të cilat duhet të vlerësohen.

Ky ligj për herë të parë rregullon ndryshe arsimin, nuk sjell vetëm një shfuqizim të ligjit ekzistues, por bën me të vërtetë një reformim total të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë.

Të nderuar kolegë, më lejoni të ndalem në një pikë të veçantë në një risi që sjell ky ligj që nuk e kemi pasur në ligjet e mëparshme as në atë të vitit 2007. Sot flasim për studimet në shkencat

juridike në shumë universitete perëndimore që hyjnë në ato programe studime për të cilat studentëve u duhet të studiojnë dhe të punojë shumë, të kalojnë ditë dhe netë të tëra pa gjumë deri në diplomimin e tyre. Krejt ndryshe kanë qenë këto studime në shkencat juridike në universitetet apo në fakultetet e drejtësisë në Shqipëri.

Pse ndodh kjo? Praktika 23-vjeçare në Shqipëri tregoi se me një kurs 6-mujor veror, buzë bregdetit të Durrësit mund të bëheshe jurist, gjyqtar, prokuror dhe drejtues i lartë në sistemin e drejtësisë.

Për shumë vite, para dhe pas rënies së murit të diktaturës, krahas studimeve me kohë të plotë, ka pasur programe të studimeve me kohë të pjesshme, shpesh si një mundësi për të marrë një formim vazhdues plotësues. Kjo është një gjë normale, shumë e mirë, por në të shumtën e rasteve për të ndjekur studime si degë e parë dhe për ta përdorur këtë shkollim me orar të reduktuar për të zënë pozicione në funksione të larta publike në institucione të ndryshme shtetërore. Por deri më sot ka një sërë paradoksesh në arsimin juridik në Shqipëri.

Masivizim të jashtëzakonshëm të institucioneve që ofrojnë këtë arsimim dhe një numër jashtëzakonisht të madh të studentëve që diplomohen si juristë. Nuk ka një analizë të tregut të punës me numrin e studentëve që pranohen në institucionet e arsimit të lartë publik ose jopublik.

Kriteret e pranimit janë të ndryshme për studentët në fakultetet publike dhe jopublike, mjafton të kenë përfunduar maturën shtetërore. Matura shtetërore jo gjithnjë solli studentët më të mirë në fakultetet publike, ndërkohë që të tjerë ndëshkoheshin goftë për një pikë dhe detyroheshin të paguanin shkollimin e tyre për shkak të vlerësimeve joreale të maturës shtetërore dhe detyroheshin të paguanin shuma të majme, ashtu siç tha edhe kolegia në fakultetet jopublike për të vazhduar shkollimin.

Nuk ka kriteret të veçanta të konkurrimit për të bërë përzgjedhjen e kandidatëve në ciklin e parë të studimeve.

Kërkimi shkencor në të shumtën e rasteve bëhet nga profesorët jashtë orarit të punës së përditshme, duke paguar shpenzimet e kërkimit nga paga e tyre mujore, përfshirë edhe

pjesëmarrjen në konferenca dhe kongrese ndërkombëtare.

Këto janë disa nga shqetësimet që unë përmenda, por ka edhe shumë të tjera, të cilat adresohen në projektligjin e ri “Për arsimin e lartë” dhe kanë pasur vëmendjen e duhur nga të gjithë ne që vijmë nga jeta akademike, qoftë në komisionin tonë apo edhe në komisionin përgjegjës, në atë të Edukimit.

Kam ndjekur me vëmendje reagimet e kolegëve të universiteteve publike. I mirëkuptoj, sepse çdokush ka të drejtë të shprehë mendimin e tij, të dëgjohet dhe të vlerësohet, por nuk arrij të kuptoj një pjesë të kolegëve të opozitës që flasim në tryeza sikur kanë qenë tërë jetën në opozitë, sikur nuk kanë qenë në pushtet dhe nuk kanë pasur një ligj për arsimin e lartë që u debatua dhe u bë objekt diskutimi në Gjykatën Kushtetuese dhe sikur nuk ishin qenë fare në komisionet parlamentare kur u diskutua ky projektligj për orë dhe orë të tëra.

Ju lutem, hapni procesverbalet e mbledhjeve dhe lexoni angazhimin, seriozitetin e çdo deputeti në diskutimet, shqetësimet që erdhën nga kolegët, si edhe nga studentët e universiteteve publike anëmbanë Shqipërisë!

Edhe ne deputetët e kësaj maxhorance kemi diskutuar me përgjegjësi dhe me një frymë kritike, madje shumë më kritike sesa ju, por për ta bërë ligjin më të mirë, për të bërë një ligj të qëndrueshëm, sepse nuk mendojmë që ky ligj bëhet për këtë maxhorancë, por bëhet për të mirën e të gjithë studentëve dhe të gjithë universiteteve publike dhe jopublike.

Të nderuar kolegë,

Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj se në 10 vjetët e fundit në pamundësi për të krijuar hapësira për punësim në tregun e punës për të rinjtë e shkolluar, brenda dhe jashtë vendit, ju ofruat formime profesionale vazhduese në fushat ku nuk kishte nevojë tregu i punës. U synua masivizimi i arsimit të lartë publik dhe privat vetëm për të mos pasur telashe me njerëzit që kërkonin punë.

Në vitin 2003 kishte vetëm dy fakultete publike dhe dy departamente të krijuara në institucionet private që jepnin arsim juridik.

Kolegë të opozitës,

Në harkun kohor të tetë vjetëve të qeverisjes suaj, ju lejuat hapjen e 44

institucioneve të larta jopublike, ku kishte 22 fakultete ose departamente juridike.

Pyetja që shtrohet është: sa para dhe sa të mira të tjera materiale, (sepse ka pasur fakultete ku studentët paguanin në natyrë me bagëti, me vezë, me fruta dhe shërbime, por mos t’ua përmendim emrat atyre fakulteteve) u mblodhën nga tarifat e studentëve që ua morën xhepave të familjarëve të tyre që donin t’i shkollonin fëmijët në një degë të preferuar, por nuk arrinin qoftë edhe për një pikë, ose që nuk donin t’i shkollonin në degë që nuk kishin matematikë, kimi, fizikë, sepse nuk ishin të mirë të shkencat e natyrës? Asnjëri, nuk ka bërë një llogari të tillë për firma të tilla që disa prej tyre mund të quhen edhe piramidale. Pavarësisht se një pjesë e tyre qofshin apo jopublike ofrojnë studim me nivel të lartë shkencor.

Numri i lartë i studentëve që kanë nxjerrë fakultetet juridike në 44 institucione jopublike, nga të cilat 22 kanë fakultete, nuk përkon me vendet dhe me nevojat që ka sistemi në Shqipëri.

Më lejoni t’ju përmend se ne kemi 402 gjyqtarë në të tri nivelet, 907 vetë staf administrativ në të gjitha gjykatat, 62% e gjyqtarëve vijnë direkt nga Magjistratura. Ne kemi 336 prokurorë, nga të cilët 153 janë oficerë të Policisë Gjyqësore. Ne kemi gjithsej 2098 avokatë aktivë, 450 noterë, 57 përmbaues shtetërorë, 230 privatë, nga të cilët 150 aktivë.

Këta mijëra studentë, që janë shkolluar, përse i kemi shkolluar? Pra, çfarë u kemi ofruar? U kemi ofruar dije, kulturë, apo thjesht i kemi lehtësuar ata që të merren me një arsimim, pavarësisht se nuk ofrohet vendi i punës?

Të nderuar kolegë, unë do të doja të theksoja 4 risi që sjell ligji në fushën e arsimit juridik:

E para, arsimi juridik në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, që ofrojnë programe në arsim, do të ketë programe të integruara të ciklit të dytë. Pra, nuk do të ketë më arsim trevjeçar, bachelor dhe menjëherë studentët të futen në punë edhe në administratë publike.

Arsimi do të zgjasë jo më pak se 5 vjet, nga tre që është sot. Sot në administratë publike kemi punësuar juristë me bachelor, që nuk kanë përfunduar ende masterat dhe janë studentë me master, qofshin në fakultete publike dhe

jopublike, dhe kjo është administrata që do të çojë Shqipërinë në BE.

Së dyti, të gjithë ata që duan të vazhdojnë kualifikimet, pra, t'i nënshtrohen konkurrimit për gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë; ata që duan të punojnë në Avokaturën e Shtetit, noterë, përmbarues privatë e shtetërorë dhe të gjithë ata që duan të punojnë juristë në administratën qendrore-vendore duhet të japin provimin e shtetit në drejtësi.

Pra, me këtë ligj merr fund dhënia e një teme që mund ta përgatisë edhe një zyrë avokatie noterie kundrejt pagesës dhe studenti ta paraqesë si mënyrë për të mbrojtur diplomën e tij.

Së treti, të gjitha institucionet e arsimit të lartë, që do të ofrojnë programe të studimit të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, e fillojnë zbatimin e programeve të integruara në vitin akademik 2017-2018. Pra, u kemi dhënë mundësinë fakulteteve, qofshin publike dhe jopublike, për të bërë azhornimin dhe përgatitjen e programeve të reja të integruara, duke u dhënë kohën e mjaftueshme dhe jo duke i bërë me nxitim.

Së katërti, provimit të shtetit do t'i nënshtrohen të gjithë ata që kanë përfunduar studimet nga viti 2006 -2007 dhe që janë në kërkim të punës.

Kolegë, unë përmenda disa nga ndryshimet që sjell ligji për arsimin e lartë juridik, pasi kemi ndër mend të kryejmë reformën në drejtësi dhe me këto amendime dhe përmirësime, që i janë bërë ligjit në Komisionin e Ligjeve dhe në Komisionin e Edukimit, ne fillojmë edhe zbatimin e një elementi nga grupi i ekspertëve të lartë të reformës në drejtësi. Ligji ofron edhe më shumë liri akademike, autonomi financiare - organizative, por që një gjë e tillë të bëhet realitet, është e rëndësishme se si fakultetet do të zgjedhin autoritetet drejtuese, stafet, si do të përfshihen ato në kërkimin shkencor.

Të nderuar kolegë, ky ligj ka shumë të reja. Suksesi i këtij ligji varet nga 4 elemente:

E para, se si do të zbatohet ligji nga të gjitha strukturat e reja që krijohen me ligj.

E dyta, nga krijimi i një mjedisi real, që do të mundësojë konkurrencë të drejtë në institucionet e arsimit të lartë.

E treta, nga stafet akademike që punojnë në institucionet e arsimit të lartë dhe angazhimi i tyre.

E katërta, sa buxhet do të japë qeveria për arsimin e lartë dhe sa do të miratojmë ne këtu në Kuvendin e Shqipërisë.

Si një pedagog me përvojë 30- vjeçare në Universitetin e Tiranës, që i kam kaluar të gjitha shkallët e karrierës akademike dhe të menaxhimit, përfshi edhe senatore në bordin e administrimit të universitetit, do të vlerësoja hapësirat që krijohen në ligj, por do të vlerësoja edhe cilësinë e akteve nënligjore, që do të dalin; qartësinë dhe transparencën e tyre, kriteret profesionale dhe personalitetin e personave, që do të punojnë në agjencitë që do të krijohen; krijimin e një mjedisi mbështetës për arsimin si shërbim publik për studentët më të mirë, që hyjnë në universitete për meritë dhe jo për prindërit e tyre, që kanë lekë dhe mund t'i çojnë në çdo lloj universiteti.

Unë kam besim se kolegët e mi në institucionet e arsimit të lartë, sidomos në fakultetet e drejtësisë, do të angazhohen maksimalisht për të reformuar tërësisht arsimin juridik dhe në këtë mënyrë do të kontribuojnë në forcimin e shtetit të së drejtës, të ekonomisë, në sistemin e drejtësisë së Shqipërisë dhe në respektimin më të mirë të të drejtave të njeriut të Shqipërisë.

Faleminderit!

Ilir Meta – Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Eduard Halimi.

Eduard Halimi – Zoti Kryetar i Kuvendit, Zonja deputete, zotërinj deputetë,

Pak ditë më parë në seancën e fundit pati një tension politik gati të pakuptimtë. Në kundërshtim të hapur me Rregulloren e Kuvendit, edhe pse komisionet parlamentare nuk e kishin përfunduar shqyrtimin e projektligjit "Për arsimin e lartë", edhe pse të gjithë në këtë sallë nga i pari i Kuvendit, deri tek i fundit, e dinim se neni 70 i Rregullores nuk e lejonte kalimin e ligjit në seancë plenare, u krijua një tension i jashtëzakonshëm, pasi Kryetari i Kuvendit dhe maxhoranca kërkuan me insistim të futej në axhendën e asaj seance.

Tensioni politik dëmton reformat, kishte thënë dy ditë më parë, zoti Schulz, President i Parlamentit Europian. Madje e këshilloi edhe Ramën, edhe maxhorancën këtu në syrin tonë që të mos jenë arrogantë me votat dhe të mos krijojnë tensione politike të panevojshme.

E vërteta është se Rama kërkonte të krijonte një tension, siç është po aq e vërtetë se projektligji u shty vetëm e vetëm me ndërhyrjen e partnerëve ndërkombëtarë. Dhe ja ku jemi sot në një seancë plenare tërësisht atipike. Nuk ka ndodhur asnjëherë të bëhet seancë e jashtëzakonshme për një ligj, siç është ligji për arsimin, aq më shumë ditë të marte. Për një ligj, i cili është po aq atipik, jashtë çdo standardi dhe parimi ndërkombëtar.

U ndala pak te procedura, sepse ajo tregon pikërisht mënyrën se si konceptohet një qeverisje nga kjo maxhorancë. Është treguesi i qartë i autoritarizmit dhe Rama njihet nga të gjithë si një njeri, që vuan nga autoritarizmi, si një njeri që e urren ligjin, si një njeri që e injoron ligjin dhe Kushtetutën. Për të, ligji, Rregullorja e parlamentit dhe Kushtetuta nuk janë asgjë. Modë e tij e filozofisë së qeverisjes është qëllimi për të kapur dhe për të pasur në kontroll të gjithë. Kapja dhe nënshtimi politik është kryefjala e filozofisë së tij në mënyrën e qeverisjes dhe kjo metodë qeverisjeje ka pak shanse, që reformat të jenë në dobi të qytetarëve. Ato shkojnë vetëm në të mirë të kryetarit të partisë, por nuk shkojnë në dobi të qytetarëve, sepse po të shkonte edhe ky ligj në dobi të qytetarëve, po të shkonte edhe ky ligj në dobi të studentëve, që janë jashtë, në dobi të profesorëve, edhe ne do të vinim këtu e do të thoshim “po”, ta miratojmë. Të japim pëlqimin tonë.

E vërteta është se nuk ka prindër në Shqipëri që të mos e kenë problem arsimimin e fëmijës së tyre dhe ky ligj është shumë i rëndësishëm për ta. Nëse ligji do të ishte i mirë për të gjithë ata prindër, nëse do ta bënte më të lehtë shqetësimin e atyre mijëra prindërve për të arsimuar fëmijët e tyre, të atyre qindra e mijëra pedagogëve dhe të gjithë atyre pjesëtarëve të shoqërisë civile, atëherë edhe ne do të ishim në krahun e tyre, do të ishim të gjithë bashkë këtu. Por tensioni politik, rrëmuja në diskutime dhe arroganca janë mjetet për të fshehur qëllimin kryesor të një qeverie. Qëllimi kryesor është në dritë të diellit. Qëllimi është asgjësimi dhe vënia në kontroll në politikë të akademikëve dhe profesorëve. Dikush mund të thotë: Po çfarë problemi ka? Ku është autonomia? Pse është kaq e rëndësishme autonomia?

Unë me modestinë e njeriut të ligjit do t'ju lexoj vendimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit

2008, i cili flet për një ligj, që e kemi miratuar këtu në parlament. Qëllimi i autonomisë universitare është ruajtja e lirisë së shkencës, kërkimit shkencor dhe mësimdhënies, si dhe mbrojtja e studimeve dhe profesorëve nga influencat politike, sepse shkenca dhe mësimdhënia, -thotë Gjykata Kushtetuese, - normalisht mund të ekzistojnë dhe të sjellin progres vetëm kur janë të lira dhe të pavarura. Autonomia universitare është thelbi i vetëqeverisjes, -thotë Gjykata Kushtetuese, nuk e thotë opozita,- për një vendimmarrje efektive të institucioneve të arsimit të lartë në përmbushje të detyrave akademike dhe arsimore.

Ky ligj që ne kemi sot është jo vetëm antikushtetues, por mbi të gjitha, siç thotë edhe profesori, Jan De Groof, është marrëzi dhe një ligj shokues. Është dramatike,- thotë profesori,- sesi ky ligj interferon me kompetencat e Ministrisë së Arsimit. Dhe ky nuk është ndonjë profesor dosido. Ai është profesor në kolegjin e Europës në Belgjikë, president i Shoqatës Europiane për Legjislacionin dhe Politikën në Arsim. Ky është profesor Jan De Groof.

Kurrë,- thotë profesori, -kam 25 vjet që merrem, kam shkuar edhe në Afrikë, por kurrë më parë nuk kam parë si ky model. Ky ligj është i pazakontë. Tamam një marrëzi.

Paratë publike duhet të shkojnë për interes të publikut, për universitetet publike dhe jo te privatët. Këtë nuk e thotë opozita, por e thotë profesori. Në qendër duhet të jenë studentët dhe akademikët dhe interesat e tyre. Por këtë model, se e pyetëm në Komisionin e Ligjeve, nga e gjetët? Na thanë se këtë model e kanë marrë nga Rumania. Në Rumani, thanë këtu, ka pasur sukses dhe pikërisht kjo është rruga që ne duhet të ecim drejt BE-së.

Po çfarë thotë profesori për këtë gjë? Projektligji,- thotë,- nuk është mjaftueshëm europian. Dimensioni europian i këtij projektligji, për ne që po shkojmë dhe që duam me çdo kusht të futemi në BE, është trajtuar shumë dobët në disa kapituj. Marrëdhëniet me BE-në janë të lidhura edhe në këtë ligj për arsimin e lartë, -vazhdon profesori. Rasti i negociatave në Rumani për ligjin e arsimit të lartë ishte një rast i dështuar dhe që ndikoi për keq në marrëdhëniet e mëtejshme të vendit për anëtarësimin e vendit në BE, -vazhdon profesori.

Projektligji nuk përputhet me parimet e qeverisjes së mirë, nuk zbatohet parimi i kontrollit dhe i balancës. Dokumenti krijon problem me qeverisjen e universiteteve. Ligji për mua, -thotë profesori,- është një marrëzi.

Ne do ta votonim, nëse ligji do të ishte i mirë, nëse ligji do të ishte pjesë e një pakete të një qeverisje të mirë. Por e dimë të gjithë këtu se Gjykata Kushtetuese ka të drejtë me vendimin që ka dhënë, se profesori ka shumë të drejtë në të gjithë analizën që ka bërë, sepse ai është një ligj, i cili është hartuar për interesa klienteliste, për të asgjësuar zërin e akademikëve dhe të profesorëve të pavarur dhe e kanë thënë të gjithë profesorët dje në tryezën, që kishin me kryetarin e opozitës.

E dëgjuan të gjithë, e dhanë edhe lajmet. E gjithë kjo bëhet për të pamundësuar shkollimin e mijëra të rinjve shqiptarë, të na kthejnë në modelin e konkurseve të para vitit 2005, të cilët e kujtojnë të gjithë se sa hall të madh kishin prindërit për t'i çuar fëmijët në fakultetin e drejtësisë, në fakultetin e mjekësisë e kështu me radhë. I kemi trajtuar edhe më parë këto gjëra.

Në këtë mënyrë ligji nga garant për respektimin e parimit kushtetues të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, kthehet në një instrument që e cenon atë nëpërmjet ndërhyrjes në organet ekzekutive.

Kompetencat e ministrisë,- thotë profesori,- janë absurde. Të emëruarit dhe Kryeministri do të vendosin për gjithçka, që ka të bëjë me administrimin e universitetit. Kryeministri, në fakt, e ka shpallur veten kryepolic, përpara disa kohësh, kur mblodhi të gjithë në Pallatin e Kongresit, gjyqtarë, prokurorë për të arrestuar këdo që nuk paguante energjinë. Tani na e shpall veten kryerektor, *de facto*, sepse nuk mundet dot që ministri, përfaqësuesi i Kryeministrit, të shkarkojë rektorin, që emërohet nga Presidenti i Republikës. Kjo është alfa, e dimë të gjithë këtë gjë. Dhe e dimë që ky përcaktim është antikushtetues.

Të nderuar kolegë, po e mbyll fjalën time me fjalët e profesorit belg: “Ky ligj është një marrëzi dhe këtë model nuk e kam parë askund, as edhe në Afrikë”. Kjo çmenduri sigurisht që nuk mbyllet këtu. Marrëzitë i paraprijnë shkatërrimit.

Unë kam bindjen se të gjithë bashkë: opozitë akademike, profesorët e studentët do ta

vazhdojnë këtë betejë, për këtë marrëzi me të gjithë forcën dhe vullnetin dhe me të gjitha dimensionet kudo që të jetë.

Faleminderit!

Ilir Meta – Fjalën e ka deputetja Evis Kushi.

Përgatitet deputetja Jozefina Topalli.

Evis Kushi – I nderuar zoti Kryetar, Zonja dhe zotërinj deputetë,

Ligjin për arsimin e lartë e kam pritur me padurim jo thjesht për faktin se arsimit është një nga sektorët më të rëndësishëm me efekte afatgjata në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, por sidomos për faktin që eksperiencia ime e deritanishme 18-vjeçare lidhet ngushtësisht me arsimin e lartë, si pedagoge në universitet. Për këtë arsye e kam parë nga afër, e kam parë me sytë e mi, e kam ndjerë sesi ky sistem ka ardhur duke u përkeqësuar nga viti në vit, sidomos vitet e fundit, dhe këtë më besoni se e them me shumë keqardhje dhe dhimbje. Askush sot nuk e mohon dot që sistemi i arsimit të lartë në Shqipëri ka shumë problematika, të cilat lidhen si me aspektet e ligjshmërisë, ashtu edhe me aspektet e cilësisë, sidomos pas procesit të masivizimit të universiteteve, që me të drejtë deri para një viti mund t'i krahasonim me piramidat e “Sudes” dhe të “Xhaferrit”. Pikërisht, për këtë arsye, hapi i parë i qeverisë aktuale ishte mbyllja e 18 universiteteve private, të cilat nuk plotësonin kriterin e ligjshmërisë, pasi këto universitete përbënin rreth 40% të të gjitha institucioneve të arsimit të lartë privat dhe ofronin rreth 60% të programeve të studimit. Ky hap ishte më se i domosdoshëm, sidomos për situatën emergjente dhe skandaloze në të cilën ndodhej sistemi i arsimit të lartë, por pa dyshim ishte një hap i pamjaftueshëm, sepse duhej të shoqërohej detyrimisht me një reformë rrënjësore që do ta përmirësonte gradualisht këtë sistem, për ta ngritur në standardet europiane bashkëkohore.

Prandaj sot jam shumë e lumtur që më në fund në Kuvend na vjen një projektligj i ri, i cili është hartuar nga një grup pune, me profesorë të nderuar dhe me ekspertë të fushës, i cili ka punuar për ta hartuar këtë ligj për një periudhë kohore gati një vit e gjysmë, duke marrë në konsideratë praktikën më të mira europiane, si dhe është konsultuar me grupet e interesit në forume publike, në debate televizive,

me pedagogë, me studentë dhe me qytetarë për të arritur përfundimisht në këtë draft final, të cilin sot ne e kemi përpara, që jam e bindur se do ta reformojë rrënjësisht sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri.

Ligji sjell shumë risi, por unë do të ndalem në një nga ato risi, të cilën e konsideroj shumë të rëndësishme që, në fakt, është ajo pjesë, e cila ka hasur edhe më shumë debate, sidomos nga opozita, është fjala për skemën e financimit të universiteteve të arsimit të lartë në përgjithësi. Nuk do të ndalem shumë në detaje, sepse zonja ministre i shpjegoi shumë qartë këto risi, por dua të theksoj faktin që e vlerësoj këtë skemë, pasi parimet bazë që e udhëheqin atë janë të njëjtat parime në themel të sistemeve të arsimit të lartë më të suksesshme dhe më të zhvilluara sot në Europë.

Konkretisht, kjo skemë bazohet në nxitjen e konkurrencës së lirë dhe ofrimin e mundësive të barabarta për institucionet e arsimit të lartë, sigurisht në varësi të statusit që ato kanë.

Së dyti, shpërndarja e fondeve bëhet në bazë të treguesve të cilësisë, punës kërkimore-shkencore, inovacionit dhe zhvillimit në përgjithësi. Sigurisht, gjithçka bëhet duke u mbështetur edhe në sektorët prioritarë strategjikë të vendit. Pra, projektligji në themel të tij mbështet konkurrencën e lirë, duke vendosur me ritëm edhe kriteret e performancës për një arsimim sa më cilësor. Prandaj nuk ka asnjë arsye pse të tremben as universitetet shtetërore, as universitetet private dhe as opozita, sepse ky ligj nuk e vë në rrezik perspektivën e universiteteve, qofshin këto private apo publike, por, përkundrazi, u jep atyre një shans, një mundësi për t'u zhvilluar dhe për të përmirësuar cilësinë e tyre, duke e theksuar përsëri, si për universitetet private, ashtu edhe ato shtetërore. Ne jemi mësuar deri tani të flasim për problematikën në sektorin e arsimit të lartë privat, por askush nuk flet për dobësitë që ka edhe sistemi publik i arsimit të lartë. Shpeshherë këto dobësi janë po aq të mprehta, ndonjëherë akoma edhe më të mprehta. Për shembull, do të theksoja se rreth 2/3-at e institucioneve të arsimit të publik nuk plotësojnë standardet e njësive bazë në lidhje me numrin dhe kualifikimin e stafit akademik. Kjo është një shifër shumë e lartë dhe vërtet është për të të ardhur keq që ekziston në universitetet publike.

Nuk dua të përmend as emra universitetesh, as emra fakultetesh. Ne të gjithë i dimë se nuk është ky qëllimi i këtij debati, por e vërteta është se ligji i zgjon nga gjumi, i ndërgjegjëson të gjithë ato universiteteve, fakultete apo departamente që deri më sot kanë qenë shumë pasive për sa i takon përmirësimin të cilësisë dhe kriterëve të performancës, ku deri më sot nuk kanë bërë asgjë për këtë.

Megjithatë, pavarësisht të gjitha risive që sjell ky ligj, pritshmëri të larta për sa i takon impaktin rrënjësor që pritet të ketë në sistemin e arsimit të lartë, ka një aspekt që nuk duhet neglizhuar, madje duhet theksuar fort, pasi pikërisht nga ky aspekt do të varet edhe suksesi i të gjithë kësaj iniciative. E kam fjalën për implementimin e ligjit dhe respektimin me rigorozitet të tij nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë, strukturat e arsimit të lartë, duke arritur deri te strukturat e ministrisë apo të qeverisë. Në fakt, unë nuk mendoj që sistemi i arsimit të lartë në Shqipëri dështoi për shkak të ligjit të keq, pasi ligji që kishim sigurisht kishte të meta, kishte aspekte të cilat duheshin përmirësuar, për ta sjellë sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri në një kontekst të ri dhe bashkëkohor, por sistemi degradoi më tepër, sepse ligji nuk u respektua për shkak të neglizhencës, për shkak të mungesës së vëmendjes, për shkak të mungesës së kontrollit qoftë nga universitetet, qoftë nga ministria, drejtoritë apo agjencitë në varësi të saj.

Sot, për fakt të keq, siç e thashë edhe pak më lart, ekzistojnë departamente apo fakultete që ofrojnë cilësi të ulët vetëm e vetëm për faktin se janë hapur duke mos plotësuar kriteret ligjore dhe universitetet, qoftë ministria edhe drejtoritë e saj, kanë lejuar që kjo të ndodhë, duke mos bërë asgjë për të penguar këtë paligjshmëri. Përfundimisht, unë dua të nënvizoj që kemi përpara një projektligj shumë të mirë, bashkëkohor, cilësor, por për zbatimin me sukses të tij dhe për të arritur rezultatet e dëshiruara duhet të japim kontribut të gjithë së bashku, duke filluar që nga institucionet e arsimit të lartë, ministria, drejtoritë e saj, agjencitë, për të vazhduar tek universitetet, fakultetet deri te njësia bazë, që është departamenti, më tutje duke marrë pjesë në këtë proces e gjithë shoqëria, duke përfshirë studentët, ku sigurisht edhe roli ynë si parlamentar është shumë i rëndësishëm.

Nëse të gjithë e kryejmë siç duhet detyrën tonë, atëherë unë jam e bindur se pas disa vjetësh ne do të jemi të lumtur që votuam këtë projektligj dhe pa dyshim jo të gjithë do të zgjedhim që fëmijët tanë t'i dërgojmë për studime jashtë vendit, siç ndodh sot me shumë kolegë dhe qytetarë që e kanë mundësinë, të cilët nuk e konsiderojnë aspak si alternativë arsimimin në Shqipëri. Sigurisht universitetet tona nuk kanë emrin, nuk kanë reputacionin, nuk kanë historinë e Oksfordit apo Harvardit, por unë jam e bindur se ne i kemi të gjitha mundësitë që të diplomojmë mjekë të aftë, ekonomistë të zotë dhe, në përgjithësi, specialistë të të gjitha fushave, por kjo kërkon jo vetëm ligj të mirë, por vullnet dhe dashuri për arsimin e lartë.

Faleminderit!

Ilir Meta – Fjalën e ka deputetja Jozefina Topalli!

Përgatitet deputetja Kejdi Mehmetaj dhe më pas deputetja Enkelejda Shkrelti.

Jozefina Topalli – Është shumë interesante historia e hyrjes në parlament e këtij ligji. Kryeministri Rama e solli këtë ligj në parlament në kohën e zgjedhjeve lokale, kur askush nuk e kishte mendjen dhe askush nuk po interesohet, por atij nuk i duhej që dikush që të merrej me këtë ligj. Kryetari i Kuvendit, pas Kryeministrit, e futi në seancë plenare, në thyerje të ligjit të parlamentit, i cili parashikon të paktën 48 orë nga mbledhja e fundit e komisionit që e diskuton, e cila u bë dje.

Kur ka ndodhur në këto dy vjet, që ne jemi në opozitë, të bëhet seancë plenare ditën e martë? Asnjëherë! As në 8 vjetët që unë kam drejtuar parlamentin nuk është bërë seancë plenare ditën e martë. Çfarë ka që në një ditë të veçantë duhet të bëhet seancë? Çfarë është ky ligj që duhet të kalojë me urgjencë? Është reformë historike apo historitë i bëni ju ditë të marte, meqë nuk është ditë ters.

Unë sot kam vendosur të dëgjoj porosinë publike të profesor Artan Fugës, që na sugjeroi të mos bëjmë ekspertin e arsimit, por politikanin. Ne duhet të bëjmë politikanin, sepse në ligj antikushtetutshmëria është ulëritëse. Nëse je i varfër, nuk e bën dot shkollën e lartë, njësoj si në diktaturë: nëse kishe biografi të keqe, shkolla ishte vetëm një ëndërr. Ky ligj dënon ata që nuk janë të pasur, sepse tarifa vjetore vetëm për regjistrim llogaritet 1000 apo 2000 mijë euro, e

fshehur në ligj. Ky ligj është segregacioni në kohë moderne, në një vend që pretendon të hyjë në negociata me Bashkimin Europian. Ne nuk do ta lejojmë. Ne duhet t'u japim të pasurve dhe të varfërve të njëjtën mundësi për arsimim. Këtë nuk e kemi detyrim kushtetues dhe për këtë ne e kemi bërë betimin të gjithë bashkë.

Neni 18 i Kushtetutës thotë: "Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet për shkak të gjendjes ekonomike". Prandaj ky ligj vendos segregacionin, zhdok shanset e barabarta për shkollim, si një e drejtë universale, dhe rikthen luftën e klasave, e njëjta mendësi si e etërve diktatorë, asnjë meritë. Nëse nuk je i pasur, nuk shkollohesh. Por ka një rrugëdalje, të marrësh kredi dhe të hysh në borxh, t'i ngjash Edi Ramës. Ndryshimi është se 1 miliard dollarët që ky ka marrë borxh për 2 vjet, i paguajnë shqiptarët, ndërsa borxhin e panevojshëm, që ky ua detyron të rinjve për të paguar shtrenjtë shkollën e lartë, do ta paguani ju vetë, të dashur të rinj dhe studentë, kur të hyni në punë. Në punë nuk hyhet se je i shkolluar, por puna fitohet me tesserë partie dhe atëherë, përveç kështit të kredisë së shkollës, do të paguani edhe kuotizacionin e anëtarësisë së partisë, sepse kështu e ka vendosur në mbledhjen e fundit plenumi i partisë. Ky është skenari më optimist për të rinjtë e Shqipërisë.

Ligji është antikushtetues edhe sepse përmbysat garancia kushtetuese e nenit 57, që garanton antoniminë universitare dhe liritë akademike. Është dramatike sesi ky Kryeministër, i diplomuar si mësues vizatimi, merr nën kontroll tempujt e dijes dhe të vendosë për gjithçka në jetën universitare, duke kthyer në farsë borde dhe senate. Kryeministri, ky mësues i vizatimit, i do të gjitha edhe kur nuk i duhen, edhe kur nuk i kupton. I do, sepse me atë blen pushtet duke pushtuar të ditur dhe duke paguar klientët e pushtetit të lincensuar për shpërndarje diplomash universitare, por jo për dije. Ne duhet ta ndalojmë këtë rrezik që është kombëtar. Ligji është antieuropian. Mësuesi i vizatimit, i cili me 1 milion vota u punësua Kryeministër, reciton në medien e huaj dhe mendon se ëndrra jonë është Europa, kjo është e vetmja herë që nuk gënjen. Por ai ka vetëm fjalë të bukura, siç thoshte miku i tij i ndjerë, Ardian Klosi: "Edi Rama është ai që di më pak nga ne, por ai i tregon bukur". Ligji për arsimin është antieuropian, pasi ky ligj jo

vetëm që nuk pasqyron një sërë dokumentesh bazë të rëndësishme të Bashkimit Europian, por nuk i përafrohet në model asnjë sistemi të vendeve anëtare të këtij komuniteti. Ky ligj bën të kundërtën, sepse Kryeministri, mësues vizatimi, i cili përbetohet për Europën, ka rrëzuar parimet dhe standardet themelore europiane dhe i ka rrëzuar jo pa qëllim. Nëpërmjet këtij ligji qeveria vendos të sakrifikojë dijen, të cilën duhet ta garantojë njësoj për të gjithë, si për të pasurit, edhe për të varfrit, si për 5%-shin, ashtu dhe për 95%-shin, apo 1 milion të papunët e fushatës së Rilindjes. Këta janë harruar, sepse tani gjithçka shitet dhe blihet. Pothuajse të gjithë janë të gatshëm për pazar!

Fatkeqësia është që pazari bëhet me paratë publike të shqiptarëve. Prandaj ky ligj është klientelist dhe korruptiv, sepse paratë që shqiptaret paguajnë për buxhetin e shtetit që të arsimojnë fëmijët në shkolla publike me një tarifë të arsyeshme, do të shkojnë për universitetet private, që zotëria i quan publike, indipendente. A ka arsye? Asnjë. Thjesht sepse kështu do Edi Rama me Ilir Metën. Do t'u japin miliona euro në vit nga buxheti i shtetit disa pronareve universitetesh të licencuar për shpërndarje diplomash dhe të vetëlicencuar për lajkatim të kryeministrit, në çdo formë që atij i duhet.

Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Refuzojeni këtë ligj. 1 milion të papunët dhe ata që mbeten nuk kanë 1 mijë euro, apo 2 mijë euro në vit për të paguar tarifën e regjistrimit në shkollë publike. Refuzojeni këtë ligj, sepse 1 milion të papunët dhe ata që mbeten nuk kanë 3 ose 4 mijë euro në vit për të paguar masterin. Dhe përsëri po flas për universitetet publike. Në këtë tarifë nuk përfshihen librat, transporti, ushqimi, fjetja.

Refuzojeni këtë ligj, sepse ky është ligji që u thotë të rinjve: "Ikni në eksod! Ky vend nuk bëhet". Sepse ky Kryeministër i paditur ka zgjedhur të bëjë tregti milionere diplomash, duke sakrifikuar dijen dhe bashkë me të edhe të ardhmen.

Është tragjike se si pas 100 vjetësh Gjergj Fishta është kaq aktual, kur tregon me një mjeshteri të rrallë episodin e një tregtie të çuditshme, shumë të ngjashme me këtë për të cilën po flasim.

Shënkolli – thotë-me urdhër të Zotit, del nëpër botë me një barkë ngarkuar me mend. Kush donte t'i shtonte ato që kishte, mund të blinte edhe do të tjerë. Më në fund rruga e qiti shenjtin në Shëngjin. Në të njëjtën kohë del në ketë port edhe Djalli, që vinte nga Franca me një barkë ngarkuar me shkarpa për t'i shitur. Se ç'ndodh me blerësit shqiptarë, At Gjergj Fishta e shkruan në vargje:

“Ranë shqiptarët at-her n'kuvend,
E me folun rend-e rend,
(Shka ndër ne nuk mbahet mend...
E pleqnuen se për ketë vend
Duhet shkarpa e jo mend.
E prandaj kta banë tobën,
E ma tepër vunë gjobën
Për me u la me desh e që,
Mend Shënkollit mos me i ble.
Mandje çuenë n'Sh'Njin ke djalli:
Për m'e pvetë sa i bante malli.
Edhe Djalli-dreq i vjetër,
Që tue dashtë nuk ishte tjetër
Veç m'e lanë atë mall n'Shqypni,
U la shkarpat veresi”

Në fakt, si besimtar në Zot, Gjergj Fishta e bën edhe Djallin të mëshirshëm për shqiptarët. Por ai nuk mund të parashikonte që pas 100 vjetësh Djalli do të bëhej kryeministër apo kryetar parlamenti i pamëshirshëm, që po duan tëu shesin shkarpat shqiptarëve. Madje po duan me ua shit shtrenjtë!

Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, me shkollë dhe pa shkollë, me shkollën e dijes ose me shkollën e burgut, mos dënoni kaq rëndë të ardhmen e Shqipërisë! Mos e shisni atë për shkarpat e Edi Ramës dhe të Ilir Metës!

Të nderuar qytetarë,

Nëse ky ligj kalon, kjo është një nga arsyet që ky regjim meriton të përmbysset. Mos kini frikë nga kjo fjalë ju, qeveritarë! Kini frikë nga heshtja e shqiptarëve që nuk do ta blini dhe për shumë gjatë!

Ilir Meta – Fjalën e ka Kejdi Mehmetaj.

Kejdi Mehmetaj – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përpara se të parashitroj mendimet e mia për projektligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, dua të përmend, ndoshta më shumë për dëgjuesit jashtë kësaj sallë, punën e gjatë që

është ndërmarrë nga komisionet parlamentare për diskutimin dhe shqyrtimin e këtij projektligji.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, para fillimit të shqyrtimit të projektligjit në fjalë, organizoi disa mbledhje në të cilat u ftuan dhe morën pjesë në cilësinë e grupeve të interesit një numër shumë i madh përfaqësuesish nga institucione të ndryshme të vendit, si rektorë, dekanë, pedagogë, forume, studentë etj., të cilët shprehën opinionet e tyre për projektligjin përpara se komisioni ta shqyrtonte atë nen për nen, duke propozuar edhe ndryshime në nene konkrete, me qëllim përmirësimin e projektit të paraqitur.

Paralelisht dua, gjithashtu, të përmend kohën e gjatë që mori përgatitja e këtij ligji nga ana e qeverisë, kohë kjo që nuk u shfrytëzua vetëm për pjesën teknike të shkrimit të ligjit, por kryesisht për konsultimet që u zhvilluan me bazë të gjerë në të gjithë vendin dhe përfshinë të gjitha palët e interesuara. Kjo e ka bërë këtë projektligj një ndër më të diskutuarit dhe më vjen mirë që një pjesë e mirë e sugjerimeve, qeveria e reflektoi në versionin e saj përfundimtar.

Dua të përmend këtu konkretisht përfaqësimin e studentëve në vendimmarrje. Falë kërkesave këmbëngulëse të vetë studentëve, të stafëve pedagogjike, kuptohet edhe të një grupi kolegësh, studentët sot me këtë projektligj zënë një vend prej 20 % në vendimmarrjen e universitetit. Ndoshta akoma ka diskutime në këtë pikë, marrë parasysh fakti që pesha e studentit për shkak të financimit të studimeve të tij është rritur ndjeshëm me këtë projektligj, por ndoshta jemi akoma në kohë për të ndryshuar diçka në të ardhmen.

Duke e parë në një vështrim të përgjithshëm, qëllimi i projektligjit, të cilin po e diskutojmë sot, është përcaktimi i objektivave kryesore të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, përcaktimi i rregullave për krijimin, organizimin, administrimin, financimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë.

Projektligji në fjalë ka, gjithashtu, si një nga qëllimet e tij kryesore krijimin e një sistemi të unifikuar të arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, si dhe përcaktimin e rolit të shtetit në arsimin e lartë.

Projektligji në vetvete paraqet risi, nga të cilat unë do të veçoja ato që konsideroj si më pozitive:

Unifikimin dhe standardizimin e sistemit të arsimit të lartë; garantimin e arsimit për individët që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale, por që nuk kanë mundësinë financiare për t'i përballuar ato; heqjen e maturës shtetërore, por dhënien e së drejtës së IAL-ve, të përzgjedhin studentët fitues dhe të përcaktojnë kriteret e pranimit të studentëve.

Dua ta konsideroj këtë të fundit si një fitore të madhe, pasi prej më shumë se një vit kemi luftuar shumë që të ndodhë një ndryshim i tillë.

Gjithashtu, një pikë tjetër që do e veçoja është krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm të kontrollit të brendshëm të IAL-ve dhe atyre të jashtëm, në mënyrë që të sigurohen standarde europiane për sistemin e arsimit të lartë; krijimin e premisave për një arsim të lartë që u përgjigjet nevojave të tregut të punës dhe drejtimit të zhvillimit strategjik të vendit, Gjithashtu, konsideroj me rëndësi krijimin e fondit të mbështetjes studentore, që përfshin studentë të shkëlqyer, studentë në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar, studentë që i përkasin shtresave në nevojë, që studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë.

Të gjitha këto, së bashku me faktin që realiteti i universiteteve tona lë hapësira të mëdha për diskutim, duke qenë jo efektiv dhe në një pjesë të madhe të rasteve jo cilësor, bëhet e domosdoshme reforma e menjëhershme në arsimin e lartë. Por, kjo reformë nuk duhet të fokusohet vetëm në disa vështrime të përgjithshme, por të jetë e thelluar dhe e mirëmenduar. Nuk nënkuptoj me thellim sasinë e neneve që përmban ligji, por thellimin në politikat afatgjata të arsimit të lartë në Shqipëri.

I gjithë projektligji duhet të fokusohet në këto politika, pa pasur objekt të tij kryesor vetëm skemën e financimit të universiteteve.

Problemet e shumta që po vuan arsimit ynë i lartë, nuk duhet të na bëjnë në asnjë moment të nxjatur, për të vendosur zgjidhje të shpejta, që ulin përgjegjësinë tonë sociale si shtet. Ne duhet të gjejmë mekanizmat e duhur dhe t'ia bashkëngjisim këtij projektligji, për ta bërë

shkollimin dhe universitetin një mundësi për të rinjtë shqiptarë dhe jo një hall më shumë në portofolët e familjeve shqiptare.

Ndaj këtu dua të ndalem në dy çështje kryesore, të cilat shpresoj duke ua kthyer në vëmendje, së shpejti do të reflektohen në ligj. Për këto dy çështje aktet nënligjore janë një domosdoshmëri, për ta bërë ligjin të vërtetë në përmbajtje, lehtësues për familjen, dhe jo një mollë të ndaluar për të rinjtë shqiptarë. Të dyja këto çështje kanë të bëjnë me tarifën e reja të shkollimit.

E para me tarifën në vetvete.

Dhe e dyta, me mënyrën se si kjo tarifë do mbulohet nga studenti dhe familja.

Sipas projektligjit, do të jetë vetë studenti ai që do mbulojë pjesën më të madhe të kostos së shkollimit të tij. Kjo sjell drejtpërdrejt rritjen e tarifës së paguar deri më sot dhe bën që të gjenden alternativa për t'i mbuluar këto shpenzime, siç mund të jetë kredia studentore. Por për të dyja rastet ligji në vetvete përmban paqartësi.

Së pari, është e domosdoshme që ligji të përmbajë tarifën bazike të shkollimit për një student dhe duhet që menjëherë të fillojë puna për t'u hartuar akti nënligjor që do përmbajë këtë specifikim, pasi përveçse kjo qartëson familjet që kanë fëmijë për t'u shkolluar, njëkohësisht nuk lë hapësira për keqimplementim të ligjit nga institucionet e arsimit të lartë, një pjesë e të cilave mund ta shohin tarifën studentore të paguar nga studenti si zgjidhje të te gjitha halleve të gjithë universitetit.

Personalisht bie dakord me faktin se është e pamundur që universitetet të funksionojnë në mënyrë efektive, nëse menaxhimi dhe financimi bëhet vetëm nga shteti ose vetëm nga universiteti, ose vetëm nga studenti e kështu me radhë. Është e vërtetë që duhet një bashkëpunim i të gjitha këtyre hallkave në sasi të duhura që zinxhiri të funksionojë, por pa harruar në asnjë moment që për familjet shqiptare nuk ka ardhur ende momenti të zgjedhin në një treg të lirë universitar, me çmime konkurruese, njësoj siç zgjedhim të blejmë produktet e konsumit në supermarket. Ndaj në këtë pikë, qeveria, si përgjegjëse për zbatimin e drejtë të ligjit, por edhe ne si ligjvënës, duhet të jemi të kujdesshëm që tarifën, të cilat, siç e përmenda më sipër, duhet specifikuar sa më shpejt me një akt nënligjor, të

jenë të përballueshme nga çdo familje shqiptare, qoftë kjo e kryeqytetit, qoftë familje që jeton në zonat rurale, pavarësisht nga të ardhurat ekonomike që mund të kenë, sepse arsimit nuk mund dhe nuk duhet të fitohet mbi bazën e të ardhurave, por mbi bazën e aftësive dhe meritokracisë.

Çështja e dytë, të cilën dua t'juaj kthej në vëmendje, ka të bëjë me nenin 112, me kredinë studentore, e cila me të drejtë mund të jetë një zgjidhje për studentet që kanë aftësi për pamundësinë ekonomike që të vazhdojnë studimet e larta. Përpara se studenti të aplikojë për këtë kredi, duhet të këtë siguri, të cilin ky nen i ligjit, kështu siç është, nuk ta ofron. Qeveria duhet, po ashtu, edhe për këtë nen, të përgatisë aktet nënligjore që përfshijnë skemën e marrjes së kredisë, kushtet që do ketë kjo kredi, të garantojë që interesi të jetë zero, të sigurojë që kjo kredi nuk do rëndojë më shumë mbi ekonominë familjare dhe që vetë shteti do jetë garant.

Gjithashtu, unë propozoj që shlyerja e kredisë të fillojë pasi studenti është diplomuar dhe është punësuar, siç në mënyrë të menjëhershme duhet të hartohen politikat e reja të punësimit për studentët e diplomuar, që sot enden të papunë, që mundësia e tyre për ta shlyer kredinë që do marrin të jetë reale, dhe jo barrë që do t'iu kushtojë përgjatë gjithë jetës së tyre.

Dua të shkoj drejt përfundimit të fjalës sime, duke folur si studente. Patjetër që ne studentët duhet të bëjmë pjesën tonë, të përgatitemi dhe të kërkojmë nga vetja jonë, të mësojmë dhe punojmë në të njëjtën kohë. Të diplomohemi në kohë dhe me rezultate të mira. Ne duhet të trajnohemi për të qenë profesionistë të mirë. Patjetër që universitetet duhet të bëjnë më shumë. Duhet përherë brenda stafeve të tyre të kërkojnë mundësi dhe mendësi të reja. Duhet të jenë më bashkëkohorë dhe më pranë studentëve. Por në fund të fundit është qeveria ajo që duhet të rrisë financimin në arsim, të gjejë forma dhe mundësi të reja për të zhvilluar arsimin dhe të luajë rolin e saj si kontrollorë, por edhe si rregullorë. Këtë kontroll duhet ta bëjë në bazë të cilësisë dhe në të mirë të studentit, jo thjesht për të gjetur disa zgjidhje ekonomike.

Nuk duhet të harrojmë që fokusi ynë dhe i ligjit është që të përgatisim brezat të aftë, sepse do të jenë brezat tanë dhe jo universitetet e

pasuruara, ata që do të zhvillojnë vendin në të ardhmen.

Faleminderit!

Ilir Meta - Faleminderit!

Fjalën e ka ministrja Nikolla.

Lindita Nikolla - Faleminderit!

Në fakt, doja që të ndalonim të gjithë në këtë moment me një diferencë tejet të madhe të përgjegjësisë qytetare, por dhe si deputetë, deputetja e re e Lëvizjes Socialiste për Integrim, të cilën e falënderoj, foli realisht me politikë, por një politikë mbështetur mbi të vërteta që do të ishte dhe rasti më i mirë i ndjekjes së këshillës së profesorit të nderuar, zotit Artan Fuga. Por unë në fakt e përgëzoj dhe për të gjithë prezencën dhe orientimin e gjithë grupit të studentëve në gjithë debatin konstruktiv që ky grup ka zhvilluar për ligjin duke e garantuar, Kejdin dhe të gjithë studentët që do të impaktohen nga ky ligj pas hyrjes në fuqi. Sigurisht bëhet fjalë për studentët e vitit të ardhshëm akademik, që jo vetëm që nuk do të kenë rritje tarifash, por do të kenë një mbështetje të fortë të qeverisë për studentët, sipas kriterëve që kemi përcaktuar edhe për studentët në nevojë, edhe për të mundësuar që degët të mos shkretohen, edhe për të mundësuar studentë në degët e mbrojtura dhe sigurisht në ato që kanë zhvillim prioritar të vendit dhe padyshim pa lënë mënjanë ekselencën. Ju siguroj se Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe komisioni përkatës i arsimit të lartë kanë ndërtuar partneritetet dhe angazhimet, që gjithë korpusi nënligjor i këtij ligji të bëhet konform standardeve të hapësirës europiane të arsimit të lartë ku ne duam të integrohemi. Institucionet tejet të nderuara ndërkombëtare, europiane do të asistojnë në këtë proces që i gjithë ligji dhe korpusi i tij nënligjor të jetë konform vizionit dhe gjithçkaje, që ne duam ta shënojmë si një standard të ri të cilësisë në arsimin e lartë.

Faleminderit, Kejdi!

Ilir Meta – Faleminderit, zonja Ministre! Fjalën e ka deputetja Enkelejda Shkreli! Të përgatitet deputetja Albana Vokshi, deputeti Myqerem Tafaj dhe Ervin Bushati!

Enkelejda Shkreli – Para se të flas, do të doja shumë sinjerisht dhe me shumë dashamirësi t'u bëj një pyetje të gjithë kolegëve, që e kundërshtojnë ligjin dhe gjithë të tjerëve, që po ashtu e kundërshtojnë ligjin. Kam një pyetje

shumë dashamirëse: A e keni lexuar këtë ligj? Kur them e keni lexuar këtë ligj, e kam në kuptimin (më lini t'ju shpjegoj pak) etimologjik të fjalës "lexoj". Me pak durim po u shpjegoj se është një huazim, që vjen nga latinishtja, që në thelb të vet fjala "lexoj" do të thotë "mbledh, përmbledh". Pra, të krijoj një përmbledhje të të gjithë asaj që lexoj. A jeni përmbledhur dhe a e keni përmbledhur për ta lexuar këtë ligj? Sepse vura re dy reagime të kundërta në thelb nga dy liderët e opozitës. Njëri tha: "Ky ligj po shtetëzon institucionet private" dhe tjetri tha: "Ky ligj po privatizon sistemin". Tani do të bini dakord? A do ta lexoni? A do përmbledheni në çfarë do e shani këtë ligj? Po e shtetëzon, apo po e privatizon?

Ju ftoj edhe një herë ta lexoni ligjin në këtë kuptim, do të doja dhe kam përshtypjen se shkon më tepër si opinion pas opinionesh edhe opozitimi i ligjit. Më tepër se leximi i mirëfilltë, dhe mua më është dashur shumë kohë ta lexoj me gjithë kundërshtimet e mia brenda dhe jashtë vetes, dua të ndalem në dy aspekte pasi nuk dua të bëj një revistë të të gjitha tipareve që ka ky ligj, sepse këtë revistë e bëri mjaft mirë ministrja e Arsimit dhe kush foli pas saj.

Unë dua të ndalem në dy tipare thelbësore që në vështrimin tim janë zemra e ligjit dhe për të cilat ky ligj ka mbështetjen time të plotë pikërisht për këto dy tipare.

Së pari, thuhet që ky ligj nuk është europian. Gjëja e parë e këtij ligji është kthimi i gjithë vëmendjes te departamenti dhe nuk ka asgjë më europiane në sistemin tonë universitar se të kthehet e gjithë vëmendja e ligjit dhe gjithë kompetencat e ligjit në dorë të departamentit. Ju flas me bindje për këtë sepse unë prej shumë kohësh jam staf akademik i docentëve të Universitetit të Bolonjës dhe ju siguroj se nuk kam pasur kurrë punë me rektorin e Universitetit të Bolonjës, thjesht departamenti ka bërë planet e veta, ka bërë shpërndarjen e burimeve njerëzore, pikat kryesore të kërkimit, pikat kryesore të mësimdhënies, shpërndarjen e fondeve dhe të gjitha me radhë. Nëse nuk është europiane në këtë pikë, ejani dhe ma gjeni ju një model! Nëse Bolonja qenka jashtë Europës, ejani dhe ma gjeni një model tjetër europian, që nuk e ka këtë zemër!

Jam shumë krenarë që ky ligj kthen përfundimisht departamentin. Nuk mund të lë pa

thënë, që dhënia fuqi e departamentit liron mjaft rrjeta merimangash nga arsimit universitar dhe kthen vëmendjen te departamenti. Pse? Sepse departamenti është puna në universitet për atë që ka dhënë qoftë edhe një stinë të vetme mësim për atë departament, pjesa tjetër është administratë. Kthimi i gjithë fuqisë në dorë të punës, për mua është lajmi më i mirë, që më vjen nga ky ligj sikurse është edhe lajmi më integrues që ka ky ligj.

Pika e dytë, është puna në qendër te ky ligj dhe pjesa tjetër është administratë dhe kush pickohet, është problemi i vet, nuk është problemi i ligjit.

Pjesa e dytë, për të cilën po ashtu ndihem kaq mirë është kërkimi shkencor. Kemi pasur një ligj deri tani, që ndante kërkimin shkencor nga mësimdhënia. Ka qenë një ligj, për të cilën qeveria e mëparshme harxhoi miliona dhe sinqerisht unë nuk e kam kuptuar kurrë se si mund të ndahet dhe me çfarë stili europian u ndaka kërkimi shkencor nga universiteti, nga metoda. Nëse e ndajmë kërkimin shkencor nga universiteti, ku do të bëhet kërkimi shkencor? Të diplomuarit, masterizantët, doktorantët, ku do e bëjnë kërkimin shkencor? Me kë do ta bëjnë pedagogët kërkimin shkencor? Do të kemi prapë tema, siç kishim deri tani, që unë po t'ju rreshtoj listën e temave të kërkimit shkencor, kam hall se do të qeshni. Është një gaz-marak më tepër për këdo që i dhemb universiteti.

Në këtë kërkim shkencor ka një risi për mua shumë të mirë, e qendëruar, nuk di t'u them sa e qendëruar është, nëse kërkimi shkencor, që sot e tutje bëhet me aplikime. Pra, nuk jepet fondi dhe shpërndahet si rërë, si farë dhe nëse bie në asfalt mirë dhe nëse bie në tokë mirë, po mbiu mirë dhe po nuk mbiu prapë mirë. Nuk janë paratë tona, janë paratë e buxhetit të shtetit, janë paratë e gjithë shqiptarëve.

Shqipëria nuk është një vend kaq i pasur sa të ketë për të dhënë e për të lënë për kërkimin shkencor, duhet shfrytëzuar shumë mirë çdo mundësi, burim financiar që kemi për kërkimin shkencor dhe krijimi i një agjencie, e cila të paraqesë që në fillim nevojat reale që ka ekonomia e vendit, për t'u shoqëruar dhe për t'u paraprirë me kërkim shkencor interesave ekonomike dhe jo kërkimit shkencor. Për shembull, më rastisi të shoh një kërkim shkencor të madh, në financë të madhe, tema e vdekjes së

një shkrintari, por nuk më duhet. Bravo i qoftë, e bën për qejfin e vet, por vendi im nuk e ka prioritet këtë temë. Kështu që, krijimi i një agjencie, që koordinon edhe kërkimin shkencor me nevojat ekonomike të zhvillimit të vendit dhe jo vetëm ekonomike, por edhe sociale, kulturore dhe të gjithë politikave të tjera me radhë. Aplikimi dhe më pas dhënia e grantit dhe jo siç ka qenë, që unë po ta financoj, por nuk e di se për çfarë po financoj, ti merri këto lekë dhe bëj çfarë të kesh qejf, se kjo nuk ka lidhje me mua, nuk ka lidhje me Shqipërinë, pastaj puna jote, pra, aplikimi dhe më pas koordinimi edhe me mundësitë e tjera të aplikimit shkencor europian, siç janë: mbajtja e hapit me Europën, thyerja e orës së ndalur të Shqipërisë për sa i takon koordinimit me kërkimin në Europë dhe më tutje, për sa i takon projekteve europiane që ka, po ashtu përmes kësaj agjencie nuk do e quajmë këtë punë centralizim. Unë këtë punë do ta quaja anarki dhe pa dobi në të njëjtin kuptim. Thashë më sipër, që kush ka dhënë mësim në fakultet, qoftë një stinë të vetme, këto dy probleme sigurisht që do t'i ketë ndër brenda vetes.

Në këtë kuadër të kërkimit shkencor peshën e vet e merr edhe kjo skemë financimi, e cila, siç ju thashë, financon sigurisht sipas nevojës që vendi ka për atë kërkim shkencor dhe pastaj rifuancion nëse kërkimi shkencor ka qenë i suksesshëm dhe ke arritur ta çosh deri në fund. Pra, universitet me këtë ligj maten një herë në katër vjet edhe për sa i takon produktit të kërkimit shkencor.

Ku tjetër mund të bëhet? Në cilin vend tjetër do të marrin pjesë të diplomuarit, të masterizuarit, doktorantët dhe pedagogët në kërkimin shkencor të gjithë bashkë përveçse në universitet? Si do ta masin? Si do ta financojnë?

Është lajm i mirë që janë bashkë, që kërkimi shkencor dhe universiteti më në fund bëhen bashkë, se nuk e di pastaj dija për çfarë vlen në qoftë se i mësojmë thjesht që të mbushin disa alternativa dhe një fletë dhe nuk i angazhojmë kurrë studentët në kërkimin shkencor bashkë me ne pedagogët.

Këtu i rikthehem përsëri çështjes: A e keni lexuar ligjin? Në media kam parë që opozitimi i ligjit është angazhuar shumë në anën financiare. Të them të drejtën kur e dëgjova për herë të parë pasi i kishim mbyllur seancat e komisionit, pata një habi prej fëmije sepse në komisionin tonë të

arsimit, të dyja palët, pak a shumë për nenet e para, ku është fjala se si do zgjidhet senati, çfarë do ketë këshilli, si do zgjidhet filani dhe fisteku, kemi harxhuar rreth 18 minuta për një nen, ndërsa te pjesa e financimit kemi harxhuar të dyja palët bashkë rreth 2 minuta për çdo nen, që është koha e leximit të nenit. Aty janë procesverbalet dhe mund t'i kronometroni, pra nuk kishit kundërshtime.

Kur pashë opozitimin më tutje për financimin, të them të drejtën u habita e megjithatë thashë: 18 minuta për si do zgjidhet dhe 2 minuta për si do financohet tregon që halli më i madh i opozitës është ruajtja e skemave të posteve dhe të ofiqeve dhe nuk është halli se ku po shkojnë paratë e shqiptarëve.

Kështu deduktohet dhe qofsha gabim, por minutazhi është i qartë dhe tregon se ku është fokusi i interesit politik të kujt do që bën opozitimin e këtij ligji. Kështu që, për ta përmbyllur, mua nuk më duhet fare, që ky ligj ka tendenca as çintegruese, përkundrazi për të dyja aspektet që i mëshova është një ligj thellësisht integrues dhe e them nga përvoja ime modeste, por besoj që kushdo që ka pasur lidhjet e veta me Europën jam e bindur se di ta thotë edhe këtë. Nëse nuk do t'i kërkohet të fliste detyrimisht politikisht, di ta thotë edhe këtë dhe nëse fuqia e një universiteti shkon te departamenti ma thoni ku qenka ky kryerektori? Ku është centralizimi, se më duket se po biem në kurth me vetë ligjin.

Shumëkush trembet dhe unë dua ta qetësoj, se është një ligj i ri, një ligj rinovues, një ligj me kurajë, që sigurisht do pësojë edhe modifikimet e veta me kalimin e kohës për të gjitha gjërat, që mbase do të kërkojnë më tepër lëvrim, por thelbin e ka shumë pozitiv. Kushdo që trembet dhe i duket ky ligj krejtësisht i ri, meqenëse sot është ditëlindja e Martin Camajt, unë do të doja për të gjithë kolegët e mi të citoja një dyvargësh të tij. Ai thotë : “Ngjyra e verdhë e fletëve shkurtroi dritën në faqet e veta”.

Nuk shkruanim dot një ligj të zverdhur në faqet e verdha e të stërzverdhura nga përdorimi dhe shpërdorimi në emër të mbërritjes në vend të dritës, pikërisht të asaj dijeje duhet shkruar mbi faqe të bardha.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zonja Leskaj)

Valentina Leskaj – Fjalën e ka zonja Albana Vokshi! Të përgatitet zoti Tafaj dhe më pas Ervin Bushati!

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës! Dhe më lejoni t'ju uroj suksese në detyrën tuaj të re të nënkryetares!

Të nderuar kolegë deputetë!

Kjo seancë e thirrur jashtë radhe në fakt legjitimon edhe më shumë tezën se kjo maxhorancë e ka nxjerrë parlamentin jashtë radhe, e ka nxjerrë jashtë çdo shine ligjore e kushtetuese. Sepse për këtë qeveri, për këtë maxhorancë, për këtë Kryeministër, parlamenti duhet të jetë thjesht noteri i çdo ligji dhe nisme që i hap rrugë realizimit të aferave megakorruptive, që ju keni guximin të sfidoni duke i cilësuar “reforma”. Vini këtu dhe sillni në mënyrën më arbitrare, sikurse ndodh vetëm në republika diktatoriale, një ligj që në mendimin tim personal është antikombëtar, dhe jam e bindur për këtë epitet, pasi një ligj që kryqëzon interesat e rinisë dhe aspiratat e të ardhmes së saj europiane, meriton të quhet i tillë.

Ne, si opozitë, nuk mund të marrim pjesë në certifikimin e një turpi të tillë historik të parlamentarizmit shqiptar, seanca e të cilit sot ngjan me seancat e plenumëve, ku konfiskoheshin tokat, pasuritë e atyre që parardhësit tuaj i quanit kulakë, ku firmoseshin në unison pushkatimet e deputetëve dhe elitat e kombit.

Me këtë seancë ju e futët parlamentarizmin në tunelet më të errëta të historisë dhe praktikave parlamentare, të cilat e vënë në pikëpyetje lirinë dhe pavarësinë e tij si një parlament i një vendi anëtar të NATO-s.

Keni hartuar një ligj që ka hasur në rezistencën dhe refuzimin më përçmues jo vetëm të të rinjve, jo vetëm të atyre që kanë dalë në protestë, por edhe të mijëra familjeve shqiptare dhe mbi të gjitha intelektualëve, njerëzve të dijes dhe pedagogëve dhe akademikëve. Pra, i keni të gjithë kundër. Sikurse thotë filozofi i madh francez Zhan-Pol Sartri: “Intelektual do të thotë të përgjigjesh jo”. Ky ligj jo vetëm u përball me këtë reagim, por shumë më fort se mohimi e kundërshtia... Ajo është neveria popullore që ka shkaktuar kjo qeveri në këta dy vjet që ka rrënuar shqiptarët sa për 20 vjet skamje e mjerim. Dhe kjo neveri e përçmim lidhet me trajtimin dhe shpërfilljen që kjo qeveri i bën zërit dhe

vlerësimi të mendjes të punonjësve dhe pedagogëve të nderuar të universiteteve, profesorëve, doktorëve etj.

Me sa duket, kjo qeveri, ky Kryeministër, e kanë ndarë mendjen që çdo ligj dhe pseudoreformë ta sjellë me standardin e antikushetueshmërisë. Kjo është rruga e të parëve dhe mentorëve të idealit të tyre, ku çdo politikë bazohej në manifestin e Partisë Komuniste.

Të nderuar qytetarë, të nderuar studentë,

Nuk ka ndodhur në praktikën legjislative parlamentare një mënyrë e ngjashme e hartimit dhe miratimit të një projektligji si ky që po diskutojmë sot. Dhe praktika ligjvënëse që ka ndjekur ky draft që në fillimet e ardhjes në komisione e deri në këtë showseancë është antiligjore, antidemokratike që shkërmoq çdo procedurë e praktike të trupës parlamentare.

Si fillim, që të ndërmerret një reformë e rëndësishme, dhe kjo është më e rëndësishmja ndër reformat, paraprakisht duhet ndërmarrë një studim i mirëfilltë, një analizë e detajuar e gjendjes aktuale të sistemit, çfarë ka funksionuar dhe çfarë jo, sa është përqindja e punësimit të studentëve dhe sa është kjo përqindje e punësimit sipas fushave të studimit. Pra, ku e keni këtë studim? Ku janë ekspertët? Ku janë ekspertët shqiptarë apo të huaj?

Na u tha edhe dje në mbledhjen e komisionit, se është hartuar me palët e interesit. Po vallë, a e dinë këta qeveritarë se ç' do të thotë fjala "konsultim"? Për t'ju ardhur pak në ndihmë, meqë kolegja paraardhëse na foli për leximin, hapa fjalorin e Gjuhës Shqipe për t'ju sjellë përkufizimin e saktë të kësaj fjale. Pra, "konsultë-konsultim, mbledhje me specialistë dhe me përfaqësues të një dege të caktuar të shkencës, të arsimit, të prodhimit, ku shtrohen e rrihen probleme dhe shkëmbehen mendime të përvojave për një punë. Konsulta mund të jetë pedagogjike, konsultë partie, konsultë e mësuesve, e mjekëve, e të tjera". Siç duket, kjo e juaja ka qenë thjesht një konsultë partie.

Ajo që ju keni bërë, a i afrohet këtij procesi? Sigurisht që jo. A jeni konsultuar në të vërtetë me specialistët e fushave? A e keni marrë mendimin e tyre? Nga mbledhjet e djeshme, dhe ne zhvilluam jo pak mbledhje dje, rezultoi që jo. Ju mund të keni bërë mbledhje sa për të kaluar radhën. Keni futur në një sallë të madhe me drita

të shumta mjekë e specialistë, por ky nuk quhet konsultim, pasi është e pamundur të shkëmbehen mendime të vyera në një sallë të këtyre përmasave. Por profesorët e nderuar, doktorët dhe specialistët nuk përtuan të vinin edhe dje para komisionit që unë drejtoj, që ka në përbërje deputetë e mjekë të nderuar, me një lajmërim urgjent të orës së fundit, edhe në mes të vapës, mbase duke lënë edhe ndonjë punë jo pak të rëndësishme në spital, për të dhënë përsëri mendimet e tyre me shpresën se do të merreshin parasysh, që sigurisht do të mund të çonin në përmirësimin sado pak të disa neneve të këtij projektligji për sa i përket shëndetësisë. Po ashtu, edhe forumet me akademikë, shoqatat, pedagogët dhe studentët kanë folur e kanë folur që prej 1 viti, askush nuk ka denjuar t'i dëgjojë. Po, e vërtetë, janë kërkuar mendime nga të dyja ministrinë, janë dërguar sugjerime nga shumë palë të interesit, por asnjëra prej tyre nuk rezultoi të jetë marrë parasysh, nuk janë reflektuar, dhe projektligji i radhës që u ka shkuar për t'u lexuar, "ka qenë edhe më përkeqësuar se ai i pari", thonë profesorët. Absolutisht ju i keni kundër të gjitha grupet e interesit dhe jo vetëm studentët, por edhe pedagogët, dekanët dhe senatet në sektorin publik.

Do të doja ta pyesja zonjën ministre, çfarë qëndrimi ka mbajtur bashkëshorti juaj, që u bë dekan pasi ju erdhët në krye të institucionit të arsimit? Sepse kam përshtypjen se edhe ai vetë e ka kundërshtuar, dhe duke pasur parasysh që ju ende nuk keni arritur t'ia mbushni mendjen familjes suaj, a mendoni se ata studentë që po protestojnë do t'i dinë risitë dhe të mirat e këtij projektligji që po diskutojmë sot? Është skandalozë, që për hir të interesave të vetëm një numri shumë të vogël njerëzish, të disa klientëve pranë Kryeministrit, të ndërhyhet e të shkatërrohet një sistem i tërë arsimor. Madje edhe më e tmerrshme është që kjo t'i fikë të ardhmen rinisë shqiptare për hir të aferave korruptive qeveritare.

Shëndetësia tashmë është në grahamat e korrupsionit masiv. Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit e vë sektorin të parin në listën e atyre më të korruptuar së bashku me drejtësinë. Shëndetësia është thërrmuar, është copëtuar, është gllabëruar tashmë, por babëzia juaj nuk paska kufij.

Tani edhe sektori tjetër më jetik, ai i arsimit, po gllabërohet. Po shkatërrohet një sistem i tërë, që ka ndikim jo vetëm në të tashmen, por më së shumti në brezat që vijnë. Jo vetëm ne si opozitë, por të gjithë pa përjashtim, përveç këtij grupi të vogël klientësh qeveritarë, kanë bindjen se ky projektligj, përveçse është antikushtetues, shkel të drejtën e trajtimit të barabartë të qytetarëve shqiptarë në marrjen e një të mire publike.

Debate të shumta ka pasur edhe dje në lidhje me trajtimin krejtësisht preferencial të atyre që janë “Doktorë”, që kanë mbaruar studimet në vendet e Bashkimit Europian dhe të OECD-së me studentët që e kanë marrë këtë gradë në Shqipëri, e cila merret pas një periudhe jo të vogël specializimi e jo me pak mund. Këta të Shqipërisë ligji i trajton si profesionistë të dorës së dytë, që mund të rrinë në stolin e rezervave nëse rastësisht mbarojnë të gjithë miqtë e qeveritarëve që mund të kenë studiuar diku, mbase edhe në një universitet të vogël në një qytet të largët të vendit të Bashkimit Europian, por që plotësojnë kriterin e rëndësishëm, të të qenit i afërm apo mik i një qeveritari.

A ka diskriminim më të madh se ky? Pse ka frikë qeveria nga konkurrenca e hapur, nga trajtimi i barabartë në një konkurrim, në të cilin vota është përcaktuese? A e dinë qeveritarët që ligjet nuk hartohen sot për sot apo për 1 vit më pas, por duhet t'i mbijetojnë kohës, t'i mbijetojnë madje edhe mandateve qeverisëse?

Unë sot dua të shpreh kënaqësinë time, në cilësinë e kryetares së Komisionit për Çështjet Sociale të Shëndetësinë, që presioni ynë për zbatimin e Rregullores së Kuvendit bëri të mundur diskutimin, debatin, konsultimin me palët e interesit në lidhje me disa nene për sektorin e shëndetësisë, që solli edhe një përmirësim të dukshëm të tyre.

Gjej rastin të falënderoj të gjithë deputetët e PD-së, LSI-së, por edhe ata deputetë të Partisë Socialiste, të cilët, mendjehapur treguan që ndjenja e profesionalitetit të një mjeku mund të mos jetë shuar nga politika klienteliste e shefave të tyre, sidomos kur trajtohet një ligj jetik për zhvillimin e një vendi, sikurse është arsimi apo shëndetësia!

Të nderuar kolegë, ndryshe nga ajo që pretendohet, ky ligj nuk ka në qendër studentin,

ka gjithçka tjetër, por studentin jo. Ndryshe nga ajo që pretendohet, ky ligj e shkatërron autonominë universitare nëpërmjet orientimit krejt etatist të trajtimit dhe hartimit të tij.

Shteti është kudo, kontrollon çdo gjë, çdo nivel, nëpërmjet bordeve të administrimit, administratorëve, sigurisht nëpërmjet agjencive të shumta që ai po ngre. Shteti përcakton fondet, përcakton kuotat, pagat, fushat, bursat, sa para i shkojnë publikut, sa para i shkojnë privatit ose sa para i merren publikut për t'ia çuar privatit, që ai i ka klientë. Pra, me pak fjalë, shteti kontrollon çdo gjë. Autonomia ka vdekur dhe miratimi i këtij projektligji në këtë seancë do të ishte funerali i saj. Një gjë është e sigurt, edhe nëse e keni ndarë mendjen dhe e miratoni këtë projektligj, kam shumë dyshime që ai do të implementohet, pasi të gjithë kanë premtuar rezistencë, që do ta vazhdojnë edhe në muajt në vijim.

Në fjalën e saj, ministrja tha se ky nuk është ligj përjashtues, por mbështet të rinjtë mbi bazë meritash. Për cilat merita flet ministrja, kur studentëve u blihet vota në mes të ditës, në mes të auditorëve, qoftë edhe me një udhëtim vajtje-ardhje për në Korçë? A është përkrahje apo militantizëm politik një meritë për të përfutur një të drejtë studimi apo bursë? Që këtu liria dhe vlerat e saj, aq më tepër akademike, humb referencat, pasi ajo dhunohet. Kur shitet dhe kur blihet, meritat bien.

Sot vota kundër e këtij projektligji nuk është vota kundër deputetëve të opozitës, por është zëri i refuzimit të mijëra të rinjve, familjarëve të tyre, të cilët universitetin e fëmijëve e kanë qëllim të jetës. Sot vota kundër këtij projektligji është zëri i revoltës së heshtur pa retorikë dhe britma politike e intelektualëve dhe pedagogëve, njerëzve të mendjes dhe të fjalës. Sot do të merrni vulën e turpit të historisë dhe përçmimin e rinisë!

Faleminderit!

Valentina Leskaj – Fjalën e ka zoti Berisha. Të përgatitet zoti Bushati.

Një minutë, zoti Berisha, sepse ministrja ka kërkuar fjalën.

Zonja Ministre, fjala është për ju!

Lindita Nikolla – Faleminderit, zonja deputete!

Patjetër që ndoqa me shumë kërsëri gjithçka që the. Sigurisht, nuk do të jap përgjigje

për bashkëshortin, profesorin e matematikës, Ligor Nikolla, i cili ka 25 vjet që punon në Universitetin Politeknik të Tiranës, një profesor i doktoruar në Universitetin Paris 6, por, gjithsesi, ai flet vetë me punën e tij, sepse më ka mësuar të ecë vetë dhe jemi të pavarur në këtë histori dhe pa dyshim me një proces votimi. Gjithsesi, investigoni dhe do të kuptoni më shumë të vërteta.

Kam vetëm një pyetje, sepse sërish problemi me të vërtetën është kthyer në një shqetësim të madh në këtë foltore. Isha edhe unë në Komisionin e Shëndetësisë kur erdhën grupet e interesit. Më thuaj: kush tha se nuk është konsultuar? Kush nga rektorët apo dekanët tha që nuk janë dakord me ligjin? Kush prej tyre tha gjithçka që ju cituat këtu? Ata po na ndjekin, janë njerëz intelektualë, profesorë të nderuar, ju lutem, respektojini! Mos flisni këtu për respekt ndaj profesorit dhe të gënjeni pa pikën e turpit, duke vënë në gojën tuaj gjëra të pavërteta.

Isha unë, ishte zëvendësministrja e Shëndetësisë, ishin një tufë njerëz, që dëgjuaam nga rektori dhe nga të gjithë dekanët, pa përjashtim, një të vërtetë të madhe të këtij procesi, që janë pyetur dhe takuar disa herë, në gjithë rrugëtimin që ka ndjekur ky projektligj. Thanë se është një projektligj shumë i mirë, jemi dakord me gjithçka që ligji sjell, por sigurisht kishin edhe ata dilemat dhe diskutimet e tyre për çështje të veçanta që lidheshin me nenet e shëndetësisë. Kjo është e vërteta. Thoni emrat kush ishte, rektori apo dekanët? Kush ishte ndër ta, tha se nuk jemi konsultuar?

Faleminderit!

Valentina Leskaj – Fjalën e ka zoti Berisha. Më pas zoti Bushati. Të përgatitet zoti Boçi.

Keni replikë?

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Ia jep përgjigjen zoti Berisha.

Sali Berisha – Nuk mund të ndalem pa ju thënë dy fjalë, zonjë.

E ndoqa nga zyra fjalën tuaj. Më zhgënjeve në një kuptim njerëzor. Fole këtu si madam urrejtja dhe kjo gjë nuk i shkon një gruaje. Unë jam natyralisht i prirur të kem respekt për zonjat, të kem respekt për gratë. Të vetmin urim që i kam bërë zotërisë aty, ka qenë kur ai emëroi pesë zonja në kabinetin e tij. Por mendoj se nuk duhet përdorur në këtë mënyrë platforma, sepse fjalori

është i përbashkët, në fjalor kanë akses të gjithë dhe aty mund të rrëmojnë e të ngjajnë shumë llojë fjalësh.

Unë e konsideroj këtë seancë dhe këtë ligj të një anësie kapitale për vendin, të një anësie kushtetuese për atë që Zhan Zhak Ruso e ka quajtur problemin më serioz të shoqërisë, që është arsimiti i lartë. Jam marrë personalisht me këtë ligj dhe me këtë koncept 2 vjet me radhë, me dëshirën më të madhe, që ta adaptonim këtë sistem. Pse? Ky është sistemi i një vendi që ka universitetet pa diskutim më të mirat në Europë dhe nga më të mirat në botë. Ky është sistemi i Britanisë së Madhe. Por unë kam pasur një këshilltar, jo si Gjonçaj, që u bë famoz për shëndetësinë falas, që ju sollti juve, por zotin Thomson, këshilltar i Bankës Botërore për arsimin, këshilltar kryesor i Megi Thatcher për arsimin.

Pse arrita në përfundimin se ky koncept dhe ky ligj do të ishte një aventurë për Shqipërinë, ndonëse kisha dëshirën më të madhe të ecnim drejt tij? Sepse gjeta një mur të pakapërcyeshëm. Në qoftë se procedohej në këtë formë, do të bënim një gabim të tmerrshëm, sepse po krahasonim të pakrahasueshmet, krahasonim qytetarin e Britanisë së Madhe, i cili ka tri shekuj, në mos më shumë, që ka ujë të nxehtë brenda shtëpisë dhe qytetarin shqiptar, që ende nuk ka ujë të pijshëm në shumë zona dhe brenda shtëpisë; krahasonim qytetarin britanik, që është nga qytetarët me të ardhurat më të larta në botë, me qytetarin shqiptar, që e nisi këtë rrugë me 204 dollarë për frymë dhe sot është në grupin e vendeve me të ardhura të mesme të larta. Më duhej të krahasoja shoqërinë britanike me shoqërinë shqiptare, shoqëria britanike, e cila ka shekuj që prodhon diploma universitare, diplomon specialistë të fushave të ndryshme, me Shqipërinë, e cila ka universitetin më të ri shtetëror në Europë, pas universitetit të Maqedonisë, jo shtetërorit, por këtyre dy europianëve të hapur njëri nga qeveria, tjetri nga shqiptarët.

Më duhet të krahasoja Britaninë e koncepteve liberale me Shqipërinë e koncepteve totalitare, e cila edhe kur u hap universiteti, e shpreh atë në privilegj të kastës dhe të një grupi nxënësish që ishin të mirë në mësim, me nota të mira, me rezultate të mira.

Nga 75 mijë djem dhe vajza të grupmoshës së atyre viteve, në të gjitha kurset e universitetit të gjitha vitet kishte gjithsej 7000 djem dhe vajza shqiptare që shkollheshin në Universitetin e Tiranës dhe Shqipëria kishte një përqindje afrikane të shkolluarish, sepse etërit e këtyre që janë sot në pushtet ishin kategorikisht kundër shkollimit për arsye se kishin frikë prej tij dhe do të shkollonin kryesisht nomenklaturën dhe njerëzit e besimit. Isha kundër, nuk e aplikova dhe vendosa kundër, sepse konstatova që ky parim ose kjo reformë mbyll dyert e universitetit për të varfrit e vendit.

Isha kundër, absolutisht sepse vitet '80 janë ndër vitet më të rëndësishme në arsimin e botës. Universitetet hapën dyert. Deri atëherë nuk kishin qenë dyert e hapura dhe numri i studentëve u tre-katërfishua me shpejtësi në botë.

Kurse zotëria ka fobinë e taksistit. Sigurisht, kur nuk ke bërë një shkollë siç duhet, atëherë të kap frika e taksistit që është jurist dhe ua tregon shqiptarëve si një gjetje të madhe. Çfarë tregon? Tregon komplekset e tua. Ti udhëton me taksit pa shkollën përkatëse të përshtatshme, ai udhëton me diplomë juristi. Ky është mëkati i tij, thoni ju.

Pra, isha kundër që të mbyllim dyert për të varfrit. Mos harroni se Shqipëria para pesë-gjashtë vjetve kishte gjithsej më pak se 3% të popullatës me diploma universitare, në një kohë kur kjo përqindje ishte dhjetë herë më e madhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ishte tetë herë më e madhe në Gadishullin Skandinav, ishte shumë herë më e madhe në të gjitha vendet përveç Shqipërisë.

Isha kundër, sepse ne do të kapnim kohën e humbur. Unë absolutisht mbështes dhe do të mbështes çdo hap drejt cilësisë dhe ka nevojë të madhe të forcohet, por jo të mbyllen dyert.

Edhe një herë, e theksova në seancën tjetër, ka studime OECD-ja, të mrekullueshme të cilat tregojnë se nxënësit, të cilët shkojnë me nota të ulëta në universitet, në shumë e shumë vende i kanë të hapura pranimet pa asnjë kufizim. Ata mbeten, 50%-60%. Pra, nuk ia vlen, por atëherë këtyre u jepen mundësi shkolla të tjera, të cilat i mbyllën apo i hapën kundrejt ryshfetit dhe xhepit. Nuk jam kundër kontrolleve, në mënyrë absolute, por nuk duhet harruar një gjë tjetër: arsimi ka një funksion themelor: qytetërimin e personit, por edhe edukimin.

Imagjinoni se sa dënojmë në këtë mënyrë duke ua bërë atyre përsesh, duke ua shkatërruar ëndrrën universitare. Një njeriu që jeton mes maleve, një njeriu që jeton në zonat e varfra, ti i thua: nuk mund të ndjekësh shkollën, sepse edhe po të shesësh lopën e parë, po të shesësh lopën e dytë, po të shesësh çfarë ke, nuk paguan dot borxhin e kredisë. (*Bie gongu.*) E bënë këta zotërinj. (*Ndërhyrje nga salla.*) Jo, nuk është...

Zonjë, unë kam orën time këtu.

(*Ilaritet në sallë.*)

Kush e bën këtë? E bënë këta zotërinj.

Më falni, më falni! Unë i respektoj oraret e të gjitha.

E bënë këta zotërinj, të cilët pa asnjë ndjenjë njerëzore duan të përjashtojnë të varfrit nga universitetet. Duan t'i përjashtojnë nga shkollimi, nga edukimi dhe nga gjithë ato funksione.

(*Ndërhyrje nga salla.*)

Kjo është antikombëtare. E theksoj me bindjen më të thellë: kjo është antikombëtare. Nuk mund ta bëjë kurrë. Jeni më i pashkolluari i kombit në Europë! Më i pashkolluari.

Por a ka mekanizma për të rritur cilësinë? Po. A duhet rritur cilësia? Po, por jo mbi bazën e xhepit. A është ky modeli britanik? Nuk është modeli britanik i plotë, ka pjesët e tij, jua them unë, por modeli britanik ka universitete private. Asnjëri prej tyre nuk kthehet në universitet publik. Shko pak në Universitetin e Edinburgut. Nuk ka asnjë lidhje publike. Janë kthyer të tjerë. Po.

Universitetet kryesore britanike janë publike, por tani po lindin edhe universitetet private. Po lindin, kurse ju thoni: do t'i kthejmë të gjitha publike. Por nuk është ky problemi më kardinal. Problemi më kardinal është se ju mbyllni dyert për të varfrit e vendit, për të cilët në gen, në ADN, nuk keni pyetur kurrë.

Dekapitoni autonominë e universiteteve. E dekapitoni totalisht, por në qoftë se ju i merrni fjalët e mia si deklaratë politike, unë do t'ju lexoj këtu ekspertizën që i ka bërë ligjtit Ian de Groof, i cili është profesor i njohur në Universitetin e Bryzhit, është president i shoqatës së universiteteve. Çfarë thotë ky? Ky thotë se ky ligj është e kundërta e prirjeve europiane në arsimin e lartë. Thotë: "e kundërta".

O zotërinj, ju duhet t'ia dorëzoni të gjithë këtyre zotërinjve ekspertizat e ardhura. Është

kollaj ta votoni? Votojeni. Ne themi fjalët këtu dhe do t'i qëndrojmë deri në fund kundër, por nuk bëhen ligjet me lobingje që paguajnë miliona euro, se arsimi është gjëja më serioze e një kombi dhe, po të ishte se ky sistem ecte, e përdorte Gjermania, e përdorte Franca, e përdorte Suedia, e përdornin të gjitha vendet e tjera. Ja që janë vetëm dy-tre vende që kanë opsionuar për këtë. Njëri pa sukses, një tjetër e ka në diskutim, ndërkohë e vendosim ne.

Po çfarë bëni ju me sitë? Vitin e kaluar ju i rritët 30%. Tani thoni: do t'i përcaktojë fakulteti. Garanton kredinë. Ai fshatari i Çermenikës, i Mokrës, apo i Tropojës, i Mirditës apo i Përmetit, ta zëmë se mblidhet dhe shet çdo gjë për të marrë një kredi për fëmijën e parë, po me fëmijën e dytë çfarë do të bëjë?

A t'ju tregoj një histori të bukur?

Në vitet e diktaturës erdhi një kohë, kur, u mërzitët nga taksisti jurist, nuk ia jepnin fëmijës se tretë të drejtën e shkollës. U shkolluan dy, nuk pranonin të tretin, pavarësisht se ky mund të ishte më i shkëlqyeri prej tyre. Edhe ju këtë bëni, u prisni rrugët.

A u zotuat ju se do të bënit 5% buxhetin për arsimin? 5% të GDP-së. Ja ku e keni premtimin dhe e keni zbritur në 2,6%. Tani lani duart dhe u thoni familjeve: merrni përsipër shkollimin e universiteteve.

Nuk është ky funksioni që duhet të ketë shteti ndaj arsimit.

(Ndërhyrje nga salla.)

Absolutisht.

Mund të rreshtoj një listë vërejtjesh dhe jam dakord edhe për shumë gjëra, por dobësitë janë të lidhurat edhe me ne. Pse janë të lidhura me ne? Sepse numri i pedagogëve është qartësisht më i ulët sesa në vende e OECD-së. Nëse ata kanë një pedagog për 15 studentë, ne kemi 30 studentë për një pedagog. Atëherë, hajde të shtojmë pedagogët, hajde të shtojmë buxhetin.

Kollaj të merrni mendjen e atij që ju tha se do të bëjmë shëndetësinë falas. Ju solli sistemin britanik dhe ju la në baltë. Kur të gënjen tjetri një herë, pse duhet të të gënjejë dy herë? E dini pse vjen kjo? Se ishte në sintoni me nihilizmin e këtij këtu. Ishte në sintoni, se kështu e filloi: 20 vjet, tha.

Gjatë këtyre 20 vjetëve janë investuar qindra e qindra milionë nga qeveria ime, nga çdo qeveri me radhë, por vetëm në vitet e para mbi

18 milionë ka dhënë BE-ja për kualifikimin e pedagogëve tanë në universitete perëndimore, sepse duhej ndryshuar *soft-i*, se duhej bërë i ri.

Arsimi ka nevojë për ndryshime të vazhdueshme, ka nevojë për investime të vazhdueshme, ka nevojë për kujdes maksimal, kurse kjo plotëson vetëm një dëshirë tuajën: të shkollojmë sa më pak.

Për sa i përket cilësisë, e keni ekzekutuar që në fillim. Vutë mesataren, vutë ryshfetin. Vendosët mesataren e ryshfetit. Po, po. Rikthyet panairët e korrupsionit, siç ishin; do të merrni raportin për provimet e universiteteve. Kjo u përqlen universiteteve.

Panairi nuk duhej kthyer kurrë, sepse ishte shëmtia më e madhe e korrupsionit në publik. Do t'i shikoni tani. I përdorët metodat për të blerë vota, matematikën, letërsinë e të tjera. Kurrë ndonjëherë ndaj arsimit shqiptar nuk është bërë një batërdi e tillë.

Unë po lexoj edhe dy gjëra dhe po e mbyll.

Ian de Groof pyet: "Cili është roli i shtetit? Çfarë është autonomia? Cilat janë funksionet e shtetit?" "Është dramatike", thotë "sepse ky ligj interferon në kompetencat e ministrisë dhe kjo është shokuese."

Ja ku i keni.

Duhet të respektohet autonomia e universiteteve dhe ky është vërtet problemi kryesor. Por kur merr dhe i emëron të gjithë Kryeministri, autonomia është një top futbollit. Dalin Mozat, Lizat e të gjitha me radhë, po mor po, se ky është ligji.

"Si mund të respektohet autonomia kur thuhet se gjen rregullime në ligje të tjera?", thotë specialisti. Pra, në ligj thuhet se autonomia është absolutisht gjëja më e rëndësishme, e them këtu, më problematike, më e vështirë për t'u realizuar dhe për t'u përdorur siç duhet. Si mund të realizohet autonomia kur ti ua transferon ligjeve të tjera? Po cilave ligje? Ligjin që do të zhgarravitësh sipas interesit tënd. Zotëria, po tek autonomia, thotë: "Shteti nuk është faktor kyç, faktor kyç është bota akademike, studentët, pedagogët dhe tërësia e botës akademike".

Në kapitullin e dytë, neni 7, ku flitet për ministrinë thuhet: "Nuk është kjo përqsja e duhur, është i gjithi sistem i mentalitet të ndërtuar keq", nuk thuhet "mentalitet i etërve tuaj", se ai nuk merret me analizën time, por kjo është e vërteta. Nuk është ministria rojtari

kryesor. Ai thotë: “Unë jam edhe pedagog, edhe burokrat, të dyja i kam”. Ministrat nuk janë ekspertëpor janë burokratë, ekspertët janë dhe duhet të jenë akademia. Atëherë, si do të bëjmë të fusim duart e ministres e të Kryeministrit më shumë? Unë nuk them se nuk duhet bërë përpjekje, dhe është jetike, sepse pa diskutim, pa liri akademike nuk ka kurrë realizim qëllimesh. Por, a është kjo mënyra? Jo, nuk është kjo mënyra, përkundrazi “është e kundërta”, thotë ky specialisti i shquar.

Së fundi, unë e kuptoj se është e kotë, sepse ju keni marrë urdhër për ta votuar, çfarë do që të themi ne. Por thotë se 15 nene shkojnë në të kundërt me qeverisjen e mirë të arsimit. Absolutisht, shpreh bindjen e tij për këtë gjë ky ekspert, ky president i universiteteve evropiane për legjislacionin.

Ke të drejtë që qesh ti, shko merr taksistin. Po, merr taksistin dhe kërkoja diplomën të ta japë. Kërkoja diplomën, se zonja e ka marrë te universiteti “Kristal”, që shan dhe bërtet. Ti, atë doktoratën tënde të parë e fshehe fare, e zduke. E more vesh se po e kërkoja unë dhe e zduke. Tani më përmend taksistin.

Valentina Leskaj - Ju lutem, përfundojeni se keni kaluar më shumë se dyfishi i kohës.

Sali Berisha - Unë do ta mbyll zonja Leskaj, por edhe një gjë, do t’ju uroja për detyrën, por nuk e bëj dot. Pse? Sepse erdhe si rezultat i një kompromisi, më i pandershmi që mund të mbahet mend, erdhe për të pjesëtuar për dy Shpëtim Idrizin.

Unë e kam mirëpritur vizitën e Koxias në Tiranë, absolutisht. Unë mirëpres dhe vlerësoj çdo përpjekje për përmirësimin e marrëdhënieve, nuk ka diskutim. Ne, shqiptarët duhet të bëjmë përpjekje për të ndërtuar marrëdhënie sa më të mira me fqinjët tanë, por kërkesa ultimative për përzënie e Idrizit dhe kompromisi i bërë, (në atë vend duhej të ishte Shpëtimi jo ti, të themi realitetin, apo jo) që po vjen një nënkryetar për ta distancuar Idrizin, nuk ju nderon juve, o zotëri, tek ata, të cilët hoqën besimin nga Partia Demokratike dhe e vendosën te ju.

Faleminderit!

Valentina Leskaj –Fjalën e ka zoti Bushati.

Ervin Bushati – Të nderuar, deputetë dhe qytetarë,

Më lejoni t’ju sjell në vëmendje se, në fakt, qëllimi i këtij projektligji është të sjellë në krye, në fokus performancën e studentëve dhe jo thjesht të merret me liritë akademike të profesorëve, sepse, ne, shqiptarët, kemi nevojë të menjëhershme për universitetet të klasit të lartë, sepse ekonomia moderne frymëzohet dhe drejtohet nga kapitali njerëzor.

Qëllimi i çdo qeverie është të investojë te qytetarët e edukuar për të ushqyer pronësinë intelektuale në një shoqëri, në mënyrë që të stimulojë ekonominë e një vendi në zhvillim si Shqipëria. Kur themi se “kapitali njerëzor”, duhet të kemi parasysh se çdo vend, i cili ka rënë në rrethin vicioz të shfrytëzimit të vetëm të burimeve natyrore apo të asaj, që në ekonomi njihet si sjellja e qiramarrjes apo rent ciklin e Devid Rikardos, ka bërë gabime dhe nuk ka zhvilluar as teknologjinë dhe as arsimin, të cilat janë të vetmet vlera që shtojnë ekonominë, rrisin tregjet dhe punësimin.

Të gjitha vendet e zhvilluara të botës e bazojnë avancimin e ekonomik dhe shoqëror të tyre mbi një arsim cilësor. Vendet e OCD-së shpenzojnë 1,6 % të GDP-së në arsimin e lartë, ndërsa Amerika, si lider në arsimin e lartë më kualitativ në botë, investon mesatarisht 2,7% të GDP-së në arsimin e lartë. Çdo para e investuar në arsimin e lartë, qoftë kjo nga fondet publike apo kursime private, është një garanci për një shoqëri që punon më shumë, fiton më shumë dhe zhvillohet më shumë. Një diplomë universiteti në edukimin e duhur jep sot 15% kthim investimi. Më shumë trajnim dhe informacion sot, e bën më të aftë një individ në tregun e punës nesër. Nëse këta të diplomuar fitojnë më shumë, sepse studimet i kanë bërë ata më produktiv, atëherë edukimi universitar ndihmon rritjen ekonomike dhe shoqëria përfiton si e tërë.

Sot në botë, sipas një studimi, që tashmë është standard botëror i universitetit të Shangait, 17 nga 20 universitet më të mira në botë janë nga sistemi amerikan i arsimit të lartë. Kombinimi perfekt i eksperiencës së disiplinës akademike angleze me atë gjermane të kërkimit dhe zhvillimit ka më shumë se një shekull që ka vënë në krye të universiteteve, si ato publike dhe private, SHBA-të. Duke pasur parasysh këto faktorë, nuk ka asnjë surprizë që ky sistem sot është viral nëpër botë. Pjesa dërrmuese e vendeve të zhvilluara apo dhe ato në zhvillim

kopjojnë pjesë apo edhe të tërë sistemin amerikan, sepse ka provuar të jetë më i suksesshmi në tregun e punës dhe në fushën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.

Financimi, orientimi dhe kontrolli i arsimit të lartë sot po zhvendoset nga modeli i centralizuar evropian, ku gjithçka kryhet nga shteti, drejt atij amerikan më produktiv, në të cilin sektori privat mbulon pjesën më të madhe të edukimit dhe individët paguajnë apo investojnë pjesën kryesore të atyre që mbledhin në arsimin e lartë.

Po si mund të flasë opozita e sotme, Partia Demokratike, për një sistem të arsimit, kur ata në kohën e tyre mbi 90% e institucioneve të arsimit të lartë jopublik nuk kishin staf të mjaftueshëm efektiv në njësitë bazë? Si mund të flasë Partia Demokratike, kur në sistemin e saj më shumë se 2/3-at e institucioneve të arsimit të lartë nuk arrinin të mbulonin ngarkesën mësimore akademike me staf të brendshëm? Çfarë sistemi kishte Partia Demokratike për sistemin e lartë, kur mbi 90% e institucioneve të arsimit të lartë jopublik, në kohën e tyre, nuk kishin akte rregullatore të brendshme për funksionimin e tyre? A kishte sistem Partia Demokratike në kohën e saj, ku 88% e institucioneve të arsimit të lartë kishin parregullsi ose paplotësi të regjistrave themelare të progresit akademik apo të diplomimit të studentëve? A kishte sistem të arsimit të lartë në kohën e Partisë Demokratike, kur 85 % e institucioneve të arsimit të lartë, nuk zbatonin rregullat ligjore për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit zyrtar të institucionit? A kishte sistem Partia Demokratike në kohën e saj, kur 80% e institucioneve të arsimit të lartë kishin parregullsi në marrëdhënie kontraktuale me stafin akademik dhe studentët? A kishte sistem në kohën e Partisë Demokratike, kur 2/3-at e institucioneve të arsimit të lartë bënin reklamim apo marketign të pandershëm, përhapje informacioni të rremë për publikun dhe studentët? A kishte sistem Partia Demokratike në kohën e saj për arsimin e lartë, kur më shumë se 60% e institucioneve të arsimit të lartë jopublik nuk u funksiononin organet kolegjiale sipas legjislacionit? Lista është e gjatë.

Duhet të kemi të qartë se sot kemi mundësi të bëjmë një ndërprerje dhe të kalojmë në një fazë tjetër për sa i përket arsimit të lartë, të hyjmë në të me një mentalitet të ri. Nëse ne kemi

trashëguar shumë parregullsi, shumë mangësi, një sistem arsimor nga i larti deri në fund të shkatërruar, sot kemi mundësi të hyjmë një fazë të re dhe, pse jo, të marrim nga eksperiencat më të mira në botë. E kemi këtë mundësi. Nenet që lidhen me krijimin e institucioneve publike të pavarura, të cilat mund të gjejnë zbatim pas dy-tre vjetësh u japin jo vetëm pavarësi, por edhe më shumë përgjegjësi universiteteve.

Në kreun 12, i cili u dedikohet çështjeve që kanë të bëjnë me financimin e institucioneve të arsimit të lartë, ligji me gjithë parashikimet që ka, krijon një balancë të drejtë të lirisë dhe ua jep lirinë e kërkuar institucioneve të arsimit të lartë, bashkë me përgjegjshmërinë që ato kanë. E bën këtë jo vetëm si rrjedhojë e kërkesës së vazhdueshme të institucioneve të arsimit të lartë për të pasur më shumë liri, por edhe si shprehje të besimit të qeverisë që në këtë mënyrë institucionet e arsimit të lartë të mund të funksionojnë edhe më mirë.

Ligji parashikon që institucionet private të arsimit të lartë të mund të funksionojnë edhe si fondacione jofitimprurëse, por sanksionon që në fillim se duhet të miratohen nga Këshilli i Ministrave, pasi të propozohen nga Ministria e Arsimit, për t'i dhënë një status të posaçëm. Ky status nuk i jep detyrimisht dhe automatikisht financim publik nga shteti, por vetëm mundësinë për të qenë ofruer i certifikuar në një shërbim publik, si ent i shkëputur nga interesi privat, nuk gjeneron fitim dhe nuk ia çon fitimin një personi, agjencie apo enti. Ky kapitull u siguron institucioneve publike të arsimit të lartë pavarësinë kërkuar, si edhe u jep mundësinë të rrisin të ardhura e tyre jo vetëm përmes fondeve publike, por dhe atyre private.

Për herë të parë do të krijohet Agjencia e Financimit të Arsimit të Lartë, e cila do të ketë një peshë të rëndësishme në menaxhimin e të ardhurave të universiteteve në bazë të performancës së tyre. Skema e financimit që propozohet nga ligji i ri "për arsimin e lartë" ka katër elemente kryesore: ka grandin e përgjithshëm, i cili u jepet institucioneve të arsimit të lartë në bazë të treguesve të performancës, që do të thotë se sa më mirë të dalin këto institucione në nivelin e akreditimit apo rankimit, në nivelin apo cilësinë e prodhimit të kërkimit shkencor, në llojin dhe cilësinë e studentëve që arrijnë të rekrutojnë dhe shumë

tregues të tjerë që mund të vendosen, në bazë të tyre do të variojë dhe sasia e financimit publik që do t'u jepet atyre nëpërmjet këtij granti të përgjithshëm.

Ligji i ri i arsimit do të krijojë dy agjenci të reja, të cilat do të menaxhojnë çështjet e financimit të institucioneve të arsimit të lartë: Agjencia e Sigurimit të Cilësisë dhe Agjencia e Kërkimit Shkencor e Inovacionit, që do të jenë strukturat bazë që do të masin treguesit e performancës së universiteteve dhe në bazë e përfundim të këtij procesi Këshilli i Ministrave cakton edhe fondet financuese. Financimi nuk do të jetë vetëm për imputet, pra pagat e punonjësve apo shpenzimet e tjera të brendshme, financimi i ministrisë do të jetë edhe për studentët dhe kërkimin shkencor, do të financohen ato fusha ku vendi ka nevojë për njerëz dhe më të mirët. Ky është elementi i financimit përmes bursave.

Elementi i tretë është financimi i posaçëm për kërkimet shkencore të institucioneve të arsimit të lartë, për të cilët deri tani nuk merret asnjë fond. Tani do të kemi një fond të posaçëm. Ky ligj ndryshon skemën e financimit, duke futur konceptin modern të financimit në bazë të performancës. Shteti do të jetë gjithmonë e më shumë financuesi i arsimit të lartë, por këto financa, taksat e qytetarëve shqiptar, duhet të prodhojnë maksimumin e mundshëm të vlerës. Një skemë moderne financimi që pritet nga treguesit e performancës së universiteteve tona do t'i shtyjë ato të modernizohen, të përmirësojnë shërbimin ofruar ndaj të rinjve gjenerimin e më shumë të kërkimit shkencor, bashkëpunim të zgjeruar ndërkombëtar e të tjera. Në thelb do të kemi një arsim të lartë më cilësor.

Universitetet publike do të përcaktojnë vetë kuotat e studentëve, tarifën, numrin e pedagogëve, si dhe do të vendosin kriter specifik për të rinjtë që do të pranohen në universitete, pasi ato të kenë kryer provimet e maturës shtetërore. Një pjesë e institucioneve të arsimit të lartë do të mund ta përdorin maturën shtetërore si një kriter kryesor hyrës dhe mbi të mund të krijojnë kriterë të tjera ose nënkriterë, si një ndër elementet kryesore të barasmatshme në të gjithë vendin, mund të jetë një provim për fusha të caktuara që kanë nevojë për të pasur një të tillë, mund të jetë një dosje personale, siç ndodh edhe në mjaft institucione të tjera ndërkombëtare. Ligji i ri rrit ndjeshëm autonominë universitare

duke deleguar drejt universiteteve publike një serë vendimmarrjesh të rëndësishme për numrin e studentëve të pranuar, kriteret e përzgjedhjes, së studentëve, tarifën e studimit dhe numrin e stafit akademik.

Ligji i ri “për arsimin e lartë” modernizon qeverisjen e brendshme universitare duke i dhënë autoritet të qartë senatit akademik mbi qeverisjen akademike të institucioneve të arsimit të lartë dhe mbështet punën në një strukturë administrative në shërbim të misionit të institucioneve të arsimit të lartë.

Në mbyllje, në konceptet më moderne të qeverisjes së universiteteve rritet cilësia akademike, duke fokusuar akademikët në detyrat akademike dhe rritet cilësia e administrimit duke i mbështetur në administratorë profesionistë.

Ligji i ri modernizon kërkimin shkencor në universitete, duke bërë një tregues të matshëm dhe të krahasueshëm me cilësinë e universitetit.

Meqë ishim tk thënie, dua ta mbyll me një thënie të një njeriu të madh: “Fitoret e vërteta, ato me të cilat nuk duhet të kemi brejtje ndërgjegjeje, janë vetëm ato mbi injorancën”. Një njeri që ka dhënë me të vërtetë ndihmën e tij në emancipimin e qytetarëve të të gjithë botës, Napoleon Bonaparti.

Faleminderit!

Valentina Leskaj – Fjalën e ka Kryeministri Rama.

Edi Rama – Ky është një debat, që ndryshe nga shumë të tjerë, përcakton në mënyrë shumë të qartë një vijë ndarëse në filozofi, mes nesh dhe të tjerëve, sepse, përcakton në mënyrë shumë të qartë vullnetin tonë për t'u ndarë nga një histori dështimesh dhe rrënimi të madh të sistemit të arsimit të lartë.

Është me rëndësi, besoj, që duke folur për këtë projekt – që nuk është projekti për të riorganizuar edhe një herë sistemin e arsimit të lartë në vazhden e të gjithë riorganizimeve që janë bërë, por është projekti për të bërë një revolucion në arsimin e lartë – duhet paraprakisht të vendosim sfondin e këtij debati dhe t'i referohemi bazës mbi të cilën ne u nisëm për të ardhur këtu, pas një procesi, që unë e konsideroj shembullor, gjithëpërfshirjeje e diskutimi dhe për t'i kërkuar këtij parlamenti votën për këtë reformë historike të sistemit të arsimit të lartë.

Në shtator të vitit 2013 situata, jo mbi bazë opinionesh po mbi bazë faktesh, ishte si më poshtë: 59 institucione të arsimit të lartë nga të cilat 44 private. 8 herë më shumë se Britania e Madhe dhe 15 herë më shumë se Gjermania për 1 milion banorë.

Hapja e sistemit me kohë të pjesshme, part time-i i famshëm, një spektakël më vete për ditë të shtune dhe ditë të diele, brenda gjithë llahtarisë së përjavshme të arsimit të lartë publik. Ky spektakël përfshinte edhe fushat e studimeve të zbatuara, mjekësinë e të tjera me radhë, të cilat përfshihen në profesionet e rregulluara, dhe në botën e arsyes nuk mundet kurrsesi të diplomohen njësoj si të tjerët me leksione fiktive uikendi. Por ja që sistemi ynë i arsimit të lartë ishte ngritur dhe vegjetonte jashtë botës së arsyes dhe vetëm part time-i i famshëm i të shtunës dhe të dielës numëronte 28117 studentë, ose e thënë ndryshe, të shtunave dhe të dielave Shqipëria diplomonte jashtë sistemit një numër studentësh të barabartë me numrin e studentëve në universitetet private.

Në ndërhyrje, menjëherë, duke i ndërprerë kuotat për këtë lloj part-time-i origjinal, unikal në botë, part time-i në uikend, dhe me këtë ligj ndjekja me kohë të pjesshme e studimeve përcaktohet brenda një kornize normale standardesh ndërkombëtare.

Numri total i programeve të studimit ishte 1432, nga të cilat 762 programe në institucionet e arsimit të lartë publik, dhe 690 në institucionet e arsimit të lartë privat, ndërkohë që 88% e studentëve ishin në universitetet publike dhe vetëm 12% në universitete private.

Pra, shikoni se çfarë sistemi ngritën këta. Kjo ishte një zgjedhje politike, nuk ishte një politikë arsimore. Ishte zgjedhja politike për të mos u përballur me plagën e madhe të papunësisë rinore dhe për të blerë kohë në pushtet, duke iu thënë të gjithë të rinjve: “Ja ku i keni universitetet! Dynduni, dhe pastaj shohim!”.

Gjithë propaganda e bazuar te dora në zemër për të varfrit dhe në emër të bujarisë ndaj të varfërve, që shpartalloi gjithë sistemin e arsimit të lartë, është një propagandë që mund ta bëjnë ata të cilët e zgjedhin këtë politikë kur janë në pushtet, por kur e bëjnë ata që janë në opozitë, është vërtetë e vajtueshme. Sepse faktikisht, ajo çka ka sjellë si pasojë ajo politikë dhe ajo zgjedhje politike për të blerë kohë në pushtet,

duke grabitur faktikisht ëndrrat dhe paratë e prindërve me iluzionin se fëmijët po shkonin nëpër universitete, nuk ka sjellë më shumë njerëz të arsimuar, por ka sjellë më shumë njerëz të diplomuar, një ndryshim shumë i madh mes të dyjave në atë sistem, ku diplomat humbën çdo vlerë dhe ku të varfrit, të cilët investuan të gjitha kursimet e tyre për të çuar fëmijët në universitet, dolën të humbur njësoj si të gjithë ata që investuan kursimet e tyre në piramidat e Sudes, Xhaferrit, Vebiut e me radhë.

Faktikisht, ajo që u shit si masivizim, ishte një lëvizje e ofruar si një lëvizje zhvillimore, si të gjitha lëvizjet zhvillimore që kanë ofruar këta në të gjithë sektorët, që në fakt konsistonte vetëm në një zgjerim të hapësirës së kaosit dhe të korrupsionit, ku lehtësia marramendëse me të cilën epoheshin të drejtat e zhvillimit – dhe këtë e kemi në të gjithë sektorët – u shoqërua edhe këtu me një boshllëk marramendës, në mungesë të plotë të mekanizmave të standardizimit, të monitorimit dhe të reagimit ndaj pasojave negative të kësaj politike që, faktikisht, u shndërruan në një kancer në sistemin e arsimit të lartë.

Ja disa tregues që janë fakte, nuk janë opinione:

Në 2005-n kishte vetëm 7 institucione të arsimit të lartë privat.

Në 2013 shkuan 44 dhe 22 prej tyre, ose 50%, janë licencuar vetëm në mandatin e dytë të qeverisjes së rrënimit. Ndërkohë që në 2005-n kishte vetëm 10 programe studimi, në 2013-n u bënë 1432. Dhe 75% e programeve të reja të studimit, që ishin pasojë e drejtpërdrejtë e inercisë së krijuar nga ky kaos, i përkasin periudhës së fundit të 8 viteve të asaj qeverie.

Ndërkohë, shikoni treguesit e akreditimit. I referohem jo dëshirës sonë, por ligjit në fuqi, ligjit që u miratua nga shumica e deridjeshme dhe që duhej të zbatohet nga qeveria e shumicës së deridjeshme. Asnjë institucion i arsimit të lartë publik nuk është i akredituar deri në shtator të 2013-s.

Dhe, vetëm në 2013-n në periudhën para zgjedhjeve, në atë periudhën orgjiake para zgjedhjeve, janë akredituar 11 universitete private, por përsëri vetëm 25% e numrit tërësor të universiteteve private. Nëse në vitin 2006 kishte vetëm një institucion të akredituar, në 2013-n kishte 32 institucione të akredituara dhe

29 prej tyre, 85%, në periudhën e fundit të qeverisjes. Në këtë periudhë janë akredituar 13 nga 18 piramidat që u mbyllën.

Ndërkohë, vetëm dy programe studimi të akredituara për institucionet e arsimit të lartë, pra vetëm dy programe, të cilat i përkasin Akademisë së Mbrojtjes. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë që e gjithë ajo propagandë për masivizim – se do kapnim Gjermaninë, ju kujtohet, ishim në një turravrap për të kapur Gjermaninë me numër studentësh – e pashoqëruar me të gjithë instrumentet e tjera, nuk kishte si të mos sillte kaosin dhe korrupsionin që solli dhe praktikisht asnjë mekanizëm garancie për ata të varfrit, që i latë më të varfër se ç’i gjetët dhe sot ua qani hallin, a thua se nuk ishit ju që e ndërtoat sistemin që ne e kemi marrë zotim – në kohë të padyshimta, siç thonë – kur ishim në opozitë, që do ta përmbysim.

Ky ligj e përmbys sistemin, kjo është e vërtetë, nuk e riorganizon. E përmbys!

Faktikisht, 90% e programeve të këtyre universiteteve që u mbyllën si piramida, janë akredituar gjatë periudhës së fundit të qeverisjes. Vetëm nga janari në korrik, për zgjedhje, 30% e tyre. Në një mbledhje të vetme kanë bërë 40 akreditime. Për çfarë? Për të krijuar dhe forcuar më tutje iluzionin se shkoni atje, se studimin e keni të sigurt. Ju kujtohet ajo shprehja “Paratë e piramidave janë të pastra. Janë gjaku dhe djersa e shqiptarëve. Futini paratë nëpër piramida”? Njësoj edhe kjo e akreditimit. I vetmi ndryshim nga piramidat është se, nëse piramidat ranë me tërësisht të madhe, plagët e hapura nga gjithë këto vite janë plagë që vazhdojnë dhe do të vazhdojnë për një kohë të gjatë të krijojnë dhimbje në ekonominë dhe në psikologjinë e të gjithë atyre familjeve, që kanë besuar të ky sistem dhe te kjo propagandë, dhe kanë investuar kursimet e tyre duke çuar fëmijët e tyre në ato piramida, me idenë se do nxirrnin prej aty mjekë, inxhinierë, arkitektë e kështu me radhë.

Nga ana tjetër, po të shikosh procedurat e akreditimit, përsëri fakt, jo opinion, bazuar te ligji ekzistues 90% e akreditimeve janë me shkelje dhe me pasoja të rënda financiare. Pra, nuk janë bërë as procedurat e atilla, që të jenë konform ligjit ekzistues, që ne sot do ta fshijmë.

Procedura vlerësimi për akreditime të kryera në një ditë dhe akreditime të bëra për tri

ditë. Këta, që në 8 vjet nuk morën mundimin të akreditojnë asnjë universitet publik.

Më tutje, një fakt i thjeshtë: e dini kush ishte kryetari i Këshillit të Akreditimit? Ishte një pronar i njërit prej universiteteve që u mbyllën, pra, i njëres prej piramidave që u shembën duke marrë me vete ëndrrat dhe kursimet e prindërve të atyre fëmijëve, të cilët vajtën atje për të marrë shkollim dhe s’morën dot as diplomë, që ishte dhe këshilltar i kryeministrit në atë kohë.

Pra, mjafton të përmend këtë fakt për t’ju dhënë pastaj idenë e qartë sesi bëhej akreditimi në Republikën tonë, në Republikën ku 8 vjet u qeveris duke pasur kryefjalë varfërinë e aspiratave, që është rrënja e të gjitha varfërive të tjera. Varfëria e aspiratave që e bën tjetrin sot pas 25 vjetësh të thotë njësoj siç thoshin komunistët “nuk janë plotësuar kushtet që ne t’i ngajmë Britanisë apo t’i ngajmë Europës, se ne jemi të varfër, prandaj hajde t’i ngopim të varfrit me një lugë bosh, me një diplomë pa asnjë vlerë, se, në fund të fundit, më mirë t’i mbajmë nëpër auditorë sesa t’i lëmë rrugëve”. Kjo është tamam shprehje tipike e varfërisë së aspiratave. Nëse Shqipëria do ta kishte bërë këtë reformë 20 vjet përpara, unë nuk kam autorizim të citoj këtu, por po ju them se njëri prej jush, këtu në sallë, që merr vesh nga kjo punë, e thotë këtë gjë, sigurisht që këtu nuk do ta thotë këtë gjë, këtu do të dalë e do të thotë të kundërtën, sot sigurisht që do të ishim në një pozicion tjetër.

Ky ligj nuk zgjidh me magji kapërcimin epokal që garanton baza e tij, do të duhen vite, por historia e zvarritjes në kënetën dhe në llumin e varfërisë së aspiratave, këtu merr fund. Pastaj, më tutje, sfidat janë të gjitha përpara padiskutim.

Faktikisht, 18 universitete ranë si piramidat, të tjerat u pezulluan.

Ndërkohë, çfarë ndodh me universitetin shtetëror? Këtu e kam edhe merakun tim më të madh.

Për mua, të ndash universitetin shtetëror, sepse nuk është as publik, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, si të nënës dhe privatit si të njerkes e të bësh këtë zgjedhje politike, si dhe të pranosh që të mbash në këmbë me financat e këtij shteti, që nuk është as i pasur dhe nuk ka as mundësinë që të bëjë mrekullira nga pikëpamja e financimit të arsimit, institucione shtetërore që nuk plotësojnë standardet shtetërore bazë, të përcaktuara në ligjin e bërë nga këta dhe me

rregullat e nxjerra nga këta, është t'i përkasësh një bote që nuk ekziston më.

Strukturë organizative dhe numër fakultetesh përbërëse. Nuk ka.

Numër departamentesh të nxjerra për çdo fakultet dhe raport midis linjës drejtuese akademike dhe asaj administrative. Nuk ka.

Qeverisje e institucioneve në mënyrë komplet kaotike dhe hapje filialesh për fushata dhe për vota, dëgjova këtu një nga engjëllushet që foli dhe tha "ç'po bëni, po bëni një ligj arsimit për vota". Në qoftë se ka pasur ndonjë ligj të qëndisur për të marrë para dhe vota në mënyrë abuzive është ligji që do të fshihet sot. Filialet ishin jashtë çdo kontrolli, filialet ishin pa asnjë standard. Kishte ndryshime në programet e studimit komplet të paargumentuara, siç kërkon ligji juaj, dhe të pambështetura zyrtarisht. Ata që bëjnë këtë gjë nuk e marrin fare mundimin që t'i mbështesin zyrtarisht.

Nga ana tjetër, të mos hyjmë te statutet dhe rregulloret, të pavlerësuara, të pamiratuara nga Ministria e Arsimit, me shkelje skandaloze, ligjore dhe nënligjore, të mos hyjmë tek urdhrat antiligjorë të panumërt të ministrave, që kanë dashur dhe e kanë pasur vërtet për zemër që të bëjnë një ligj më të ngjashëm me këtë që bëmë ne dhe shumë më pak të ngjashëm me atë që bënë, të cilët kanë urdhëruar me një të rënë të lapsit hapje programesh studimi, akreditime me vlerësim negativ nga institucionet e vlerësimit, hapje programesh pa asnjë vlerësim nga institucionet përkatëse dhe akreditime institucionale dhe të programeve me standarde plotësisht të shumëfishta, lehtësisht të verifikueshme. Këto janë fakte, jo opinione.

Pjesa më e madhe e institucioneve kanë qenë pa përbërjen e kërkuar nga ligji të stafit akademik, sipas kriterëve të përcaktuara po nga ju! Të gjitha farsë. Po t'i marrësh dhe t'i numërosh, "kriterë për stafin e brendshëm për çdo departament", "kriterë për stafin e kualifikuar me tituj dhe grada për çdo departament", "regjistrimi i studentëve..." e me radhë... Zero! I keni bërë ju dhe i keni shkelur po ju! Zero!

Pa hyrë pastaj në shkeljet e administrimit të dokumentacionit zyrtar, në shkeljet e dokumentacionit të transferimit të studentëve, në shkelje të marrëdhënieve kontraktuale dhe financiare me studentët, të cilat janë pa fund.

Nuk po zgjatem me laboratorët dhe me radhë, por po ju them që në mënyrë të paligjshme, tre ministrat tuaj me radhë, njëri pas tjetrit, s'po i përmend emrat, kanë propozuar për hapje, as më shumë e as më pak, 21 universitete, të cilat janë mbyllur ose janë pezulluar, 17 të mbyllura, 4 të pezulluara. Skandale mbi tokë. Procedurat e hapjes së tyre ishin të paligjshme, formalisht të paligjshme.

Për arsimin e lartë, sigurisht, të gjithë mund të japin opinione, por unë besoj që një qeveri dhe pjesëtarët e një force politike në qeverisje që e kanë çuar arsimin në pikën ku të ketë kontrata të tipit: "Dhuron një makinë dhe fiton një bursë tre vjeçare universitare", "Dhuron 800 litra naftë, kontratë e hapur për tre vjet dhe përfiton katër bursa studimi trevjeçare ose shërbime të tjera", "Dhuron 17 kompjutera dhe përfiton 6 bursa studimi trevjeçare", "Dhuron punime të ndryshme në duralumin...". Ky është arsimit juaj i lartë? "Materiale të ndryshme në dru dhe përfiton katër bursa studimi", "Dhuron dy ton tallash në këmbim të dy bursave trevjeçare për titull shkencor". Ky është arsimit juaj i lartë?! A e kuptoni tani që, kur vini këtu dhe flisni sikur keni ardhur nga qielli, dukeni komplet qesharakë apo jo? "Dhuron raki rrushi, mollë dhe verë dhe përfiton një bursë studimi trevjeçare me të drejtë të së dytës në bazë të sasisë së rrushit, mollës dhe verës". E kuptoni se çfarë vreshtash dhe çfarë lloj distilierish keni vënë në lëvizje ju për të dhënë bursa apo jo? "Dhuron një makinë Volkswagen dhe një Chevrolet të përdorur, dhe të dy bashkë marrin nga dy bursa trevjeçare", "Dhuron 20 sedilje furgoni..", po këto sediljet, çfarë janë këto, "si dhe sistem të brendshëm furgoni", furgonin vetë nuk e dhuron, por këto të gjitha i dhuron, "dhe përfiton dy bursa dyvjeçare". Ky është arsimit i lartë juaji, që vini këtu dhe thoni "jemi shumë, jemi ne këtu!" Janë ata të shkretët që i keni nxjerrë mes vapës atje përpara derës, janë edhe disa të tjerë, organizata e partisë e universitetit, e vitit 89', që u mblodh e gjitha tek SHQUP-i, çudi e madhe, sesi e gjeni rrugën për të gjetur njëri-tjetrin kur vjen puna për të mbrojtur atë të vjetrën, ju e dini! Por te SHQUP-i u mblodhët të gjithë, e gjithë organizata e Partisë së Punës së universitetit. Të gjithë u mblodhët aty. Për çfarë? "Po na marrin arsimin e lartë".

Dhe më e bukura, s'po vazhdoj me këto Ford Fiesta, se janë shumë makina, kur flisni ju, po citoj një profesor të nderuar, po e citoj profesorin e nderuar. Janë ca profesorë këta që janë bashkuar në këto peticionet, që janë në të njëjtën kohë në 7 vende. Se si mund të jetë njeriu në të njëjtën kohë në 7 vende, kjo është një gjetje e tyre. Por mos harroni, në të njëjtën kohë në 7 vende, janë 7 vende ku marrin jo raki rrushi, por para, para nga xhepat e shtetit, para nga xhepat e familjeve në universitetet private.

Dëgjova njërin nga ju, "shkenca", tha, "u shkatërrua shkenca". Shiko se çfarë shkence keni bërë ju! Ju keni bërë një shkencë shumë të madhe dhe keni arritur të bëni doktoraturë për shpërndarjen e mjekëve në Prizren. Temë doktorature! Ndërkohë që sot, procesi i doktoratës, e dini ju si rezulton? Rezulton që ka një grusht të hekurt i organizatës së partisë së vjetër, me ca të partisë së re, por që është njëri që e lidh me të vjetrën si me magji, që ndërkohë që ligji juaj thotë, "jo më shumë se 5 studentë në udhëheqje", këta kanë arritur në 15 studentë. Kanë shkuar deri në rekordin e një superdekani që ka 40 doktorantë. Është edhe i partisë së vjetër, edhe i partisë së re ky. Është edhe i organizatës së partisë së punës të vitit 89', edhe i SHQUP-it. 40 doktorantë! Çfarë janë këta superprofesorë që tani na kanë bërë një superpeticion dhe kanë vënë një superalarm për të denoncuar një superskandal. Cili është skandali? Skandali është ai që, në fakt, ne e kemi kërkuar me qiri: të shkatërrojmë këtë kastë që ka marrë peng universitetin shtetëror dhe e ka kthyer në një banalitet prej 20 e kusur vitesh!

Nga ana tjetër, nuk po vazhdoj me të gjitha, por po ndalem te albanologjia. Albanologjia, temë doktorature. "Historia e funksionit të noterit", është doktor shkencash ky dhe është nga ata të peticionit. "Historia e funksionit të noterit". "Aktrimi në filmim kosovar". Albanologji! Historia e Kosovës në marrëdhënie me botën arabe. Dakord! Ky me pak më shumë pretendime. "Menaxhimi stomatologjik në rrethin e Tiranës" temë doktorature, madje keni arritur kulmin me një gjinekolog, jo me atë që morët në qafë, por me një tjetër, që ka bërë doktoratën për mami, "Si të bëhesh mami", dhe ky është gjinekolog. Ky është sistemi juaj! Ju që dilni flisni këtu për djallin, për Zotin, për Gjergjin e Milloshin, e kuptoni ku jeni, apo jo?!

Ndërkohë, asnjë nga institucionet publike të arsimit të lartë nuk ia keni nënshtruar asnjë ditë të vetme të qeverisjes suaj detyrimin ligjor për të vlerësuar cilësinë. Asnjë!

Të gjithë institucionet e arsimit të lartë kanë një bazë dokumentacioni që është për t'i ngelur në klasë dhe jo për t'i quajtur universitete, që u japin dije të tjerëve. Kush mban atë dokumentacion, do të duhej të ngelte në klasë dhe nuk do të duhej të ishte aty dhe të thoshte "jam universitet". Këto të gjitha janë me paratë e popullit shqiptar, janë të gjitha në emër të luftës me varfërinë, janë të gjitha në emër të "të kapim Gjermaninë". Fakt është që dy të tretat e institucioneve të arsimit të lartë publik nuk plotësojnë standardet e njësisive bazë. Dy të tretat, asnjë standard!

Për sa i përket pjesës së demokracisë dhe autonomisë, faktikisht, 70% e institucioneve të arsimit të lartë, organet e ashtuquajtura kolegjiale funksionojnë si banda në kundërshtim të plotë me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që keni nxjerrë ju, madje në kundërshtim të plotë me rregulloret që kanë bërë vetë. Edhe rregulloren e tyre nuk e bëjnë dot siç parashikojnë të jetë sjellja e tyre, sjellja e tyre me buxhetin, me marrëdhëniet morale kontraktuale me studentët dhe me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pa hyrë në të gjitha kriteret e rekrutimit të stafit akademik, efektiv apo të ftuar, e ku di unë, sepse këto terma i keni shpikur ju, që janë një estradë më vete.

Turp! Turp! Turp!

Të vjen turp t'i lexosh dhe jo më të kesh marrë pjesë në organizimin e këtij çorganizimi kriminal, njëqind për qind, jo nëntëdhjetëenëntë për qind dhe me fakte. Për të gjitha këto, kujtdo nga ju që dëshiron të bëjë transparencën e fjalës sime, ju vëmë në dispozicion dokumentacionin faktik.

100% e institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri nuk respektojnë kriteret ligjore përgjydhëse për pranimet e studentëve në ciklin e dytë, master profesional. 100%! Janë bërë që të gjithë me master, domethënë mjeshtër. 70% nuk respektojnë as kriteret për master shkencor. Ju edhe masterin shkencor e bëtë si ndihmë ekonomike. Le t'ia japim këtij, sepse nuk ka i shkreti, le ta marrë dhe ta gënjejë mendja se po bëhet mjeshtër në shkencë. Rëndësi ka që ky të

merret me këtë punë, ndërkohë që ne bëjmë rrëmujë në Shqipëri për sektorët e tjerë.

U çua këtu një ëngjëllushe dhe përmendi djallin. Mu kujtua një shprehje: “Djalli nuk është kërcënimi real i kësaj bote, budallallëku po”, thotë shprehja dhe jo unë. Prandaj na duhet, një kryqëzatë kundër budallallëkut dhe vetëm kështu mund të bëjmë diferencën.

Atëherë, çfarë po bëjmë ne? Po e them shumë thjeshtë, që të mos hyjmë në terminologji, çdo para e hedhur për arsimin e lartë do të përkthehet në të mirë publike, e hedhur nga shteti apo nga privati. Kjo për ne do të thotë, se sistemi i arsimit të lartë duhet të jetë fusha e konkurrencës dhe e meritës, jo fusha ku ato të nënës bëjnë pallë me lekët e babës dhe ata të njerëz grabisin ata që mbeten jetimë për t’ju marrë ëndrrat, lekët dhe për të nxjerrë para vetë.

Pas këtij ligji nuk ka më universitete që nxjerrin para për qëllime përfitimi. Gjithçka rikthehet investim në arsim. Kjo është “A”-ja. Për ne nuk ka më: “Këta janë publikë dhe këta janë privatë”. Ky është term i gabuar. Në fakt, janë shtetërorë dhe privatë. Për ne janë të gjithë publikë. Kush do të qëndrojë në fushën e dhënies së arsimit të lartë duhet t’i shërbejë arsimit si e mirë publike dhe e financon me paratë e tij, apo është i financuar nga paratë e shtetit, duhet të garantojë konkurrencë dhe meritë.

Neve na duhet studenti, na duhen ata, të cilët ju i qani dhe i nxirrni këtu në vapë, të cilët nuk e kanë lexuar as ligjin dhe kanë fatkeqësinë që t’ju dëgjojnë ju, se nuk e dinë as historinë, sado e afërt është historia.

Shumë thjesht: neve na duhet një sistem i arsimit të lartë që kush investon për të marrë arsimin e lartë, të marrë mbrapsht investimin e tij. E merr tek ajo pjesa e arsimit publik që financohet nga shteti, apo që financohet nga privati, për ne, kjo nuk ka pikë rendësie.

Ne nuk çojmë para tek asnjë universitet privat që të jemi shumë të qartë. Nuk i japim para qyl asnjë universiteti shtetëror. Paratë ne i çojmë te studenti dhe i ndajmë mbi bazën e performancës së universiteteve. Universitetet shtetërore dhe ato private duhet të konkurrojnë si të barabarta për të prodhuar të mirë publike, jo ca për të nxjerrë fitime dhe ca për të marrë rrogën e për të shkuar në shtëpi. Jo! Për të prodhuar të mirë publike!

Ju, partia e lirisë, partia e ekonomisë së tregut, partia e madhe e ku e di unë se kujt tjetër, që i keni harruar të gjitha, jeni katandisur në një organizatë bazë e vitit 1989, që flisni këtu sikur kanë ardhur ca dhe po ju marrin universitetet dhe po i çojnë jashtë shtetit.

A jeni në vete? Po ju marrin këto vatrat e dijes! Vatrat e mykura të mediokritetit, të parazitizmit, të korrupsionit dhe të vetëmashtrimit, që e kanë renditur Shqipërinë në fund fare, për turp! 25 vjet, jemi në fund fare. Shikojeni në të gjitha klasifikimet, testet, turp!

Shkoni takoni agjencinë britanike të akreditimit dhe pyetini si po shkon procesi i akreditimit. Akoma nuk po marrin dot veten, nuk po kapin dot veten ata vetë, jo më të gjejnë se ku është universiteti. Ata thonë nuk kanë parë, nuk kanë dëgjuar, nuk kanë besuar, nuk kanë imagjinuar që ka në botën e sotme universitete si këto. E kush i bëri këto? Djalli?!

Sigurisht që ne kemi premtuar, patjetër, ne i qëndrojmë të gjitha premtimeve tona, por me ato do të merremi pas dy vjetësh. Ju e bëtë një referendum në 21 qershor dhe e morët rezultatin. Ju jeni katandisur nga Partia e madhe Demokratike në partinë që ngushëllohet me ca bashki të vogla dhe thoni “Kemi bërë progres”. Me këtë më kujtohet ajo shprehja “po bëjmë progres brenda zonës së rrezikut”. Ju jeni në një botë tuajën, nuk ka problem.

Pra, premtimi është aty dhe me atë do të ballafaqohemi. Ne e besojmë masivizimin, por jo masivizim ku nuk e merr vesh i pari të dytin, por mbi bazën e standardeve në hyrje, e para dhe duke i hequr kuotat qeveria, jo e centralizuar. Gjithkush që dëshiron të shkojë në universitet ta dijë se po shkon në një fushë beteje për dijen dhe nuk po shkon në një “rifugium peccatorum” atje për të pirë hashash dhe për të parë njëri-tjetrin, sa për dijeni. Gjithkush e ka këtë drejtë, por duhet të provojë edhe meritën.

Nga ana tjetër, shteti mbetet financuesi kryesor, patjetër, sepse nuk ka si të jetë ndryshe. Por diversifikimi i burimeve të financimit, sidomos në kushtet tona është një nevojë absolute.

Vijmë ne dhe e gjejmë rrafsh arkën e shtetit. 720 milionë plus për t’ua paguar të gjithë borxhlinjve që kishin ngelur te dera, se baba i kishte hedhur zaret për të fituar zgjedhjet dhe ishte zhdukur.

Atëherë si i bëhet? Bëhet që burimet e tjera përfshihen në këtë sistem, brenda këtij misioni të mirëpërcaktuar dhe privati është i mirëseardhur.

Juve nuk e di si nuk ju vjen zor, partia e privatëve, partia e djathtë, partia e të tjera, kemi një muaj që ju dëgjojmë, rrotulloni arra nëpër dhëmbë. Se çfarë janë ca lobistë, se çfarë janë ca kështu, se çfarë janë ca ashtu. Emrin? Ore zotërinj, po ju them edhe njëherë tjetër, jeni kthyer në një organizatë partie të vitit 1989. Ky ligj ju ktheu aty, jeni organizata bazë e universitetit të vitit 1989. Ikën 25 vjet mundime që bëtë për demokraci, e kthyet veten para 1990-ës.

Si mund të jetë sektori i fortë publik? Ne besojmë te sektori publik, por sektor publik pa kompeticion? Sektor publik që kush është tek publiku merr të gjitha qyl edhe hedh zaret? Si? Sektor publik me kompeticion. Nuk ka më monopol. Nuk mund të ketë më shteti monopolin. Në universitetet që i financon kryesisht buxheti i shtetit është e lirë, e hapur, kush është më i zoti. Neve na i intereson çfarë dijesh marrin ata që hyjnë në universitet, jo i kujt është universiteti. Ky është yni, ai është i kulakëve. Kështu i bëtë ju. I gjetët emrin më të bukur “Kristal”, tamam kristal. Monumenti që ju ngritët si shembulli i gjithë filozofisë suaj për arsimin ishte kristal, qelibar edhe emrin fiks ia vutë, sepse emrin e keni vënë në bashkëpunim.

Ai që zgjedh nuk është shteti. S’ mund të jetë shteti ai që zgjedh, ai që zgjedh është studenti. Futeni mirë në mendje këtë: është studenti ai që zgjedh, është zgjedhja e studentit ajo që përcakton se ku i çon shteti paratë, nuk është shteti që përcakton se ku do të shkojë studenti, “shko ti te ky universiteti, sepse do mbajmë ca njerëz në punë ne dhe na duhet plot, edhe dil më keq sesa ata që kanë ngelur brenda”.

Fondet i merr performanca, nuk i merr ai që i ka në xhep edhe thotë: “Unë e kam, çfarëdo që të bëj unë, se e bëra, se nuk e bëra, se nxora shkencëtar, se nxora druvar, unë i kam fondet, i marr fondet dhe bëj çfarë të dua”. Jo more! Po ata që paguajnë taksat, po prindërit që çojnë fëmijët e tyre, ata nuk kanë të drejtë kontrolli? Nuk kanë të drejtë ta dinë ata se ku shkojnë këto para? Si thoni ju? Ku e keni parë? E keni parë ju, tek organizata e partisë e vitit 1989, aty tek ajo organizata e universitetit që e

mbloedhët për të bërë atë mbledhjen e madhe të alarmit.

Patjetër që sistemi duhet të jetë i njesuar, i standardizuar në mënyrë që të jetë kompetitiv, ndryshe ne jemi jashtë. Jemi jashtë komplet. Jashtë hartës së Europës, jemi jashtë hartës së rajonit. Ne nuk jemi fare. Ky është fakti, të tjerat janë përralla.

Mos harroni që prindërit e këtij vendi, krahasuar me të gjitha vendet e rajonit, janë investitorët më të mëdhenj të parasë për arsimimin e fëmijëve të tyre. Shikoni sa para investojnë për të çuar fëmijët jashtë!

Merrini shifrat dhe shikoni sa studentë shkojnë jashtë nga Serbia, nga Maqedoni, nga Bosnja, nga Mali Zi, edhe nga Greqia, po të doni. Shikoni sa shkojnë nga Shqipëria, të financuar jo nga shteti, por nga familjet. E si qenka kjo punë? Pse të mos kemi ne universitete që të paktën një pjesë e këtij investimi të rrijë këtu? Pse duhet të ikin të gjithë jashtë të lemerisur? Çfarë ka këtu për të bërë ndarje “ne” dhe “ju”? Në fund të fundit, a bëhet fjalë për t’i dhënë drejtim një historie që është pa drejtim 25 vjet?

Është fakt! Thoni çfarë të doni. Unë nuk them që e keni bërë me qëllim, e keni bërë se keni dashur të bëni më të mirën, aq keni ditur, aq keni bërë siç i bëtë të gjitha. Po pse doni tani që ne prapë të rrimë aty dhe thoni ajo është. Jeni në vete apo jo? Dy herë rresht zdrugim nga populli dhe vazhdoni e thoni ishim më mirë kur ishim më keq. Çfarë bëni?

Një gjë tjetër, pse gënjeni kur thoni: “Ky ligj rrit tarifatat dhe është për të pasurit”? Pse gënjeni?

(Drejtimin e séancës e rimerr zoti Meta. Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Ilir Meta - Ju lutem, me qetësi!

Edi Rama - Ky ligj përcakton ku investojmë ne si shtet. Ne si shtet investojmë në tri kategori që japim paratë, shteti: tek të shkëlqyerit, tek ata të cilët i stimulojmë për të shkuar në degët jo tërheqëse dhe jo kompetitive, sepse kështu siç e latë ju ka përfunduar Shqipëria që nuk ka më mësues matematike, nuk ka më mësues të gjuhës shqipe. E kuptoni apo jo? Si do t’i formojmë këta ne? Ne do t’i stimulojmë financiarisht dhe tek të varfrit që nuk kanë mundësi të paguajnë, por që paraprakisht duhet të provojnë se janë të aftë të hyjnë në universitet,

pra kanë talentin, por s'kanë paratë. Paratë do t'ia japim ne.

Të tjerët janë të gjithë të barabartë. Këto tri kategori financon shteti. Teoria "hajde ta bëjmë si këmbët e dhisë", na çoi këtu ku jemi. Kjo gjë ju pëlqen, e quani arritje të madhe, kurse ne na tmerron. Ky është ndryshimi!

E fundit fare, nuk është shteti, pra, nuk është qeveria dhe ministria që organizojnë dhe menaxhojnë punën e përditshme të sistemit të arsimit të lartë. Ky është një ndryshim tjetër shumë i rëndësishëm që ju i vini vërdallë, kapitulli 12.

Kapitulli 12 është thelbi i ligjit, sepse u jepet mundësi disa agjencive të specializuara të bëjnë menaxherin. Ju keni bashkuar botën akademike me menaxhimin. Kjo nuk ndodh në asnjë vend. Ju i doni edhe shkencëtarë, edhe menaxherë, të dyja gjërat. Pra, i merrni për shkencëtarë e u thonë: menaxhoni edhe paratë. Si mund të menaxhojnë shkencëtarët? Ç'lidhje kanë shkencëtarët me menaxhimin? Ta zëmë se janë shkencëtarë, se sa shkencëtarë janë është tjetër histori, ta zëmë se janë shkencëtarë, ç'lidhje kanë shkencëtarët me menaxhimin e parave, ku lidhen këto? Atëherë ligji krijon një sistem menaxhimi. Pra, fusim konceptin e menaxhimit në universitete, që nuk ekziston fare. Ju menaxhim quani ata që bëjnë tenderat, ai quhet menaxher.

Këto janë, për të mos u zgjatur dhe më tutje, se këtu ka shumë për t'u zgjatur. Unë nuk kam folur, kam preferuar të mos flas për këtë çështje dhe më vjen shumë keq edhe për një gjë tjetër. Ky projektligj është një shembull edhe për ne. Nën lidhshirin e ministres së Arsimit, ia kemi dorëzuar pushtetin tonë një grupi ekspertësh, ekspertë në këndvështrimin tonë ndërmë të mirët, që ofron vendi ynë, brenda dhe jashtë vendit. Nuk i kemi parë fare se çfarë tesere partie kanë në xhep. Disa prej tyre i kemi parë edhe në fushatë me ju, unë nuk po përmend emra, ju i dini. Të gjithë bashkë u kemi thënë: "Duam të bëjmë një ligj të arsimit të lartë që të adresojë gjithë këtë kancer dhe të na japë në dorë një instrument për të luftuar këtë kancer dhe për të dalë në një epokë tjetër".

Është punë e një komisioni të reformës së arsimit të lartë dhe unë dua t'i shpreh të gjithë respektin atyre, pavarësisht se nuk kam aspak simpati për një pjesë të tyre; nuk kam asnjë simpati, kur vjen puna, as te bindja politike dhe

as për faktin që besojnë ende te Partia Demokratike, kjo s'ka rëndësi, këtu jemi tek ekspertiza.

Tani ju dilni dhe thoni, se është "vullnet i Kryeministrit". Unë po ju them, është "vullnet i ekspertëve". Ne kësaj ekspertize i japim mbështetje dhe vullnetin politik, njësoj siç do të bëjmë me reformën në drejtësi.

Ne kemi vullnetin politik dhe u kemi thënë 5 parime: Duam këtë drejtim, kjo është filozofia jonë, nuk duam ta ndajmë i shtetit, i privatit, i nënës, i njerësis. Duam konkurrencë, meritë dhe paratë e publikut të shkojnë te performanca më e mirë, pikë. Ky ligj është zbrërthimi i saj.

Drejtori i Komisionit Europian për Arsimin, një personalitet europian, që ka ardhur enkas në Shqipëri, tha shprehimisht: "Ky është një ligj revolucionarizues për arsimin lartë dhe një model për t'u ndjekur në të gjithë rajonin". Dakord. Sepse nuk është ligj i shpikur nga ne, alla shqiptarçe, siç i bënit ju, nuk është "Kristali".

Këto janë ato që kisha për të thënë dhe duke dëgjuar gjithë këto debate m'u kujtua një shprehje: "Të jesh budalla, të jesh i vetëkënaqur dhe të kesh shëndet të mirë janë tri kërkesat bazë që të jesh i lumtur"! Qofshin të lumtur të gjithë ata, që mendojnë ato që mendojnë, dhe kanë thënë e do të thonë ato që kanë thënë e do të thonë, po më shumë se kaq ne nuk bëjmë dot për ta.

Ne ligjin do ta votojmë dhe arsimit të lartë në Shqipëri do të transformohet rrënjësisht me një revolucion.

Faleminderit!

Ilir Meta – Zoti Berisha, urdhëroni, në emër të grupit tuaj!

Sali Berisha – Pa dashur të krijoj ndonjë keqkuptim për disa arsye strikte personale, do të preferoja të kishe cituar gjyshen, që besoj se nuk ta ka thënë, sepse ajo ka qenë një grua fisnike, e cila, sipas teje, të ka thënë që burri gënjen. E vërteta është që nuk ia ka thënë, sepse i përkiste një familjeje, pa diskutim, të fisme. Ka shërbyer në pallatin mbretëror. Pra, nuk besoj kurrë t'i ketë thënë: "Gënje sa të duash" dhe e paraqet atë si njeriun, që licencon gënjeshtren e këtij. Kjo nuk ndodh.

Unë dua të theksoj disa momente. Iku? Mirë bëri, se nuk ka durim, e lëshojnë nervat atë. Nuk duron dot.

E ndoqa diskutimin dhe dua të theksoj dy gjëra:

Së pari, shpalosi gjithçka, konceptin dhe mentalitetin e etërve të tij për seleksionin dhe kufizimin, pandjeshmërinë totale ndaj atyre që nuk kanë. Të varfrit shumëzohen me zero nga një njeri, që u rrit në parajsën e Bllokut, nga një njeri që kishte 5 mësues privatë për të marrë liceun. Pra, dy botë, dy koncepte.

Së dyti, në fjalën e tij më kujtoi kryetarët e grupeve të kontrollit punëtor, që na vinin dhe na rrokanisnin me shembuj nga më marrëzorët, që i lejonin vetes të flisnin gjithçka, sepse kishin *carta bianca*-n e kontrollit proletar.

Së fundi, ai lexoi një fjalim, që do të hyjë në historinë e parlamentit si kulmi i mediokritetit; nuk kuptonte ato që thoshte. Cilido nga pedagogët dhe njerëzit, që e njohin universitetin, le të më thotë që nuk është kështu.

Pas këtyre konkluzioneve, dua të ndalem pak. Nuk ka diskutim që arsimit është problem themelor, për çdo vend, aq më tepër për ne. Kjo është jashtë çdo dyshimi. Nuk ka diskutim që arsimit kërkon reformim të vazhdueshëm, por të flasësh për arsimin në pozita nihilizmi, dëshmon se nuk di asgjë. Dëshmon se nuk ke konceptet bazë, kur paraqet me mburrje se në vitin 2005 kishte 7 programe. Po kjo është e tmerrshme, zotëri! Unë nuk besoj të jetë kjo. Ky është një mashtrim! A e kuptoni çfarë do të thotë 7 programe në universitetet e vendit, në një botë tregu, në një vend të hapur prej 15 vjetësh? A mund të imagjinohet kjo që thoni ju? Ai nuk e ka të qartë se çfarë është programi. Nuk ka të qartë destinacionin e programit. Prandaj flet në këtë mënyrë dhe mendon se po thotë gjëra të qëlluara, njësoj si kryetarët e grupeve të kontrollit punëtor, që na dërdëllisnin çfarë u thoshte mendja mbi bazën e psikologjisë proletare.

Zotëri, në qoftë se kanë qenë 7 programe, që nuk mundet kurrë, ti nuk e ke idenë se çfarë është universiteti, çfarë është katedra, çfarë është departamenti, sepse kjo nuk mund të ndodhë në asnjë mënyrë.

Thua se kanë kaluar 1400 e ca. Është statistika e Gjergjit. Më falni, është statistika e një sharlatani mashtrues.

Do t'ju them se çfarë u tha Gjergji shqiptarëve me porosinë e tij përpara tri ditësh. Ja ku e keni! Përpara tri ditësh, Gjergji u tha shqiptarëve dhe botës se përdorën dy metoda për

vlerësimin e rritjes ekonomike. Njëra,- tha,- është e prodhimit. Kurse tjetra është e konsumit. Dakord. Kështu është.

I keni me zë dhe me figurë. Kjo me konsumin, - tha,- bëhet për herë të parë. Metoda e konsumit bëhet me një anketë, që ta kenë të qartë ata që nuk janë të familjarizuar, dhe në metodën e konsumit 80 e ca për qind të peshës e zë konsumi i popullatës, i qytetarëve.

Sa shpenzojnë, sa blejnë? U tha shqiptarëve se rritja ekonomike me dy metodat, konfirmohet 2,82%. Çfarë thotë Gjergji? Po me statistikën e tij, thotë se rritja ekonomike, me metodën e konsumit, na rezulton recesion, na rezulton -1,07%. Shkoni dhe merreni! E keni në *site*! Ja ku e kam statistikën!

Pra, Gjergji u thotë shqiptarëve se na ka dalë me dy metoda. Gjergji nuk lexon veten e tij se është i porositur të mashtrojë, dhe të thotë se është -1,07 dhe se shpenzimet totale janë -1,22%.

E kuptoni, zotërinj se si e rrit rritjen ekonomike me 10 herë? Dhe del këtu e flet! Më vjen keq për qytetarët shqiptarë, por kam paralajmëruar nga kjo tribunë me dhjetëra e qindra herë: Zotëri, ke meritën famëkeqe të shtyrjes drejt rrokullimës së ekonomisë së këtij vendi. Kambanat po bien! Fondi Monetar, Komisioni Europian, Banka Botërore këto ditë dhanë alarmin. Prisni! Në shtator, me anketën tjetër, po përgatisni mashtrimin e ri. Bëjeni! Unë jam kundërshtari politik juaji. Kjo do t'ju kushtojë shtrenjtë mbrapa. Këtë e bëjnë vetëm ata që nuk e dinë se çfarë është rritja. Mashtrimin e rritjes e bëjnë vetëm njerëzit që nuk kanë konceptet më elementare makroekonomike. Do ta bëni, shumë bukur.

(Ndërhyrje nga salla.)

Do të dal unë edhe aty, prit! Shkove degë më degë, fole si kontrolli punëtor, more zotëri. Do të kthehem unë tek arsimit me shumë seriozitet, por po flasim për ekonominë.

Po lëri ato, se ato ishin të kontrollit punëtor. Kontrolli punëtor kishte alergjitë e veta dhe na i thoshte në çdo mbledhje kur na vinte.

Pra, sipas këtij zotërisë, rritja ekonomike është 10 herë më e madhe në prodhim sa në konsum, 20 herë më falni, sepse e ka 2,8. A ka mendje njerëzore që e të thotë një gjë të tillë? Ka njeri që ia bën vendit të tij një gjë të tillë? Këtë e bëjnë vetëm ata që janë në unitet absolut dhe nuk e dinë se çfarë do të thotë rritje ekonomike. Ke

bërë dhe *full bite*, shko merr pak statistikat e Gjergjit, shikoj! Fol me ta në grup. Ai ka bërë shkollë, nuk them se nuk ka bërë!

Kalojmë tek ekonomia, meqenëse po flet me krenari. A e dini ju se sa kanë rënë eksportet e naftës, kromit, mineraleve? Jua thotë Gjergji këtë, pasi i ka ai. Eksporti i mallrave thotë ai ka rënë minus 21%. Zotëri, merrni statistikën e mallrave “Made in Albania”. Vazhdoni dhe besoni lulet e këtyre ju! Sa është deficit i llogarisë korente? Deficiti i llogarisë korente është 26%, nga 12% që ishte.

(Ndërhyrje nga *salla*)

Po, po. Nuk ke faj ti, sepse nuk i kupton këto! Si është krediti për ekonominë? Ekonomia, thotë Banka e Shtetit, nuk kërkon, bizneset nuk kërkojnë kredi. Unë them atë që thotë Banka e Shtetit. Para 4 ditëve e ke komunikatën, zotëri.

Na thoni pak se çfarë po ndodh me këtë vend? 295 miliardë lekë kanë ikur nga Shqipëria, i ka përzënë, siç po përzë mijëra shqiptarë çdo muaj. Merrni statistikat dhe dilni këtu me shifra, asnjë gjë, absolutisht, asnjë investim, përveç atyre që lamë ne, ku edhe një pjesë e investitorëve po ikin.

Sot në zyrë kisha përfaqësuesin e “Devollit Hydropower”. Në prag të fushatës në Gramsh, në miting, ju thatë se Berisha gënjeu kur preu shiritin. Sa ka investuar, thoni ju, “Devollit Hydropower? 350 milionë euro ka investuar në dy vjet. Sa po punohet në Gramsh? Kush është deputeti i Gramshit këtu? 2 mijë punëtorë janë në hidrocentralin e Devollit nga Moglica. Këto janë reale. Bëni *check up*-in në tatime. Shkoni te hidrocentrali i Fanit, sepse flet për zhvillim ky! E vetmja fjalë që nuk e di se çfarë do të thotë, është fjala zhvillim. 35 kilometra tunel përfundojnë shpejt. Banja përfundon në muajin shkurt pothuajse dhe kërkon muajt e mbushjes së liqenit. Në Moglicë ka filluar punimet diga më e lartë në Europë e asfalt-betonit. Po këto nuk i kupton ti! Nuk mund t’i kuptosh ti, sepse janë të komplikuar, nuk janë bojëra dhe ngjyra, janë ekonomi dhe zhvillim!

Po ju flas për zhvillimin. Flet për 7 projekte. A e dini ju që në vitin 2005 interneti në Shqipëri ishte molla më e ndaluar. Sa ishte? Shkoni dhe merrni statistikat e ITU-së: ishte 4,8% dhe arriti në 63%.

Është kollaj të rrahësh gjoksin me punën e të tjerëve, por duhet të mburresh me punët e tua.

Ti mburresh me zhgaravinat tablo që nuk t’i ble njeri. Përdor pushtetin për t’u bërë piktor, e kam thënë dhe e them 100 herë. Sigurisht, po të shkosh si Kryeministër dhe t’ju kërkosh të hapësh një ekspozitë, hape do të thonë. Ky mendjen te boja e ka, nuk e ka te puna.

Dëgjova një ministër dje, i cili tha: “Jo, nuk e prek fasadën ajo mballoma plastike”. Turp i madh! Ajo nuk është shtëpia jote! Nuk bëhet kurrë ajo që ti i bërë asaj godine, që t’i vësh plastikë me neon dhe ta shesësh për ar. Shko çoje në fasadën e një banjoje publike, por as aty nuk ta lënë! Kujt i thua ti? Ti vetëm kulturë nuk jep, absolutisht. Gjen ndonjë gazetar, të cilit i mbush mendjen se ndërtesa e Gheraldo Bosio qenka vepër e komunizmit. Mashtrim total! Ti ke mashtruar botën, si nuk mund të mashtrosh një gazetar të “Financial Times”-it. Pse e thotë këtë? Unë ta them ty, por po ua them edhe shqiptarëve, se ajo është një nga ndërtesat më të mira qeveritare që mund të bëhet. Dinjitoze. Çdo kryeministër që është futur aty, ka shprehur vlerësimet më pozitive. Nuk ka ndërtesë më të mirë. Ndërsa, zotëria, tani për të justifikuar mballomën që ka vendosur në hyrje, u thotë: “Është një zymtësi e komunizmit dhe unë po e rinovoj”. Ti mashtron botën, jo të mos mashtrosh një gazetar! Atje me gazetarët mund ta bësh, por këtu jo, se nuk të lëmë ne. Po gazetari që u shet shqiptarëve ndërtesën e Kryeministrit, të Gheraldo Bosio, për trashëgimi komuniste, është fatkeq, është viktimë e një mashtruesi të specializuar!

Pra, kemi të bëjmë me një paradë mashtrimesh. Ndonëse jeni përpjekur të bëni shumë, por shumë më tepër duhet të bëni për arsimin. Kjo nuk ka diskutim. Por vetëm një gjë: ka rekorde dhe nihilizmi yt përplasat me to dhe dështon. Këto rekorde janë: 70% e mësuesve në zonat rurale, 38% e mësuesve në shkollë kombëtare në vitin 2005 ishin pa arsimin përkatës. Mësuesit largoheshin masivisht nga profesioni. Pse? Sepse rrogat e tyre ishin absolutisht të papërbalueshme për jetën. Çfarë bëmë? Rritëm rrogat nga 120 deri 150%, aty i ka. Por çfarë ndodhi me këtë që bëmë ne? Ndodhën dy gjëra: së pari, u ndërpre largimi nga arsimit.

Së dyti, u përmirësua, duke zbritur në 10%, unë i besoj statistikës, sepse kjo zonja ka deklaruar që kanë gjetur 4 mijë mësues pa arsimin përkatës. Po, zonjë, gjete 4 mijë, por kur

e morëm ne ishin më shumë se 20 mijë dhe zbriti në 4 mijë. Ti mund ta çosh me poshtë: nga 4 mijë, çoje në 2 mijë. Është më se normale kjo, është proces. Për të shkuar dhe për të inauguruar ato që janë ndërtuar gjatë periudhës sonë, shko dhe rreh gjoksin, si investim i kohës tënde, që nuk ke asnjë lidhje me të, përveç shitjes së ndonjë pikturë aty. Ndërsa kur vjen puna për të përmendur të tjerat, këto nuk i përmend, sepse nuk të lë nihilizmi, verbëria ndaj kundërshtarit, kjo është e gjitha.

Së dyti, merrni statistikën. Në vitin 2005 në shkollat e Shqipërisë kishte gjithsej 960 kompjuterë me inventarë. E dorëzuar me 24500 kompjuter në të gjitha shkollat e vendit.

(Ndërhyrje nga salla)

Sigurisht, ti je mjeshtër i prishjeve, ekspert i prishjes, duke futur programet e tua, si puna e skanerëve. Ti prish edhe skanerët!

Ilir Meta – Ju lutem, mos ndërhyjni!

Sali Berisha – Së treti, sa ishte stafi i shkollave të larta në vitin 2005? Merrni statistikën, ishin 5600 asistentë dhe pedagogë. Sa ishte stafi në vitin 2013? Ishin 11600 asistentë dhe pedagogë. Sa ishte në tërësi rekrutimi? Mbi 30% e tyre ishin doktoruar jashtë shtetit dhe u rekrutuan mbi atë bazë. U vendosën stimuj, u vendos programi i ekselencës, ku kanë përfituar edhe fëmijët tuaj, por me shëndet se e kanë merituar. Mbi bazën e konkursit përzgjedhës dhe atë program qeveria shqiptare paguante për më të mirët, të cilët fitonin shkollimin në universitetet më të mira. Nuk e di se çfarë keni bërë me të?

Së katërti, shkollat ishin haure, një tmerr për t'u parë. 1360 shkolla u ndërtuan apo rindërtuan, mbetën 300-400, ku shkonte Marini, a ju kujtohet? Këtu foli si Kallaku, çonte Marini "Shqipëria tjetër", ja ku është kjo shkollë që i ka rënë dritarja! "Shqipëria tjetër" a ju kujtohet emisioni? Unë nuk them që nuk ishin, nuk i shpikte ai, por rëndësi ka që janë rindërtuar 1360 shkolla, kopshte dhe objekte arsimit.

Ai flet sikur nuk ka jetuar kurrë në këtë vend. Mohon si nihilist, duke dëshmuar. Mos harro se nihilistët janë tabula rasa. Ai që është nihilist, nuk di asgjë, por duhet të ruhesh shumë prej tij. Vazhdo sa të duash, sepse mua më vjen mirë kur shoh nihilistë, ç'është e vërteta.

Në Shqipëri u ftua kompania gjermane, ndër më seriozet në Europë, për Rateingun, i cili u bë. Përmende këtu ti një ish-këshilltar timin.

Unë të garantoj se i gjithë ky kabinet që unë kam mbrapa, nuk kanë as gjysmën e njohurive të tij në arsim, as në fushën e tij. Bardhyl Musai është një nga njohësit më të shkëlqyer të arsimit në Shqipëri, të cilit ia mbyllën universitetin me urrejtje patologjike, një universitet (ishte një shkollë për kualifikimin e mësuesve), me vlerësimet më të larta. Ata që nuk u ndalën, pasi i udhëheq urrejtja, hodhën poshtë çdo gjë. Bardhyl Musai ishte njëri nga novatorët më të kryesorë të transformimit të kurrikulave në këtë vend. Për sa i përket konfliktit të interesit, institucionet shtetërore dhe funksionarët më të lartë të shtetit që janë sot në detyra, kanë certifikuar se ai nuk kishte asnjë konflikt interesi. Po si mund të flasësh për konflikt interesi kur ministrat tuaj ua japin vëllezërve tenderat, kur kompanitë e ministrave bëjnë kërdrinë me fondet publike, kur i ndërrojnë emrat e kompanive 3 herë brenda ditës?

Tani le të kthehemi pak te arsimit dhe tezat e tij. Nuk ka asnjë vend në botë në dijeninë time, por dhe mund të ketë ndonjë, që nuk ka sistem korrespondence. Ku bazohet sistemi i korrespondencës? Bazohet në filozofinë e hapur të shoqërisë ndaj atij që nuk ka kurrfarë mundësie të ndjekë ditën shkollën. Ndaj atij që është detyruar për të rritur fëmijët, për të mbajtur familjen dhe për një seri arsyesha ka ngelur i pashkolluar, tani i krijohet mundësia. Në qoftë se më gjen një vend të zhvilluar që ka ndaluar këtë sistem, unë do ta studioj me shumë interes. Unë jam marrë me këtë problem. Unë e kam gjetur atë kudo, përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që unë e mbaj si vendin me arsimin më të zhvilluar, përfshirë sistemin part-time. Ti ke alergji ndaj arsimit, more zotëri! Një praktikë botërore. Hajde ta përmirësojmë, por nuk e sulmojmë, sepse çfarë kërkohet? Kërkohet të merren ca dije më shumë.

Ke shtruar një tezë, por nuk mendon, se po të mendosh, nuk e shtron dot kurrë. Ke shtruar një tezë ku thua se Berisha kryeministër i mbushi universitetet për të blerë kohë. Po mirë, Berisha opozitë që po kërkon për të mbushur universitetet, po e kërkon këtë për të blerë kohë për ty? A e mendon një gjë të tillë kur i thua gjërat? Pse, për të blerë kohë punoi qeveria? Jo, more zotëri! Ka interesa shumë më të mëdha, shkollimin. Nuk janë marrë as atëherë për të blerë kohë, nuk insistoi as tani për të blerë kohë

kjo qeveri, por insistoi që renta universitare e fëmijëve shqiptarë duhet të respektohet. Jo të veprsh me modelin dhe parimin e vjetër.

Sigurisht i rritur në parajsën e Bllokut kurrë nuk mund t'ia dish të varfrit. As nuk mund të arrish të konceptosh se arsimiti, një nga misionet e tij kryesore ka luftën kundër varfërisë. Kujt i thoni ju që nuk rriten çmimet? Këto janë gënjeshtër cinike. Apo të gënjejmë se burri duhet të gënjejë, mund të gënjejë? Jo, burri nuk duhet të gënjejë! Përderisa ligji ia jep të drejtë fakultetit, 8 vjet rresht, jo nga fakultetet, por me Ministrinë e Financave dhe me një pjesë të ministrave, të cilët janë përballur me çdo mbledhje për tarifën, sepse donin t'i rrisnin, gjersa bëra vendimin se nuk mund të rriten, përveç inflacionit. Pse e bëra këtë? Nuk kishte nevojë qeveria ime për para? Shumë. Por, sepse tarifën e universiteteve, kështu siç janë, janë 2 deri në 5 herë më të larta nominalisht në proporcion me çdo vend të Europës, përveç Britanisë së Madhe.

A e dini ju që shqiptarët paguajnë më pak në Itali, në Austri, në Gjermani sesa në fakultetet këtu në Shqipëri? Qartësisht më pak. Absolutisht po. Këto nuk i dini. Futuni në internet, i ke të gjitha të shpallura. Në Slloveni paguan 30 dollarë. Në Suedi nuk paguhet fare. Në Francë shumë pak, ose hiç. Në Austri pothuajse fare për vendasit. Të huajt paguajnë 300 euro.

Nuk ecet në këtë mënyrë. Por t'ju lësh fakulteteve, fakultetet caktojnë shifra katastrofale, të papërbalueshme. Ke futur sistemin e kredisë. E theksova dhe më parë. Kush dënohen? Të varfrit. Ata nuk marrin dot kredi. Ata nuk kanë sepse kanë një korrektesë. Ai nuk mund të marrë kredi sepse nuk e paguan dot. Nuk e bën dot ai atë. Ai e lë fëmijën pa shkollë dhe i thotë vajzës, djalit, se nuk mund ta shkollojë, se kërkojnë 1500 euro.

Por do të ndalem edhe diku tjetër. Në vendet ku funksionon kredia, bordi studentor është bërë një problem madhor. Është bërë një problem madhor, lexoni ka shkrime të pafundme. Në Shqipëri borxhi është absolutisht një problem madhor. E bëtë ju. E morët me 62 e keni sot 74, dhe çfarë bëni? Kabinetin, sipas Bankës Botërore, sipas FMN-së, sipas të gjitha institucioneve, e ka dorëzuar me 62. Tani e keni 74. A e dini pse e pësoi Greqia, e cila e kishte 100% ose 120%? Pse nuk e pëson Japonia që e

ka 200%? Pse nuk e pëson Britania e Madhe, që e ka shumë më të lartë? Pse nuk e pëson Gjermania që e ka mbi 80%? Zotërinj, nuk pësojnë asgjë nga borxhi ato vende të cilat prodhojnë, krijojnë dhe paguajnë borxhin. Por ato vende ekonomia e të cilëve është e brishtë, ato falimentojnë nga borxhi. Greqia nuk falimentoi për arsye tjetër. Ky është shkaku më themelor i falimentimit.

Çfarë do të thotë të fusësh kredinë për studentët? Do të thotë 200 milionë euro më shumë borxh në vit. Në 5 vjet do të thotë 1 miliard euro. Ka këllqe ky buxhet dhe kjo ekonomi për ta përballur këtë? As që pyesni fare. Për çdo gjë keni folur këtu, por nuk keni folur për koston e këtij projekti aspak. Pse? Sepse absolutisht do të kufizoni në maksimum numrin e studentëve, do përjashtoni të varfrit nga shkollimi. Arsimiti e ka mision atë, por natyrisht pse do të pyesni ju për të varfrit kur jeni rritur në Bllok? Në një kohë kur të tjerët sëmureshin nga pelagrat, se hanin vetëm bukë misri, kripë, një litër vaj dhe një kilogram sheqer në muaj, ai pinte qumësht dallëndysheje. Ai nuk mund t'ia dijë të varfërve kurrë.

A ka probleme? Absolutisht që ka probleme. Dhe nuk zgjidhen problemet duke e komplikuar shumë më tepër, nuk zgjidhen problemet duke goditur trendin, se prapë ne kemi numrin më të ulët të të shkolluarve për frymë në Europë. Nuk zgjidhen problemet duke marrë një kompani dhe merresh vesh me të që t'i mbyllë të gjitha.

Të kthehemi tek ajo kohë kur vetëm fëmijët e një kaste, pavarësisht nga mësimet, ndiqnin universitetet, kurse të tjerët duhet të ishin të shkëlqyer që të mund të trokisnin në dyert e tyre. Mendoj se duhet ta shqyrtonit këtë moment. Shkelmoni me këmbë, duke votuar këtë ligj, jo vetëm ëndrrën universitare të të rinjve shqiptarë, por shtoni mjerimin në të gjithë zonën verilindore dhe juglindore të vendit, që nuk do të mund të shkollojnë fëmijët e tyre. Detyra juaj është që ta konsolidoni këtë trend, por jo ta ktheni drejt së shkuarës, drejt koncepteve atërore të dikurshme. Nuk mund të jetë universiteti mollë e ndaluar për një fëmijë. Ajo ditë që universiteti do të shndërrohet mollë e ndaluar për një të varfër, ajo është ditë mjerimi për dijen e kombit. Ajo është ditë trishtimi. Lexoni pak, se ka prej jush këtu pedagogë. E dëgjova dhe atë

zonjën, nuk po ia kthej, se e teproi shumë me mënyrën si u shpreh, por sot i bëj thirrje arsyes së këtij parlamenti ta hedhin poshtë këtë ligj. Ky ligj ndëshkon mbi 20%-30% të popullatës shqiptare, që nuk do të mundë të shkollojë fëmijët e tyre me kreditë që ofron qeveria, të cilat minimumi janë 1500 euro në vit, janë 6 mijë euro në 4 vjet. Nuk është ky misioni. Mos e lini këtë proces jetik për kombin në dorë të një njeriu që nuk ka konceptet më elementare të shkollimit dhe arsimit, të një njeriu që vjen dhe thotë gjëra këtu që nuk di se çfarë thotë. Se po të dinte, nuk mund t'i thoshte, se përgënjeshtro veten e tij. Nuk ka fatkeqësi më të madhe se kjo. Thirrja ime është që të mos e votojmë ligjin. Të shqyrtohen modalitetet dhe qëndrimet që do të garantojnë akses të plotë të të varfërve në universitete, të atyre që nuk kanë mundësi. Natyrisht mbi bazën e kërkesave të caktuara. Të përpunohen mekanizmat që garantojnë lirinë ekonomike, por jo t'i jepet një njeriu e drejta e emërimit të të gjithë drejtuesve, që nuk ndodh. Çfarë do të bëjë? Do të shkojë te kushërira të marrë listën e 8 mijë punonjësve, e 8 mijë aplikimeve dhe t'i emërojë siç i ka emëruar deri më sot.

Po të emërosh Gazhelin në krye të agjencisë së larjes së parave, nuk ka gjë më të paimagjinueshme, more zotëri! Vazhdoni, se mirë e keni.

Së fundi, kam dy gjëra për zgjedhjet. Meqenëse i djeg, se ka bërë dhunimin më të pashembullt në zgjedhje, i them më vjen keq që flas kështu, se nuk ishte për ta mbyllur. Këtë proces zgjedhor nuk do ta gëzoni.

Ilir Meta – Po.

Po, zoti Paloka.

Edi Paloka - Besoj është interesante edhe për deputetët e pranishëm që janë këtu ta dëgjojnë këtë regjistrim.

(Deputeti Edi Paloka paraqet një regjistrim audio me anë të celularit para foltores së Kuvendit)

Nuk e di a dëgjohet? Megjithatë do t'ua vë në dispozicion të gjitha mediave meqenëse nuk dëgjohet këtu.

E dëgjuat Kryeministrin, që lëshoi lloj-lloj epitete, sharje ndaj opozitës, ndaj profesorëve dhe ndaj të gjithë atyre, që e kundërshtojnë këtë projektligj? Ky zotëria, që po e kundërshton këtu quhet Ligor Nikolla, dhe është dekan i

Universitetit të Shkencave të Natyrës dhe bashkëshorti i ministres së Arsimit.

Nuk besoj se edhe ky ka mbledhur organizatën bazë për të bërë 15 vërejtjet që ka për ligjin dhe që ka paraqitur këtu, ndaj qytetarë të dashur. Kur këta nuk kanë arritur t'i mbushin mendjen atyre që kanë në shtëpi, imagjinoni se çfarë ligji po u servirin shqiptarëve.

Faleminderit!

Ilir Meta – Fjalën e ka deputeti Genc Pollo! Të përgatitet ministrja Mirela Kumbaro!

Genc Pollo – Faleminderit zoti Kryetar!

Zonja deputete, zotërinj deputetë,

Ishte rasti për të folur për projektligjin. Dëgjuam Kryeministrin, që foli për 45 minuta dhe vetëm 5 minuta ia kushtoi projektligjit, shpjegimit të synimeve që ai kishte si qeveri, si Kryeministër.

40 minuta u mor vetëm me të shkuarën. Kur je në opozitë, kur je në fushatë për të fituar, kur je dhe 3 muaj, por hajde t'ia bëjmë 6, të parët e qeverisë mund merren me kritikën e të shkuarës, me kritikën e kundërshtarëve në politikë dhe me të gjithë ata që nuk pëlqejnë, por kur jemi futur në gjysmën e dytë të mandatit dhe koha, norma, kultura e shëndoshë politike të kërkon që të japësh një bilanc, ajo që mund të them unë është se të gjithë ata, që duan të kenë një Kryeministër serioz u zhgënjyen. Të gjithë ata, që dëshirojnë të kenë një Kryeministër, i cili të tregojë rrugën drejt së ardhmes, u zhgënjyen. Të gjithë ata, që shpresojnë të kenë një Kryeministër, që bën një punë për këtë vend dhe për këtë shoqëri, gjithashtu, u zhgënjyen, por jo, ata që kanë votuar Partinë Socialiste, që duan të kenë një Kryeministër që bën gallatë, ata nuk u zhgënjyen, madje u kënaqën, që tregon barsoleta, që shpreh batuta të cilat i ka menduar 24 orë para me një pasion të jashtëzakonshëm. Të gjithë ata janë kënaqur.

Arsimi lartë dhe ligji i tij nuk besoj se janë shërbyer si duhet sepse ishin një koleksion faktesh pjesërisht të vërteta, të cilat ishin shkëputur nga konteksti. Vetëm potpurisë dhe gallatës mund t'i shërbejnë. Gjithashtu, kishte një mosnjohje reale e një teksti, që ka ardhur këtu prej disa muajsh dhe është diskutuar në komisione dhe diskutohet edhe sot. Ky është profili psikologjik dhe për këtë nuk duhet t'i vëmë kujt faj, por do shihet se çfarë është bërë deri tani. Ka qenë mallkim, ka qenë nxirje, ka

qenë sterrë dhe ligji do shuhet komplet, nuk ka më vazhdimësi. Ka vetëm një revolucion me “rr” të madhe. Kemi kaluar 48 orë në mënyrë të panevojshme, 48 orë pa ndërprerje, dhe pandërprera është e panevojshme në komisionin për arsimin, sepse qeveria donte ta kalonte shpejt e shpejt, fshehtëzi, por nuk ia arriti se nuk e la opozita.

Kam pyetur rregullisht përfaqësuesit e arsimit që kaluan natën bashkë në komisionin se çfarë ndryshimi ka ky kapitull nga ky tjetri? Dhe në përgjithësi ishin sistemime, bërje grupi me ndryshime, dakord disa për të mirë dhe disa për keq dhe me dy kapituj të rinj. Vetëm dy kapituj, përbëjnë revolucionin e qeverisë “Rama” në arsimin e lartë, kapitulli i administrimit financiar dhe shumë i famshmi kapitulli XII, që lejon institucionet e arsimit të lartë privat, pra universitetet private që nëpërmjet disa procedurave të kthehen në publike të pavarura dhe të përfitojnë nga paratë e taksave, të përfitojnë nga buxheti i shtetit. Këto janë dy ndryshimet, tek të cilat vetëm ministrja, që nuk u ndal sa duhet te këto, por as Kryeministri nuk i tha, madje nuk i përmendi fare, por tregoi gallata e qyfyre, foli për arka me dru, për makina të përdorura, foli për rrush, për melaninë dhe nuk foli konkretisht se çfarë pasoje do të sjellë ky ligj. Ndoshta nuk e di se çfarë pasoje. Ndoshta dhe nuk di dhe nuk i kupton. Unë mendoj se disa gjëra i di mirë, pasi kanë qenë të piketuara që në fillim dhe është përtej qesharakes të thuash: e majtë, e djathtë përkrahje privatit, përkrahje publikut. Këtu kemi të bëjmë me mënyrën se si i shërbehet interesit publik apo si nuk i shërbehet atij, se në fund të fundit universitet private ishin para 2005-ës, u shtuan dhe arritën jo atë numër dramatik prej 44 copë, që është mënyra e gabuar për ta matur, por për faktin që vetëm 15% e studentëve studionin në institucione të arsimit të lartë privat. Kjo është e vërteta dhe në një mënyrë ai e tha, dhe, gjithashtu, tha edhe se brenda këtij grupi privat 100%-shi kishte një pjesë që ishin universite të mëdhenj, kishte dhe disa më të vegjël.

Ku është problemi këtu? Mbylli 2 të mëdhenj, ose një të madh dhe një gjysmë të madh dhe përsëri me projektligjin që ka sjellë ka lejuar, ndoshta në mënyrë të drejtë, që të ekzistojnë edhe ata të vegjlit, por që janë të fokusuar në një fushë. Me një dorë e jep, me

tjetrën e merr. Me një dorë të gënjen, me tjetrën pohon. Ky ishte prezantimi që bëri.

Çfarë ka tjetër ky ligj? E them sërish, kapitulli financiar është një kapitull që do të jetë me pasoja sepse fut një skemë të re, e cila do të ishte shumë e thjeshtë për çdo qeveri, që nuk do t’i shpenzojë paratë për arsimin. Shumë e thjeshtë për një qeveri, që në fyerje të ndërgjegjes dhe të fjalës premtoi që financimin për arsimin ta çonte në 5% të prodhimit të brendshëm bruto. Aktualisht jemi në vitin e tretë të qeverisjes dhe ka mbetur 2,7%. Çfarëdo akrobacie ligjore, çfarëdo norme në ligj, çfarëdo institucione hibride të shpikë qeveria, në qoftë se financimi mbetet në këto nivele, nuk ka as edhe një shans që në mënyrë sinjrikative të kemi jo revolucion, por edhe një evolucion të butë drejt cilësisë, drejt përshtatjes me tregun, drejt standardeve europiane. Kjo është e vërteta faktike dhe për këtë gjë nuk foli asnjë fjalë as ministrja dhe as Kryeministri. Folën për qyfyret e të shkuarës duke marrë fakte, duke i nxjerrë nga konteksti dhe duke paraqitur tablonë e madhe, mjeshtëria në të cilën shkëlqejnë, por nuk folën për thelbin, që mund të ketë nevojë për t’u ndryshuar dhe për të riparë një ligj, që është bërë 8 vjet më herët kundrejt një shqyrtimi të situatës në terren, të nevojave reale të pedagogëve dhe studentëve, të nevojave reale të shoqërisë shqiptare, por pa rritur financimin dhe pa aplikuar fondet publike në mënyrë korrekte edhe aty ku kjo nuk ndodh. Duke e shtrënguar herë me të butë dhe herë me të fortë kjo nuk ka se si të ndodhë.

Kush e mban këtë barrë, nëse duam jo vetëm të mos e rrisim 5% e GDP-së aq sa premtuan, por ta mbajnë te 2,7% dhe brenda kësaj shifre 0,4% e GDP-së është arsimi i lartë? Atëherë, ku do ta shtrydhim? Ku do ta nxjerrim parinë? Kujt do t’ia marrim? Është target i kollajshëm, ranë mollët që varen poshtë. Janë studentët, që duhet të paguajnë, që me një skemë të re financohen dhe mbështeten degët prioritare dhe këtu nuk ka asnjë gjë të keqe, mbështeten studentët e ekselencës dhe ata të vobektët, që meritojnë të futen në arsimin e lartë dhe këtu ka qenë dhe nuk ka asnjë gjë të re.

Për të gjitha degët e tjera, dhe listën e tyre do ta caktojë qeveria me vendim të Këshillit të Ministrave, tarifat e shkollimit nga një mesatare prej 230 mijë lekë të vjetra, që e ka sot

Universiteti Tiranës, mesatarja e përafërt që e kanë edhe Universiteti Politeknik dhe Bujqësori, ato të rretheve mund ta kenë diçka më poshtë, te 180 mijë apo 175 mijë lekë të vjetra, do të shkojnë 200, 300 apo 400 mijë lekë të vjetra vetëm e vetëm që të kursejë nga buxheti, që ta çojë te palmat, ose te projektet e tjera që i pëlqejnë atij dhe po e them në mënyrë figurative.

Kjo është e vërteta e thjeshtë e këtij ligji. Të gjitha të tjerat janë butafori, por Edi Rama shkëlqen. Të gjitha janë llafë boshe për të mbushur orarin e atyre që me të drejtë duan të dëgjojnë parlamentin. Fakti është që një barrë e tillë është relativisht e rëndë, është e rëndë edhe për familjet e shtresës së mesme e deri diku ndoshta jo shumë për ato që janë pak më të kamura, por për një situatë sociale siç ka sot Shqipëria ku varfëria me gjithë treguesit, përfshirë edhe ato të institutit të statistikave, është në rritje, është në migrim nga zonat rurale drejt periferive qytetare, është në rritje sepse edhe papunësia është në rritje, është në rritje sepse edhe prodhimi i brendshëm bruto po stagnon dhe nuk ka rritje, pavarësisht falsifikimeve.

Të ndërtosh familje pa një të drejtë bazë është shumë e padrejtë, është jokorrekte, është politikë e gabuar dhe nuk po them se është një parti e majtë, se ndoshta nuk ka lidhje fare ky koncept, se kush është vërtet i majtë në këtë sallë do t'i vinte zor t'i dëgjonte këto fakte, të cilat nuk janë thjesht pohimet e mia, janë normat e ligjit, që sot shtrohen për votim dhe ky është problemi i madh i këtij ligji, krahas shumë e shumë të tjerëve.

Ndalemi tek ajo që është përmendur herë pas here, te klientelizmi. Tani t'i bëjmë gjërat e qarta. Jemi të gjithë dakord, se kështu dëgjova edhe nga bankat e qeverisë, që arsimit i lartë është një e mirë publike dhe kur këtë të mirë publike e prodhon edhe arsimit privat, të gjithë duhet ta përqafojmë dhe ta përshëndesim dhe ta ndihmojmë, por ka mënyra e mënyra se si kjo bëhet.

Në qeverinë e mëparshme privatët dhe publikët u barazuan. Ashtu si publikët, edhe privatët kishin akses në fondet e kërkimit shkencor. Po ashtu, nëse ka subvencionim apo garanci të kredisë studentore, gjithashtu, edhe studentët që janë te privati kanë në mënyrë të natyrshme të drejtën për të përfituar nga kjo

skemë për të financuar studimet e tyre, por që një institut i arsimit të lartë privat, i cili funksionon mbi parimin e profitit të fitimit, ku në fund të ditës, pasi ka paguar taksat, reston, fitimin neto pronari e fut në xhep, ta kthesh me skema pak të përdredhura në një të ashtuquajtur IAL, Institucion i Arsimit të Lartë Publiko-Privat dhe pastaj t'i hapësh derën e financimit publik njëlloj si universiteteve të Tiranës, si Politekniku, Bujqësori i Kamzës, ndërkohë që pronari pavarësisht se ka themeluar një fondacion prapë mbetet ndikues në administrim në universitet e financave të tij përmes strukturave ku ai komandon shumicën, kjo nuk është besoj rruga më e mirë për të përkrahur universitetet private. Nuk kemi dashur të jemi paragjyqes, dyshues me kapitullin XII ku përmbahet kjo procedurë dhe as me të gjithë ligjin, por kemi pritur shpjegimet për këtë dhe për gjëra të tjera. Dhe cili ka qenë shpjegimi i qeverisë? Kemi pyetur madje, kanë qenë jo vetëm deputetë të opozitës, por edhe të maxhorancës se cili është modeli suksesshëm që ju keni gjetur nëpër botë?

Përgjigjja ishte me gjysmë zëri nga një zyrtar i ministrisë, m'u duk se dëgjova për Portugalinë, pastaj tha se do e sjellim me shkrim. Nuk erdhi asnjë përgjigje nga ministria se ku e kishin gjetur këtë model të kthimit të universiteteve private në publike. Erdhi pastaj një sqarim nga kryetari i grupit të punës të caktuar nga Kryeministri, që e kishin në Angli, por në Angli, edhe materiali e thotë qartë, se nuk panë kthimin e privatëve në publikë, por panë publikë që ekzistojnë si *charitable foundations*, si fondacione bamirëse prej dy-tri shekujsh, në mos më shumë, të themeluara me një kartë ruajale, *royal card* apo gjëra të tilla, të njohura për shumicën e njerëzve që janë marrë me arsimin, asnjë argumentim sesi dhe pse duhet, që në këtë mënyrë një privat të përfitojë pasivisht, duke filluar nga rrogat e pedagogëve te shpenzimet operative, kur pronari i tij, në njëfarë mënyre, mbetet indirekt më shumë se direkt pronar. Përgjigje nuk morëm asnjëherë, dhe kur e morëm nuk ishte përgjigje, aq më pak të ishte bindëse.

Prandaj kritikohet për mënyrën sesi është bërë dhe prandaj ishte ai dyshimi fillestar, që ky projektligj ndoshta ka pasur një qëllim të caktuar dhe të gjitha të tjerat janë veshur rreth e qark tij, me mish e kockë, me këto shpjegime të mangëta

dhe me këto shtrembërime që i janë bërë. Për të dalë te problemet e tjera pa fund, sepse Kryeministri tha: “Do të futen në arsimin e lartë me standarde”, ç’kuptim ka fjala “standarde”? Futja e mesatares si kriter për pranimin, që ia tha edhe një dekan, i cili i përket një force politike në koalicion, se në qoftë se vihet mesatarja 6 për t’u pranuar në arsimin e lartë, nuk do të guxojnë, në shkollat tona të mesme, në klimën, në të cilët janë, me Lizat dhe ata që kanë emëruar Lizat të pandëshkuara, me politizimin dhe me favorizimin, të vënë nota 5. Në qoftë se kjo do të jetë përcaktuese, nuk do të ketë as 6-ta as 7-ta, do të ketë vetëm 9-ta dhe 10-ta. Presioni i jashtëzakonshëm do të korruptojë notat përmes trysnisë ndaj mësuesve.

Kjo është e vetmja gjë që keni bërë duke e kthyer kokëposhtë një sistem meritë-preferencë, i cili kudo në botë mund të kritikohet për një aspekt ose një tjetër, por në tërësi funksiononte, sepse bazohej në vlerësimin e jashtëm dhe jo në vlerësimin e brendshëm, që, për nga natyra, i nënshtrohet konfliktit të interesit.

Kjo është një reformë absolutisht korruptive dhe po t’i shtosh edhe problemet, festivalet e stadiumeve që kemi parë deri në vitin 2004 dhe vitin 2005 japin vulën e një vizioni korruptiv për arsimin. Po të shtosh edhe atë që u verifikua në vitin 2004, se listat e pranimit të studentëve ishin të sigluara nga FRESH-i dhe vetëm vuloseshin në Ministrinë e Arsimit, kjo i jep dimensionit korruptiv edhe atë partiak e abuziv në pranimet e arsimit të lartë, dhe kjo është e shkruar si e zeza mbi të bardhë në projektligj. Këtë nuk e thotë asnjëri, flasin për automobil të përdorur, flasin për verë dhe raki, por “gjënë” që na sjellin për votim nuk e përmendin, se nuk e dinë, se nuk e kuptojnë, se duan ta fshehin?! Kjo është diçka që, besoj se kush e ka ndjekur këtë debat, është në gjendje ta thotë fare mirë.

Zonja dhe zotërinj, rritja galopante e tarifave të shkollimit, që do të vijë përmes normave të këtij ligji, besoj se është mënyrë e dëmshme për shoqërinë në kushtet sociale ku ne jetojmë, por ndoshta është një mënyrë jo fort korrekte, madje e pandershme për të përafuar tarifën e shkollimit të shtetërori me tarifën e shkollimit të privatit. Ndoshta kjo më shumë sesa kapitulli 12 i transformimit, që do të ndodhë nga privatit të publiku është ajo që do të favorizojë në

mënyrë jo korrekte privatët, sepse, me sa njohim, me sa kemi parë, studiuar dhe krahasuar, vërtet që studenti mbart një pjesë të barrës financiare, që është proporcionale, por kjo në universitetet publike kudo në Europën kontinentale e më gjerë nuk barazohet me ato universitete që janë mirëfilli private, qofshin me fitim, qofshin këto fundacione *no profit*, ku të ardhurat investohen të gjitha në institucion. Ka një dallim të tillë, është një zgjedhje e qartë, është një zgjedhje e lirisë dhe e mundësisë së gjithsecilit, barazimi i tarifave që ky sjell, pra, nga 250 mijë kushton 300 mijë, 400 mijë, 500 mijë dhe t’i afrohem 1 mijë dhe 2 mijë eurove që kanë sot universitetet private, është një mbështetje e pandershme që u bëhet këtyre, sepse ky dallim duhet të ekzistojë dhe universiteti publik duhet të mbetet i tillë me të gjitha traditat që ka me Europën kontinentale. Dhe të shtojmë këtu edhe një lloj qasje refuzuese ndaj universiteteve të rretheve, ndaj atij të Shkodrës, që është më i vjetri i themeluar si institut pedagogjik, që sot mban emri universiteti “Luigj Gurakuqi”, tek i Korçës, “Fan Noli”, i Elbasanit, i Vlorës, që është themeluar në periudhën e demokracisë. Të gjitha këto janë universitete, që ndoshta me të drejtë, thuhet, se nuk i përmbushin dot disa nga kriteret. Po cila është rruga për t’i trajtuar ato, t’i vësh në satër, ose edhe më keq, t’u japësh zgjidhje midis vetëvrasjes me armë zjarri apo lakut, apo t’i ndihmosh financiarisht dhe strukturalisht, që ato të kapin 1, 2, 3 standarde, sipas rastit, që ato nuk përmbushin?!

Qeveria ka një tjetër zgjidhje, e ka gjetur kategorinë, e ka shkruar, quhen kolegje universitare, dhe e humbin emrin universitet, humbin atraksionin që kanë te publiku njësoj si shkollat profesionale, humbin disa të drejta të rëndësishme që universitetet kanë dhe futen në rrugën e degradimit, të shuarjes dhe të mbylljes, ndërkohë që në qendrat ku janë, përveç se janë një pol arsimor jo për t’u neglizhuar, janë edhe një motor social i rëndësishëm për mbajtjen gjallë të rinisë në një aktivitet të dobishëm për ata vetë, por edhe më gjerë, për shoqërinë. Mbyllja e këtyre universiteteve, shtoj edhe universitetin “Çabej” të Gjirokastrës, do të jetë një dëm i madh ndër dëmet e mëdha që ky ligj, nëse hyn në fuqi, do të sjellë për arsimin e lartë të Shqipërisë, për të vazhduar më pas te problemet e tjera që shtrohen në emër të

autonomisë. Natyrisht, ky është një koncept kompleks dhe autonomia do kohë për t'u adoptuar si kulturë, sepse si normë ligjore mund të jetë relativisht e lehtë për t'i adoptuar, por mënyra sesi parashikohet financimi, që nuk parashikon një garanci shtetërore, rrogat e pedagogëve permanentë, profesorë, profesorë të asociuar, doktorë, docentë, lektorë, po ia lë një kalkulimi të brendshëm, të ndikueshëm nga çdo lloj motivi, përfshi edhe motivet jokologjiale, mund të jetë gjithashtu një tortë me helm për universitetet, sepse çdo liri, çdo autonomi, çdo e drejtë jepet në mënyrë proporcionale më aftësinë, dhe ata që e marrin, kanë për ta menaxhuar. Heqja e përgjegjësisë, abdikimi i qeverisë nga mbajtja e thelbit të universiteteve, që është profesori, është, gjithashtu, një dëm tjetër i madh që i bëhet arsimit të lartë shqiptar, për të mos kaluar te gjërat e tjera që janë relativisht më teknike, si superpërgjegjësitë që merr departamenti, duke e lënë fakultetin një instancë të zbrazët tanimë, që nuk jam i sigurt që do të funksionojë, sepse ndihet një lloj zbalancimi në gjithë arkitekturën institucionale të institucioneve të arsimit të lartë.

Këto janë, zonja dhe zotërinj, një pjesë e shqetësimeve që ne i paraqitëm në komision. Kushdo që vlerëson apo edhe ironizon opozitën konstruktive, mund të dëgjojë që diskutimi në Komisionin e Edukimit, të paktën nga anëtarët e opozitës, përfshi edhe relatorët, zotin Tafaj dhe zotin Boçi, të cilët gjej rastin t'i falënderoj, ishte për të gjetur zgjidhje më të mirë, ishte për të ndrequr të keqen edhe në kushte të vështira, ishte për të paraqitur amendamente rregulluese, por edhe kundërshtuese në pikat themelore ku ne nuk biem dakord dhe ku paraqitëm pikëpamjen tonë në formë amendamentesh, dhe natyrisht, e pritshme kjo, u mbivotua.

Por, në fund të fundit, besoj që askush nuk mund të thotë se nuk e dëgjuam çangën e paralajmërimit të një problemi të madh, të një të keqeje të madhe, që po e bie arsimin shqiptar në trajtat e asaj që përshkova, sepse nuk është nisur thjesht nga nevoja e arsimit, nuk është nisur nga dëshira për të ardhme më të mirë të shoqërisë, nuk është nisur nga sfidat që Shqipëria, si vend i vogël në Europën Juglindore e më gjerë, has si çdo vend tjetër i krahasueshëm me ne, por është nisur nga inati i verbër për të bërë zero të kaluarën, aq sa mundet, të paktën edhe verbalisht

dhe për të zgjidhur dy-tri probleme të tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me interesin publik. Prandaj ky ligj duhet të kundërshtohet edhe sot, por edhe nesër dhe pasnesër, sepse ky kundërshtim është shërbimi më i mirë që i bëhet interesit publik.

Faleminderit!

Ilir Meta – Faleminderit!

Fjalën e ka ministrja e Kulturës, zonja Mirela Kumbaro. Të përgatitet deputeti Luan Rama. Më pas deputeti Luçiano Boçi.

Mirela Kumbaro – Të nderuar deputetë,

Po e marr fjalën sot jo aq si ministre sesa si universitare. Kam 28 vjet që jap mësim në Universitetin e Tiranës duke e vëzhguar deri në detaje sistemin. Kjo periudhë e gjatë më jep mundësinë, në njëfarë mënyre, ta shikoj mirë sesi ka evoluar dhe sesi funksionon vota universitare në Republikën tonë, por edhe si ka vuajtur dhe si vuan.

Në këta 2 vjet, kur qeveria dhe ministrja Nikolla posaçërisht ndër morën punën për kryerjen e reformës në arsimin e lartë, theksoj, reformë në arsimin e lartë dhe jo ndryshim i statusit të këtij apo atij universiteti, ishim të bindur se kjo reformë ishte urgjente, e domosdoshme, pa kthim dhe natyrisht e vështirë për të gjithë. Degradimi i situatës së arsimit të lartë, këtu nuk e pranoj argumentin që nuk do t'i ktheheni asaj që ndodhi, sepse nuk ka kuptim, nuk flasim për reformë, flasim për kozmetikë dhe nuk duam një të tillë, pra, degradimi i situatës së arsimit të lartë në publik dhe në privat në 25 vjet është bërë kaq evident dhe i përditshëm sa, për fat të keq, na duket edhe si normalitet, duket sikur u mësuam me të. Kjo është tragjike!

Të gjithë e kujtojnë historinë e Troftës, djali i politikanit italian që ra në rrjetën e drejtësisë italiane. Në Shqipëri plasën diskutimet dhe habitë, por protesta nuk pati. Sinqerisht do të preferoja shumë që të kishte qenë e kundërta, që rrjeta të kishte qenë shqiptare dhe më pas le të bënin italianët galletë me ne, por ata galletën e bëjnë. Po a i hyri ndokujt ndonjë gjemb në këmbë? Askujt.

Do t'ju kërkoja, të nderuar deputetë, ta shikojmë të vërtetën në sy! Ka ardhur koha që jo vetëm ta pranojmë me veten, por ta themi këtë të vërtetë me zë të lartë. Do të bëjmë universitet, apo do të bëjmë sikur u qajmë hallin studentëve?

Do të bëjmë sikur u qajmë hallin universiteteve publike? Sikur u qajmë hallin prindërve?

Unë kam punuar gjithë jetën me studentët dhe vetëm në universitet publik, jam edhe prind. Ajo që unë besoj se duhet të na interesojë nuk është thjesht pyetja “universitet publik, apo privat, student, apo pedagog”, por arsim i lartë si sistem vlerash, si politikë zhvillimi, si themel e ekuilibër midis të ardhmes së shoqërisë dhe interesave të ekonomisë. Por çfarë kemi bërë? Çfarë bënë të gjitha qeveritë, dua të them, në dy dekada? Procesi i Bolonjës u fut në zbatim fill pasi ishte ratifikuar në vitin 2003, por ne as nuk arritëm ta studionim mirë atë ndryshim jo më të parashikonim mundësitë, kapacitetet, tregun, prirjet, sepse me ngut na u desh t’i nxirrnim teshat nga sëndukët e sistemit 4-vjeçar për t’i paketuar sipas formatit të ri me kartë Bolonje. Në rrugë e sipër filluan të shikonin se nuk i kishin palosur mirë, se disa ishin vjetërsuar aq shumë sa duheshin bërë të tjera, se tregu i punës kishte ndryshuar e ne nuk ishim gjëkund. I nxorëm prap e prapë i ndryshuam, eksperimentuam me veten, eksperimentuam me studentët, me diplomat, me taksapaguesit.

Në vitin 2005 kujtoj shumë mirë vullnetin e ish-Ministrisë së Arsimit të sapo ardhur për të bërë ndryshime të thella. Jemi konsultuar jo pak për këtë asokohe, por ai vullnet nuk u përkthye dot në një politikë të qëndrueshme. Mbase nuk e lanë ta bënte. Me këmbënguljen e pedagogëve e të studentëve fituam zgjedhjet si model qeverisje në universitet dhe kjo është një vlerë që mbetet. Në vitin 2007 u bë i domosdoshëm hartimi i një ligji të ri, i cili më shumë u debatua për formën e mandatet e zgjedhjes së drejtuesve me emra të përveçëm, sesa për ndryshimet e mëdha që do të duhej të sillte në arsimin e lartë dhe në kërkimin shkencor. Mirëpo për të përshtatur programet e kurrikulat e reja na u lanë në dispozicion veçse fare pak javë. Prapë u nxituam dhe vetëm dy vjet më pas, ligji na doli problematik, i pazbatueshëm dhe u desh të amendohej sërish në vitin 2010, sërish në vitin 2011, se helbete ndryshuan emrat dhe sherri përfundonte vetëm në interesa emrash konkretë, në mandate dhe në emra qelqesh.

Gjatë mandatit të parë, qeveria pararendëse u turr me një politikë super populiste duke hapur universitete në çdo gjimnaz. Në të njëjtën kohë, liberalizohen licencat për universitetet private, që u shtuan si kërpuhat, duke konfirmuar nga ana

tjetër se sa fitimprurës ishte ky biznes që, në fakt, e nxirrte paranë pa e shitur mallin, biznes i ndërtuar sipas atij modeli, pa u dhënë asnjë garanci shqiptarëve se si ta administrojnë buxhetin e tyre për arsimimin e fëmijëve.

Institucionet e arsimit të lartë privat ofruan një alternativë, është e vërtetë, në shkollimin universitar. Po. Plot 48 të tilla u licencuan në dhjetë vjet, përveçse dhjetë universitete të tjera publike, pa llogaritur këtu edhe disa filiale të hapura në Kukës, në Sarandë, në Fier, në Berat, shëtitën gjithandej. Të gjitha këto vetëm për më pak se 3 milionë shqiptarë, pa llogaritur këtu që mijëra studentë shkojnë çdo vit për studime jashtë shtetit.

Për vite të tëra nuk pati asnjë statistikë dhe asnjë të dhënë mbi diplomat e as punësimin e tyre, asnjë marrje përgjegjësie, as në publik dhe as në privat, me përjashtim të ndërgjegjes individuale të ndonjë drejtuesi apo të pedagogëve.

Çfarë duhet të bënte një prind në ato kushte? Kishte rreth 50 universitete në listë, nga Burreli në Berat, nga Kukësi në Sarandë, nga sheshi “Nënë Tereza” në Kashar; kë të zgjidhte, si t’i zgjidhte, si t’i dallonte? Ngado hidhje sytë, bombardohesh me publicitet universitetesh si në supermarkete, madje, nëse e ndaje mendjen shpejt, kishe edhe oferta. Po të shkoje i pari, kishe 20% ulje; i gjeni në internet këto, nëse çojë edhe ndonjë shok, të jepnin edhe një semestër falas; duke paguar gjithë vitin menjëherë, mund të kishe zbritje 10% të tarifës ose të ofronin edhe kursin e makinës falas. E thënë shkurt, një tmerr, se ky quhej universitet në mes të qytetit. Një tmerr dhe tetë vjet u gënjyen shqiptarët duke u premtuar vlerësim dhe rankim, i cili kurrë nuk u bë. Tashmë gjashtë breza u kthyen në kavie të atij eksperimenti të madh që quhet arsimit i lartë.

Objektivi i qeverisë pararendëse ishte 150 mijë studentë në fund të mandatit, që do të thoshte rreth 4% e popullsisë që do të kalonin në atë laborator njerëzor pa ditur se si do të dilnin, me çfarë diplomash, në cilin treg pune.

Dhjetë vjet rresht kam firmosur personalisht shtatë tipa diplome, që njëra nuk ngjasonte me tjetrën. Bombë me efekt të vonuar, e kam quajtur diku këtë fenomen, dhe prit se ndoshta nuk ia kemi dëgjuar ende avazin.

Nuk po prek këtu historinë e sistemit “part-time”, që ka prodhuar diktaturën e mediokritetit.

Po si vallë nuk u tronditën për të gjithë ata studentë që jo vetëm paguan para, vetëdije, por as dije nuk morën? Pa përmendur kërkimin shkencor, që jo vetëm ka lënguar, por edhe ka shpërdoruar frikshëm buxhetin që familjet shqiptare, por edhe taksapaguesit shqiptarë kanë harxhuar për edukim.

Dyndja, në fakt, për tituj akademikë vazhdon ende sot që flasim. I kemi të gjitha dosjet njëra pas tjetrës nëpër senate me shpresën që t'i marrin sa ende nuk ka hyrë në fuqi ligji. Kjo është mungesë e plotë përgjegjësie nga vetë trupat akademike.

Sa për qind e këtyre doktoratave në vite janë përdorur? Kuji i kanë hyrë në punë? Sa prej tyre janë verifikuar nëse janë plagjiatura ose jo? As edhe një. Po, kjo është antikombëtare.

Sa do të vazhdojmë të gënjejmë vetveten? Kjo nuk është autonomia akademike, kjo është ngopje me lugë të zbrazët dhe me paratë e taksapaguesve.

Arsimi është nga ato çështje kombëtare që kërkon strategji afatgjata. Nuk mund të ndërtohet strategjia e arsimit të lartë mbi baza mandatesh katërvjeçare që vijnë me lulet e fushatës pararendëse dhe duan të dalin me disa dafina për fushatën pasardhëse. Kjo do guxim. Këtë guxim treguam se e kemi, duke propozuar këtë ligj, i cili jo vetëm garanton pavarësinë akademike, e forcon atë, por jep edhe lirinë financiare për menaxhim, liri e cila nuk do të thotë vetëm pavarësi, por edhe përgjegjësi, e sidomos përgjegjësi.

Përgjegjësia dhe llogaridhënia mungojnë sot. Sfida mbetet gjithmonë te ndërgjegjja individuale. Mungesë përgjegjësie sepse askush nuk ndihet i prekur nga rënia e lirë e sistemit, askush nuk përballë me konkurrencën dhe nuk ndihet i sfiduar nga tjetri përballë, askush nuk kërkon llogari se si janë përdorur paratë që shoqëria shpenzon për arsimin universitar.

Të nderuar deputetë,

Ky ligj nuk është i rehatshëm për askënd, as për universitetet, as për qeverinë dhe as për shoqërinë. Nuk ka iluzione për këtë dhe nuk duhet të jetë e tillë një reformë si kjo, sepse, përndryshe, do të thoshte që nuk po bëjmë asnjë reformë, ndërkohë që është një reformë e domosdoshme. Nga ana tjetër, ky ligj frenon masivizimin degradues të hyrjeve në studimet universitare duke vendosur kriterin e mesatares

së studimeve të shkollës së mesme, kthen vëmendjen nga cilësia e mësimdhënies dhe integrimi i saj me kërkimin shkencor, rrit autonominë e aktivitetit universitar dhe njësitë bazë që nuk e kanë pasur asnjëherë departamentet, cakton kriteret të qarta të karrierës dhe të promovimit akademik, rrit llogaridhënie ndaj shoqërisë përmes Bordit të Administrimit, forcon disa aspekte të autonomisë universitare, siç është rregullimi i brendshëm administrativo-financiar, mënyra si jepen titujt dhe gradat shkencore, thekson nevojën për nxitjen e studimeve ndërdisiplinore përmes programeve të përbashkëta brenda dhe ndërmjet IAL-eve, duke përfshirë edhe ato të huaja; kufizon mandatet e autoriteteve drejtuese, duke synuar eliminimin e klientelizmit dhe zgjerimin e bazës demokratike të drejtimit të IAL-eve.

Ky ligj është i rëndësishëm dhe i guximshëm, pasi u treguam shqiptarëve se deri ku ka shkuar e keqja, pasi përfshimë në debat të gjithë shoqërinë, ndonëse jo të gjithë e kanë lexuar ligjin dhe ndoshta edhe janë ngutur ta gjykojnë me të dëgjuar, pasi u konsultuam jashtë dhe brenda, pa pretenduar, është normale që të gjithë të bien në një mendje dhe respektoj sinqerisht gjithë mendimin ndryshe se është pjesë edhe e shëndetit të debatit publik.

Pasi i kryem të gjitha këto, Ministria e Arsimit, qeveria shqiptare e sjell këtë ligj para jush, e ndërgjegjshme se puna nuk mbaron me miratimin e tij, për çka ju ftoj. Puna vetëm sa ka filluar.

Sa për debatin estetik, përgëzime, është një hap shumë i madh për parlamentin!

Kujtoj që vetëm pak vite më parë thereshim për gardhin mbrojtës rreth Kryeministrisë, për ushtarët me kallashnikov, kurse sot flasim për elementin estetik. Faleminderit kulturës!

Ilir Meta – Fjalën e ka deputeti Luan Rama. Përgatitet deputeti Luçiano Boçi dhe më pas deputeti Musa Ulqini.

Luan Rama:

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

E nderuar zonja Ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar studentë, pedagogë, profesorë dhe punonjës shkencorë të këtij vendi,

Do të duhej që në fakt diskutimi i sotëm të kishte në fokus tërësinë e reformës në sistemin arsimor, pasi arsimit i lartë është vetëm një

hallkë, padyshim shumë e rëndësishme, e tërësisë së këtij sistemi, ashtu sikundër do të duhej të kishim një paketë të plotë me disa ligje që përfshin jo vetëm sistemin arsimor prej edukimit parashkollor, por edhe çfarë do të bëhet me veprimtarinë dhe me kërkimin shkencor në këtë vend.

Ashtu sikundër dua theksoj që një ligj, në cilëndo fushë, por sidomos këtë që ka të bëjë me arsimin, nuk miratohet për të na treguar se deri ku ka shkuar e keqja, por për të na projektuar se deri ku do të shkojë e mira.

Ligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në universitete” është në qendër të debateve që prej dy vjetësh. Hartimi i projektligjit u parapri me një varg masash administrative për disiplinimin formal të veprimtarisë universitare, që përfshijnë ndalimin e institucioneve arsimore të palicensuara, ndërprerjen e specialiteteve dhe të programeve jo të akredituara, përgjithësisht filtrimin e diplomave që lëshohen në sistemin arsimor në Shqipëri.

Në tërësi këto masa patën për qëllim mbrojtjen e veprimtarisë universitare prej informalitetit dhe nxjerrjen e saj nga anarkia. Këto masa, megjithëse penalizuan një varg institucionesh të arsimit të lartë, janë mirëpritur, pavarësisht karakterit të tyre ndalues. Sikurse dihet, kjo vënie rregulli, megjithëse u shoqërua me pezullimin e përkohshëm tërësor të dy shkallëve të formimit universitar, së paku në arsimin publik, të shkallës master e doktoraturë, pati në përgjithësi efekte pozitive dhe vetë subjektet e ligjit u pajtuan në heshtje me të. Këto masa kanë pasur një efekt pozitiv, por nuk e kanë zgjidhur problemin.

Sistemi arsimor në Shqipëri është edhe sot i deformuar rëndë. Janë komprometuar në thelbin e tyre gjërat më të rëndësishme të veprimtarisë universitare. Anarkia dhe vullnetarizmi kanë prekur jo vetëm arsimin e lartë privat, por edhe atë publik. Është prishur kontrata e besimit për programet, për Profesoratin, për notën, për gradat dhe titujt shkencorë. Sot numri i atyre që diplomohen është dhjetëra herë më i lartë se dikur. Praktikisht të gjithë ata që duan të shkojnë në universitete, shkojnë pa ndonjë filtrim. Ky masivizim i universiteteve nuk është shoqëruar me mbrojtjen e garancive të formimit të brezave të rinj. Njerëzit po arkivojnë diploma njëra pas

tjetrës për të dalë në tregun e punës, por tregu i punës është i pakënaqur me ta, sepse pedagogu shet notën, administratori shet diplomën, universiteti privat liçenson dhe akrediton vetveten. Kështu është shkelur parimi themelor rregullues i jetës universitare, karakteri unik i arsimit kombëtar. Kjo gjendje është e padurueshme dhe kërkon zgjidhje ligjore të menjëhershme, prandaj dhe unë e përhëndes nismën e marrë nga qeveria, sado që ajo është e pjesshme, për të miratuar ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në universitete”. Nuk mund të vazhdohet më me një sistem arsimor të shthurur dhe të dyshimtë fund e krye. Gjendja është e tillë që e bën të detyrueshme vënien dorë përmes ligjit.

Kush i ka ndjekur debatet paraprirëse për projektligjin, e di mirë se kundërshtimet ndaj tij kanë ardhur në vijimësi nga brenda institucionit ligjvënës, pra nga parlamenti, prej shumicës dhe opozitës, po aq sa edhe nga profesorati e përgjithësisht trupat mësimore-akademike të universiteteve.

Është për t'u vënë në pah se kundërshtimet dhe qortimet kanë ardhur kryesisht nga institucionet e arsimit publik, kurse prej universiteteve jopublike nuk ka pasur asnjë kundërshtim.

Fakti që universitetet jopublike kanë qenë jopjesëmarrëse në debat, nënkupton se ligji i ri për arsimin e lartë u shkon sipas interesit, ndërkohë që universitetet publike duken krejt të pakënaqura.

Sa është përfillur reagimi i institucioneve subjekt të ligjit? Fakti që tri herë ky projektligj ka ndërruar edhe titullin, pa hyrë më në thellësi, na jep të kuptojmë se një zonë ndërkomunikimi ka funksionuar. Se në çfarë thellësie është dëgjuar zëri i profesoratis, kjo nuk është e qartë as për ne sot që po diskutojmë, sepse asnjëherë nuk na është paraqitur një vështrim krahasues midis kërkesave dhe propozimeve nga njëra anë dhe reflektimeve në ligj nga ana tjetër.

Më ka bërë përshtypje se gjatë procesit të diskutimit Karta e Bolonjës, si një dokument referencial për rregullimin ligjor evropian të veprimtarisë universitare, nuk është përmendur as nga hartuesit e ligjit, as nga kundërshtuesit e tyre. Kjo është një pikëpyetje e madhe. Nëse sistemi arsimor në Shqipëri do të funksionojë

kështu, duke mitizuar një dokument një herë në pesë vjet, e ardhmja e tij do të jetë rastësore, ndërkohë që dihet se universitetet janë nga vetë karakteri i tyre institucione konservative. Shkolla nuk ndjek modën. Natyrisht që projektligji shënon disa progrese dhe ofron mundësi për reformim. Është një përpjekje për t'u vlerësuar për krijimin e një sistemi unik arsimor edhe në nivelin universitar, siç është në traditën e vendit dhe në të drejtën kushtetuese, për të krijuar kushte juridike për konkurrencë dhe për të mbrojtur vlefshmërinë e diplomave, të gradave dhe të titujve shkencorë.

Nga ana tjetër, nuk mund të jemi indiferent ndaj disa vërejtjeve themelore që i janë bërë projektligjit dhe që, për çudi, nuk kanë të bëjnë me konceptin e sotëm shtetëror për arsimin e lartë, por me raportet e institucioneve arsimore me buxhetin e shtetit dhe me njëri-tjetrin, pra me administrimin e arsimit dhe jo me standardet e tij.

E ndiej të nevojshme të ndaj me ju një shqetësim shumë të rëndësishëm që ka lidhje me projektligjin dhe që duhet të miratojmë sot.

Siç e dini, në krye të herës projektligji titullohej "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor". Në gjendjen përfundimtare na ka ardhur me titullin "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në universitete". Këtu nuk kemi të bëjmë me një ndërrim emri, por me një ngushtim të qartë të fushës së veprimit. Praktikisht, me miratimin e këtij projektligji dhe me abrogimin e ligjit të vjetër, nuk ka më mbulesë ligjore për kërkimin shkencor në institucione që funksionojnë për të, si Akademia e Shkencave dhe Qendra e Studimeve Albanologjike. Kjo e fundit deri sot e zhvillon veprimtarinë e saj brenda ligjit ekzistues të arsimit të lartë, por, me miratimin e ligjit të ri, në të cilin nuk ka asnjë referencë për të. Ky institucion formalisht do të rezultojë i paligjshëm, derisa të ketë një zgjidhje tjetër juridike, për të cilën është thënë gjatë debatit se do të vijë por që praktikisht ende nuk ka asnjë hap konkret për këtë gjë. Kjo e rrezikon shumë statusin e Qendrës së Studimeve Albanologjike, ashtu siç rrezikon edhe statusin e Akademisë së Shkencave, e cila, megjithatë, një statut të brendshëm gjithsesi e ka. Është arbitrare kjo sjellje nga hartuesit e ligjit. Nuk mund të lihet një institucion kombëtar dhe unikal, si Qendra e

Studimeve Albanologjike pa çati ligjore, qoftë edhe përkohësisht. Është thënë se po përgatitet një ligj për shkencën, dhe do të ishte mirë ta kishim një ligj të tillë, por ai ligj duhet të ishte, tashmë në procedurë për miratim, pjesë përbërëse e së njëjtës paketë, paralelisht me ligjin për arsimin e lartë. Nuk mund t'ia lemë rastësisë fatin e institucioneve që kanë të bëjnë me shkencat e identitetit, siç janë shkencat albanologjike.

Le të kujtojmë këtu se konkurrenca në mendimin shkencor albanologjik është shtuar jashtëzakonisht jo vetëm në qendrat tradicionale të albanologjisë, si Gjermania, Austria, Italia, Franca; por dhe në shtete të tjera si: Rusia, Polonia, Kroacia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Mali i Zi, Maqedonia, Greqia, Turqia, deri dhe Kina e Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Numri i katedrave të albanologjisë po shtohet dhe i albanologëve të huaj, gjithashtu. Dy vjet më parë, katedra e albanologjisë në Universitetin e Beogradit kremtoi 50-vjetorin e saj me një konferencë shkencore ndërkombëtare albanologjike me pjesëmarrje nga të gjitha këto qendra, me përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës. Më lejoni t'ju kujtoj që kjo katedër e ka gati trefish më shumë numrin të punonjësve shkencorë, krahasuar me Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë.

Në kushtet për fatin e mirë të albanologjisë rrethi i studiuesve të saj në botë po zgjerohet; në kushtet kur botimet dhe konferencat shkencore për çështje themelore të saj janë shtuar dukshëm; po dhe në kushtet kur paradigma tradicionale e albanologjisë është tronditur, lënia e institucioneve të kërkimit elitare të saj në Shqipëri, qoftë dhe siç thashë, për një farë kohe, pa mbulesë dhe mbrojtje ligjore është një pabesi e madhe ndaj shkencës kombëtare.

Dy janë çështjet më të debatueshme ku dua të ndalem: ku do të shkojë buxheti shtetëror për arsimin dhe kush do ta kontrollojë zbatimin e këtij buxheti. Në diskutimet publike, të dyja këto çështje, janë parë si rreziqe që mund të cenojnë autonominë akademike-universitare. Kështu i kanë parë dhe universitetet vetë. Unë do ta shtroj pyetjen: a po bëjmë me këtë ligj padrejtësi ekonomike?

Projektligji u njeht të drejtën universiteteve private të përfitojnë nga buxheti publik nëse shndërrohen formalisht në subjekte

jofitimprurëse, pra nëse raportojnë një bilanc negativ, sipas parimit ku shkon studenti, shkon buxheti. Barazia e shtetit me privatin është një parim themelor në një shtet ideal të së drejtës, që është edhe synimi i Europës së Bashkuar. Në këtë kuptim, nëse dhe kjo pjesë e projektligjit bën pjesë në ato që zakonisht argumentohen thjesht “Kështu na e kërkon Europa”, është mirë të thuhet publikisht. Ne të gjithë e dimë se në legjislacionin tonë ka herë pas here nisma të tilla, që përbajnë edhe propaganda dhe që hartohen për hatër të Europës.

Në anën tjetër, tabloja parashihet e rrezikshme, sepse ligji tenton një gjendje ideale kundrejt një realiteti aspak garantues. Dalin një mori pyetjesh: si do të garantohet që institucionet e arsimit jopublik të raportojnë bilance të vërteta edhe të besueshme financiare? Në kushtet kur, edhe në veprimtaritë ekonomike e tregtare, ku mundësitë e fshehjes së të dhënave janë më të vogla, bilancet e dyfishta vazhdojnë të jenë dukuri e zakonshme: Nga përgjigjja e kësaj pyetjeje varet më tej dhe garancia, nëse buxheti shtetëror do të shkojë tek institucioni i merituar apo te falsifikuesit. Dhe kështu, nga diplomat false do të biem te bilancet false, prej këndeje, në padrejtësi ekonomike.

Sot për sot dihet mirë se veprimtaria universitare jopublike është mirëfilli vetëm biznesi, domethënë çështje fitimi. Kush ka themeluar në Shqipëri universitet për qëllime iluministe, për ideal shkencor apo për filantropi? Askush. Por në këtë vështrim, Kryeministri është i inkurajuar të pohojë se universitetet jopublike nuk do të jenë përfituese të buxhetit shtetëror. Por çfarë do të ndodhë kur shumica e universiteteve të sotme private të na dalin me bilance institucione që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre për bamirësi dhe pa fitim? Atëherë do të gjendemi para një problemi të madh. Unë mendoj se projektligji ynë nuk bën keq të mendojë edhe për ata që ka mundësi të paguajë doktoratën me 10 mijë euro, por kjo është e fundmja gjë për të cilën duhet të mendojnë. Më së pari, duhet të zgjidhë problemin e atij që e nis fëmijën në universitet me 10 mijë lekë të reja në muaj. Kush mund t’ia japë mundësinë e shkollimit kësaj shtrese përveç universitetit publik? Na duhet të mendojmë seriozisht për këtë pikë, që garantët e shkollimit të atyre që rrojnë me pensione edhe paga modeste do të jenë

dhe në të ardhmen universitetet publike. Shteti e ka për detyrë këtë. Pasi të ketë plotësuar këtë detyrë, do të kemi luksin të mendojmë sesi të mbështetet rrjeti i universiteteve private-publike dhe partneriteti mes tyre.

Kam mendimin se duhet të ruhem prej termave të dyfishtë dhe evazive, sepse do të na hapin ndërlikime të mëdha në të ardhmen. Duhet të jemi seriozisht të shqetësuar që universitetet publike, gjithë vëmendjen e tyre kritike e kanë përqendruar jo tek aspektet profesionale të arsimit të lartë në ligj, jo te sistemi arsimor universitar si i tillë, por te çështjet e administrimit të buxhetit për arsimin dhe vetëm tek ato, që janë jo të pakta, por unë u ndala vetëm te njëri prej tyre, te raporti midis universiteteve publike dhe atyre jopublike, te pjesëmarrja e privatis agjent në arsim në rishpërndarjen e të ardhurave që krijon shteti prej taksapaguesve.

Shteti, përmes politikave buxhetuese, ka përgjegjësi edhe për mbrojtjen dhe rregullimin e konkurrencës brenda për brenda arsimit publik, jo vetëm midis arsimit publik dhe atij privat. Unë përmenda në fillim se disa prej masave reformuese që i kanë paraprirë projektligjit kanë qenë të efektshme, sepse kanë kufizuar paligjshmëritë në këtë veprimtari dhe po u kthejnë autoritetin diplomave të arsimimit dhe profesionalizimit.

Por ne po shohim, ndërkaq që në sytë tanë po ndodh humbja e perspektivës për disa institucione të arsimit të lartë, që kanë traditë të gjatë universitare dhe janë pika reference për arsimin në Shqipëri. Duhet të shqetësohemi seriozisht që universiteti i Gjirokastrës, që mban emrin e gjuhëtarit më të njohur shqiptar, Eqrem Çabej, po shkon drejt pakësimit absolut të numrit të pranimeve, gjë që e ka errësuar shumë perspektivën e tij. Nuk është argument siç është thënë, nga specialist të ministrisë, se kjo lidhet me pakësimin absolut të popullsisë banuese në Gjirokastër e në rrethina. Kjo nuk është as gjysma e së vërtetës. Nuk mund të bëjmë sikur nuk e dimë që ministria vitin e kaluar mbylli atje disa programe, duke përfshirë specialitetin e turizmit dhe disa degë të gjuhëve të huaja; nuk mund të bëjmë sikur s’e dimë që po ministria inkurajon me kuota rivalizuese për të njëjtat degë, filialin e Universitetit të Tiranës diku aty pranë; nuk mund të bëjmë sikur nuk e dimë, po

ashtu, që Universiteti i Gjirokastrës është i vetmi që ka një katedër të gjuhës greke në Shqipëri dhe kjo i njeh atij një rëndësi edhe gjeopolitike.

Të gjitha këto janë për t'u menduar edhe për Universitetin e Shkodrës, edhe për të Elbasanit, ndoshta edhe për të Korçës, për të përmendur vetëm universitetet me më shumë se një gjysmë shekulli jetë e veprimtari në Shqipëri.

Këto janë çështje për t'u rimenduar e rivendosur jo vetëm me masa vepruese nga ministria, por dhe me zgjidhje juridike, të cilat duhet t'i paraprijnë çelje së punimeve të sesionit të ardhshëm në vjeshtë.

Në fund më lejoni t'ju kujtoj, të nderuar kolegë, që në vitin 2008 në Francë qeveria "Sarkozy" me propozim të Ministrisë së Arsimit tentoi rritjen e tarifave të shkollimit në universitetet publike, në emër të barazisë me universitetet private. Megjithëse ligji do të hynte në fuqi pas tre vjetësh, pas miratimi, studentët u ngritën në protestë dhe ligji nuk u miratua. Megjithëse brezi i regjistruar i studentëve nuk prekej nga ligji, sepse ishin të përjashtuar që ligji të kishte efekt ndaj tyre ai ligj nuk u miratua. Dhe ai ligj nuk është as sot në Francë.

Faleminnderit!

(Drejtimin e seancës e merr zoti Spaho.)

Edmond Spaho – Faleminnderit zoti Rama!

Fjalën e ka deputeti, Ditmir Bushati.

Ditmir Bushati – I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po shqyrtojmë një nga politikat më të rëndësishme publike në vend gjatë tranzicionit tonë nga shembja e regjimit komunist drejt vendosjes së një sistemi demokratik dhe ekonomisë funksionale të tregut.

Siç është bërë zakon në këtë sallë, përkundrajt pritshmërisë sime, diskutimi nuk u karakterizua as nga sensi i përgjegjshmërisë dhe as nuk u orientua në mënyrë vetëkritike mbi situatën ku është katandisur arsimit i lartë në Shqipëri, jo më të skiconte një alternative opozitare ndaj projektit tonë si mazhorancë për arsimin e lartë dhe dijen, si të mirë publike dhe përgjegjësi. E mira dhe përgjegjësia publike shkojnë bashkë në një pozicionim të shtetit, në një rol të tij që, sikundër parashikohet nga reforma që ne propozojmë, duhet të jetë i trefishtë: rregullator, financues dhe ofrues shërbimesh.

Ne nuk propozojmë thjesht një rrugëdalje ndaj situatës kritike të arsimit të lartë, por fillimin e një procesi ku shteti merr përgjegjësinë që i takon mbi arsimin e lartë. Kemi trashëguar një sistem të arsimit të lartë, i cili ka prodhuar, për fat të keq, vetëm diploma, ka nxitur kërpuhëzimin e universiteteve, qofshin këto private apo publike duke shndërruar institucionet e arsimit të lartë jo në djepe dijeje e as qendra ekselencash, por në çadra të mobilizimit partiak.

E pabesueshme, por e vërtetë, arsimit i lartë shndërrohet në ngjarje politike veç kur politika e thërret në ndihmë, në funksion të jetësimit të agjendës së saj. Tryeza që kishte organizuar kryetari i opozitës me një pjesë të pedagogëve, për fat të keq, përkonte me atë grup njerëzish që firmosnin sistematikisht kundër çdo veprimi opozitar gjatë qeverisjes suaj.

Jo vetëm kaq, por sistemi i trashëguar i arsimit të lartë, jo vetëm është shumë larg nevojave të tregut, dhe ka shërbyer si gllabërues i parave nga familjet shqiptare.

Shumëkush është dëshmitar që gjendemi në kushtet e një sistemi aspak konkurrues, që në rastin më të mirë ka qenë objekt i batutave dhe talljeve, në rastin më të keq ka qenë simptoma e metastazave të një tranzicioni që nuk njeh fund.

Për të gjithë vajtuesit dhe profetët fals, të së ashtuquajturës publike, shifrat dhe faktet që shoqërojnë projektligjin dëshmojnë qartë se gjatë qeverisjes së Partisë Demokratike universitetet publike degraduan, ndërkohë që universitetet private nuk arritën të shndërroheshin në kudhra të farkëtimit të dijeve. Ne jemi dëshmitarë të një autonomie universitare të shndërruar në bajraqe. Në vend që institucionet e arsimit të lartë të merrnin përmasa publike, pamë që ato fituan tone privatizimi. Edhe dija u përkthye në mall fitimprurës.

Sistemi i arsimit të lartë që po lëmë pas e reduktoi gjithçka në përcaktime kuotash studentësh. Kështu iu vu rëndësi sasisë dhe jo cilësisë. Kriteri i vlerësimit ishin kuotat e studentëve dhe jo cilësia e kërkimit shkencor, që është vlera publike e universitetit. Kemi qenë dëshmitarë të universiteteve shtetërore, të cilët, në një farë mënyre, masakruan tregun e dijeve, duke krijuar kuota përtej çdo logjike. Vetëm e vetëm me mendimin se kështu do të mund të kapërcehej hendeku që na ndante me vendet e Europës, u mundua në mënyrë artificiale që ne të

barazoheshim me gjendjen e burimeve njerëzore të një Europe të kualifikuar dhe kjo duhej mbuluar brenda një brezi! Sali Berisha nuk e fshehu strategjinë e tij, pra kërkoi që përmes universitetit të merrte përsipër të zëvendësonte kohët.

Po me të njëjtën shtysë hapën privatin, duke shkuar kundër përkufizimit të universitetit privat. Pra, u krijua rrënjësisht mentaliteti i privatizimit të dijes.

Universitetet shtetërore, duke përfituar nga fakti i autonomisë, krijuan dekanë e rektorë të përjetshëm, me tituj pompozë, por me pak kontribute shkencore për shoqërinë shqiptare, për të mos përmendur rrokadat ad infinitum dekan-rektor, rektor-dekan apo transferimin postit të dekanit nga daja te nipi. Jemi dëshmitarë, dhe një pakicë në këtë sallë protagoniste, të privatizimit legal të universitetit në format e universiteteve private dhe të privatizimit ilegal të universitetit shtetëror. Aktualisht, fondet publike nuk shkojnë te krijimi i pasurisë publike, te produkti publik i dijes. Përkundrazi, privati shet njohuri publike për fitim privat dhe i kërkon shtetit t'ia njohë shtetërisht këtë, ndërsa universiteti shtetëror dobëson cilësinë e arsimit, duke holluar gjithnjë e më shumë kriteret e diplomimit. Shtetërori që kemi pasur, me paaftësinë për të qenë publik, i dha shtysë dhe polli universitetet private. Ishin pikërisht këta privatë që legjitimonin një universitet shtetëror të paaftë.

Pra, e keqja, prodhoi të keqen gjatë qeverisjes suaj.

Pyetja që parashtrohet është: a duam ta ndryshojmë këtë situatë apo jo? Pse kaq rezistencë dhe nostalgji për status quo lukrative për një pakicë në këtë sallë, por dëmtuese për gjeneratat e reja?!

Qasja jonë duhet të jetë kritike, sepse ne nuk jemi konkurrues jo vetëm ndaj vendeve të BE-së, por as krahasuar me vendet e rajonit. Për më tepër, deri më sot kërkimi shkencor nuk e ka ndihmuar politikbërjen as me oponencë e as me ndihmë në trajektoren që duhet ndjekur. Rastet janë pa fund. Shqipëria është pjesë e projekteve strategjike, një prej të cilëve është projekti TAP. Më thoni, në rast se keni lexuar një punim shkencor të universiteteve tona në këtë drejtim. Më thoni nëse ne kemi projekte apo punime për mënyrën se si mund të përdoret më mirë pasuria nëntokësore në këtë vend; për mënyrën se si

bujqësia mund të kthehet në një motor zhvillimi. Për të mos folur për projekte të tjera, ku Shqipëria është e përfshirë.

Cila është përgjigja jonë? Për ne dija është një e mirë publike, dhe arsimit i lartë në përgjithësi. Kur arsimit i lartë prodhon diploma, është e mirë private, kur bën para korrupsioni për ndonjë pedagog, është e keqe publike. Vetëm kur prodhon dije mund të quhet e mirë publike. Dhe me dijen e cilësinë ne nuk kemi pse të bëjmë më kompromis.

Ndër kritikën që janë bërë zëshëm kohët e fundit, ka qenë ajo e mangësisë së autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë. Në qasjen tonë çështja e autonomisë fiton një ngjyrim tjetër. Pra, kemi autonomi, por duke theksuar brenda kësaj dy dimensionesh të rëndësishme: dimensionin administrativ dhe atë pedagogjik. Si do të rregullohen raportet mes këtyre dy dimensioneve, dhe si do të rregullohen të gjitha institucionet, që janë jo thjesht ekstrauniversitar, por janë instanca të administrimit të kërkimit shkencor? E thënë ndryshe, a do të lihet që universiteti shtetëror të vazhdojë të privatizohet, në vend që të bëhet publik? A mund të pretendohet që universiteti privat të ketë ndonjëherë kërkesë për të qenë universitet publik? Përgjigja jonë është adoptimi i një qasjeje funksionale në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kontekstualizuar në realitetin shqiptar, në trajtën e institucioneve të arsimit të lartë. Kjo mënyrë i vendos universitetet shtetërore në konkurrencë me njëri tjetrin apo me universitetet private, për t'i shndërruar në ofrues publik të dijes, në dobi të studentit e të shoqërisë. Me politikën e granteve, me politikën e prioritetëve kombëtare, me alokimin e bursave, dëshmoret për kujdesja e shtetit ndaj studentit si kurrë ndonjëherë. Edhe studentit i shkëlqyer, edhe studentit në nevojë, marrin një shërbim cilësor arsimor, që të jenë të gatshëm për tregun e punës.

Në rast se për ju kjo është politikë etatiste, për ne është përgjegjësi dhe përgjigje për gjeneratat e reja e për Shqipërinë moderne europiane. Që universiteti privat të shndërrohet në një formë publike, do të thotë të mos kemi më një pronar që shet dije apo që thjesht shton numrin e diplomave e doktoraturave. Sepse, ajo që kishim e bënte të pamundur krijimin e një sistemi unik të kërkimit shkencor në Shqipëri.

Por ne e thërrasim privatën të vijë drejt formës publike, duke respektuar një lloj ideje të prioritetëve të shoqërisë dhe të mos nisim nga preteksti se ekziston një treg i lirë, i fshehtë, që e rregullon vetë punën, si me magji.

Ne jemi qeveria e transformimit dhe e ndryshimit, e jo e fiksimit të tmerrshëm të shkatërrimit të së kaluarës. Ky është çasti kur mund të rrisim një ndërgjegje qytetare. Ne vetë, me këtë reformë, kemi krijuar një ndërgjegje qytetare që po vepron dhe, vetëm pak metra larg nesh, u zhvillua një protestë. Më erdhi mirë që pas njëzet e pesë vitesh pashë në Shqipëri një protestë, sepse në kohën tuaj, ju i vinit pedagogët dhe universitetet në rresht, për të firmosur peticione kundër opozitës. Pra, gjendja aktuale në universitete kësaj nuk prodhoi lëvizje as të studentëve, as të trupës pedagogjike, kundër shkeljes, dhunës e mediokritetit në rritje të departamenteve. Shteti duhet të ndërhyjë në respekt të taksapaguesve, duke rritur cilësinë e universitetit, që shteti vetë e ka, dhe duke mos e lënë atë të degjenerojë për shkak të autonomisë universitare, a thua se autonomia qenka qëllim në vetvete. Autonomia është qëllim në vetvete vetëm kur universiteti është bërë publik, domethënë kur i merr fondet nga shteti, por i angazhon ato në mënyrë publike.

Më e rëndësishmja është se nuk do të kemi më universitet privat të kulluar. Natyrisht, mund të kemi vullnet privat për universitet, por jo si këto gërmadha arsimore që duam të lëmë pas. Do të kemi institucione publike të pavarura të arsimit të lartë dhe institucione specifike të profilizuara. Ndaj shpreh bindjen se reforma për arsimin e lartë, që shqyrtojmë sot, është jo thjesht një përgjigje ndaj së kaluarës, por një vizion ndaj së ardhmes.

Më gjeni, të nderuar kolegë, një tjetër ligj në Shqipëri, që të jetë miratuar e të jetë shoqëruar me një *green paper* dhe me një *white paper*, me një punë voluminoze që ka rreth një vit e gjysmë që bëhet dhe që përfshin qindra persona në këtë proces, qofshin këta aktorë shtetërorë apo jo. Pra, procesi ka qenë gjithëpërfshirës dhe transparent, por kjo nuk do të thotë se qëllimi i këtij procesi ishte arritja e një konsensusi të përgjithshëm. Krejt ndryshe. Ky proces synonte vjeljen e sugjerimeve më të mira dhe ravijëzimin e një vizioni të ri reformues për sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri.

Pra, sot ne kemi një projektligj, ku qeveria merr rolin që duhet të ketë, atë të sigurimit të ngritjes së një organizimi të drejtë e të pavarur vlerësimi, akreditimi dhe renditjeje të universiteteve, qofshin këto publike apo jo publike.

Reforma jonë ndryshon skemën e financimit të arsimit të lartë, duke rritur financimet që shkojnë drejt sistemit, dhe duke rritur cilësinë. Sigurimi i autonomisë së universiteteve deri në njësitë bazë, shoqëruar me rritjen e kapaciteteve menaxhuese të njësisë, përbën një tjetër prioritet të reformave që do të ndërmerren në arsimin e lartë.

Reforma jonë ridimensionon rolin e trefishtë të shtetit në arsimin e lartë, rolin rregullator, atë të financuesit, dhe rolin e ofruesit të drejtpërdrejt të shërbimit në arsimin e lartë. Ridimensionimi i rolit të shtetit ecën paralel me theksimin e autonomisë universitare, e cila përkthehet në autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndërkohë, dëshiroj të nënvizoj faktin se, pavarësisht mënyrave të ndryshme për ta lexuar projektligjin, një gjë është e qartë: ky ligj nuk çon para publike drejt institucioneve private. Përkundrazi, shtyn drejt rritjes së financimit publik e privat, drejt arsimit publik. Krijojmë kështu mundësinë që, nëpërmjet institucionit të arsimit të lartë publik e privat, të ofrojmë më shumë shërbim publik, por edhe liri më të madhe, në marrjen e një hapi larg mediokritetit ku është kredhur sistemi i arsimit të lartë në vendin tonë.

Nëpërmjet këtij projektligji modernizohet qeverisja e brendshme universitare. Dhe në fakt, unë sot prisja, sidomos nga ish-ministrat përgjegjës për katandisjen e arsimit të lartë në këtë gjendje, që të kishim një debat për mënyrën se si do t'i mbështesim institucionet e arsimit të lartë, për të menaxhuar më mirë burimet njerëzore, për të menaxhuar më mirë skemat kompetitive të financimit, që ofron projektligji i ri, dhe për t'u bërë konkurrues në projektet e Bashkimit Europian, sepse universitetet shqiptare renditen edhe aty – për fat të keq – të fundit.

Me këtë projektligj në duam të garantojmë një rritje të cilësisë akademike dhe administrative, duke bërë që akademikët të

përqendrohen në detyra akademike, të mbështetur nga administratorë profesionistë. Jam i bindur se pas kësaj nuk do të ketë më garë të ethshme për të qenë përjetësisht dekan a rektor, apo për t'ia trashëguar dekanllëkun nipit apo mbesës apo vajzës.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, reforma jonë i ka themelet në procesin e Bolonjës, duke reflektuar thelbin e reformave të arsimit të lartë, të aplikuar mbi dyzet shtete evropiane. Jo vetëm kaq, por projektligji jetëson konceptin e standardizimit të të gjithë hapësirës e të aktorëve.

Për sa u përket standardeve akademike, nuk ka më institucione të nënës e të njerëzës. Natyrisht, projektligji është vetëm hapi i parë. Ne presim të vijmë në parlament e të debatojmë edhe projektligjin tjetër, shumë të rëndësishëm "Për shkencën në Republikën e Shqipërisë", natyrisht, ky është thjesht e vetëm fillimi i një reforme, suksesi i së cilës do të varet nga zbatimi i saj dhe nga përshpejtimi i miratimit të akteve nënligjore, si dhe krijimi i infrastrukturës së nevojshme institucionale.

Unë besoj se detyra jonë e radhës është jo të vajtojmë për atë çka lamë pas, jo të vajtojmë për krimet që ne bëmë në sistemin e arsimit të lartë, por prisja këtu që ish-ministrat, të cilët kanë ulur kokën, t'i kërkojnë një ndjesë të madhe opinionit publik, dhe më pas të debatojmë se si do t'i skicojmë rrugëzgjdhjet më të mira, për ta çuar arsimin e lartë publik në Shqipëri, aty ku e ka vendin dhe aty ku duhet të jetë.

Ju faleminderit!

Edmond Spaho – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjalën e ka zoti Luçiano Boçi. Përgatitet zoti Oerd Bylykbashi.

Atëherë, përgatitet zoti Taulant Balla.

Luçiano Boçi – I nderuar drejtues i seancës!

Të nderuar deputetë!

Të nderuar pedagogë!

Të dashur studentë!

Meqenëse këtu, më përpara u bënë shumë përbetime për të vërtetat, madje u tentua të thuhet disa të vërteta, sigurisht edhe unë e kam shumë për zemër thënien e Sokratit: "E dua Platonin, por dua më shumë të vërtetën". Për këtë arsye, dua të ballafaqoj çështjen ndër më sensitivet që u diskutua këtu, që ka të bëjë

pikërisht me tarifat e studentëve. Sepse, përtej kësaj salle, ka një dilemë shumë të madhe në familjet shqiptare: do rriten apo s'do rriten tarifat e studentëve?

Madje, për kujtesë, këtë pyetje ia kam bërë vetë zonjës ministre në seancën dëgjimore dhe nga ajo kam marrë përgjigjen refuzuese, që unë refuzoj të përgjigjem për këtë pyetje, por sot më bëri një lloj sqarimi, duke bërë pjesën e falënderimit për kolegen tonë. Cilësoi se tarifat e studentëve nuk do të rriten.

Por, e thashë për hir të së vërtetës, unë këtu kam tekstin e raportit final të komisionit të reformës, i cili në kreun 6, pika 3, 1, 5, përcakton në mënyrë taksative: "Deri tani këto tarifa kanë qenë minimale, dhe si të tilla nuk përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të të ardhurave të IAL-ve publike. në të ardhmen, komisioni vlerëson si të pashmangshme rritjen e kontributit të tarifave të nivelit bachelor në buxhetin e IAL-ve".

Pra, ky është teksti i reformës, i komisionit që ka hartuar pikërisht reformën dhe e ka përkthyer atë në ligj. Unë nuk dua të bëj atë pjesën e replikës që, sinqerisht, nuk më pëlqeu, e ke lexuar ligjin, s'e ke lexuar, dhe nuk po i them Ministres: a e ke lexuar tekstin përfundimtar të reformës, apo jo? Sepse, është shkruar e zezë mbi të bardhë, që tarifat e studentëve rriten, sigurisht janë rritur 30%-40% këtë vit. Normal, do të rriten edhe në përqindje më të madhe, në mënyrë progresive, më pas për të arritur të njëjtin nivel të universiteteve private, sepse është ajo që është kërkuar në këtë situatë trevjeçare, me qëllim që në momentin e kthimit të universiteteve publike në universitete publike të pavarura dhe të jopublikeve të tilla, tarifat të jetë të njëjta.

Pra, kjo është e vërteta. Unë, sinqerisht, nuk e kam zakon të shkëputem nga pjesa e fjalës sime, për arsye edhe të profesionit tim, por, meqenëse fjala e Kryeministrit, si gjithmonë krijon ato ilaritetit e veta, më ngacmoi kësaj radhe. Meqenëse ai i jep të drejtë vetes, tregoi shumë barsoleta, unë do t'i jepja vetes sime të drejtë që të evokoj një skeç nga fëmijëria ime, e që më ka ngelur në mendje. Dua ta sjell për të bërë analogji pikërisht me fjalën dhe me atë punën e madhe që është bërë për këtë ligj. Kujtoj këtu aktorin e famshëm Ben Shaka, i cili në skeçin e tij kishte në qendër një shkrimtar, i cili

merr lejen krijuese dyvjeçare, dhe pas dy vjetësh do të dorëzonte romanin e tij, paratë e të cilit i kishte konsumuar. Kur shkoi te kryeredaktori, i thotë: “Unë romanin e mendova, por romanin ende s’e kam gati; pasi e kisha gati, u mendova, u mendova, e përmbloodha, e përmbloodha, e bëra novelë”. “Po, - i thotë kryeredaktori. - Dorëzo novelën!”. “Jo, - i thotë ai, - prit! Novelën e përmbloodha, e përmbloodha dhe e bëra tregim”. “Shumë mirë, meqenëse ke bërë tregimin dy vite, sill tregimin!”. “Jo, - tha. -E përmbloodha, e përmbloodha dhe e bëra gjëgjëzë”. Në fund nxori një letër dhe tha: “Kjo është gjëgjëza”.

Kjo ishte edhe fjala e Kryeministrit. Nga e gjithë fjala e tij, nga ajo puna dyvjeçare, nxori nga xhepi atë gjëgjëzën e famshme, dhe tha: “A e dini se thelbi i këtij ligji janë IAL-të publike të pavarura?” Dhe gjëgjëza ishte: “Çfarë janë këto universitete ose IAL publike të pavarura?”. Revolucion, ishte përgjigja. Kjo ishte pra, përgjigja që, pak a shumë, po t’i rris vlerën, sepse nga skeçi do të kalojë në mitologji, po ta barazoj me përgjigjen që Edipi i dha Sfinksit për të çliruar Tebën, ka vlerë. Por, të mos harrojmë një gjë nga mitologjia, s mitologjia të mëson për shumë gjëra. Vërtetë Teba u çlirua, se u dha ajo përgjigja e gjëgjëzës, që ishte njeriu qenia që ecte me katër këmbë në mëngjes, me dy në drekë dhe me tre në darkë. Ishte njeriu. Por gjetja e gjëgjëzës përmbante mallkimin mitik brenda dhe dihet ajo pjesa e historisë së Edipit. Unë kam frikë se kjo përgjigje e kësaj gjëgjëze që Kryeministri e nxori sot nga xhepi, përmban me vete pikërisht mallkimin. Ky mallkim, në radhë të parë, bie mbi xhepat e familjeve shqiptare, mbi studentët dhe të rinjtë shqiptarë.

Meqenëse e ruaj standardin tim, dua të theksoj që ky ligj është sjell me nxitim. U zgjodh zhegu i këtij korriku, vapa e famshme, si për t’u vënë flakën edhe atyre arritjeve që arsimit në Shqipëri realisht i ka si vlera dhe që i trashëgon. Por ky projektligj e vendos arsimin përballë një kryqëzimi dilematik dhe në një perspektivë konfuze ose e thënë më mirë në një udhë pa krye. Ai përvëlton totalisht buxhetet e varfra të familjeve shqiptare duke vënë hapur në lojë dëshirat e pakufishme të tyre për të arsimuar fëmijët dhe brezat. Ndërkohë, ai djeg lehtësisht dhe përfundimisht ëndrrat e të gjithë të rinjve për të pasur akses në arsimin e lartë, për të pasur

diploma cilësore, për të pasur mbështetjen që kësaj qeverie ia detyron Kushtetuta e këtij vendi.

Ai sot do të hyjë në histori si ligji më i kundërshtuar, sepse ka kundërshtimin e plotë të botës akademike, të grupeve të interesit, ka kundërshtinë e plotë të studentëve. Përcaktimet e tyre janë: tepër etatist, i centralizuar, i prapambetur, agresiv. Këto janë fjalët e tyre, nuk janë fjalët tona. Në qoftë se bëjmë një analizë, ata kanë plotësisht të drejtë. Kanë plotësisht të drejtë, sepse dimensionet e lirisë akademike dhe të autonomisë universitare brenda këtij ligji goditen rëndë dhe shkërmoqen. Kjo bëhet në emër të interesave politike-shtetërore dhe të interesave klienteliste private. Nenet që e shprehin qartë këtë janë nenet 3.1, 4, sikurse edhe nenet e tjera në vazhdimësi dhe gjithçka realizohet brenda një shkeljeje kushtetuese. Shkeljet vazhdojnë jo vetëm në këto nene, por në tërësinë e trupës së ligjit. Ai zhbalkancon sistemet arsimore, u tha edhe nga kolegu parafolës, madje u referohet edhe koncepteve që nuk gjenden në ligjin e sistemit parauniversitar. Ai e detyron këtë arsim, parauniversitar, të shformohet dhe të devijojë qëllimin dhe synimin e tij.

Modeli i ofruar i këtij ligji është i pangjashëm dhe nuk është aplikuar në asnjë prej vendeve, brenda të cilave ne kërkojmë e ëndërrojmë të shkojmë. Hartuesit e tij me siguri nuk kanë pyetur as për deklaratën e Erevanit, deklaratë e cila është miratuar në maj të vitit 2015, në brendi të së cilës ajo i detyron vendet anëtarë që të ndjekin përaftrimin e legjislacionit të tyre për arsimin e lartë me vendet e tjera të hapësirës europiane. Por këta hartues nuk e kanë marrë në konsideratë.

I parë në tërësi, nëse e shohim në mënyrë figurative, ky projektligj i ngjan një pëlhurë të grisur, jo pëlhurës së zakonshme, por në formën e atyre napave të para viteve ’90 të famshme, dhe i arnuar keq me stof anglez. Brenda këtij stofi anglez, i përcaktuar në nene të veçanta, gjoja në emrin e agjencive ose në drejtime të tjera, fshihen pikërisht interesat arriviste, makute për të rrëmbyer para nga kushdo dhe kudo, fshihen mentalitetet sunduese, mentalitete për të vënë në kontroll politik dhe për të bërë zap universitetet dhe botën akademike. Diku kjo pëlhurë është punuar imët, ka shpjegime shumë të cekëta për nene dhe paragrafë të caktuar. Diku lihet me gropa të thella, diku lihet e grisur

shumë, me qëllim që tani të arnohet me atë teritalin e famshëm të VKM-ve dhe vendimeve të ministrave, që të realizohet pikërisht ndërtimi i atyre agjencive. Ka gjithsej 35 VKM. Të mos harrojmë që në variantin e parë ishin parashikuar gjithsej 46 VKM brenda këtij ligji. Si i tillë, ai nuk mund të jetë as britanik, nuk mund të jetë as europian dhe as shqiptar. Ai është një imitim konceptesh e termash, por që zbatohen brenda një konteksti ligjor krejtësisht të ndryshëm, brenda një konteksti social dhe ekonomik të pangjashëm me Britaninë apo Europën. Kjo shpjegon faktin që agjencitë, si ajo e financimit apo e sigurimit të cilësisë, nga brenda janë detashmente, të mbushur me komisarë politikë, që vendosen aty për qëllime politike. Ato kontrollohen dhe strukturoren me vendim të Kryeministrit ose ministrit dhe nuk gëzojnë kurrfarë autonomie apo pavarësie. Më së shumti, e tha profesori i nderuar Fuga, për të cilin do të ruaj gjithmonë respektin tim, pavarësisht fobisë së Kryeministrit, ato janë drejtori që nuk mund të quhen agjenci. Kur emërtohen agjenci, hyjnë në konflikt me vetë ministrinë, marrin kompetencat e saj. Por si të tilla, duke mos qenë as drejtori, as agjenci, më shumë u ngjajnë zyrave elektorale, partiake, zyrave që ndajnë para, benifite sipas preferencave politike, sipas lidhjeve personale, hapin programe, mbyllin programe, japin bursa, mbyllin e godasin universitete, që mund të punojnë kundër, sikurse përkrahin ato universitete që përulen dhe i shërbejnë më mirë. Këto agjencitë e famshme janë kaq shumë sa krijojnë një rrjet burokratik të pakapërcyeshëm që u merr frymën universiteteve dhe u krijojnë atyre një varësi atipike nga ekzekutivi.

Universitetet publike, me detyrimin e tyre për t'u shndërruar në mënyrë progresive, humbasin ndjeshëm peshën dhe rolin e tyre mësimdhënës e kërkimor-shkencor dhe u dorëzohen pa kushte konjunkturave të tregut brenda të cilave dija bëhet malli me më pak vlerë. Nga human dhe iluminist, ato shndërrohen në magavelist dhe selektiv mbi bazën e parasë.

Konkurrenca që instalon ky ligj nuk është ajo e duhura, sepse universiteti publik nuk mund ta shesë dijen dhe nuk e shet dijen. Ai e ofron dijen, ndryshe nga ajo që ndodh në universitetin jopublik.

Synimi i universitetit publik nuk është të gjejë klientë që kanë thjesht paratë, pavarësisht

sesi i kanë, i kanë të vetat, i kanë të marra borxh apo i kanë me kredi. Synimi i tij është të thithë studentë dhe t'u shërbejë atyre me arsim.

Vendosja e tij në një garë për të bërë marketing banal me dijen që ofron, e deformon plotësisht atë dhe e shndërron në një mekanizëm të ftohtë, gjigand, pa shpirt dhe pa mision publik, që prodhon vetëm para, interesa dhe politikë osaniste. Një pjesë e mirë e tyre, të vendosura në rrethe, megjithëse kanë traditë, sipas këtij ligji, rrezikojnë të humbasin statusin e universitetit dhe të shndërrohen në kolegje universitare. Kjo jo për faj të tyre, por është qeveria e tashme ajo që vendos për fakultetet, që vendos se cili universitet do të ketë tri cikle studimi apo që vendos edhe përqindjen e përbashkët në programe mësimore.

Stafet akademike zhvishen nga e drejta e vendimmarrjes dhe u nënshtrohen plotësisht çirakëve qeveritarë, të emëruar në borde fuqiplote. Bordi është ai që përcakton gjithçka, përcakton pagat sipas preferencave politike, sipas inateve dhe mlllefeve. Miraton strategjinë, miraton statusin, miraton hapjen e një programi studimi. Bordi këtu e bordi atje. Është e reflektuar pothuajse në një pjesë të madhe të neneve, gati 20 nene flasin vetëm për bordin e administrimit, madje ky në momentin e kalimit të një universiteti nga publik në publik të pavarur nuk pyet askënd, këtë e përcakton neni 116, as rektoratin, as asamblenë e personelit akademik, madje as senatin. Këtij të fundit mund t'i marrë thjesht një mendim sa për të larë gojën, por ky mendim nuk ka rëndësi sesi është, është pozitiv apo negativ, sepse 2/3 e anëtarëve të tij, me shumicë qeveritare, janë ata që vendosin sipas urdhrin politik. Për më tepër, ky bord nuk respekton asnjë normë apo standard ligjor. Përbërja e tij e kushtëzuar, në shumicë, në favor të financuasit kryesor, në një raport të palogjikshëm 4 me 3, dhe njëkohësisht cilësia e ulët e përfaqësuesve të ministrisë, e përcaktuar kjo me master shkencor, shkojnë në dëm të autonomisë dhe lirisë akademike. Ndërsa studentët, megjithëse detyrohen të zbrazin xhepat e tyre dhe të bëhen financuesit kryesorë, konsiderohen si vrima e fundit e kavallit të sistemit dhe shihen vetëm si objekt vjeljeje për të shpëtuar nderin e humbur financiar të Kryeministrit. Ky i fundit heq dorë nga premtimi dhe detyrimi për rritjen e përqindjes së arsimit në

përgjithësi dhe atij të lartë në veçanti, i cili për vendin tonë mbetet në nivelet më të ulëta, 0,4% të produktit të përgjithshëm bruto. Ai ofron një skemë të re financimi sipas parimit të paprovuar ende “Më shumë para, më shumë cilësi”, por këto para nuk i nxjerr nga buxheti, ua rrëmben studentëve. Pra Kryeministri u thotë shqiptarëve: “Hajdeni të bëjmë reformë me lekët tuaja. Unë jua tregoj si bëhet, ju thjesht paguani.”

Në vazhdimësi të debateve, pyetjes sime sesi do të jenë pedagogu dhe universiteti pas miratimit dhe zbatimit të këtij ligji, një nga zërat më të fortë kundër, iu përgjigj saktë dhe shkurt: “Jo vetëm nuk përmirësohem, por do të jem akoma më keq”. Arsyeja është e thjeshtë, pedagogu nuk ka më pagë të garantuar, granti i pakushtëzuar nuk e përmban një përcaktim të tillë, duke i vendosur ata në një pozitë tronditëse për investimin e jetës së tyre, pedagogu nuk ka karrierë të vlerësuar, pasi puna e tij kërkimore-shkencore nuk vlerësohet objektivisht brenda një agjencie të kërkimit shkencor tërësisht politike, nuk ka vend pune të garantuar sipas meritës, as promovim të paanshëm dhe objektiv. Ai nuk ka të drejtë të imponojë vendime me një senat të gjymtuar dhe me organe akademike të sakatuara dhe nuk tejkalon dot strukturat e mbyllura dhe të atrofizuara që i imponohen.

Senati, si organi më i lartë kolegjal akademik, brenda përcaktimeve të këtij ligji, nuk ka kompetenca të plota dhe komisionet e përhershme të dala prej tij vuajnë nga koha mandatuese dhe nga përbërja e zgjedhur mbi baza subjektive.

Zhbalancimi i rolit të fakultetit në favor të departamentit, i cili në përcaktim mbetet njësi e mbyllur, pasi nuk konsideron strukturat e ndërmjetme si departamentet e fushave të ngjashme, nuk është se duket që sjell një spunto studimore universitare. Aq më tepër, shkrirja e këshillit të profesorëve, fshirja e këshillit të fakultetit dhe shpërndarja e kompetencave të tij në drejtim të organeve të tjera, ulin ndjeshëm efektivitetin e punës kërkimore-shkencore dhe mësimore.

Ndërsa shqetësimit të një deputeti të maxhorancës, pse deputetët protestonin aq shumë, këta të fundit iu përgjigjën pa mëdyshje, jo pa ironi, sepse ky projektligj nuk ka në qendër të vëmendjes studentin dhe cilësinë e diplomimit të tij, por ka në qendër paranë që vjen nga ai dhe

tarifën e lartë me të cilën do të blejë një shërbim që është publik dhe është detyrim kushtetues i çdo qeverisjeje. Për këtë arsye, ai nuk duhet të votohet.

Faleminderit!

Edmond Spaho – Faleminderit, zoti Boçi!

Fjalën e ka zoti Balla.

Do t’ju lutesha të respektoni kohën, pasi, siç e shihni, jemi në orën 23:00 dhe kemi edhe disa diskutantë të tjerë.

Taulant Balla – I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pak më shumë se dy vjet më parë, rasti më bëri që të takoja dy djem që për profesion kishin bojaxhiun. Kërkonin punë si bojaxhinj, por nuk kishte pune. Njëri më tha: “Unë jam bojaxhi, por kam edhe diplomë juridiku.” I thashë: “Çne?” “Punuam para tre muajsh në një degë të një universiteti privat në Korçë dhe, pasi lyem universitetin, pronari na tha që lekë nuk kam t’ju jap, po dy diploma juridiku jua jap si kondravlërë e lyerjes së fasadës së universitetit.

Mua më vjen keq që Partia Demokratike kalë beteje gjen fusha të caktuara, ku për 8 vjet në pushtet ka qenë për të qarë me ojna. Sigurisht, mund të ketë pasur edhe sektorë që keni pasur sukses, por ka një sektor ku keni lënë nam, për të mos jua kujtuar asnjëherë, dhe ai është sektori i arsimit të lartë. Kam cituar vite më parë në këtë sallë të Kuvendit një universitet privat, Universiteti “Vitrina”, që shkruante në autobusët e Tiranës: “Regjistrohuni te Vitrina, merr dhuratë një telefon celular.” Pasi erdhëm në qeveri, u bë kontrolli i këtij universiteti, shikoni se çfarë u gjet në këtë universitet. Kontratat model që aplikonte Universiteti “Vitrina”, i licencuar nga ministri i Arsimit të Partisë Demokratike. A.T. dhuron një makinë dhe përfiton tri bursa trevjeçare universitare. Sh. G. dhuron 800 litra naftë, kontratë e hapur për tre vjet dhe përfiton katër bursa studimi trevjeçare dhe shërbimesh të tjera të universitetit “Vitrina” me po të njëjtën vlerë. Se çfarë shërbimesh të tjera ofronte ky universitet, një Zot e di! A.V. dhuron 17 kompjuterë dhe përfiton 6 bursa studimi trevjeçare. M. Zh. dhuron 50 kilogram fasule dhe përfiton një bursë studimi trevjeçare. B.F. dhuron punime të ndryshme në duralumin, materiale të ndryshme dhe përfiton katër bursa

studimi. P. M. dhuron dy ton tallash në këmbim të dy bursave studimi trevjeçare.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Dëgjoni, se kjo është më e bukur!

Janë kontrata të gjetura në universitet. Z. B. dhuron raki rrushi, mollë, verë dhe përfiton bursë studimi trevjeçare. I.P. dhuron pjesë për makinë “Wolswagen” dhe përfiton një bursë studimi trevjeçare. A.Z. dhuron një makinë “Chevrolet” dhe përfiton tetë bursa. Kjo është akoma më e bukur. L.Gj. dhuron 20 sedilje furgoni dhe asistentë të brendshëm furgoni dhe përfiton bursa trevjeçare. M.K. dhuron autoveturë “Ford Fiesta” dhe përfiton tri bursa studimi. Ka histori si këto pafund.

Ju ka mbetur merak universiteti “Kristal”: në vitet 2005 -2010 janë regjistruar 78 studentë dhe rezultojnë të diplomuar 170.

Të kërkohet një mirëkuptim, të paktën aty ku e keni bërë dëmin kala, gjëja më e mirë është të heshtni.

Bëni mirë të dëgjoni kryetarin *de facto* të partisë sesa atë *de jure*, sepse të paktën kryetari *de facto* për shkak edhe të ndonjë diplome jashtë Shqipërisë di të bëjë diferencën me kryetarin *de jure*. Të paktën këtu duhet ta kishit dëgjuar Lulzim, sesa dëgjoni përsëri Saliun, i cili edhe pasi Shqipëria ka ardhur në vitin 2015, flet ende për shitje lopësh për të marrë diplomën.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Koha kur shitej lopa për të blerë diplomën ka përfunduar në të njëjtën ditë me ju: në vitin 2013. Mjaft më me historitë që u thoshit shqiptarëve: “Hajde te Sudja dhe lini lekët! Hajde te Sudja universitare, paguaj lekët dhe merr diplomë që nuk të hyn në punë fare!”

Si ka mundësi që nuk e keni kuptuar ende edhe pas dy vjetësh që ndër një milion shuplakat që u dhanë shqiptarët, 15 mijë shuplaka i keni marrë pikërisht nga ata djem dhe vajza që i morët në qafë. U thatë: “Hajdeni, hyni në universitet!”. U dhatë një copë letër në dorë, që nuk vlen asgjë në tregun e punës. Shqiptarët nuk kanë nevojë për letra pavlerë që nuk i hyjnë në punë fare, ata kanë nevojë për një diplomë, e cila t’u garantojë karrierën, një vend pune të mirë dhe të ardhura për familjen e tyre. Në universitetet që ju bëtë: “Vitrina”, “Kristal” dhe histori emrash, aq pa vizion i kishit biznesmenët e partisë, të cilët i shpërblyet me licenca universitetesh, sa edhe emrat e universiteteve i gjen me emra idiotesh.

Si mund të quhet emri i një universiteti “Vitrinë” apo “Kristal”? Turp i madh!

Dilni sot këtu dhe akuzoni Ministrinë e Arsimit, e cila më në fund po bën një reformë për ta shpëtuar sistemin e arsimit në Shqipëri, i cili nëse do të vazhdonte në drejtimin ku e kishit çuar ju, do të falimentonte, ndërsa rivendosja në drejtimin e duhur të sistemit tonë universitar bën të mundur që çdo vajzë dhe djalë shqiptar që mbaron shkollën e mesme, të mos shohë si alternativë të vetme një shkollë të mirë studimi jashtë Shqipërisë, por të besojë se shkollë me vlera europiane mund të bëhet edhe në Shqipëri.

Ka edhe një çështje tjetër që është shumë e rëndësishme, kjo ka të bëjë me mënyrën sesi ju doni të bëni politikë, me diçka që kurrësesi nuk mund të bëhet politikë. I pari juaj i vërtetë Sali Berisha deklaroi këtu, në këtë sallë, në këtë foltore se sistemi që ka zgjedhur Ministria e Jonë e Arsimit është më i miri, sepse është sistemi, i cili funksionon në shtetet ku botërisht gjithëpranohet se ka universitetet më të mira në botë, qoftë britanik, amerikan, apo ku të doni ju. Të thuash se Britania e Madhe nuk ka sistem universitar elitari, nuk ju beson njeri.

Për sa u përket kushteve shqiptarët janë njerëzit më të zgjuar dhe për këtë të jeni të sigurt, sepse në çdo universitet të botës që shkojnë dhe studiojnë shqiptarët, jenë ndër studentët më të mirë. Nuk u kemi krijuar djemve dhe vajzave të Shqipërisë kushte për një mësimdhënie ashtu siç duhej në Shqipëri. Arsyeja pse po e bëjmë këtë reformë, është për t’u ofruar djemve dhe vajzave shqiptare mundësi shkollimi të barabarta, të njëjta edhe me vendet europiane ku ne duam të anëtarësohemi. E ardhmja e Shqipërisë është tek investimi dhe tek arsimiti. Hiqni dorë nga mbrojtja e një sistemi, të cilin ju me vetëdije të plotë politike kërkuat ta ktheni në një mundësi për të mbetur mbrapa, për të shpërndarë diploma dhe për të mbledhur vota! Morët veten në qafë, desh morët në qafë edhe sistemin, por këtë nuk e bëtë dot. Shqiptarët ju dënuan. Ndryshoni kurs, se jeni në rrugën e gabuar. Ka ardhur koha të ngremë një universitet në PD! Nuk keni nga shkoni.

Faleminderit!

Edmond Spaho - Faleminderit, zoti Balla!

Po, zoti Paloka për procedurë.

Edi Paloka – Zoti drejtues i seancës, do t’ju kërkoja meqenëse jemi edhe në një orë të

vonë, atyre që do të flasin të mos përsërisin fjalimet e njëri-tjetrit, sepse fjalimin që sapo dëgjuam, e dëgjuam një orë përpara fjalë për fjalë, pikë për pikë dhe presje për presje nga Kryeministri. Nuk e di kush ia bën njëri-tjetrit: ia bën Rama Ballës apo Balla Ramës, por mirë është të mos i dëgjojmë gjërat nga dy herë.

Faleminderit!

Edmond Spaho - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Gjergji Papa.

Gjergji Papa – Faleminderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të doja edhe unë të thosha dy fjalë për atë që tha zoti Paloka: përsëritja e fjalëve nuk do të thotë të injorosh punën plotë përkushtim të pedagogëve të Republikës së Shqipërisë në edukimin e brezit të ri në përgatitjen e mijëra studentëve, profesionistëve në punën e mirëfilltë shkencore që kanë bërë në fushat përkatëse. T'i heqësh një kryq dhe ta shumëzosh me zero të gjithë punën e pedagogëve të universiteteve të Shqipërisë është mëkat dhe gjynah që maxhoranca e konsideron, sikur duke filluar që sot, do të fillojë një jetë e re dhe se pedagogët deri sot nuk kanë bërë asgjë në punën e tyre humane.

Me urdhër të Kryeministrit Rama, sot deputetët e maxhorancës do të votojnë në bllok pro për projektligjin “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Ky projektligj vjen me paramendim të plotë në seancë plenare në një moment të tillë, kur auditorët e universiteteve janë bosh për të shmangur protestat, rebelimin legjitim dhe të drejtë kundër këtij ligji nga studentët dhe pedagogët, me qëllim që ai të harrohet deri në shtator në fillimin e vitit të ri akademik.

Kolegë deputetë, Partia Demokratike është pa dyshim për reforma në fushën e arsimit të lartë. Ka ende shumë probleme që duhen zgjidhur dhe shumë hallka që duhen përmirësuar. Partia Demokratike nuk është kundër liberalizimit dhe konkurrencës së ndershme të institucioneve të arsimit të lartë.

Si pedagog universiteti prej 22-vjetësh, më lejoni të përmend disa nga pasojat negative që sjell ky projektligj dhe të jap disa argumente që tregojnë pse ky projektligj është abuziv,

korruptiv, klientelist dhe bën hapa prapa në rrugën drejt zhvillimit të arsimit të lartë.

Ky projektligj vjen sot në seancë plenare për miratim pa dëgjuar fare zërin e grupeve të interesit, të studentëve, prindërve të tyre dhe pedagogëve. Shqetësimi kryesor i shqiptarëve është arsimimi i fëmijëve të tyre.

Ky projektligj u mbyll derën e universiteteve maturanëve që nuk kanë mundësi financiare për të vazhduar shkollën e lartë. Cila është rruga që ka zgjedhur qeveria, për gjoja financimin e arsimit të lartë?

E vetmja rrugë, sipas qeverisë është rritja e kontributit nga familjet e studentëve përmes rritjes së tarifave të shkollimit për të përballuar rritjen e tarifave të shkollimit. Qeveria parashikon që studentët të marrin kredi nga skema e kredisë studentore. Pra, me këtë model financimi që parashikon ky projektligj, qeveria synon të rritë financimin e arsimit të lartë duke futur në borxhe të mëdha studentët dhe familjet e varfra shqiptare. Qeveria nuk synon aspak të rrisë buxhetin për arsimin, siç u premtoi shqiptarëve në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013. Premtimi ishte: “Buxheti për arsimin do të jetë 5% e GDP-së”. Deri tani buxheti për arsimin në tërësi është vetëm 2,7%, dhe për arsimin e lartë vetëm 0.4%. Ky ishte një nga mashtrimet e mëdha elektorale të Partisë Socialiste para dy vjetëve.

Tani, pas dy vjetësh u thotë shqiptarëve: “Paguani nëse doni t'i shkolloni fëmijët tuaj në universitetet tona publike, ndryshe rrini pa shkollë ose merrni rrugët e botës edhe për tu shkolluar”!

Kjo skemë u fshin të drejtën kushtetuese mijëra të rinjve shqiptarë për t'u arsimuar, të cilët edhe aktualisht me tarifa të reduktuara, ku shteti merr përsipër shpenzimet në universitetet publike e kanë të vështirë, se familjet e tyre nuk kanë më burime financiare për shkak të papunësisë dhe varfërisë në rritje.

Barazimi i tarifave të studimit në universitetet publike me ato private është një shkëlqje e rëndë e të drejtës kushtetuese që u njeh studenteve më të aftë mundësinë që, pavarësisht kushteve ekonomike, shteti t'u ofrojë arsimin e lartë, i cili përballohet nga vetë shteti. Objektivi social i parashikuar nga Kushtetuta e detyron shtetin që nga viti në vit të rrisë, jo të

pakësojë numrin e studentëve që u ofrohet arsimit i lartë pa pagesë.

Me gjithë kundërshtimin masiv të studentëve, prindërve, stafëve akademike të universiteteve publike, Kryeministri ka vendosur të shkojë në drejtim të rrënimt të universiteteve publike të vendit. Projektligji krijon pasiguri të madhe tek pedagogët e universiteteve publike, jo vetëm për pagat, por edhe për vendin e punës. Ndryshe nga ligjet e mëparshme, shteti nuk njuh më detyrim të përballojë me buxhet të pakushtëzuar pagat e pedagogëve të universiteteve publike, por u lihet universiteteve publike të përcaktojnë tarifat e studimit për studentët mbi bazën e një logjike ekonomike që bazohet te kostot dhe shpenzimet. Ligji u jep universiteteve publike të drejtën të përcaktojnë numrin e punonjësve dhe nivelin e pagave, si shprehje e rritjes së autonomisë së personelit dhe të financimit.

Çfarë do të bëjnë me këtë të drejtë universitetet kur nuk kanë buxhet? Do ta përdorin atë për të shkurtuar numrin e pedagogëve në mënyrë që të mos ulin pagat.

Projektligji përcakton një skemë të tillë financiare që çon në mbylljen e universiteteve publike rajonale. Qeveria synon të rishikojë statusin e universiteteve publike rajonale që kanë krijuar një histori zhvillimi. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, disa ose të gjitha universitetet rajonale do të humbasin statusin e universitetit dhe do të bëhen kolegje. Si mundet që me një të rënë të lapsit të shumëzohet me zero kontributi i jashtëzakonshëm që kanë dhënë këto universitete në shkollimin e mijëra profesionistëve në dhjetëra vjetë dhe në zhvillimin rajonal?

Nga ana tjetër, kjo e bën të pamundur shkollimin e mijëra të rinjve, të cilët deri më sot ishin në gjendje t'i përballonin studimet afër vendbanimit të tyre. A do të pranojnë të rinjtë e këtyre rajoneve të shkojnë dhe të studiojnë në kolegje? Sigurisht, që jo! Po ku do të shkojnë? Ata janë të detyruar të largohen në tri drejtime të mundshme, drejt universiteteve publike të Tiranës, por u duhen së paku 3500 dollarë, për të përballuar koston e studimeve dhe atë të jetesës në Tiranë; drejt universiteteve private të Tiranës ku u duhen së paku 6000 dollarë, për të përballuar koston e studimeve dhe të jetesës në Tiranë.

E treta, të largohen drejt vendeve të tjera për t'u shkolluar. Kush e njuh nivelin alarmant të varfërisë në rajon dhe në vend, e kupton fare qartë se shumë të rinj të rajoneve nuk do të kenë mundësi të vijoje arsimit e lartë.

Nga ana tjetër, nuk ka punë. U mbetet vetëm një rrugë, të largohen nga vendi. Pra, një eksod i ri masiv i rinisë, ose këta të rinj do të bëhen kontingjent i drogës dhe i krimit.

Projektligji legjitimon edhe skema financiare në favor të klientelës së qeverisë. Ai parashikon transformimin e shkollave të larta private në universitete publike të pavarura, të cilat përfitojnë nga fondet publike. Tipe shumë të ngjashme universitetesh ekzistojnë në disa vende shumë të zhvilluara dhe shumë të pasura, si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe. Në këto vende aplikohen tarifa shumë të larta shkollimi, ndryshe nga vendet e Europës kontinentale, që kanë tarifa përgjithësisht të ulëta shkollimi në raport me të ardhurat e familjeve dhe në paga.

Shqipëria nuk është një vend aq i pasur sa të krahasohet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Britaninë e Madhe. Lind pyetja: çfarë e ka shtyrë qeverinë të aplikojë një model të tillë? Asgjë tjetër përveçse rrugës më të shkurtër, të heqë dorë nga financimi i arsimit të lartë publik.

Nga ana tjetër, ky lloj institucioni i arsimit të lartë, që fiton të gjitha të drejtat ekstra vetëm me firmë dhe me vulë të Kryeministrit, prish jo vetëm barazinë në treg në universitetet private, por krijon edhe situata klienteliste dhe ndikim politik. Tashmë, liria e tyre e fjalës, e mendimit, opinionit të tyre, ekzistenca e tyre do të jenë të lidhura pazgjidhshmërisht me Kryeministrin.

Alternativa e Partisë Demokratike në këtë drejtim është e përcaktuar. Ne jemi për rritje të financimit, së paku dyfishim, të buxhetit për universitetet publike dhe reformimit të tyre për të rritur cilësinë; inkurajimin e arsimit të lartë privat, në mënyrë që ai të konsolidohet, të reformohet për t'iu përshtatur kërkesave të tregut të punës dhe të zhvillimit të ekonomisë dhe të bëhet plotësisht i krahasueshëm për nga cilësia me universitetet publike niveli i buxhetit dhe investimi tërësor që bën vendi për arsimit e lartë t'i afrohet nivelit së paku të vendeve të reja të BE-së, atëherë mund të bëhet fjalë për modele të mbështetura në konkurrencën e lirë midis

universiteteve publike dhe atyre private edhe për fondet publike.

Autonomia universitare si e drejta kushtetuese që kanë institucionet e arsimit të lartë për t'u vetorganizuar, si dhe liria akademike si e drejta e pedagogëve dhe studentëve për të qenë të lirë dhe të pandikuar në procesin mësimor dhe shkencor, të arritura me aq mundim deri tani, asgjësohen nga ky projektligj.

Projektligji rrit dukshëm kontrollin e shtetit mbi universitetet publike dhe i kthen ato në varësi direkte të Kryeministrit. Shteti e rrit kontrollin e tij mbi universitetet publike nëpërmjet dobësimit të rolit të organeve kolegjiale dhe autoriteteve akademike të zgjedhura nga komuniteti akademik.

Shumicës së përfaqësuesve të qeverisë në bordin e administrimit, influencës direkte të përfaqësuesve të qeverisë në emërimin e administratorëve të universiteteve publike, kontrollin mbi universitetin përmes një sërë agjencish në varësi direkte të ministrisë, përmes emërimeve të mirëfillta politike nga Kryeministri të titullarëve të bordeve dhe të agjencive, heqja e maturës shtetërore dhe vendosja e notës mesatare si kriter bazë i pranimit në arsimin e lartë, do të shkaktojnë menjëherë presion mbi mësuesit dhe shkollave të mesme dhe në klimën e politizuar korruptive do të çojë në nota pa lidhje me meritën.

Nga ana tjetër, konkurset në universitetet publike do të kthejnë në amullinë korruptive testimet në stadiume dhe në pallate sporti, ashtu sikundër ndodhte përpara vitit 2005.

Për arsyet që përmenda më lart, u bëj thirrje deputetëve, u bëj thirrje kolegëve pedagogë të maxhorancës, me të cilët në biseda formale kemi ndarë të njëjtat mendime, të mos i binden verbërisht urdhrin të Kryeministrit dhe me përgjegjshmëri politike, intelektuale dhe akademike të mos e votojnë këtë projektligj.

Faleminderit!

Edmond Spaho –Faleminderit, zoti Papa!

Fjalën e ka zonja Blerina Gjylameti!

Blerina Gjylameti – I nderuar drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë,

Jemi mbledhur sot për të diskutuar për një projektligj të rëndësishëm, i cili shënon edhe një nga reformat më të thella në të gjithë sistemin e arsimit të lartë. Përmes këtyre ndryshimeve që

propozohen sot, synohet të realizohet një herë e mirë shkëputja nga sistemi i vjetër dhe i kalbur, mbi të gjitha edhe nga keqshfrytëzimi. Synohet, një herë e mirë, të shkëputemi nga prodhimi masiv dhe shqyerja e dyerve të universiteteve në kurriz të cilësisë.

Kjo reformë, si një nga reformat më të rëndësishme të viteve të fundit, ka qëllim të ofrojë të gjitha premisat e duhura, për të ndërtuar një sistem universitar që në të ardhmen do të ofrojë kapacitetet e duhura për tregun e punës.

Drafti i sotëm përcakton në mënyrë të qartë rregullat për krijimin, organizimin, administrimin, financimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë. Kam ndjekur me vëmendje këto kohë kolegjë e opozitës, në lidhje me këtë projektligj, por, për fat të keq, nuk kam dëgjuar asnjë propozim konkret nga ata. Kundërshtojnë vetëm e vetëm për të përbaltesur punën e një komisioni të përbërë nga ekspertët më të mirë dhe nga bashkëpunëtorët e përzgjedhur, për të përmbytur këtë mision.

E konsideroj mision, pasi kur bëhet fjala për arsimin, nuk duhet ta shikojmë atë si një biznes ku vetëm prodhojmë studentë, por që, për fat të keq, kur përballen me nevojat e tregut të punës, nuk janë askund.

Të nderuar kolegë, e konsideroj mision, sepse edhe si pjesë aktive e jetës universitare kam parë nga afër në këto vite se çfarë do të thotë të investosh në kohë lekë, vitet më të bukura të jetës, për të marrë thjesht një diplomë, që shpeshherë, nuk vlen as sa kostoja e letrës në të cilën është printuar. Çfarë gjen? Vetëm pasiguri për të ardhmen, pasi nuk ke investuar siç duhet.

Gjatë këtyre viteve dhe aq më tepër gjatë 8 vjetëve të fundit të qeverisjes së opozitës së sotme u hapën me dhjetëra institucione të arsimit të lartë, aq sa filluan të barazoheshin edhe me numrin e kafeneve të lagjes. Diploma pa fund janë lëshuar nga këto institucione të arsimit të lartë, duke vjedhur prindërit shqiptarë, të cilët si çdo prind për të mirën e fëmijëve të tyre kanë investuar deri në qindarkën e fundit.

Më lejoni t'ju sjell këtu disa shifra për të kuptuar edhe katrahurën që u krijua këto vite në sistemin e arsimit të lartë, ku sigurisht ndonjëri prej jush, që në atë kohë ka qenë edhe drejtues i ministrisë përkatëse, nuk do të dojë ta dëgjojë, pasi ka hedhur edhe vetë firmën.

Në universitetet shtetërore pedagogët e brendshëm mbulonin ngarkesa, që shpeshherë ishin tri herë më të larta se ngarkesat e lejuara dhe, nga ana tjetër, në universitetet private nuk kishin as minimumin e pedagogëve të brendshëm dhe pa dashur të citoj ndonjë universitet përkatës me zero pedagogë të brendshëm.

Të nderuar kolegë të opozitës, dhe në mënyrë të veçantë ata që janë pjesë aktive e botës akademike, flisni për arritje të viteve të qeverisjes suaj, por nuk flisni çfarë ju shtyu të shkatërronit deri në gjenezë sistemin e arsimit të lartë, duke hapur pa kriter universitete, duke licencuar aq shumë universitete, sa edhe emrat nuk ju dihen dhe duke arritur atë që e keni merakun më të madh për t'u krahasuar aq sa ia kaluat çdo vendi të zhvilluar për nga numri i universiteteve, por që po të krahasohet me numrin e banorëve, jemi të parët rrezik në botë për çfarë kemi arritur.

Të nderuar kolegë, pyetja që do t'ju drejtoj është: çfarë u ofruat të rinjve shqiptarë? U ofruat një iluzion, u ofruat një ëndërr, një mashtrim dhe në fund të fundit, për çfarë, për t'u punësuar si kamerier apo si shitës me diploma juridiku, me diploma ekonomiku, me diploma mjekësie, me diploma stomatologjie që realisht nuk vlenin asgjë. Kjo është politika juaj e përgjegjshme? Këto janë ato arritjet që flisni shpesh? Ky është sukcesi i qeverisjes suaj? Kjo është ajo *miracle of freedom* që donit të ofronit në 8 vjet?

Arritët në 8 vjet, me 3 ministrat tuaj përkatës, të jepnit 22 licenca për universitetet private, 22 licenca të cilat vetëm vitin që shkoi nga këto u mbyllën 14 prej tyre dhe 4 u pezulluan, pasi nuk plotësonin as kriteret minimale për t'u licencuar.

Çfarë bëtë në 8 vjet? Cilat janë politikat tuaja të përgjegjshme për arsimin e lartë? Arritët të shqyeni dyert e arsimit shtetëror ku mësimi bëhej me dy turne, bëhej të shtunë dhe të diel. Detyroheshin pedagogët të mbulonin ngarkesa që as nuk i kishin imagjinuar ndonjëherë dhe e gjithë kjo në kurriz të cilësisë së mësimdhënies.

Të nderuar kolegë, arritët të bënit një tjetër mynxyrë si shumë mynxyra, që keni bërë, duke shkatërruar këta të rinjtë dhe për të bërë atë që do të kemi shumë vite që ta mbajmë mbi kurriz. E keni shkatërruar në mentalitetin e tyre, ku çdo gjë shikohej si mundësia e vetme, merr disa diploma se ndoshta gjejnë një vend pune. Lëri të

jenë me idenë se do të arrijnë diku, por në fund nuk kanë asgjë.

Mashtruat të gjithë ata të rinj që në universitetet e licencuara prej jush nuk ishin askund të regjistruara, sepse ishte një falsitet pa fund. Akredituat programe dhe institucione, duke shkelur haptas të gjitha procedurat e vlerësimit dhe të akreditimit. Madje, besoj se do të ishte rasti të hynit edhe në librin *Guinness* të rekordeve, ku 24 orë, një ditë, por më saktë një ditë pune 8 orë u është dashur për të vlerësuar procedurat për një universitet apo për shumë dhe tre ditë u është dashur për të akredituar universitetet. Do të hyni në librin *Guinness* sikundër keni hyrë edhe për shumë gjëra të tjera.

Me anë të këtij projektligji ajo çfarë ne kërkojmë është pikërisht t'i japim fund kësaj situatë katrahurë, që keni krijuar në universitete; t'i japim fund hapjes dhe mbylljes së universiteteve si kafenetë e lagjes dhe të synojmë të afrojmë një arsim të lartë me cilësinë e duhur. Të ofrojmë një arsim të lartë që të kontribuojë ashtu sikundër ne që jemi pjesë, të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendit, në zhvillimin social dhe kulturor.

Dëgjova shpesh sot, por edhe nga ajo çfarë keni ngritur si shqetësime tuaja kryesore, se shqetësoheni për gjendjen ekonomike, shqetësoheni që po shtojmë varfërinë, shqetësoheni që do të ngrihen tarifat. Një tjetër gënjeshtër si gënjeshttrat e herëpashershme që përdorni për të bërë opozitë.

Tarifat nuk do të rriten, tarifat sipas autonomisë që të gjithë ne pedagogët dhe të gjithë ata kolegët e mi, dhe ju keni kërkuar sipas autonomisë së universiteteve, tarifat nuk rriten, tarifat sipas një vendimi të Këshillit të Ministrave, do të ketë një tavan.

Thatë pak më parë, e dëgjova nga disa kolegë, faktin që do të ketë një njehsim të tarifave ndërmjet universiteteve private dhe universiteteve shtetërore. Përsëri tarifat, të cilat kanë tavanin nga Këshilli i Ministrave, por doja të dija pse nuk jeni shqetësuar këta 10 vjet për ndryshimet e tarifave? Në këta 10 vjet ka pasur rritje të tarifave të arsimit të lartë. Sot tarifa mesatare e studimit është 26500 lekë. Një tarifë për bachelorin, por mendoni se ky është problemi me të cilën i pengon shumë studentë shqiptarë për të qenë pjesë e arsimit të lartë? Jo. Është kostoja e jetesës. Dhe këtë e kemi zgjidhur

nëpërmjet pjesës së financimit të të gjithë atyre studentëve që nuk kanë mundësi ekonomike për të ndjekur studimet.

Janë 3 pikat kryesore që do të desha t'i përmendja sikundër i përmendën edhe të tjerët:

Financohen të gjitha kategoritë e studentëve në nevojë. Do të financohen të gjithë studentët, që ndjekin degë me prioritet kombëtar. Të gjithë ata që kanë qenë pjesë e arsimit, e dinë mjaft mirë që kemi prodhuar mësues matematike, kemi prodhuar mësues kimie, kemi prodhuar mësues fizike, që kanë qenë me mesatare të shkollës së mesme 5 dhe shkojnë të edukojnë breza të tërë. Kjo ishte politika juaj e përgjegjshme.

Do të financohen, gjithashtu, studentë të ekselencës dhe kjo është një tjetër mënyrë për të bërë që studentët shqiptarë të jenë këtu, të diplomohen këtu dhe të mos shkojnë të investojnë jashtë shtetit.

Flasim për pjesën e autonomisë. Shumë pedagogë e kanë ngritur ndër vite këtë problem, autonominë financiare dhe autonominë organizative të universiteteve. Zgjerim të autonomisë financiare pikërisht e bazuar në performancë nuk mundet kurrsesi të drejtohet një institucion i cili përdor fondet publike pa konceptin e eficiencës dhe efektivitetit.

Nuk mundet, në mënyrë absolute, të prisnin universitetet, sikundër prisnin drejtuesit çdo vit, që pasi t'u përcaktojnë buxhetin të vendosnin se si do të kishin planin apo implementimin e buxhetit vjetor. Ka ndryshuar, pasi do të ketë edhe planin e zhvillimit për buxhetin afatmesëm, si dhe implementimin e buxhetit vjetor.

Autonomi e mirëfilltë qeverisëse me rolin kryesor dhe këtu dua të them një tjetër gënjeshtër që u tha nga kolegët parafolës ku i ulet ose më saktë humbet autonominë senati. Jo, të dashur kolegë! Këtu është një tjetër gënjeshtër juaja: senati merr kompetenca të plota, gjithashtu, edhe asambleja universitare, liria akademike përsëri dhe vetë universiteti që ka vendimmarrje në ciklin e tretë të studimeve, jo më sikundër ka ndodhur më përpara, që bllokoheshin doktoraturat për arsye të caktuara, herë jepeshin e herë nuk jepeshin, duke kufizuar të drejtën e çdo anëtarit të botës akademike për të pasur zhvillime në karrierën e tyre. Ajo çfarë të gjithë ne kemi kërkuar është autonomia financiare dhe organizative e universiteteve dhe pikërisht ky ligj e ofron atë. T'u japim një tjetër risi

akademikëve, mundësinë për t'u zhvilluar në karrierën e tyre nëpërmjet kërkimeve shkencore dhe ky projektligj e mundëson atë, duke bërë një herë e mirë ndarjen ndërmjet botës akademike dhe administrimit.

Të dashur kolegë,

Misioni ynë është të ndërtojmë të ardhmen, jo të bëjmë biznes me të, ndaj ju ftoj ta votoni këtë projektligj.

Faleminderit!

Edmond Spaho – Faleminderit, zonja Gjylameti.

Fjalën e ka Eleina Qirici!

Përgatitet zoti Ilir Pendavinji.

Eleina Qirici – Të nderuar kolegë deputetë,

Doja t'i vlerësoja sot sugjerimet nga deputetët e maxhorancës për këtë projektligj, sidomos nga ata që kanë eksperiencë akademike, por as nga ata nuk i pashë, sepse të tjerët, duke dashur që të bëjnë politikë, gabojnë në gjykimin e këtij projektligji. Arsimi i lartë nuk është vetëm për universitetin privat. Propozimet e deputetëve të opozitës janë bërë në komisionet parlamentare, pavarësisht se këtu u tha që nuk janë bërë këto propozime. Mos harroni se keni dy vjet në qeveri, por e paskeni harruar, dhe ende merreni me opozitën.

Ministria e Arsimit erdhi me projektligjin, i cili u prezantua sikur do të zgjidhte problematikat e arsimit të lartë dhe do të rriste cilësinë. Ajo që e dinë të gjithë e dimë është fakti që është një projektligj shumë i debatueshëm nga qarqet akademike dhe nga studentët, të cilët janë kryesorët. Ndërkohë, ky është një projektligj, i cili po tentohet që të miratohet me dhunë dhe, më kryesorja, i largohet premtimit për buxhetin e arsimit të lartë, që do të rritej. Jo vetëm që rritje nuk ka, por më e keqja është se shteti nuk e garanton më as pedagogun në punën e tij, as studentin në studimet e tij, as maturantin që do të hyjë në universitet dhe aq më pak të ardhmen e arsimit. Ku u bazua projektligji? Në Kushtetutë? Jo! Ai e shkel disa herë këtë Kushtetutë, pikërisht liritë, të drejtat e pedagogëve, të studentëve, të maturantëve. Është një projektligj miratimi i të cilit po nxitohet, për faktin që të ketë sa më pak rezistencë sociale nga pedagogët dhe studentët. Ky projektligj i anashkalon vlerat europiane dhe këtë e ka shprehur qartë edhe eksperti evropian i politikave arsimore, përveç faktit se pa pasur një ligj të mirë për arsimin

parauniversitar dhe pa arritur për ta transformuar atë krejtësisht, nuk mund të reformohet as universiteti. Projektligji nuk zgjidh problemet për të cilat flitet se u hartua, nuk zgjidh problemin e falsitetit të diplomave apo të vlerësimit të tyre, dhe, ajo që është më e rëndësishmja, nuk zgjidh as punësimin e të rinjve. Kursimet e familjeve shqiptare shkojnë dëm, sepse paguajnë për të nxjerrë një jurist, por që, në fakt, është një i papunë. A e reformon sistemin arsimor universitar ky projektligj? Absolutisht, jo. Tarifa më të larta dhe mundësi më të pakta shkollimi. Universitetet publike i godet rëndë, duke i çuar drejt falimentimit dhe mbylljes, ndërsa autonominë universitare jo vetëm që nuk e rrit, por e mbyt.

Dalja e universiteteve nga problematikat që kanë, nuk mund të bëhen me metoda menaxheriale të një putinizmi lindor. A mund ta çojë ndonjë në mend se mund të ketë rezultate pozitive ky projektligj, kur nuk merr mendimin e profesoratit për zgjidhjen e problemeve në universitet? Përkundrazi, universiteti shtetëror shkon drejt falimentimit. Nëse miratohet në formën aktuale ky ligj do të sjell dëme në sistemin arsimor universitar, madje të parikuperueshme. Paratë që do të shkonin për arsimin publik nxisin tregtinë e lirë, tarifa më të larta për në universitet, por që komandohet nga zëdhënës qeverie dhe ky zëdhënës, apo delegat i qeverisë, do të vendosë se çfarë është mirë apo keq. Ndërsa për ata që punojnë aty me vite të tëra, siç duket, aty janë kot. E mira publike shndërrohet në të mirë private, ndoshta kjo është ajo drejt së cilës synon politika qeveritare për arsimin.

Autonomia universitare është shprehur, por jo, pasi kjo goditet rëndë. Pretendohet se diku ligji i jep pavarësi, por ia merr këtë pavarësi nëpërmjet agjencive qeveritare. Prezenca shtetërore atje është shumë e dukshme, autoriteti më i lartë në universitete nuk janë ministrat. Pikërisht ky projektligj e përlligj ndërhyrjen arbitrare. Dalja e disa agjencive shtetërore të varura apo të krijuara direkt nga ministri, të cilat do të kenë në dorë të gjitha vendimmarrjet përfundimtare në universitet, është në kundërshtim me Kushtetutën. Ato nuk janë gjë tjetër, veçse një delegim të vullnetit të pushteti tek universitetet. Pikërisht do të ndodhë ajo që ata, të cilët janë kompetentë për të vlerësuar, janë

në fund të hierarkisë, por ata nuk i dëgjon kush. Profesorët flasin, por vendimet merren në mënyrë arbitrare.

Ku është ndikimi pozitiv që ka ligji? Ky është një projektligj që i shndërron në ndërmarrje biznesi universitetet, ku pika akademike qëndron nën atë financiare, ku administratori është më i fortë se rektori (të mos harrojmë që administratori është politik) dhe studenti nuk është më në qendër të politikave universitare, por thjesht një klient i radhës, i cili do ta blejë shërbimin sipas xhepit.

Ligji ka një ndikim pozitiv dhe ky ndikim është për qeverinë, sepse e vendos në kontroll të plotë shtetëror universitetin publik, duke ndërtuar një burokraci vertikale. Po bordi i administrimit? Siguron numrin më të lartë të përfaqësuesve të qeverisë, sepse është shprehur se nëse institucioni siguron vetë 50% ose më shumë të buxhetit, katër prej anëtarëve të tij janë përfaqësues të universitetit. Si do ta sigurojë vetë universiteti publik këtë? Pra, në të kundër, këta katër anëtarë do të jenë pikërisht përfaqësues të ministrisë. Universiteti nuk i rrit dot tarifat. Jo, zotërinj, pasi shteti ka për qëllim të garantojë arsimin e lartë dhe të gjejë mekanizmat për të siguruar pikërisht arsim. Ky është një projektligj, i cili krijon një dualizëm midis drejtimit akademik dhe atij administrativ, pasi asnjë vendim i rektorit apo i dekanit për çështje akademike nuk hyn në fuqi pa miratimin e bordit të administrimit, që, në fakt, është i kontrolluar direkt nga qeveria dhe vendimmarrja tashmë kalon deri lart. Përfaqësuesit e vetë universiteteve kanë shprehur sugjerimet që kompetencat akademike duhet t'i mbeten senatit. Po pedagogët? Ata tashmë nuk e kanë lirinë e tyre akademike dhe janë të pasigurt për vendin e punës. Shteti duhet të garantojë pagat e pedagogëve, por, në fakt, vihet në rrezik financimi i pagave dhe i shpërblimeve për personelin, duke e vendosur universitetin përballë dilemës: të rrisë tarifat për studentët, apo të pranojë të vegjetojë në limite me mjetet e veta financiare. Trupa akademike nuk duhet të trajtohet sikur të ishin punonjës civil të një niveli të lartë.

Pozita e pedagogut me këtë projektligj pëson rënie jo vetëm me mosgarantimin nga shteti të pagave, por edhe me vlerësimin e punës së tij shkencore dhe mënyrën e konsiderimit të

titujve. Titujt shmangen, që të jenë me vlerë kombëtare, por kjo krijon premisa të një konkurrence institucionale dhe jo parimore.

Këshillit të profesorëve, të cilin nëpërmjet këtij projektligji i jepet një goditje e fortë vlerave profesionale, duke fshirë rolin drejtues në kërkimin shkencor dhe në mësimdhënie, ku ky këshill tashmë bëhet inekzistent.

Këshilli i profesorëve nuk na duhet, pasi kemi shtetin profesor! Debatimi shkencor në fakultet ku do të bëhet? Nuk ka pse të ketë më debat, kemi agjencitë qeveritare, të cilat nuk do të zhvillojnë debat, por bisedime të frytshme për të ndarë përfitimet. Ndërsa universitetet, qeveria as i njeh si të tilla dhe as nuk ka çfarë t'i duhet se çdo të bëhet me to. Po cilësinë e punës së pedagogut kush do ta kontrollojë? Nëpunësi? Edhe po të dojë nëpunësi nuk e bën dot, pasi puna shkencore vlerësohet nga agjenci shtetërore, pra e humb pavarësinë nga shteti dhe politika. Agjenci sigurimi të cilësisë apo bord akreditimi? Cili do të jetë më përgjegjës për sigurimin e cilësisë? Po auditimi, cili i kontrollon kontrollorët? Linja e parë e kontrollit normalisht është shtetërore, por auditimi jashtëm duhet bërë nga ekspertë të besueshëm, të cilët kanë ekspertizë të mirë. Cilësia e një universiteti nuk mund të matet vetëm me mjediset, por me cilësinë e dijeve që jep. Sigurisht ka metoda për t'i matur, jo dinakëri për t'i anashkaluar. Po universitetet e vendosura në rrethe? Ka një tendencë për të ulur statusin e tyre nga universitet në kolegji. Kjo nuk do të thotë reformim për arsimin e lartë, por përçmimi i këtyre universiteteve, përçmimi për punën e deritanishme, përçmimi për investim në karrierën profesionale të stafit akademik, ndonëse janë universitete me jetëgjatësi mbi 40 vjet.

Projektligji parashikon rishikimin e statusit të universiteteve publike rajonale, por kjo nuk është shumë e drejtë. Ndërkohë nuk shohim që të ketë ndonjë dispozitë kalimtare në këtë projektligji, ku të thuhet se universitetet publike që kanë statusin e universitetit e ruajnë këtë. Publik apo privat, ky projektligji ka shumë pak kontrolle dhe rregulla për universitetet private, domethënë duket sikur do të merret vetëm me universitete shtetërore, ndërsa privatet kontrollohen vetëm së jashtmi nga ana e agjencive shtetërore.

Po studenti? Për të vazhduar studimet e larta, ai duhet të marrë hua që të paguajë për të mbaruar studimet. A e konceptoni dot se studentit nuk i duhet vetëm huaja e studimit, por i duhet të marrë hua edhe për koston e jetesës dhe më keqja është se ai mbetet vetëm borxh ndaj shtetit.

Universiteti përgatit të papunë, të cilët do të marrin një diplomë, po studenti që sapo mbaron si do t'i shlyejë? Ku e ka ai sigurinë e punësimit? Ajo që është e sigurtë është se ai do të mbetet borxhli dhe pa të ardhme. Shteti mbështet studentët ekselent me bursa. Shumë mirë! Sa është përqindja e tyre? Do të mbështesë edhe studentët me pamundësi ekonomike apo ekstremisht të varfra, po sa për qind e këtyre shtresave dërgojnë fëmijët në universitet? Ndërkohë, për nivelin ekonomik që kanë familjet shqiptare dhe me tarifat e rritura, është e pamundur ndjekja e arsimit të lartë. Si i ndihmon shteti studentët? Me dhënie e kreditë studentore? Garanci do të thotë që buxheti i shtetit të bëhet garant për një bankë të nivelit të dytë që studentët të marrin kredi, kjo është logjika, por problemi qëndron te kthimi i kreditë, pasi, në fund të fundit, janë studentët që do të paguajnë kredinë.

Universitet publik i pavarur është forma që u përfol më shumë, një formë që tregon se universiteti është i pavarur nga akademizmi dhe është i varur nga tutela shtetërore.

Së fundi, për të mos u zgjatur më shumë, projektligji arrin ta fundosë arsimin e lartë dhe e zyrtarizon braktisjen e auditorëve, të profesoratit, ku studenti shndërrohet në mjet brenda një ndërmarrjeje ku do të vendosin qeveritarët.

Mos e votoni këtë projektligj kështu siç është paraqitur, sepse ai është jo vetëm në dëm të studentëve dhe profesoratit, por dëmton edhe vetë vlerat. Duhet një financim optimal dhe i drejtë, i cili i lejon studentët të kenë akses në arsimin universitar.

I ftoj deputetët e maxhorancës të mos e votojnë në këtë mënyrë që është, por të shprehin me votë atë që arsyeja jua ka treguar gjatë diskutimit të këtij projektligji, që ai nuk i shërben as arsimin të lartë, as cilësisë, as studentëve, as personelit akademik.

U drejtohem atyre deputetë të maxhorancës, që e kanë kryer realisht arsimin e lartë, për t'ju kujtuar se do e varrosin në qoftë se

e miratoni. Në qoftë se e doni këtë, mjerë elektorati që ju ka votuar!

Edmond Spaho – Faleminderit, zonja Qirici!

Fjalën e ka zoti Ilir Pendavinji!

Tërhiqeni? Po.

Atëherë, fjalën e ka zonja Olta Xhaçka, diskutantja e fundit!

Olta Xhaçka – Kolegë deputetë,

Projektligji në fjalë meriton pa diskutim të gjithë vëmendjen që po merr për rëndësinë që ka dija, jo vetëm për avancimin e cilitdo individ, por edhe përparimin e vendit që investohet te kjo e mirë publike. Projektligji në fjalë nuk meriton të gjitha kundërshtitë në adresë të tij, ardhur si pasojë e nevojës për të baltosur një përpjekje nga më seriozet, në vlerësimin tim, për të ndriçuar rrugën e dijes në këtë vend dhe për t'u ndarë një herë e mirë nga diplomat që nuk hapim mendje, që nuk aftësojnë, që nuk punësojnë ose punësojnë duke ushqyer paaftësinë dhe mediokritetin. Ajo që duam të bëjmë ne është krejt ndryshe nga ajo që është bërë deri dje. Duam të ndahemi një herë e mirë përmes këtij projektligji nga modeli i groshës dhe i tallashit, kur bursat e studimit bliheshin në natyrë me groshë, me tallash, me sedilje furgonash etj., sikurse e përmendi edhe parafolësi.

Akuzuat ministrinë se po ngutet të kalojë një ligj, që nuk është diskutuar mjaftueshëm dhe për këtë arsye po sjell jo reformë, por një shthurje të sistemit të arsimit të lartë. Këto nuk qëndrojnë. Për çfarë e keni fjalën? Për Komisioni për Reformën në Arsimin e Lartë të përbërë nga profesorët më të nderuar në institucionet më prestigjioze të arsimit të lartë këtu dhe jashtë vendit, i cili është mbledhur plot 58 herë vetëm gjatë pak muajve të vitit 2014, për të marrë me qindra komente dhe materiale nga departamente të ndryshme të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri; që ka përgatitur opinione publike, me dhjetëra e dhjetëra diskutime publike televizive, me qindra shkrime; që prodhoi fillimisht të raport të parë të quajtur “Dokumenti i gjelbër”, si mundësi për të hapur një debat, që angazhoi më shumë se 2000 pedagogë dhe mbi 30 forume publike; që vlerësuan të gjitha këndvështrimet për të prodhuar një dokument të dytë, të ashtuquajturin “White paper”, ose dokumentin e bardhë, si dokumenti përfundimtar që do të udhëhiqte procesin e reformimit të

arsimit të lartë; që hartuan draftin e parë të ligjit, i cili u debatua në çdo departament të çdo universiteti publik dhe privat në vend. Pavarësisht se synimi nuk mund të jetë kurrsesi, dhe ju këtë e dini shumë mirë, një konsensus i përgjithshëm, por një vjelje e mendimeve më të mira për realizimin e një vizioni të ri. Sërish ky komision mori parasysh çdo argument duke e debatuar edhe më tej kokë më kokë me disa nga propozuesit, siç mund të ketë qenë dhe ndonjë pedagog i nderuar që e përmendët këtu, pasi kishit regjistruar rekomandimet që kishte bërë. Nuk besoj se është mëkät. Fundja fare ky ka qenë qëllimi i këtij procesi, marrja e rekomandimeve dhe e vlerësimeve të të gjithëve. Mjafton të përmendet se për draftin e parë vetëm Universiteti i Tiranës dërgoi mbi 200 faqe komente, ndërsa për draftin e dytë vetëm 6 faqe, për të kuptuar se sa këmbëngulës kanë qenë anëtarët e komisionit për të rivlerësuar çdo rekomandim.

Po hidhem te kritika tjetër. Cila pjesë e reformës është antikushetuese? Pjesa ku dyert e institucionit të arsimit të lartë nuk mund të shqyhen për të pajisur lloj-lloj përfituesish pavarësisht meritës me copa letre të ashtuquajtura diploma që penalizojnë ata që i meritojnë vërtet? Arsimi i lartë është një e mirë publike dhe sipas përkufizimit një e mirë publike duhet të plotësojë dy kushte: jo rivalitetin dhe përjashtueshmërinë. Arsimi ynë i lartë nuk i plotëson ekzaktësisht këto dy kushte për t'u konsideruar një e mirë publike.

Së pari, kur ne angazhojmë burime për të arsimuar një të ri, pakësojmë burimet për të tjerët. Pra, ka rivalitet.

Dhe së dyti, disa njerëz nuk përfitojnë nga arsimi i lartë. Pra, ka përjashtueshmëri. Po. Çdo të thotë që arsimi i lartë është një e mirë publike? Arsimi i lartë është udha e dijes dhe si e tillë dhe vetëm si e tillë mund të konsiderohet një e mirë publike. Kur arsimi i lartë prodhon diploma, kjo nuk është një e mirë publike, por një e mirë private. Kur bën para korrupsioni për ndonjë pedagog, kjo është një e keqe publike. Vetëm kur prodhon dije, mund të quhet një e mirë publike dhe ky projektligj që vjen sot nuk bën kompromis me këtë parim.

Thoni se ky projektligj drejtohet nga klientët të caktuar që kanë marrë peng qeverinë për të sjellë një ligj në favor të institucioneve të arsimit

të lartë privat dhe kundër atij publik. Të gënjeshtër kaq hapur dhe të gjithë njëzëri nuk mendoj se është e turpshme. Pa emocionalitet po u referohem thjesht shifrave. U gjetën 1432 programe studimi nga të cilat 762 në institucionet e arsimit të lartë publik dhe 690 në institucionet e arsimit të lartë privat, në 762 programe studimi në institucionet e arsimit të lartë publik, ku studionin 88% e studentëve dhe 690 programe studimi në institucionet e arsimit të lartë privat, ku studionin 12% e studentëve. Pas ndërhyrjes së parë nëse para mbylljes së piramidave në arsim kishim një raport gati 1 me 1 të programeve publik-privat, sot ky raport është 3 me 1 në favor të institucioneve të arsimit të lartë publik.

Si mund të thoni që ne nuk duam të mbështesim arsimin e lartë publik kur gjatë qeverisjes suaj nga 7 institucione të arsimit të lartë në 2005-n i bëtë 44 në 2013-n? Si mund ta thoni këtë kur nga 10 programe studimi në 2005-n u bënë 1432, ku 90% e tyre në institucionet e arsimit të lartë privat janë licencuar vetëm gjatë periudhës 2009-2013 me 40 akreditime kaluar dhe në një mbledhje të vetme? Sigurisht u mbyllën 40% e institucioneve të arsimit të lartë privat që ofronin 60% të programeve të studimit të privati për arsye tashmë të ditura. Seriozitetin e një pjese e njihni tashmë dhe përmes atyre shembujve që i përmendi dhe kolegu im këtu ku tallashi, grosha, pjesët e makinës Volkswagen, sediljet e furgonëve e të tjera gjëra të kësaj natyre, blinin në natyrë bursa dhe diploma nëpër universitetet e licencuara dhe akredituara të qeverisë së shkuar.

Dhe së fundi, një jo të madhe. Ky ligj nuk çon para publike drejt institucioneve private. Përkundrazi, shtyn drejt rritjes së financimit publik e privat drejt arsimit publik. Po, financon studentin sipas nevojës, sipas meritës, që të zgjedhë ai universitetin ku do të studiojë. Financimi me grantin e përgjithshëm, i cili përbën pjesën më të madhe të financimit publik, bursave të prioriteteve kombëtare dhe bursave për mbështetjen e kategorive në nevojë, do të mbeten ekskluzivisht mekanizma për mbështetjen e institucioneve të arsimit të lartë publik.

Institucionet e arsimit të lartë privat ashtu si dhe në ligjin ekzistues, do të kenë të drejtë të aplikojnë për projekte të kërkimit shkencor. Kjo

nuk ka ndryshuar pasi edhe tani me agjencinë e kërkimit të teknologjisë së inovacionit mund të aplikojnë të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Po reforma nxit rritjen e ofruesve të shërbimit publik të arsimit të lartë dhe në respekt të parimit se arsimi është një e mirë publike, përmes këtij ligji është krijuar mundësia që institucionet jofitimprurëse të arsimit të lartë të shndërrohen në ofrues publik të arsimit të lartë. Pra, të bashkërendohen institucionet publike të themeluar dhe financuar nga shteti me institucione publik të iniciuar dhe financuar nga aktorë privatë, duke krijuar kështu mundësinë nëpërmjet institucionit të arsimit të lartë publik të pavarur të ofrojnë më shumë shërbim publik.

Thënë sa më lart, unë dëshiroj të përgëzoj ministrinë për këtë reformë të rëndësishme dhe për sjelljen sot në votim të një projektligji produkt i një procesi të gjatë e gjithëpërfshirës dhe ju ftoj të gjithëve ta votojmë dhe të mos bëjmë politikë me të ardhmen e të rinjve shqiptarë.

Faleminderit!

Edmond Spaho – Zonja Xhaçka, ju kërkoj ndjesë që thashë diskutantja e fundit, pasi janë dhe një grup deputetësh që e kanë emrin në listë, por unë mendova që janë tërhequr. Po e lexoj dhe një herë listën dhe nëse dikush tërhiqet, të njoftojë.

Lista me deputetë për të folur janë: Irma Kopliku, Esmeralda Shkëj, Asllan Dogjani, Fatmir Toçi, Liljana Elmazi, Mira Shehu, Arbjo Halimi, Klodiana Spahiu, Albina Deda dhe Mimoza Hafizi.

Kryetarët e grupeve parlamentare të njoftojnë nëse deputetë të grupeve të tyre tërhiqen nga diskutimet.

Fjalën e ka zonja Kopliku.

Irma Kopliku - I nderuar drejtues i seancës Të nderuar deputetë,

Prej gati një viti e gjysmë, projektligji "Për arsimin e lartë" diskutohet si një prej reformave më të rëndësishme që do të prekë universitetet shqiptare.

Gjatë kësaj periudhe ai paraqet projektligjin më të debatuar, pasi synon të ndërtojë një sistem që do të krijojë një raport të ri mes universiteteve publike dhe jopublike, si dhe brenda vetë stafëve akademike universitare.

I paraqitur si modeli anglo-sakson, projektligji u kritikua që në fillim për një sërë

mangësish, duke filluar nga paqartësitë e trajtimit të universiteteve jopublike, disbalancat e kompetencave, krijimi i agjencive dhe bordeve të reja që i mbivendosen njëri-tjetrit. Dhe lista e vërejtjeve është shumë e gjatë. Duke pasur parasysh se një projektligj i tillë na prek të gjithëve, dhe përbën një prej reformave më të rëndësishme në jetën e vendit, diskutimi i gjerë i tij pritej që ta përmirësonte dukshëm dhe ta bënte të pranueshëm, pasi një sistem arsimor cilësor dhe me standarde të qarta është themeli i çdo shoqërie të shëndoshë.

Por çfarë na paraqitet sot në Kuvend? Një projektligj që në thelb është po ai i draftit fillestar, me shumë aspekte të vagullta dhe me frymën e theksuar etatiste, ku shteti, ose më saktë politika kërkon të kontrollojë jetën e universiteteve. Vërejtjet kryesore të bëra nga stafet akademike dhe specialistët nuk janë marrë parasysh dhe, më shumë sesa rregullime të mirëfillta, projektligji i sjell vetëm ka më shumë ndryshime numrash të neneve të tij.

Qëllimi i ligjit është që “tregun përkatës të arsimit të lartë” ta bazojë në parimin e konkurrencës së lirë mes institucioneve të arsimit të lartë, personelit akademik dhe studentëve. Dispozitat e ligjit bëjnë krejt të kundërtën. Ato jo vetëm që cenojnë garën e lirë, të ndershme mes institucioneve të arsimit të lartë, por krijojnë dhe një pozitë jo të favorshme për universitetet publike. Kjo pozitë rëndohet nga ndërhyrjet e ekzekutivit në vetëqeverisjen e institucioneve të arsimit të lartë, siç është anëtarësia e Bordit të Administrimit, miratimi i statutit të arsimit të lartë nga Bordi i Administrimit, përcaktimin e kuotave për pranimin e studentëve në ciklet e studimit dhe veçanërisht në përcaktimin e tarifave të shkollimit.

Duke dashur të mos paragjykoj nevojën për një reformë në arsimin e lartë, duket se shtyja kryesore e hartimit të ligjit ka qenë reformimi i universiteteve publike, ndërkohë që problematikat në tregun e punës janë shfaqur kryesisht nga ato jopublike. Që në fillim bie në sy që institucionit të arsimit të lartë i është vendosur edhe një mision tjetër: të mbrojë dijet. Tani shteti zotohet të vlerësojë cilësinë e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore në nenet 1 dhe 2. Më pas, që në fillim te neni 2, mbi qëllimin, në pikat “a” dhe “b”, si dhe neni 3, bien në kundërshtim me parimet e autonomisë së

shprehura në nenin ku shteti duhet të krijojë një sistem të unifikuar dhe të standardizuar të mësimdhënies. Të thuhet në një ligj të arsimit të lartë se qëllimi i këtij ligji është të krijojë një sistem të unifikuar dhe të standardizuar të mësimdhënies, kërkimit shkencor, inovacionit, bashkëkohor dhe konkurrues në hapësirën europiane të arsimit të lartë, është e kundërta e pritjeve europiane në arsimin e lartë. Sistemi arsimor duhet të jetë i diversifikuar dhe jo i standardizuar, pasi kjo sjell shumë dëme në botën universitare. Një sistemi i unifikuar dhe i standardizuar do të mbyisë rrititë dhe performancën dhe nuk do ta përgatisë arsimin e lartë shqiptar për të ardhmen.

Ideja e sistemit të unifikuar, shprehur dhe në planin e reformës, është konkretizuar më tej me një matematikë të çuditshme, që i detyron institucionet të njësojnë programet me 80% për profesionet e rregulluara apo me 70% për të tjera programe me emërim të njëjtë, neni 84. Ligji nuk thotë gjëkund se në bazë të cilit kriter e program unifikues do të realizohet kjo.

Gjithashtu, ky unifikim cenon autonominë akademike dhe synimin e institucioneve për t'u dalluar në tregun e arsimit të lartë nëpërmjet misionit të tyre. Kjo bie në kundërshtim dhe me parimin e nenit 1, pika b: “Mbi parimin e konkurrencës së lirë mes institucioneve të arsimit të lartë, personelit akademik dhe studentëve.” Mbi cilat baza zhvillohet konkurrenca, në mos në cilësinë e produktit që janë studentët dhe programet e studimit? Kjo është shumë larg frymës anglo-saksone që pretendoni se keni ngritur projektligjin.

Roli i shtetit në qeverisjen e arsimit të lartë mbizotëron dukshëm, megjithëse ky rol nuk është i përligjur nga premtimi për financim. Ligji ka reduktuar aspekte të përfaqësimit të studentëve në qeverisjen e institucioneve të arsimit të lartë, ka kufizuar autoritetin e rektorit vetëm në drejtimin akademik dhe ka rritur autoritetin e administratorit. Po kështu nuk trajtohen auditi, llogaridhënia. Mungojnë parametrat dhe objektivat për transparencën e buxhetit.

Por të gjitha këto paraqiten dytësore para deformimit që ky projektligj i bën autonomisë së universiteteve, të drejtës themelore kushtetuese të tyre. Kjo del krejt qartë sidomos në nenet 7 dhe 119. Në këtë ligj është dobësuar autoriteti i

rektorit, i cili tanimë vetëm firmos vendimet e senatit dhe të njëjsteve më të ulëta. Problemi është se ka paqartësi në lidhje me kompetencat e emërimit dhe të shkarkimit, apo anëtarësimin e organeve drejtuese. Ministri urdhëron shkarkimin e rektorit, neni 7/j, ndërkohë që emërohet nga presidenti, neni 38/8. Ministri mund të shkarkojë një autoritet drejtues, por këtë e emëron rektori, neni 38/11. Rektori nënshkruan kontratat e punës për personelin akademik, neni 38/5, edhe pse nuk i emëron apo zgjedh ai.

Kjo është një përpjekje për të cenuar autonominë organizative të institucioneve të arsimit të lartë publik, duke ndërhur në hartimin e akteve të cilat rregullojnë aspekte të organizimit të brendshëm të institucioneve të arsimit të lartë. Statuti i këtyre institucioneve, si akti rregullues i çështjeve të brendshme, nuk duhet të ndikohet nga stafi administrativ i institucioneve të arsimit të lartë. Administratori i institucionit nuk duhet të përfshihet në procedurën e hartimit duke imponuar vullnetin ekzekutiv. Ndërhurja ekzekutive theksohet kur ligji kërkon që statuti t'i nënshtrohet miratimit të Bordit të Administrimit. Statuti duhet të jetë kompetencë ekskluzive e senatit akademik. Prandaj, një senat akademik, në përbërje të të cilit janë pedagogë me tituj të lartë shkencorë "Profesorë", "Profesor i asociuar" apo edhe "Doktor", përfaqësues e specialistë të fushave të ndryshme, mes tyre edhe juristë e ekonomistë, nuk mund të barazvlerësohet në vendimmarrje me bordin e administrimit, anëtarët e të cilit nuk thuhet se çfarë titulli, grade apo formimi kanë. Mendojmë se në këtë rast kemi dualitet kompetencash. Neni 47: përbërja dhe krijimi i bordit të administrimit, nuk vihen kritere lidhur me anëtarët që e përbëjnë atë, ashtu siç kishim për senatin, pedagogë me tituj dhe grada shkencore.

Duke pasur parasysh se Bordi i Administrimit është një organ vendimmarrës, propozojmë që ligji duhet të parashikojë zgjedhjen e kryesuesit të Bordit të Administrimit.

Në nenin 50, pika 4, për administratorët nuk thuhet nëse kanë mandat dhe sa zgjat mandati i tyre. Ndërkohë që të gjithë drejtuesit e strukturave janë të zgjedhur dhe kanë mandat me kohë të kufizuar, për administratorin nuk parashikohet një gjë e tillë.

Gjithashtu, sipas këtyre parashikimeve, më specifiku në nenin 32/2, ministri ka të drejtë të kontrollojë ligjshmërinë e statuteve dhe rregulloreve të universitetit. Po sipas këtyre parashikimeve, ai ka të drejtë ta rikthejë për ndryshim, nëse mendon se dispozita të caktuara bien në kundërshtim me ligjin, pra, dispozita në këtë rast nuk është e qartë në lidhje me parashikueshme e pasojave. Nga mënyra si është formuluar dispozita, rezultati duket sikur në këtë rast senati akademik është i detyruar që t'i bindet në çdo rast mendimit të ministrit. Kjo mënyrë veprimi bie në kundërshtim me parimet dhe jurisprudencën kushtetuese të sipërcituar, pasi në këtë rast ministri, e theksoj, nuk është organ epror i universiteteve.

Jeta dhe veprimtaritë akademike, janë të lidhura ngushtë me mënyrën e administrimit dhe financimit të këtyre veprimtarive, ndaj pasja e një bordi ku shumica e anëtarëve janë përfaqësues të ministrisë do të sjellë më pas që drejtimi i veprimtarive jo vetëm në anën administrative, por edhe akademike të ishin nën kontrollin e ministrit.

Meqenëse disa gjëra u thanë më përpara, unë desha të them edhe dy gjëra të vogla. Si mund të realizohet garantimi i misionit të autonomisë të institucionit të arsimit të lartë nga bordi i administrimit, i cili ka përbërje domethënëse të përfaqësuesve të ekzekutivit?

Në nenin 58/8 theksohet: "Ngarkesa minimale për personelin akademik përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin". Do të ndalem pak sepse forumi aktual i projektligjit nuk merr në konsideratë edhe mendimin e shoqatës të juristëve europian në raportin e cituar. Citoj: "Kjo siguri, presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve të shteti".

Besueshmëria ka të bëjë me faktin, që qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative, që cenojnë të përkeqësojnë në gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Prandaj, edhe sipas doktrinës së të drejtës kushtetuese shqiptare siguria juridike është një nga elementet thelbësore të së drejtës. Në këtë këndvështrim unë do ta mbyllja këtë fjalë time me disa pyetje që për mua janë thelbi që duhet të zgjidhë ky projektligj, por për të cilën nuk marr përgjigje.

A besoni se më këtë projektligj ju arrini të zgjidhni problemin e arsimit të lartë? A mendoni se një kontroll kaq i rreptë qeveritar do të arrijë të krijojë kushte për një cilësi më të mirë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor? A mendoni se strukturat paralele në drejtimin e universiteteve, rektor dhe administrator, si dhe ngritja e një sërë njësisish të reja do ta bëjnë më rezultative punën e një universiteti, pa paragjykuar vullnetin tuaj të mirë? A mund të jetë jeta akademike e universiteteve kaq e varur nga ministria, e cila gjithnjë edhe pas jush do të drejtohet nga persona politikë, çka do të thotë që universitet publikë apo jo publikë do të jenë gjithnjë nën presionin dhe humorin e politikës? Përveç kësaj, a keni bërë ndonjëherë pyetjen, se përse sistemi anglosakson nuk është më i përhapur dhe më i përzgjedhuri në vendet e Bashkimit Europian? Megjithëse duhet kohë për sa i takon konceptit të ekonomisë, ky projektligj është shumë larg modelit.

Duke mos dashur që të bëj asnjë hamendësim për prapavijën e këtij projektligji, por vetëm duke besuar se ky projektligj ka filluar si një përpjekje për të bërë një hap përpara drejt cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë më duhet të pranoj, se ky projektligj paraqet një mosnjohje të realitetit shqiptar dhe bën një trajtim sipërfaqësor të paqarta të problemeve të mirëfillta që ka arsimit i lartë në vend. Aty ku ligji nuk parashikon dhe nuk di rezultatet që do të japë dy janë pasojat: kaosi dhe abuzimi.

Faleminderit! Dhe sjell zërin e Shkodrës, që të mos miratohet ky projektligj!

Ilir Meta – Fjalën e ka deputeti Asllan Dogjani! Të përgatitet deputeti Fatmir Toçi dhe më pas deputetja Liliana Elmazi!

Asllan Dogjani – Zoti Kryetar! Të nderuar kolegë deputetë!

Kryeministri foli gjatë sonte, por vetëm një fjalë tha për projektligjin. Ajo që tha dhe ajo që mësuam ishte, që të varfrit nuk do të mundën të vijnë në universitet në qoftë se nuk plotësojnë kriteret, në qoftë se nuk kapin mesataren, por, nuk na tregoi se si duhet ta plotësojnë ose ta kapin mesataren kur në shumicat e shkollave në zonat rurale mungojnë mësuesit e matematikës, fizikës, kimisë. Pra, në këtë projektligj, Kryeministri, duhet t'i jepte zgjidhje këtij problemi dhe jo të dëgjonim sonte, që mohoi të drejtën më shumë së gjysmës së popullsisë që

nuk mundën të vijnë në universitet edhe për shkak të varfërisë.

“Nuk do të këtë fonde nga buxheti i shtetit për arsimin privat. Janë vetëm spekulime të opozitës” - ka deklaruar Kryeministri këto ditë. Të njëjtën gjë ka deklaruar, por me pak ndryshime në prill të vitit 2013 në një takim me rininë. Po citoj: “Vizioni i qeverisë- thoshte në atë kohë, janë fondet publike për arsimin privat, ndërkohë vizioni ynë është: fonde private për institucionet e arsimit të lartë”.

Çfarë ndodh në të vërtetë? Pse ka ndryshuar në këto dy vjet vizioni Kryeministrit? Kush e ka detyruar atë? Pse ndryshe e ka pas ndjerë dhe ndryshe vepron sot? Pse akoma sillet sikur është në opozitë? Dje fajin e kishte Saliu dhe qeveria e tij sepse kishte vizion për të financuar me fondet publike arsimin privat. Po sot kush e ka fajin? Përsëri akuzon opozitën se po spekulon? Kujt t'i besojmë, Kryeministrit apo ekspertëve, profesorëve dhe studentëve, që e kundërshtojnë prej shumë kohësh këtë projektligj? T'i besojmë Kryeministrit apo projektligjit?

Dokumentit ku është shkruar e zeza në të bardhë, shprehimisht parashikohet: “Transformimi i universiteteve publike dhe shkollave të larta private nga universitet publikë të pavarura kanë akses të barabartë edhe në fondet publike”. Siç shihet Kryeministri tashmë nuk e ka vetëm vizion, siç akuzonte qeverinë e djeshme, por po e bën realitet me fondet publike sipas këtij projektligji do të financojë edhe shkollat e larta private.

Në Korçë në vitin 2012 Kryeministri, i cili në atë kohë ishte në opozitë u shpreh: “Gjithkund mund të shpërdoret buxheti, por tek arsimit nuk duhet dhe nuk do të bëjmë kompromis. Kemi marrë përsipër dhe do ta bëjmë 5% buxhetin për arsimin”. Sa është mbajtur ky premtim? Sa është sot buxheti për arsimin? Vetëm 2,7%, ndërsa për arsimin e lartë zë vetëm 0,4% të GDP-së. Mashtrim i madh!

Në projektligj parashikohet rritja e tarifave të studimit. Me këtë rritje, a do të kenë mundësi familjet me ndihmë ekonomike, që marrin 1500 lekë në muaj në Kukës, Bathore, Valias, Kamzë, Paskuqan, kudo në të gjithë Shqipërinë, që nesër me këtë projektligj të paguajnë 3000 apo 3500 dollarë për shkollimin e djalit apo të vajzës së tyre? Sigurisht që jo, por edhe familjet e mesme

me një apo me dy të punësuar nuk do ta kenë këtë mundësi pa imagjinuar, që te privati shpenzimet së bashku me tarifën e shkollimit mund të shkojnë deri në 6000 mijë dollarë në vit. Në këto kushte qindra e mijëra të rinj shqiptarë nuk do të kenë mundësi të ndjekin arsimin e lartë. Do t'u privohet e drejta për t'u shkolluar, pavarësisht se mund të jenë shumë të mirë në shkollë. E than troç, kush ka para, do të ketë mundësi të shkojë në shkollë.

Ecja e maturës shtetërore dhe vendosja e notës mesatare si kriter bazë i pranimit në arsimin e lartë do të shtojë korrupsionin dhe kështu do të përfitojnë ata që kanë para dhe që janë të lidhur me partinë në pushtet. Rrjedhimisht do të kemi diploma të pavlerë, njëlloj si në kohën e diktaturës. Në atë kohë shkonin në shkollë bijat dhe bijtë e pushtetarëve, ndërsa sot shkojnë në shkollë ata që kanë para dhe që janë të lidhur me partinë në pushtet. Ndërsa të tjerët, sipas vizionit të kësaj qeverie le të mbeten injorantë, të varfër, skllëvër dhe të marrin rrugën e kurbetit për një copë bukë.

Ky është vizioni, që deklaroi sot, por keni deklaruar edhe dje gjatë fushatës elektorale. Edhe këtu dua të kujtoj një pjesë nga deklarata juaj në Korçë, zoti Kryeministër, me arsimtarët apo kur u takuat me disa fëmijë në rrugë që ktheheshin nga Shishtaveci pranë fshatit Topojan, ku u angazhuat dhe përsëri po citoj fjalët e tua: "Asnjë fëmijë të mos mbetet pa shkollë për shkak të varfërisë. Të sigurohet transporti falas për nxënësit, që e kanë shkollën më shumë se 20 minuta larg. Mësues matematike, fizike, kimie, anglishteje, libra falas" dhe shumë premtime të tjera. Nuk po flas se sa janë realizuar këto premtime se të gjithë e dinë se dolën mashtrime, por dua t'u kujtoj se edhe nëpërmjet këtij projektligji do të rritet edhe më shumë numri i fëmijëve, që do të mbeten pa shkollë për shkak të varfërisë dhe humbjes së shpresës.

Nxënësit që takuan në rrugë vazhdojnë të ecin përsëri në këmbë për të shkuar në shkollë dhe shumë prej tyre mund ta kenë lënë shkollën, apo edhe për vajzat nxënëse, që ju interesoheshit aq shumë, ju sigurohej që për shkak të mungesës së transportit, mungesës së mësuesve, kushteve, ato mund ta kenë lënë shkollën.

Ato pak universitete, që kanë mbetur në rrethe me këtë projektligj i ktheni në kolegje,

duke mos marrë parasysh se sa universitete mbyllët dhe sa pasoja keni sjellë në këto rrethe tek ato familje, që nuk kanë mundësi t'i sjellin fëmijët në Tiranë edhe me këto tarifa që janë sot, imagjinoni me rritjen e tarifave.

Për të përballuar rritjen e tyre, qeveria parashikon që studentët të marrin kredi studentore. Çfarë kredie? Doni t'i merrni peng, duke i futur në borxhe edhe të rinjtë shqiptarë. Pse nuk parashikoni në projektligj kushte lehtësuese siç e ka e gjithë bota demokratike, që kredia të fillojë të paguhet pasi studenti të mbaroj shkollën dhe të futet në punë dhe me të ardhurat që merr nga puna të paguajë kredinë?

Keni parashikuar krijimin e bordeve. Këto lloj bordesh dhe agjencish do të veprojnë kundër vullnetit të pedagogëve dhe studentëve. Projektligji rrit dukshëm kontrollin e shtetit mbi universitetet publike. Godet rëndë dhe asgjëson autonominë universitare dhe lirinë akademike.

Emërimet politike në administratë, kryhet nëpërmjet agjencive, dobësimi i rolit të organeve kolegjiale do të rrisë klientelizmin dhe korrupsionin brenda sistemit arsimor dhe këto organe do të bëhen kamxhik në duart e qeverisë. Po përsëris një fjalë tuajën "kamxhik" sepse e keni përdorur shpesh. Të gjitha këto vijnë në kundërshtim me nenin 57/7 e Kushtetutës, ku autonomia dhe liritë akademike garantohen me ligj dhe sot nëpërmjet ligjit po i asgjësoni këto. Me këtë ligj pagat e pedagogëve janë të pasigurta. Dobësohet roli i studentit, pavarësisht se studenti do të paguajë më shumë.

Ne nuk jemi kundër arsimit privat, ne jemi për liberalizimin dhe konkurrencën e lirë por jemi kundër diskriminimit, kundër tutelës qeveritare, pabarazisë për shkak të varfërisë të mundësisë ekonomike, klientelizmit, pakësimit të buxhetit dhe gjithçka që bie ndesh me interesat e familjes shqiptare. Këto janë arsyt, që ne e kundërshtojmë me forcë këtë projektligj.

Duke përfunduar, ju bëj thirrje deputetëve të maxhorancës: Mos bini pre e klientelizmit dhe interesave të grupeve të caktuara, por mbronni interesat e atyre familjeve shqiptare që ju besuan, përndryshe në rast se do votoni do të penalizimi me këtë ligj shumicën e familjeve shqiptare duke i hequr të drejtën e arsimit, jam i bindur se prindërit familjet shqiptare nuk do t'u harrojnë.

Prindërit shqiptarë kanë bërë gjithçka, kanë sakrifikuar çdo gjë deri në kafshatën e gojës për

arsimin e fëmijëve të tyre. Këtu dëgjova edhe sot Kryeministrin që tha se e mbante ekonominë me ata studentë që ikin jashtë shtetit për tu shkolluar. Ju siguroj që ato familje që kanë çuar fëmijët jashtë e dinë mirë se me sa vështirësi i mbajnë pa llogaritur për disa familje të kamura, që mund të jenë lidhur ndoshta me shtetin dhe pushtetin.

Ju bëj thirrje: Mos i prekni aty ku u dhemb më shumë shqiptarëve, se nesër do të jetë vonë dhe nuk do të mundni ta ndaloni fuqinë e tyre. U bëj thirrje ta votojnë kundër këtë projektligj.

Faleminderit!

Ilir Meta – Fjalën e ka deputeti Fatmir Toçi. Të përgatitet deputetja Liliana Elmazi. (*Deputeti Toçi nuk ndodhet në sallë.*)

Fjalën e ka deputetja Liliana Elmazi. Të përgatitet deputetja Mira Shehu.

Liliana Elmazi – Kolegë deputetë,

Të nderuar studentë të universiteteve publike, studentë të universitetit tim, ku kam shërbyer për 24 vjet, Universitetit të Tiranës, kolegë dhe pedagogë të universiteteve publike, por edhe atyre private,

Do të më duhet ta nis, po e quaj replikë, me Kryeministrin, i cili kritikoi qeverinë “Berisha”, që kishte hapur degë apo edhe universitete që bënin studime *part time*. Sikur të mos ishin hapur ato, ndoshta një pjesë e qeverisë nuk do të ishin ulur sot aty, ose ndoshta edhe një pjesë e deputetëve do të kishin ngelur pa diploma. Nuk e di të blera apo jo, por nuk ka rëndësi.

Janë 1 milion vota më 23 qershor, që ju fare thjesht i përktheni në 1 milion shuplaka për maxhorancën e djeshme apo opozitën e sotme, një konfirmim, sipas jush, për të qeverisur shumicën e bashkive më 21 qershor, edhe pse për herë të parë në historinë e zgjedhjeve shqiptare jo vetëm pluraliste, ndërkombëtarët, miq të Shqipërisë, artikuluan qartë e prerë se pati blerje të votës, pati kërcënime nga qeveria, shto këtu edhe kandidatët e kriminalizuar. Ju u entuziazmuat për të alla reformuar çdo gjë, më mirë të themi, për të filluar çdo gjë nga zero në këtë vend, sepse të majtë e të djathtë që kanë qeverisur para jush, ishin thjesht fare djaj, që e shkatërruan dhe e dogjën këtë vend, por fat i madh për shqiptarët, trokiti më 23 qershor, ku në pushtet erdhët ju, të cilët do të bënit shtet, jo shaka. Do të reformonit çdo aspekt të jetës ekonomike, sociale, ligjore, do të ndërmerit

reforma të thella, që do t’u mundësonin shqiptarëve parajsën në vend të ferrit Berishian, pse jo edhe të Nanos, të Majkos, të Metës Kryeministër, apo edhe Finos.

E nisët me atë të ashtuquajtur reforma ekonomike fiskale, që do të lehtësonin barrën fiskale të shqiptarëve të varfër duke premtuar që do t’u merrnit më shumë para të pasurve dhe rezultati: taksat janë rritur, përditë rëndohet xhepi dhe ekonomia e shqiptarëve, ata po bëhen më të varfër, të varfrit të mjeruar, e po u hiqet dhe po u ulet edhe ndihma ekonomike, por të pasurit pasurohen përditë e më shumë, veçanërisht klientela.

Ju e zhytët ekonominë në kllapi, që, për fat të keq, ende nuk po jep shpirt, jo se ju për ta shpëtuar po injektoni fonde për ta ringjallur, por po tërhiqni fonde parash në formë borxhi për të mbajtur në këmbë një ekonomi në kllapi. Ndërkombëtarët u bien kambanave edhe ditët e fundit: “Kujdes, ekonomia po prek fundin”. Rezultati ekstremisht më i keq juaji, i çorbës rilindëse, janë azilantët nga Shqipëria që po shënojnë rekord. Jemi në vend të parë, ia kaluam edhe Sirisë në luftë. Përditë ka shqiptarë që ikin nga sytë këmbët, sa më larg kësaj parajse rilindëse.

Le t’i kthehemi projektligjit në fjalë. Duke përshëndetur dhe vlerësuar personalisht ministren e Arsimit për dëshirën dhe vullnetin e saj të mirë për një arsim universitar cilësor, larg sjelljeve joetike korruptive, jo të rralla, të disa pedagogëve që detyrohen të shesin notën, apo të ndonjë drejtuesi universiteti apo fakulteti rajonal që shet vendin e punës, nuk është as i PS-së, as i PD-së, apo të privatëve, bashkëqeverisësve tuaj, që e konsiderojnë universitetin si një kioskë që shet domate, pra si çdo biznes fitimprurës apo edhe problematikave të tjera që hasin universitetet shqiptare sot, kam mendimin se një reformë e tillë në arsimin e lartë, i kalon caqet e dëshirës dhe vullnetit të mirë të zonjës ministre. Madje, reforma në fjalë nuk ka sesi të shmangë edhe interesat klienteliste të segmenteve të caktuara.

Natyrisht, ky projektligj nuk ka ardhur si nevojë e arsimit të lartë, edhe pse ka problematika të mëdha, madje goxha serioze, por gojë të liga thonë, jo unë, që pronarë universitetesh private jo vetëm që janë porositës, por madje edhe shkruar të tyre.

Çfarë bëtë ju në 2 vjet? U bëtë ekspert në hedhje lakësh në fytin e shqiptarëve, e bëtë fytin e shqiptarëve të shkretë sikur të ishte shtyllë betoni, përditë, gjithmonë, duke hedhur nga një lak të ri. Lak kur rritët taksat, lak kur shtuat taksa të reja, lak kur hoqët ndihmën ekonomike për mbi 20 mijë familje apo e ulët në vlerën e 15 dollarëve, lak kur rritët çmimin e energjisë dhe qytetarët duhet të paguajnë padrejtësisht faturat abuzive të majme, përndryshe i pret qelia dhe prangat.

Kësaj radhe laku u vihet studentëve me pamundësi ekonomike dhe familjeve të tyre, sepse projektligji në fjalë lë pa shkollë mijëra të rinj që nuk kanë mundësi financiare për të përballuar tarifat e rritura të studimit apo edhe koston e studimeve. Ky projektligj i kthen universitetet në varësi direkte të Kryeministrit, sepse, ashtu si edhe në raste të tjera, kur kemi sjellë për t'u miratuar ligje në parlament, keni vendosur në varësi të Kryeministrit institucione të tjera të vendit. Pra, në një fjalë, ky projektligj i kthen universitetet nën thundrën e politikës dhe të parave.

Pjesa më e debatueshme e këtij projektligji është ajo e financimit në arsimin e lartë. Ju pretendoni që përmes tij të implementoni një model të ri të financimit të arsimit të lartë, i cili mbështetet në dy elemente kryesore: në performancën e universiteteve dhe në kredinë studentore. Parimisht jam dakord, nuk ka asgjë të keqe, ky model është prirje e kohës, por ne kemi një buxhet shumë të ulët prej 0,4% të GDP-së të arsimit të lartë, ndërkohë që modele të tilla kërkojnë të paktën buxhete prej 1,2 të GDP-së. Kuptohet që edhe vitet e tjera, ndoshta për 15 vjet, ekonomia shqiptare nuk do të ketë burime private për të rritur investimin në arsimin e lartë. Pra, rritja e buxhetit në këtë rast nuk do të ndodhë. Atëherë, nga do të mbulohet ky model? Kuptohet, rruga e vetme do të jetë rritja e kontributit nga familjet e studentëve duke rritur tarifat e shkollimit. Për të përballuar rritjen e tarifave, qeveria parashikon që studentët të marrin kredi nga skema e kredisë studentore, e cila nuk do të miratohet nga legjislativi, pasi nuk ka një të tillë në ligj, por me një vendim të Këshillit të Ministrave, duke bërë që studentët të varen gjithmonë nga qeveritë që do të shkojnë e do të vijnë.

Skema e kredive studentore aplikohet në shumë vende dhe në parim përsëri nuk jam kundër, por nuk gjej në këtë projektligj asnjë kusht apo kriter lehtësues të kredisë studentore, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të studiojnë pavarësisht gjendjes së tyre ekonomike dhe ta kthejnë me lehtësi atë kredi pas përfundimit të studimeve. Me pak fjalë, ju po u thoni shqiptarëve: “Paguani nëse doni t'i shkolloni fëmijët tuaj në universitetet publike, ndryshe rrini pa shkollë!”

Projektligji parashikon transformimin e universiteteve publike dhe shkollave të larta private në universitete publike të pavarura, që kanë akses të barabartë edhe në fondet publike, gjë që profesori Jan De Groof e quajti një marrëzi të pahasur dhe parë më parë. Në këtë model, edhe shkollat e larta private të transformuara në këtë tip universiteti, përfitojnë nga këto fonde të shumta, siç thoni ju, përfitojnë nga fondet gjoja të doktoraturave, përfitojnë nga fondet gjoja të ekselencës, apo nga fondet gjoja të kërkimit shkencor.

Ju pretendoni se keni marrë modelin britanik, por universitetet amerikane dhe britanike thithin financime edhe nga industria dhe nga degë të tjera të ekonomisë, nga fondacione apo agjenci të fuqishme të shkencës, donacione private e të tjera, gjë që në Shqipëri unë nuk e shikoj të aplikueshme. Nuk e di nëse mendoni se ne jemi shteti i 51-të i USA-së ose jemi pjesë e Komonuelthit britanik dhe ajo që është më e rëndësishme, që qeveria e justifikon me autonominë më të madhe, është ajo që parashikon Kushtetuta. Ndryshoni Kushtetutën, të paktën!

Projektligji dëmton apo u heq të drejtën, më mirë të themi, mijëra studentëve për t'u shkolluar në arsimin e lartë publik, që vijnë nga familje të varfra apo që vijnë nga zona rurale, për shkak të rritjes së tarifës së shkollimit. Projektligji është i bazuar në atë që quhet qasje e etatiste, pra shteti në qendër dhe jo universiteti. Edhe me dëshirën e mirë që ministrja, por edhe të gjithë ju, edhe ne pse jo, për të mos pasur më ato sjellje joetike korruptive të universiteteve, unë nuk pash që të kishit ndonjë kapitull apo ndonjë pjesë që kishte të bënte me auditin dhe me llogaridhënien në projektligjin e arsimit të lartë.

Gjithashtu, edhe pse premtuat se do të hapnit 300 mijë vende pune, ky projektligj nuk u

garanton pedagogëve të universiteteve shtetërore, por sidomos atyre të rretheve, vendin e punës dhe pagën. Nuk e di, në qoftë se ju mendoni që ata sigurim të parë të financimit për pagën e tyre do të kenë jo buxhetin si deri tani, por vetëfinancimin, çfarë do të ndodhë me ato universitete që nuk kanë numër studentësh për të përballuar numrin e pedagogëve, natyrisht, do t'i nxjerrin tepër ata.

Gjithsesi, i mirë apo i keq, sipas jush, ligji i arsimit të lartë që kemi pasur ne nxiste edhe kthimin e studentëve që shkolloheshin apo bënë doktoratura jashtë shtetit, por nuk shikoj që ligji juaj të jetë i tillë. Midis kërkesës suaj për të votuar një ligj të tillë dhe zërit të dhjetëra mijëra studentëve, të kolegëve të mi, unë zgjedh këtë të dytën, për të mos e votuar projektligjin tuaj.

Faleminderit!

Ilir Meta – Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Mira Shehu. Të përgatitet deputetja Arbiola Halimi. Më pas e ka fjalën deputetja Mimoza Hafizi. Më pas do të flitet në emër te grupeve.

Mira Shehu – I nderuar Kryetar i Kuvendit!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputete,

Të nderuar pedagogë dhe studentë,

Pas një pune shumë të madhe, të gërshtuar me debate, analiza dhe konsultime shumë produktive me aktorë dhe faktorë të arsimit të lartë publikë dhe privatë në Shqipëri, një pune të palodhur dhe të duruar të strukturave drejtuese të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe të Komisionit të Edukimit, paraqesim sot një ligj të ri të arsimit të lartë, më të mirin e realizuar në këta vjet, me gjithëpërfshirje; me hapësira të reja për studentë dhe pedagogë; me hapësira për një konkurrueshmëri të drejtë, për mundësi moderne të krahasueshme me vendet Europiane; me hapësira të vërteta për një autonomi jo vetëm në letër, por funksionale për përgatitjen e brezave, orientimin e tyre me degët prioritare, për zhvillimin ekonomik social kulturor të vendit tonë. Një ligj që vjen jo si rezultat i arnimeve apo korigjimeve të neneve të veçanta për interes të njërit institucion apo tjetrit, të njërit ministër apo rektor, por një ligj i transformuar rrënjësisht në respekt të plotë për çdo familje shqiptare, për gjithë shoqërinë shqiptare, si një vlerë e mirë, për popullin dhe të ardhmen e brezave, që meritojnë të edukohen në institucionet që kanë parimin të

prodhojnë dije, shkencë dhe njohuri bashkëkohore.

Qeveria e mëparshme nuk pati kurajën, por edhe dëshirën, të ngrejë një sistem të mirëfilltë të arsimit të lartë, duke e katandisur në këtë krahurë. Devijojnë ta mbrojnë edhe sot me fanatizëm, jo për familjet shqiptare, jo për studentët por për aferat korruptive, për interesat personale të lidhura me këtë biznes, duke e shndërruar sistemin e arsimit të lartë, dijen, në një institucion tregu, një treg me shumicë dhe me pakicë. E them këtë, pasi blihet nota, diploma, licenca, akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë.

Reforma në arsimin e lartë dhe hartimi i këtij projektligji nuk u realizua për një ditë, as për një muaj dhe as gjatë fushatave elektorale apo për interes të fushatës elektorale, por u drejtua nga një komision i posaçëm personalitetesh dhe specialistësh të fushave të ndryshme shkencore dhe kaloi përmes një procesi të veçantë në auditore universitare, duke mosshmangur asnjë opinion, duke pyetur dhe konsultuar si asnjëherë studentët, pedagogët dhe grupet e interesit.

Nuk e kuptoj sesi ju, deputetë opozitarë, gjeni gjithëçfarë argumentesh të paqena, duke përcjellë imazhe të pavërteta mbi atë të vërtetë që ky ligj i ri i arsimit të lartë ofron. Unë dua t'ju përmend sot sesi deri 2 vjet më parë ju keni lejuar universitete që licencimin e kanë deklaruar si akreditim; keni lejuar regjistrimin e studentëve dy-tre vjet përpara se këto universitete të licencoheshin; keni lejuar të diplomohet dyfishi i studentëve të regjistruar, si dhe keni lejuar të regjistroheshin studentë në universitete pa mbaruar shkollën e mesme. Çfarë prodhon kjo? Padyshim, mijëra të diplomuar që nuk dinë asgjë, qindra pedagogë që vegjetojnë, duke cenuar shumë rëndë cilësinë e profesoratit, të programeve të studimit dhe të studentëve.

E them me bindje, nisur nga përvoja ime 15-vjeçare në stafet akademike, se ky ligj siguron autonominë më të mirë të mundshme, lidhur kjo me lirinë akademike, me mënyrën e organizimit të mësimdhënies bazuar, gjithashtu, në autonominë financiare, duke pasur të drejtë në krijimin e të ardhurave të ligjshme dhe përdorimin e tyre mbi bazën e mundësive të ndarjes dhe të klasifikimit të performancës dhe

veprimtarive ushtruese pranë departamenteve, fakulteteve dhe universiteteve.

Ky ligj, gjithashtu, siguron autonominë bazuar në autonominë organizative qoftë për të zgjedhur organizmat drejtues, por edhe duke rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të kritereve, të procedurave të përzgjedhjes në mënyrë të pavarur, të numrit të personelit, në caktimin e kritereve të pranimit të studentëve, si dhe në lidhjen e marrëveshjeve me persona juridikë publikë e privatë, vendas e të huaj, për zhvillimin e veprimtarive të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të kualifikimit të tij.

Gjithashtu, në këtë projektligj përcaktohet qartë roli i shtetit si garant kryesor i autonomisë dhe i lirisë akademike të institucioneve të arsimit të lartë, duke monitoruar dhe plotësuar standardet për hapjen dhe akreditimin e këtyre institucioneve.

Dua të evidentoj disa prej strukturave të reja, një prej të cilave është Qendra e Shërbimeve Arsimore, sepse edhe nuk u përmend, si një strukturë e re me një rëndësi shumë të madhe për reformimin e rregullave të pranimit në arsimin e lartë, në krijimin dhe në administrimin e Regjistrimit Kombëtar të Studentëve, në ruajtjen e të dhënave akademike lidhur me programet, me diplomat, me certifikatat, si dhe pajis çdo student të regjistruar në një institucion të arsimit të lartë me një numër unik matrikullimi, regjistron të gjithë studentët që regjistrohen në ciklin e dytë apo të tretë të studimeve, duke i shoqëruar ky sistem elektronik të gjithë aplikantët e regjistruar deri sa ata dalin në tregun e punës.

Një risi tjetër e këtij projektligji është Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, shumë e përfolur në shumë debate të ndryshme, por mendoj dhe them me bindje se është një prej risive të këtij projektligji, e cila ndan fondet dhe grantet mbi bazën e meritës dhe të performancës, lidhur kjo me mësimdhënien në universitetet, në institucionet e arsimit të lartë dhe e kontrolluar shumë qartë nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Janë bursat e studimit që nuk jepen kuturu, ashtu si edhe vetë Kryeministri e përmendi, por jepen mbi bazën e ndarjes dhe të klasifikimit të studentëve të shkëlqyer apo të ekselencës, të

studentëve të cilët zgjedhin programet prioritare të studimit dhe të studentëve që kanë nevojë për ndihmë sociale.

Jepen grante dhe fonde për kërkimin shkencor, për inovacionin dhe idetë inovative, edhe skema e re e krediteve të studentëve, duke i ndihmuar ata që në fazën më të vështirë të kenë mundësi që të ndjekin studimin e tyre.

Gjithashtu, shifrat si risi në këtë projektligj janë organizimi i institucioneve të arsimit të lartë në institucione publike, jo publike dhe publike të pavarura. Këto të fundit synojnë të kenë një nivel më të lartë të lirisë administrative dhe asaj financiare, por që nuk përjashtojnë dy të parat në rast se ato do të plotësojnë kriteret dhe t'u bashkëngjitet këtyre institucioneve të arsimit të lartë publik, privat dhe të pavarur.

Një risi tjetër në projektligj është rikonceptimi dhe roli i njësisë bazë, i departamentit për t'i dhënë mundësinë të menaxhojë fondet bazë të kërkimit shkencor, fonde të tjera që gjeneron nga burime të ligjshme publike dhe jopublike, kombëtare apo ndërkombëtare kryesisht lidhur me procesin e hapjes së programeve të reja të studimit, të pranimit të studentëve, të procesit të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, të ndjekjes së karrierës, si dhe marrjes së gradës shkencore "Doktor i Shkencave".

Gjithashtu, ndahet qartazi se kush do të rrisë cilësinë akademike duke angazhuar akademikët, se kush do të ndikojë në cilësinë e administrimit, duke vendosur administratorë profesionistë dhe funksione me detyra qartësisht të ndara për çdo institut të arsimit të lartë, midis senatit, bordit të administrimit, midis rektorit dhe administratorit.

Ky është pra, një ligj tërësisht i transformuar, i krijuar mbi një bazë të shëndoshë eksperience të vendeve të zhvilluara, duke ofruar mundësi të qarta, të barabarta, me konkurrencë të lirë ndërmjet vetë institucioneve. Ligji ofron një sistem të kontrollit dhe të monitorimit të cilësisë së brendshme dhe të jashtme, sistem transparent të akreditimit, të dhënies së dijes nëpërmjet meritës.

Ky ligj vë në punë duke filluar nga studenti e deri te rektori, nga shefi i departamentit dhe deri te senatori, i vë idetë krijuese dhe inovative në garë për të fituar dhe për t'u përkthyer në kërkim shkencor, në arritje akademike dhe

sukses në konkurrim dhe mundësi të mëdha. Është një ligj i bazuar në nxitjen e fitimit të dijes me risi dhe shanse të barabarta.

Kjo është padyshim një reformë e domosdoshme që nxjerr haptazi abuzuesin dhe vlerat akademike dhe qytetare, promovon intelektin dhe mbështet fort zhvillimin e tij, duke i bërë institucionet e arsimit të lartë të ushtrojnë atë funksion që duhet të kenë, që ka vite që e ka humbur, të provojnë shkencë, të provojnë dije si një detyrë dhe e mirë publike.

Duke përshëndetur të gjithë aktorët që kanë marrë pjesë në këtë punë të shkëlqyer, ju ftoj ta miratojmë këtë ligj që do t'i shërbejë shumë arsimit të lartë në Shqipëri dhe në rajon.

Faleminderit!

Ilir Meta – Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Arbjola Halimi. Përgatitet deputetja Mimoza Hafizi, më pas në emër të grupeve dhe më pas kemi votimin. Kështu që do të njoftohen deputetët që për 40 minuta do të fillojmë procesin e votimit.

Arbjola Halimi – Në fakt, kur dëgjon ligjërimet tuaja, duket sikur ligji është një mrekulli. Personalisht do të shpresoja që të ishte i tillë, po ashtu sikurse edhe do të shpresoja që të gjitha sa ne themi të ishin gënjeshtër, por fakti është se nuk janë gënjeshtër dhe është e mira që t'u thoni të vërtetën shqiptarëve, veçanërisht pedagogëve dhe studentëve.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar pedagogë,

Të nderuar studentë,

Fati e deshi që sot në parlamentin e Shqipërisë të vinte për miratim një ligj, ai "Për arsimin e lartë", ndër më të rëndësishmit në një vend, nga njerëz që, në gjykimin tim, ose e kanë njohur universitetin në mënyrë tangenciale, ose nuk e kanë njohur fare atë.

Sigurisht që vota ime në bindje të plotë personale, si pedagogje dhe si deputete, është kundër dhe sigurisht që edhe opozita do të vazhdojë përpjekjet e saj, por prapë ndihem me turp që nesër, pasi ju ta miratoni këtë ligj, të përballim me profesorët e mi, me studentët e mi dhe më gjerë njësoj si të kem qenë pjesëmarrës në një krim, pavarësisht se ne nuk do ta votojmë kurrsesi atë.

U ndieva thellësisht e indinjuar nga mënyra sesi sot ministrja iu drejtua profesoratit dhe stafit akademik të vendit duke ngritur veç akuza mbi ta

dhe duke poshtëruar misionin dhe punën e tyre të realizuar me mund dhe me pak vlerësim.

Të nderuar kolegë deputetë, pedagogë, studentë dhe qytetarë,

Aq shumë u përpoq kjo qeverisje për ta miratuar këtë ligj, sa që vendosën me shpejtësi një mur shurdhërie anembanë vetes kundrejt të gjitha recensioneve akademike që e hodhën poshtë atë.

Paturpësisht edhe këtu në këtë sallë flasin për konsultime të bëra me ta. Janë mësuar të gënjejnë, edhe pse i gjithë shtypi i shkruar gëlon nga deklaratat kundër të profesorëve të nderuar në këtë vend.

Unë do të citoj vetëm pak fjalë nga memorandum i nënshkruar prej 200 prej tyre: "Krejt i papërshtatshëm dhe i gabuar në thelbin e vet, dhe që nuk është aspak në përputhje me standardet bashkëkohore dhe statusin e universiteteve në një shoqëri demokratike. Ky projektligj nuk u përgjigjet pritshmëriave tona dhe mbi të gjitha përgatitjes së një kuadri tërësor juridik, ku kërkimi dhe shkencë, si dhe njerëzit e përgatitur me nivelet më të mira të njohurive shkencore do të mund të gjenin vendin e tyre në shoqëri, përkundrazi, projektligji anashkalon zgjidhjen e problemeve të tjera të mprehta sikurse janë pamundësia midis të diplomuarve, prapambetja në sistemin e mekanizmit ekonomik të funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë, mungesa e kriterëve të përpunuara të matjes së cilësisë së kërkimit shkencor, kushtet e punës dhe të mësimdhënies së profesoratit, kushtet e jetesës dhe të drejtat e studentëve. Mbi të gjitha, projektligji në fjalë e përkeqëson kuadrin e tanishëm juridik".

Eklektizmi i theksuar ka karakterizuar pothuajse platformat e paraqitura në projektligj, të mbështetura në asnjë studim të thelluar e konkret të realitetit shqiptar, e kundërta me atë që u deklarua pak më parë këtu nga ministrja përkatëse, çka na jep shqetësimin e improvizimeve subjektive.

Po vihet në rrezik parimi kushtetues, i cili thekson se autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike garantohen me ligj. Kjo duket në të gjithë frymën e projektligjit.

Parashikohet të kontrollohen të gjitha aspektet thelbësore të jetës universitare. Një radhë nenesh i jep ministrit të Arsimit

kompetenca duke e bërë atë një autoritet të skajshëm mbi institucionet e arsimit të lartë.

Është fshirë krejtësisht roli drejtues në kërkimin shkencor dhe në mësimdhënie i trupës së profesoratit, eliminohen këshillat e profesorëve, këshillat e fakulteteve, si dhe juritë e ngritura prej tyre për vlerësimin dhe drejtimin e punës shkencore dhe kualifikimin shkencor të punonjësve.

Nuk e kuptoj se ku i ka ministria ekspertët ekselentë, të cilët do të mund të vlerësojnë, të gradojnë profesoratin?

Vihet në rrezik financimi i pagave dhe i shpërblimit për personelin duke mos shpallur të drejtën për të pasur grantin e pakushtëzuar dhe duke e vendosur universitetin publik përballë dilemës: ose të ngrejë çmimin e tarifave të studimit për studentët, ose të pranojë të vegjetojë në një varfërim jetësh dhe mundësish materiale dhe financiare.

Nga konstatimet tona rezulton se projektligji krijon një peizazh konkurrencial krejtësisht të pabarabartë.

Thërrmimi i buxhetit publik në një numër tipologjisht universitetesh publike shkon krejt në kundërshtim me priirjen e sotme të krijimit të poleve universitare. Ndërkaq, parashikimi për të financuar institucionet private të arsimit të lartë në kushtet e liberalizimit të tarifave që ato ushtrojnë, jo vetëm krijojnë një padrejtësi sociale rrënqethëse, por lejon edhe shpërdorimin e parasë publike”.

Ju lutem, zonja Ministre, meqenëse keni thënë që jeni konsultuar dhe keni gjetur miratimin e stafit akademik dhe të studentëve, sillni të paktën 200 firma të pedagogëve që e miratojnë këtë ligj.

Të nderuar kolegë,

Ky ligj që vjen sot këtu kalon çdo limit demokracie dhe lirie që i duhet një vendi dhe e kthen arsimin e lartë 40 vjet prapa, një prapakthesë në kohën kur paraardhësit e tyre, me gjithë forcën që u jepte pushteti absolut, vendosnin se kush do të arsimohej dhe kush jo, çfarë përmbajtjesh do të kishin tekstet mësimore shkencore, duke manipuluar dhe kontrolluar masivisht shkencën, arsimin, zhvillimin e një populli për gjysmë shekulli me radhë.

Të nderuar kolegë, pedagogë, studentë,

Ky ligj e tejkalon në fakt satanitetin e paraardhësve të tyre, kjo pasi ai shuan

përfundimisht meritën, dijen dhe lartëson analfabetizmin, klientelizmin, shitblerjen e diplomave, një treg shumice, ku nëse ke para mund të blesh, një ligj që mbyl vlerat sikurse u konfirmua sot nga mënyra sesi ministrja i drejtohej sot profesoratit në vend.

Më respekt për ta, zonja Ministre!

Të nderuar kolegë, studentë dhe pedagogë,

Një shtet ligjor ka si mision të sigurojë dhe të jetë garant për të mirën publike të një vendi, sikurse janë edhe universitetet publike, dhe jo t'i shndërrojë ato në ndërmarrje fitimprurëse, duke e goditur arsimin e lartë dhe formimin e brezave të rinj nga themelet, por edhe arsimin në tërësi.

Arsimi i lartë në çdo vend që aspiron zhvillim është një nga prioritetet themelore me një buxhet të konsiderueshëm, pasi është vlerë themelore e një shoqërie, mirëqenies së zhvillimit të saj. Fatet e njerëzve varen prej tij, por ju nuk doni këtë. Ju doni t'i shikoni shqiptarët gjithmonë e më tepër në përvuajtje për të kënaqur, së pari, perversionet tuaja që dita-ditës dëshmojnë se janë pa limit se edhe pse kështu të përvuajtur, të paarsimuar dhe të pazhvilluar, me psikologjinë dhe filozofinë tuaj të shtypjes mendoni se mund t'i kontrolloni më mirë.

Por, i nderuar Kryeministër dhe e nderuar Ministre, populli është sovran. Ai të ngre, ai të ul, sidomos nëse e shtyp atë. Nuk mundesh sot të bësh një politikë të presionit. Ju po përpiqeni të skllavëroni Shqipërinë; këtë e them me plot bindje, se nuk ka si të gjejë një përgjigje tjetër për ato pak reforma dhe ligje haptazi abuzive, që ju i miratoni në këtë sallë, ashtu sikurse ishte ai i shërbimit laboratorik disa ditë më parë, edhe pse në kundërshtim të plotë me të gjithë profesionistët e fushës; profesorë të shquar ishin ata, ashtu edhe sot me këtë ligj të arsimit të lartë ju doni të miratoni me të gjithë universitetet kundër, publike e private.

Shpikni e stisni terma, jepni si përgjigje argumente boshe që nuk kanë asgjë konkrete në përpjekje për t'u shmangur, por e vërteta e gjen rrugën e saj dhe pas përpjekjeve të thella për ta kamufluar debatin dhe rëndësinë e këtij ligji edhe në medie.

E nderuar zonja Ministre,

Thatë që ky ligj thekson autonominë. Kjo është një gënjeshtër e madhe që fyen inteligjencën e gjithkujt.

Po ju citoj vetëm disa prej agjencive të panumërta që citohen në këtë ligj: “Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit është institucion publik në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë është institucion publik në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencia e Vlerësimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë, emërtimi i drejtorit të saj bëhet me urdhër të Kryeministrit, mbështetur në propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin. Ku është autonomia këtu, zonja Ministre? A e imagjinoni si bëhet shkolla kur thoni se mbështeteni në parimin financim në bazë të performancës? Për të thënë të vërtetën nuk kemi asgjë kundër, por si do t’i sigurojë universiteti, e nderuara zonja Ministre, performancën e për rrjedhojë edhe financimin, sipas këtij ligji, kur shqetësimi i tyre, realisht, është ai ekzistencial, pra: do të jenë apo nuk do të jenë?

Zonja Ministre!

Keni shkruar këshillat e profesorëve, komisionet e gradave. Kush do t’i japë ato, zonja Ministre? Kush do t’i japë konkretisht? Çfarë kualitetesh akademike kanë ministrinë, e nderuara Ministre, për të drejtuar arsimin e lartë nëpërmjet këtyre agjencive, që kanë jo pak funksione akademike?

E nderuara zonja Ministre!

Qëllimi i vërtetë dhe i thellë i këtyre strukturave dhe këtij ligji, është që të kontrollojë gjithçka.

Të nderuar kolegë, pedagogë dhe deputetë!

Pasi mbarova së shfletuari projektligjin, me dhimbje ndjeva se kishte humbur universiteti. Ku është universiteti në këtë ligj, e nderuara zonja Ministre? Ku është universiteti, kur gjithçka i delegohet këtyre agjencive në varësi të ministrisë, shtetit dhe qeverisë. Ministria dhe qeveria që delegon dhe vendos për kërkimin, financimin, për gjithçka.

Të nderuar kolegë dhe qytetarë!

Miratimi i këtij ligji, jo vetëm që nuk shpreh vullnetin e studentëve e të pedagogëve, por thekson gjithnjë e më tepër arrogancën që e shoqëron prej kohësh këtë qeverisje të ledhatuar nga pushteti, që bën luftë me dijen, duke e konfirmuar më tej arrogancën e vet.

Të nderuar kolegë!

Kjo nuk është luftë me opozitën. Kjo është një luftë e dijes me antidijen, e vlerës me

antivlerën, e meritës kundrejt klientelizmit dhe blerjes së gjithçkaje. Për këtë, ftoj të gjithë intelektualët e majtë, që kam besimin se ndodhen dhe janë të pranishëm në këtë sallë, që të mos e votojnë këtë ligj, për të mos përbaltur dhe mbartur mëkate që nuk janë kryer prej tyre, por që do t’u rëndojnë brezave.

Kam disa pyetje për ju, zonja Ministre. Shpresoj ta marr përgjigjen.

Jo, do t’ia bëj pyetjet, se e kam merak. Sepse... thatë se mbështetet në investimin për arsimin e lartë, e kështu me radhë. Sa është buxheti për arsimin e lartë, aktualisht, zonja Ministre, dhe sa parashikohet të rritet ai. Për të kuptuar si do të financohen universitetet.

Së dyti, thatë se keni bërë studime. Personalisht, vi nga universiteti i Elbasanit dhe e përgënjeshtroj deklaratën tuaj, kur thatë se jeni konsultuar. Të paktën për Universitetin e Elbasanit kjo nuk ka ndodhur.

Së treti, për ta mbyllur: Si mundet që Shqipëria, një vend evropian që është realisht, por me të ardhura të pakta, nuk ka ndjekur një model mirëfilli evropian, por shkon e ndjek një nga modelet më të shtrenjta për arsimin e lartë?

Faleminderit! Shpresoj që Ministria të më japë përgjigje.

Ilir Meta – Atëherë, fjalën e ka deputetja Mimoza Hafizi. Përgatitet deputeti Petrit Vasili, në emër të grupit parlamentar.

Mimoza Hafizi – Të nderuar kolegë!

Ky ligj për arsimin e lartë është i katërti që kalon në parlamentin shqiptar vetëm që pas vitit 1991, pa llogaritur amendamentet e pjeshme që i janë bërë secilit prej tyre. Është një numër pa konkurrencë, besoj, nga të gjithë sektorët e tjerë, dhe tregues i paqartësisë sonë kolektive për udhën e sistemit të arsimit të lartë.

Ligji i 1996-ës ishte i pari dhe u pasua nga ligji i 1999-ës, i hartuar me synim kryesor instalimin e rregullave demokratike të zgjedhjeve në universitete, në ato pak universitetet e para, të lindura e të rritura në epokë diktature. I hartuar pra, në periudhën kur ishte parësore që demokracia ta bënte funksionale lirinë akademike të çdo pedagogu dhe rolin e tij në autonominë e institucionit. Ligji i 1999-ës i hapi, gjithashtu, dyert arsimit të lartë privat, që u pa si shteg për ta shpëtuar sistemin nga financimi i mangët dhe pasojat e tij, ikja masive e intelektualëve nga vendi, duke e shtuar sistemit

dhe financimin privat të studentëve dhe familjeve shqiptare, që shkrinë pa kursim ekonominë e tyre ëpr shkollimin e fëmijëve, u synua të krijoheshin në Shqipëri universitete të cilësisë së lartë, të nivelit perëndimor.

Sot, në distancën e gjashtëmbëdhjetë viteve, në vitin 2015, gjendemi shpesh diametralisht larg nga këto ide fillestare. Zgjedhjet universitare në mjaft raste degraduan në autokraci, që ia morën frymën autonomisë së brendshme, kurse dera e hapur për arsimin privat, përfundoi në një dramë me dyzet e katër akte institucionesh, që u krijuan brenda një dhjetëvjeçari.

Në vijim, ligji i 2007-ës zgjeroi trupat zgjedhëse në universitete, me synim rritjen e nivelit të demokracisë. Ai vendosi edhe sistemin e Bolonjës. Por, edhe ky ligj u shfaq po aq inert dhe i pafuqishëm për të ndalur instalimin e kastave drejtuese në universitetet publike. me gjithë rregullat e qarta të sistemit të Bolonjës, ligji bëri sehir shpërthimin jashtë kontrollit të qindra e mijëra programeve të studimit, kryesisht nëpër universitetet private, që pas 2007-ës u shumëfishuan eksponencialisht.

Edhe ky ligj, ashtu si pasardhësi i vet, i ndenji besnik shprehjes cinike: “Ku ligji e ku realiteti që ai prodhon”.

Qëllimi themelor i ligjit që po diskutojmë, ngrihet mbi barrën e madhe që qeverisja dhe maxhoranca kanë mbi vete, barrën për të vënë rregull mbi sistemin që na u la në dorë në vitin 2013, për të vënë rregulla e për t’i respektuar ato. Veprim shumë i guximshëm ishte ndërhyrja në vitin e kaluar, që mbylli tetëmbëdhjetë universitete private dhe pezulloi trembëdhjetë prej tyre. Ministria e Arsimit dhe qeveria, e përballuan me kompetencë të lartë situatën dramatike të mijëra studentëve të mashtruar nga ato dhjetëra skema falsiteti. Universitetet publike qenë aleati më i madh në këtë aksion. Ato morën përsipër ngarkesën e disafishtë të një numri mbytës studentësh. Prandaj dhe aksioni mori rrugë të suksesshme. Ky është një tregues domethënës, që qeveria e sotme e ka vullnetin politik të respektojë ligjin. Ky është një faktor besueshmërie për zbatimin e neneve të ligjit që po kaloj.

Për shembull, financimi me bazë konkurrencën i universiteteve publike apo financimi i degëve prioritare nuk është penguar

nga ligjet e mëparshme, por nuk është aplikuar asnjëherë, unë besoj se kjo qeveri do të fillojë të realizojë skema të tilla financimi, të domosdoshme për përdorimin efikas të fondeve publike në të gjitha universitetet, që lekët të shkojnë aty ku është cilësia dhe interesi kombëtar. I ndaj veçmas këtu degët që diplomojnë mësues në të gjitha profilet. Nevoja për cilësi dhe studentë të mirë, që të kemi mësues të mirë, është emergjente.

Në organizimin e brendshëm të universiteteve ligji parashikon ndarje më të prerë të detyrave akademike nga detyrat administrative. Nga këshilli i administrimit kalohet në bordin e administrimit, i cili do të menaxhojë buxhetin, kurse rektorëve, senateve dhe dekanëve u mbeten detyra akademike, programet mësimore, puna në auditor, kërkimi shkencor. Unë e mbështes këtë ndarje të qartë, e cila kërkohet prej kohësh.

Situata aktuale hibride, ku akademikët menaxhojnë fondet, ka çuar shpesh në konflikt interesi se ata që kërkojnë fonde dhe ata që i akordojnë janë të njëjtit. Mbetet për t’u parë, nëse ndarja e prerë midis akademizmit dhe administrimit do të lejojë fleksibilitet dhe shpejtësi.

Ligji u jep rol vendimtar universiteteve për pranimet e studentëve, një rol që është kërkuar si i tillë prej vitesh. Vihet si kusht respektimi i një note mesatare të fiksuar nga qeveria. Uroj që edhe këtu politika e qeverisë të jetë inkurajuese e cilësisë me standarde kombëtare, duke mos lejuar situatën e deri sotme, ku i njëjti program studimi, a, për shembull, mjekësia, diku ka kritere të forta pranimi, e diku tjetër i ka dyert lehtësisht të hapura.

Me këtë ligj përjashtohen studimet me kohë të pjesshme, një plagë kohëgjatë në arsimin e lartë. Nuk ka më diploma të fituara me dy ditë leksione në javë, studimet do të jenë të standardizuara me të njëjtin numër orësh dhe kreditesh.

Në ligj ka rregulla më të forta strukturimi në universitete, kolegje universitare, kolegje të larta, ku nxitet shkollimi profesional 2-vjeçar. Mbetet gjithmonë që ata të respektohen. Në këtë linjë po fus edhe sistemin e cilësisë dhe të akreditimit, i cili ka prej 15 vjetësh i ngritur me thujse të njëjtat norma si edhe te ligji që po diskutojmë sot, por ishte ky sistem akreditimi që

lejoji kaosin aktual. Ne besojmë e shpresojmë se akreditimi i premtuar nga qeveria, edhe me praninë e një agjencie të huaj, të funksionojë sa më parë.

Për sa u përket studimeve të doktoratës shumë problematike dhe të përfolura për falsitetin, plagjiaturën dhe abuzimin financiar, besojmë që qeveria të ndërhyjë shpejt përmes sistemit të akreditimit, por dhe normave të vendosura me VKM. Gjendja aktuale ku një profesor udhëheq mesatarisht 15 studentë, në raste ekstreme deri në 40 studentë, është skandaloze dhe karikaturë e shëmtuar e çdo përpjekjeje për cilësi dhe dinjitet. Në ligj kërkohet që doktoraturat të jenë pjesë e aktivitetit shkencor universitar. Ato do të financohen posaçërisht nga shteti. Në debatin në komision ne kërkua dhe arritëm të shtojmë një kusht në ligj, që çdo financim i mundshëm të shkojë vetëm drejt projekteve shkencore, jo fonde publike për institucionet private. E kemi premtuar politikisht dhe e kemi shkruar në ligj.

Së fundi, dëshiroj që përshkruaj modelin e IALPP -ve, Institucionet e Arsimit të Lartë, Publik të Pavarur, që themelohen nga fondacione, dhënë në ligj përmes 6 neneve të kapitullit 12.

Universiteteve aktuale publike mund t'u lindë e drejta të transformohen sipas këtij modeli duke përfiturat që për fondet publike të mos zbatohen rregullat shtetërore të shpërndarjes së të ardhurave dhe as rregullat e prokurimit publik. Gjithashtu, universitetet do ta rrisin praninë në bordin e administrimit. Prania e shtetit do të ushtrohet për mes një fondacioni të krijuar prej tij, shtetit, dhe jo sipas mënyrës së deri sotme.

Universitetet publike aktuale mund të transformohen në IALPP jo më parë se sot dy vjet, siç është vendosur në dispozitat kalimtare të ligjit. Deri atëherë dy ngjarje të mëdha do të ndodhin në jetën e universitare.

E para, e zgjedhjet universitare, ku besoj se tema kryesore do të jetë transformimi apo jo në IALPP. Pedagogët studentët çdo aktor do të ketë mundësinë ta eksplorojnë këtë temë dhe të zgjedhin rektorët, dekanët, shefat e departamenteve, senatorët nga ata njerëz që do të dinë të negociojnë me qeverinë për këtë proces.

E dyta, do të jenë zgjedhjet politike të vitit 2017. Besoj se secila prej forcave politike që do të garojë do ta ketë universitetin një nga

kryetemat, ashtu siç ndodhi dhe në vitin 2013. Secila prej tyre do të shpalosin qartë vizioni e këtij transformimi të mundshëm, shumë më tepër sesa ç'japin edhe nenet e ligjit që po diskutojmë sot. Do të shpalosë vizionin për të ardhmen e arsimit të lartë për nivelin e financimit publik dhe nivelin e tarifave të studentëve. Po kështu, votat popullore e vitit 2017 do të mbajë brenda saj edhe të ardhmen e universiteteve publike. Kurse, universitete private, edhe ato sipas ligjit, mund të transformohen në IALPP dhe kështu të marrin fonde publike. Por kjo mundësi do t'u lindë vetëm si sot tre vjet, një vit më vonë se universitete publike. Ky është ndryshimi që e kërkua ne grupi i deputetëve njëzëri në Komisionin e Ligjeve dhe në Komisionin e Edukimit dhe Arsimit, duke e motivuar me nevojën për mbështetje të sistemit publik nga konkurrenca e pabarabartë.

Gjithsesi, i mbetet parlamentit të ardhshëm që si sot tre vjet t'ua lërë apo jo këtë të drejtë universiteteve private, t'ua shtyjë edhe më tutje në kohë apo t'ua heqë difinitivisht.

Ligji u punua për gjatë 3 muajsh në parlament në vijim të mbi një viti pune nga komisioni i ngritur prej qeverisë.

Dua të falënderoj për zemërsisht të gjitha grupet e interesit që e thanë hapur mendimin e tyre! Universitetet tona pikërisht për këtë kanë nevojë, mendimin pjekur dhe fjalën e hapur, deri luftarake dhe me pasion.

Falënderoj kolegët e Komisionit të Ligjeve, me në krye zotin Xhafaj, për vëmendjen dhe mbështetjen, ku vend të veçantë merr natyrisht Vasilika Hysi, kolegja e palodhur dhe pafundësisht e saktë!

Besoj se me Vasilikën, për punën që bëmë, do të jemi krenare dhe me kokën lart kur të kthehemi në departamentet prej nga vijmë.

Falënderim kolegëve të Komisionit të Arsimit për profesionalizmin. Bashkërisht ne ndërhymë në shumë nene për ta bërë më të përshtatshëm këtë ligj.

Për të gjitha këto arsye bëj thirrje që ta votojmë.

Faleminderit!

Illir Meta – Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Petrit Vasili në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së.

Të njoftohen të gjithë deputetët të jenë prezent për votimin.

Petrit Vasili – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi sot në një moment shumë të veçantë, që ka lidhje me arsimin universitar dhe konkretisht ka të bëjë me prezantimin saktësisht të një modeli të ri të administrimit të sistemit universitar, i cili mëton që të kthejë përgjigje dhe të zgjidhë një seri problemesh të vështira, të akumuluar në vite, që kanë qenë të lidhura edhe me efektivitetin, edhe me probleme të një disiplinimi organizativ, por edhe me prapambetje të karaktereve të tjera, të cilat në një mënyrë apo një, kanë krijuar një pamje jo pozitive për sistemin.

Megjithatë, personalisht nuk bëj pjesë tek ata, të cilët besojnë në rrënimin e një modeli dhe lindjen e një modeli të ri, duke harruar gjithçka ka ndodhur. Besoj se vetëm leximi shumë i mirë dhe i vëmendshëm i çdo eksperience pozitive të së shkuarës dhe stigmatizimi i rreptë dhe dhënia zgjidhje e problemeve që janë demonstruar si negative, është qëndrimi më i ftohtë dhe më racional që ne mund të kishim përpara një reforme të tillë. Insistoj ta them këtë gjë, sepse gjithë kjo reformë dhe ky model që ne prezantojmë, të cilit shpresojmë t'i japim besimin parlamentar, do të jetë në duart e po të njëjtës klase të madhe pedagogësh, asistentësh, teknikentësh shkencorë e të tjerë, që do ta marrin në duar këtë reformë për ta jetësuar e për t'i dhënë formë. Ndaj raporti i vazhdueshëm i besimit të konsoliduar dhe i besimit që rritet në rrugë e sipër, mund të ishte dhe mbetet i vetmi qëndrim racional ndaj çështjes. Sigurisht, problematikat e akumuluar në vite nuk mund të jenë shkak apo alibi për të krijuar zgjidhje të tilla, ku kostot sociale do të shndërrojnë në një pamundësi të pakapërcyeshme arsimimin dhe vrasjen e të ardhmes së shumë të rinjve shqiptarë. Ndaj modeli duhet të mëtojë që të ketë një vëmendje të jashtëzakonshme për monitorimin e përditshëm të ekuilibrit shumë delikat ndërmjet ekuilibrit akademik dhe atij social. Peshimi i njërit në kurriz të tjetrit dhe anasjelltas, sigurisht do ta zhbalancojë sistemin dhe, në vend që të ndërtonte atë sistem për të cilin ne po investohemi sot politikisht, me besim të madh se ndryshimi do të ndodhë, do të prodhonte pikërisht të kundërtën.

Ky debat i gjerë ka qenë një risi pozitive, një ringjallje e një diskutimi të gjerë, ku përfshihen grupe interesi, ku përfshihen aktorë në proces, ku përfshihen të gjitha shtresat që janë të interesuara drejtpërdrejt, por që ka përfshirë në distancë edhe shumë qytetarë shqiptarë, të cilët mendojnë për të tashmen e fëmijëve të tyre, por ka edhe mjaft të tjerë, mijëra e mijëra të tjerë, që shikojnë edhe mënyrën si ndërtohet e ardhmja e fëmijëve të tyre. Ndaj edhe debati ka synuar të shterojë, por sigurisht nuk ka mundur të shterojë gjithçka, çdo pyetje, çdo hamendje, çdo mosbesim e çdo dyshim. Ky është fillimi i një rruge, por askush nga ne nuk mund të mendojë se ky është fundi i rrugës. Sot ne i japim, e thashë edhe një herë tjetër, modelin e besimit, dhe i japim njëkohësisht besim asaj që quhet ideja e pandryshuar për t'u reformuar dhe për t'u ndryshuar. Kjo ide e reformimit dhe e ndryshimit nuk mund të jetë as tabu dhe as një moment i transformimeve të jashtëzakonshme, të papara ndonjëherë, sepse sistemit të reformimit i janë nënshtruar shtetet ku kanë lindur universitetet në qindra vjet dhe nuk reshtin së përmirësuar sistemet e tyre. Pikërisht në një këndvështrim të tillë duhet ta shikojmë edhe ne këtë reformë, duke qëndruar tek eksperiencat pozitive të së shkuarës dhe duke çrrënjësuar ato eksperiencat negative, që kanë ngjallur mosbesim te qytetarët lidhur me të ardhmen e fëmijëve të tyre.

Sigurisht, mjaft çështje edhe sot kanë nevojë për përgjigje të tjera, por një nga momentet, nga më delikatet, do të thosha, dhe atje ku do të jetë edhe prova e së vërtetës së këtij ligji, që jemi mbledhur për ta diskutuar e për ta miratuar sot, do të jetë ai moment që ne rëndom në praktikën parlamentare e quajmë “aktet nënligjore”, por që për këtë ligj besoj se është mundësia e vetme e madhe për të davaritur gjithçka që ne kemi pasur të pabesuar, gjithçka që shumë njerëz edhe sot e kësaj dite nuk janë të qartë, sepse aty mbase do të marrë përgjigjet konkrete se cila do të jetë kjo ngrehinë, që tullë pas tulle do ta ngremë.

Sot ky akt parlamentar më së fundi konfiguroni një model. Ky model do të jetësohet me aktet nënligjore, ku besoj se gjithçka që nuk funksionoi në perfeksion në dialogun e madh me grupet e interesit, është një mundësi e madhe për të ecur e për t'u zhvilluar gjithmonë e më shumë, sepse, e them edhe një herë tjetër, nuk do të kemi

një armatë të re që do ta vëmë në dispozicion të këtij ligji, por do të kemi edhe armatë, e cila, duke menduar ndryshe dhe duke perceptuar e absorbuar e thithur këtë ligj, do të bëjë të mundur që ky të jetë i vërtetë dhe pozitiv.

Një nga elementet që ligji ka, që me aktet nënligjore sigurisht do të jetësohet në një mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe deciziv, do të ishte raporti i anës akademike dhe administrimit. Personalisht, edhe nga eksperiencia ime, edhe në të kaluarën time si punonjës i shkencës, mendoj se ne duhet të stabilizojmë modelin e menaxherit të padukshëm. Emrin, performancën, simbolizmin e një strukture universitare nuk e bën menaxheri, kushdo që e mendon këtë do të bënte një gabim shumë të rëndë. Modelin e saj e bën profesorati, e bëjnë liderët shkencorë. Janë ata që i japin fytyrën e suksesit. Menaxheri është lehtësuesi, thujse i padukshëm, i shumë proceseve të karakterit administrativ, financiar, të cilat në fund fare bëjnë të mundur që të kemi sukses. Nuk duhet të matet asnjëherë puna e një strukture universitare me bilancin ekonomik, pozitiv ose negativ të saj, por do të matet me sy çfarë do të prodhojë ajo, në të mirë të të gjithë linjës universitare, por edhe të arritjeve të reja, të kërkimit shkencor, që synojnë të japin një shtysë të re me këtë ligj.

Gjithashtu, kompleksiteti i jashtëzakonshëm i ngjyrimin social që ligji prodhon, bën të domosdoshëm që shumë përgjigje, që kanë të bëjnë me aksesin e pakufizuar për arsimim, të marrë një përgjigje të drejtpërdrejtë në aktet nënligjore.

Sigurisht, në formulimet aktuale të ligjit, këto përgjigje nuk ka mundësi të shterohen e të ezaurohen, dhe sigurisht që aktet nënligjore do të kenë mundësinë e madhe që këtij mosbesimi t'i japin fund apo të tregojnë se qëllimi i ligjit ka qenë i qartë dhe i drejtë dhe ky më në fund jetësohet me veprime praktike.

Dihet nga të gjithë se çdo reformë qysh në fillim është qëllimshme, e tillë është edhe kjo reformë, por prova e së vërtetës, ajo që ndan suksesin nga dështimi është sesi kjo provë bëhet në mënyrë konkrete.

Në këtë sallë parlamenti, por edhe nga vëzhgues të huaj, monitorues të Shqipërisë, kemi dëgjuar shpeshherë që kemi ligje të mira, por kemi zbatim të dobët. Kjo ka ardhur si pasojë se aktet nënligjore apo ndonjëherë edhe interesat e

ngushta që i kanë kushtëzuar ato kanë bërë që edhe qëllimi i mirë të mos ketë fatin e duhur. Ndaj momenti që pason është shumë delikat dhe është përcaktues më shumë se edhe nata e sotme.

Sigurisht, në ligj ka mjaft elemente, të cilat e nënvizojnë këtë në mënyrë sistematike, do të thosha, edhe në disa momente kur edhe çekuilibrohet, duke demonstruar që menaxhimi dhe administrimi i fondeve, i bilanceve do të ishte kyçi i suksesit. Bota akademike universitare nuk ka qenë gjithmonë kështu. Jeta e shkencës në qindra vjet ka provuar që në momente të caktuara, në momentet e një bilanci negativ ekonomik, kanë lindur arritje të mëdha, sepse drejtimi shkencor dhe akademik ka qenë në rrugën e duhur. Ky duhet të na prijë edhe në të ardhmen.

Disa probleme të tjera të rëndësishme i përmendën edhe kolegët e Grupit Parlamentar të LSI-së, në mënyrë të veçantë momentin shumë delikat të kreditimit të studentëve.

Së dyti, problemi i tarifave kërkon një sjellje shumë delikate, shumë të kujdesshme dhe shkëputja e çdo lloj qëndrimi nga konteksti social i vendit do ta bëjë këtë ligj një vendosje, një ornament shumë të kushtueshëm në një qafë të varfër, do të figurojë edhe butaforike.

Ky ngjyrim i fortë social dhe mostransformimi i ligjit në një ligj pengues, i cili nuk hap perspektivë, sigurisht do të ishte një moment shumë delikat dhe duhet vlerësuar me kujdes më të madh sesa hartimit të ligjit, i cili i mbështetur në modele, të cilat janë të konsoliduara në vendet e tyre, kërkon interpretim kreativ në Shqipëri. Të gjithë duhet ta dinë, shumë kolegë kanë eksperiencë edhe në implementimin e drejtpërdrejtë të reformave dhe e dinë shumë mirë që nuk mund të ketë një reformë identike në vende të ndryshme. Modeli merret dhe zbatohet në mënyrë kreative. Këtij rreziku të madh duhet t'i ruheni edhe në këtë rast, sepse një shkujdesje apo një eufori që: tashmë kemi ligjin e mirë dhe gjërat funksionojnë, mund të na shtyjë në një rrugë pa krye.

Një nga elementet e rëndësishme është që procesi i diskutimit ka treguar në mjaft momente të tij edhe reflektime edhe drafte, të cilat janë përmirësuar në një periudhë për më shumë se një vit e gjysmë dhe kanë treguar se që nga modeli fillestar deri në modelin përfundimtar kishte

nevojë për diskutime dhe përmirësime të vazhdueshme.

Do të thosha se edhe për momentin tjetër, i cili ka të bëjë me raportet mbi ngritjen e institucioneve, kam formuluar rezervat e mija edhe në komision lidhur në mënyrë të veçantë me institucionet, të cilat janë publike të pavarura. Ky duhet të jetë një problem, i cili duhet të trajtohet me kujdesin më të madh, sepse qartësia që vërehet në institucionet publike dhe në ato jopublike, në të dyja përkufizimet që jep ligji në nenin 6, nuk ka të njëjtën qartësi në institucionet publike të pavarura. Këtu kujdesi duhet të jetë shumë i madh për t'iu ruajtur rrezikut të çdo lloj teprimi apo abuzivizmi, i cili nuk do të ishte i justifikuar.

Është për t'u përshëndetur që edhe në disa momente që kishin të bënin me rregullimet përkatëse që i takonin specificitetit që ka sistemi arsimor në fushën e shëndetësisë, siç ishte kufizimi për pjesëmarrjen në garë, jo për fitimin e garës së doktoruarve në Shqipëri, përjashtimi i tyre do të shërbente si një stigmatizim ndaj një sistemi arsimor që ka prodhuar edhe asistentëprofesorë dhe profesorë, është një kufizim që me anë të dakordësisë arritëm të kemi mirëkuptim. Heqja e këtij kufizimi ishte një hap i mirë reflektues për t'u përshëndetur.

Do të përshëndesja edhe mirëkuptimin e gjetur për mosbarazimin e të njëjtave kriteret për drejtuesit e departamenteve që janë një shkallë më e lartë në organizimin universitar në raport me ata që drejtojnë shërbimet mjekësore, sepse duhet ta themi që specificiteti në fushën e mjekësisë nuk ngjan aspak me shumë fusha të tjera për shkak të bioapartinencës që prodhon këtë problematikë të caktuar.

Në tërësinë e tij, duke theksuar disa parime të rëndësishme, si edhe duke mbyllur fjalën time, si unifikimi dhe standardizimi i sistemit të arsimit të lartë, krijimi i mekanizmave të qëndrueshme për sigurinë e standardeve europiane në institucionet e arsimit të lartë dhe në mënyrë të veçantë, mbi të gjitha krijimi i premisave për një arsim të lartë që i përgjigjet tregut të punës, janë disa nga risitë themelore, dhënia e përgjigjeve të të cilave na bën të kemi një projektim të një modeli, i cili na çon gjithmonë e më afër një shoqërie si kjo që jetojmë dhe na largon nga ai fiktivitet inproduktiv që ka prodhuar deri sot, duke e bërë

një investim të besueshëm dhe të dobishëm për çdo qytetar dhe familje shqiptare për arsimin universitar.

Për arsyet e mësipërme, duke u nisur nga reflektimi i disa prej rezervave të diskutuara, por që kanë gjetur mirëkuptimin e duhur, ne shprehemi në parim në mbështetje të kësaj nisme parlamentare për reformimin e arsimit të lartë, duke qenë shumë të kujdesshëm dhe monitorues rigoroz, në mënyrë të veçantë në gjithëpërfshirjen dhe në të gjithë mekanizmin që do të pasojë në hartimin e akteve nënligjore, ku shpejtësia, transparenca dhe realizimi i atij dialogu, i cili mund të ketë munguar në momente të caktuara, mund të plotësojnë edhe boshllëqet në komunikimin që është verifikuar deri tani.

Faleminderit të gjithëve!

(Drejtimin e seancës e merr zonja Leskaj.)

Valentina Leskaj - Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike fjalën e ka deputeti Myqerem Tafaj.

Myqerem Tafaj – E nderuara zonja drejtues e seancës,

Zonja dhe zotërinj kolegë deputetë,

Koha e zgjedhur për të hartuar një ligj të ri për arsimin e lartë edhe unë mendoj se ka ardhur. Ligjet e arsimit të lartë janë ligje që ndoshta ndryshojnë më shpejt sesa ligjet e tjera. Arsimit të lartë shqiptar ka njohur një zhvillim të shpejtë dhe të vrullshëm. Në 25 vjetët e fundit në dekadën e parë pas ndryshimeve dhe pas vendosjes së demokracisë në vend universitetet pësuat një transformim rrënjësor. Në dekadën e dytë ky transformim u thellua dhe sot jemi në vitin 2015 që do të thotë se sistemi ynë arsimor është në dhjetëvjeçarin e tij, pra ka dhjetë vjet që po implementon një proces jashtëzakonisht të thellë, siç është reforma e bazuar në procesin e Bolonjës. Nëse kjo reformë është radikale, e cila është e vështirë jo vetëm për vende si ne, si Shqipëria, por edhe për vende të tjera që janë shumë të zhvilluara, me kapacitete shumë të mëdha njerëzore dhe financiare, sigurisht që mund të shoqërohet dhe është shoqëruar edhe me rrjedhoja, të cilat kanë çuar në shumë programe, në shumë profile, në shumë drejtime studimi, në atë që ky proces ka në thelb të tij: t'u japë mundësi institucioneve të arsimit të lartë të shprehin atë vetëdije akademike që kanë, përpjekjet që bëjnë për të zgjeruar, për të

përshtatur ofertën e tyre akademike në përputhje me tregun.

Ne nuk kundërshtojmë faktin që duhej bërë apo jo një ligj i ri. Sigurisht, edhe ne ishim në rrugën për të bërë një ligj të ri, por, a mund të bëhet një ligj, duke u bazuar vetëm në nihilizëm? Të thuash që në Shqipëri në 25 vjet nuk është prodhuar asgjë në arsim, mendoj se është krejtësisht gabim. Ky është një nihilizëm i pastër. Jo. Në Shqipëri është prodhuar dije. Unë i përkas një brezi që kam studiuar përpara vitit '90. Unë i përkas një brezi që kam filluar punën përpara vitit '90. Ne të gjithë e dimë sa pedagogë dhe kërkues shkencorë kishte Shqipëria në vitin 1990, sa kishte në vitin 2005 dhe sa ka sot.

Sot Shqipëria ka rreth 12 mijë pedagogë dhe kërkues shkencorë dhe 12 mijë mendje, që përpiqen të merren me shkencë dhe të zhvillojnë mësimdhënie me studentët. Pra, 12 mijë njerëz të rinj e të rritur, të moshave dhe gjeneratave të ndryshme, që kontribuojnë në zhvillimin e një sistemi. Pra, këtu është prodhuar dije.

A është bërë çdo gjë dhe a kemi vetëm arritje? Nuk kemi vetëm arritje, kemi edhe mangësi. Pikërisht, këtyre pyetjeve dhe kësaj situatë duhet t'i përgjigjet ligji i ri. Ai duhet të thoshte se ku do të shkojë arsimi i lartë.

Ligji i ri që ne po e diskutojmë sot në një seancë më vete, që po e diskutojmë në një kohë jo fort të përshtatshme, është praktikë dhe normale që në çdo vend kur diskutohen ligjet për arsimin e lartë, studentët të protestojnë së bashku me pedagogët dhe kjo nuk duhet të na habisë. Ne duhet të jemi të gëzuar që ka studentë dhe pedagogë, që protestojnë. Po pse protestojnë ata? Ata protestojnë, sepse ky ligj, në radhë të parë, nuk u siguron perspektivë studentëve dhe është një nga çështjet e para që u diskutua edhe këtu, edhe në komision.

Çfarë ndodh me studentët? A e kanë ata të drejtën e arsimimit të lartë, që iu garanton Kushtetuta? Jo të gjithë. Këtë të drejtë e kanë vetëm ata studentë që kanë mundësi financiare, ndërsa të tjerët jo dhe në mënyrë të veçantë nuk e kanë studentët, që vijnë nga shtresa e varfër dhe nga familjet në nevojë. Vërtet projektligji thotë që do t'u japë bursë, por projektligji e thotë qartë që do të përqendrohet në ciklin e parë të studimeve.

Të nderuar kolegë, në mënyrë të veçantë ju që vini nga universitetet, të gjithë ne e kemi këtë përvojë me sistemin e Bolonjës.

Sistemi i Bolonjës vërtet është i ndarë në dy cikle: në ciklin e parë dhe të dytë, por është tepër e vështirë që me ciklin e parë të punësohesh, pra duhet edhe cikli i dytë. Nëse studentët, pikërisht kjo kategori studentësh, nuk mbështeten edhe për ciklin e dytë, atëherë si është realizuar e drejta kushtetuese për arsimim për studentët që e kanë meritën, por nuk e kanë mundësinë financiare?

Këtu u trumbetua me të madhe sistemi i unifikuar dhe i standardizuar. Është tjetër standardizimi dhe tjetër unifikimi. Pikërisht, ky është edhe diskutimi, unifikimi asgjëson diversitetin. Pra, në qoftë se institucionet e arsimit të lartë dhe universitetet nuk kanë mundësi të diversifikojnë ofertën e tyre akademike, atëherë si do të garojnë në treg, ku është aftësia e tyre për të konkurruar?

Një moment tjetër që u diskutua këtu për raportin e këtij projektligji me Kushtetutën është raporti me autonominë, me atë autonomi dhe liri akademike, që u garanton Kushtetuta në nenin 57.

Unë po marr vetëm një aspekt, ky raport cenohet kur merr fuqinë që ky ligj i jep bordit në raport me senatin. Universitetet janë komunitete, që janë krijuar, sepse ka studentë dhe pedagogë. Fjalën e parë dhe vendimet më të rëndësishme duhet t'i marrë komuniteti akademik me përfaqësuesit e tij në organet kolegjiale të zgjedhura.

Në fakt, në këtë ligj bordi merr një fuqi të një superfuqie brenda universitetit. A ka modele të tilla? Po, ka modele të tilla, por në asnjë rast bordi nuk mund të marrë forcën e senatit. Imagjinoni që bordi ka të drejtë që me 2/3-at e votave të votojë për kthimin e një universiteti publik, në universitet publik të pavarur. Kjo është një fuqi e jashtëzakonshme që ka bordi, dhe ky bord, së bashku me përbërjen e tij, nuk mund ta kryejë atë.

Europa kontinentale kur ka implementuar bordet, ka bërë konstituim të tillë të bordeve, që edhe vende shumë të zhvilluara të Bashkimit Europian kanë marrë anëtarë të bordeve nga vendet fqinj, nga vende të tjera, në mënyrë që të sigurohet prestigji i lartë i një bordi, distanca e

konfliktit të interesit, pra personalitete, të cilat vërtet mund të marrim vendime të rëndësishme. Ky bord, kjo përbërje që ka ky ligj, nuk e siguron këtë kurrsesi.

Kryeministri tha që ligji do të bëjë revolucion, do të bëjë përmbyse. Kjo e dyta është më e sigurt. Ku e bën përmbyse? Atë e bën në dy momente themelore: në modelin e ri të financimit dhe në modelin e ri të organizimit dhe funksionimit dhe përsëri të financimit nga institucione publike ose private, në institucione të arsimit të lartë publike të pavarura.

Modeli financiar bazuar në performancë. Është diçka shumë e mirë. Vetëm se këtë model kanë filluar ta bëjnë vendet e Bashkimit Europian në 10 vjetët e fundit. Po ku nisemi ne dhe ku jemi ne? Kjo është performanca e lidhur me kredinë studentore, që fillon në janar të vitit 2016. Ku jemi ne sot? Ne jemi me 0,4% buxhet ndaj GDP-së për arsimin e lartë; ne jemi me rreth 400 euro për studentët në vit, kur vendet më të reja të Bashkimit Europian e kanë të paktën 10 herë më shumë financimin.

Të gjitha vendet që kanë ndjekur këtë rrugë për të zhvilluar një model mbi performancën, kanë shpallur, në radhë të parë, se çfarë do të bëjnë me financat dhe këtë e kanë bërë vendet më të zhvilluara të botës kur kanë vënë qëllime të tilla. Por këtu nuk thuhet asgjë. Nuk kishte asnjë deklaram në relacion, asnjë deklaram në komisione dhe nuk kishte asnjë deklaram nga Kryeministri dhe nga qeveria sot në sallë.

Pra, performanca e vlerësimit mund të sigurohet vetëm atëherë kur ky buxhet të trefishohet. Por ne jemi të vetëdijshëm sesi financohen universitetet tona sot. Ato financohen nga buxheti i shtetit dhe nga tarifatat e studentëve. Këtu duhet bërë një parantezë. Tarifatat e studentëve sot nuk janë të ulëta. Sot ka tarifa studentësh që janë sa dy rroga minimale në Shqipëri. Pra, tarifatat e studentëve që janë sot në Shqipëri, janë tarifa në kufirin e një modeli shumë liberal. Kontributi që zë pjesëmarrja e studentëve në financimin e universitetit është rreth 30%. Ndërkohë që modelet më liberale konsiderohen 15%-20%.

Pjesa tjetër është buxheti dhe buxheti plus tarifatat është i gjithë financimi. A ka shanse të ndryshojë kjo skemë? Vetëm këto dy kolona mund të ndryshojnë, sepse kolonat e tjera, kolonat që vijnë nga industria, nga ekonomia

private, nga fondacionet e fuqishme, nga agjencitë e fuqishme të shkencës, nga donacionet natyrisht edhe në 10 vjetët që vijnë janë absolutisht të pamendueshme.

Cila është rruga? Rruga është vetëm për të rritur financimin. Si? Me buxhet? Buxheti afatmesëm tregon të dhënat, që flasin për një rritje të pakoncentrueshme të buxhetit. Çfarë mbetet? Mbetet tarifa. Kjo do të thotë që studentët duhet të paguajnë më shumë, sepse jo se këtë e dëshirojnë universitetet, por universitetet do t'i kenë detyruar ta bëjnë këtë gjë. Përndryshe, nuk financojnë dot as pagat e pedagogëve.

Ndryshimi tjetër është ndryshimi i krijimit të institucioneve të arsimit të lartë publik të pavarur. Natyrisht, elemente të këtij modeli mund të ketë edhe në vende shumë të pasura. Por, a mund të realizohet kjo në Shqipëri?

Së pari, a kalojnë fonde në institucionet private, apo jo? Në momentin që një institucion i lartë i arsimit privat kalon, transformohet në këtë formë, ai ka akses të barabartë në të gjitha programet buxhetore. Atëherë, a është ndopak realist ky model? Absolutisht, jo! Si mund të jetë realist! Për cilat fonde do të konkurrojnë këto institucione publike ose private, që kthehen apo transformohen në institucione publike të pavarura? Sigurisht, vetëm për fondet e buxhetit të shtetit. Fondet e tjera janë fonde krejt të pakonsiderueshme dhe shtylla tjetër është që do të rrisin tarifatat e studentëve.

Pra, ligji në mënyrë të qartë do t'i çojë universitetet drejt kërkesës së tyre të vendosur për rritjen e tarifës. Rritja e tarifës është një barrë e rëndë për familjet. Kjo tarifë do të përballohet me kredi. Kredia në asnjë vend të botës, nuk mund të implementohet me dy nene. Këtu ka dy nene. Në njërin deklarohet që agjencia bëhet garant dhe në tjetrin thuhet që shteti, qeveria ndërmjetëson.

Tagri i vetëm i ligjvënësit është jo vetëm të tregojë në atë draft se cilat janë kushtet dhe kriteret, kur do të kthehet dhe sa do të kthehet, cilat do të jenë lehtësirat në momentin e kthimit, por edhe ta konsultojë gjerësisht me studentët. Ne studentët i kishim në komision dhe ata nuk dinin asgjë për këtë. Imagjeroni, kredia studentore mund të zbatohet dora-dorës që në janar të vitit 2016 dhe i prek direkt studentët.

Të mos shkojmë te momenti i riorganizimit të sistemit dhe perspektiva që do të kenë universitetet rajonale. Në fakt, ne e diskutuam gjerësisht në komision. A është zgjidhje kolegji? Absolutisht, jo! Kolegji universitar nuk është zgjidhje.

Në rast se duhet të riorganizohet sistemi, atëherë qëllimi primar duhet të ishte zhvillimi i arsimit të lartë profesional. Nuk është kolegji që e zgjidh këtë, nuk është akademia me këtë formulim që mund ta zgjidhë këtë. Kjo kërkonte një nen tjetër dhe në rast se kolegji do të prekte universitetet rajonale, atëherë kjo do të ishte krejtësisht e papranueshme, sepse këto universitete janë universitete me kontribut, universitete që kanë kontribut jo vetëm për përgatitjen e studentit, por janë universitete që kanë kontribut drejtpërdrejt në zhvillimin e rajonit dhe janë nukleuse që të nxisin zhvillimin rajonal të vendit.

Janë të gjitha këto aspekte që unë për shkak të kohës përmenda vetëm disa prej tyre dhe që ne si opozitë na kanë bindur që ky projektligj duhet kundërshtuar, ky ligj nuk duhet votuar dhe ne ju ftojme të mos e votoni ligjin.

Faleminderit!

Valentina Leskaj – Faleminderit!

Në emër të Grupit të Partisë Socialiste, deputeti Alftred Peza, urdhëroni!

Alfred Peza – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Ndihem i vlerësuar që flas në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, në lidhje me projektligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, sepse pas afro 6 dekadash histori, një regjim i vjetruar i marrëdhënieve midis studentit, universitetit dhe shtetit i filluar që nga viti i largët 1957, kur është themeluar Universiteti i Tiranës dhe improvizuar në 25 vjetët e fundit, deri në lindjen dhe zhvillimin në hapat e para të arsimit privat, po i vjen fundi.

Sot ky sistem do të përmbysset dhe në vend të tij me votën tonë ne do të hapim pas pak çastesh një fazë të re me një sistem të ri, një sistem që trajton dhe rregullon veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë si një e mirë e përgjithshme publike e të gjithë neve,

nëpërmjet një ligji modern, sipas modeleve më të mira perëndimore, një e mirë dhe përgjegjësi publike e çdo familjeje shqiptare, e grupeve të interesit, shoqërisë dhe veçanërisht qeverive tona.

Reforma e universiteteve në fushën e arsimit të lartë e fut edhe këtë sektor plotësisht në rregullat e qarta të lojës së ekonomisë së tregut, ku ligjin nuk do ta bëjë më mekanizmi i ndryshkur aktual, por kërkesë-oferta, dora e padukshme e Adam Smithit dhe roli rregullator i shtetit jo më si monopol i patjetërsueshëm, por si një garant i sistemit.

Ligji i ri “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” vjen pas rregullimeve që kjo maxhorancë i bëri disa javë më parë ligjit “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, duke i dhënë në këtë mënyrë një formë të plotë reformimit pothuajse të të gjithë piramidës së sistemit tonë arsimor pjesë e korpusit të reformave të thella strukturore që ka ndërmarrë kjo maxhorancë.

Për të gjithë ata që rreken ta kanalizojnë këtë debat në hullitë e teorive politike apo drejt lëndinave ideologjike, më duhet të them se kjo reformë nuk është as e majtë dhe as e djathtë. Kjo është reforma e duhur, në kohën e duhur në një periudhë sfidash të mëdha për të sotmen dhe të ardhmen e sistemit tonë arsimor, pasi jetojmë në periudhën pos-ideologjike, kur partitë, koalicionet dhe maxhorancat ndahen në të mira dhe në të këqija, në progresive dhe regresive; në parti që i mbajnë apo nuk i mbajnë premtimet, në qeverisje që duan dhe i realizojnë reformat, apo në opozita që kanë ose nuk kanë alternativa, apo kauza në të mirë të qytetarëve të vet.

Një gjë është e sigurt për të gjithë kritizerët e këtij projektligji që e shohin gjithçka me lentet e teorive dhe rrymave politike gjithfarësh, se reforma e universiteteve ose e gjithë mësimëve, siç Sami Frashëri te “Shqipëria çka qenë, ç’është dhe çdo të bëhet” e thotë: “Nuk është edhe aq e majtë saç do të donin ata”.

Duke qenë ndoshta aq e djathtë sa do të donte në fakt opozita e sotme, sepse ajo që e ndryshon në thelb projektligjin që po diskutojmë me ligjin aktual është veç të tjerash dhe sistemi i ri i financimit të arsimit tonë të lartë dhe kërkimit shkencor në të.

Është ky dhe ndryshime të tjera thelbësore që do të rrisin konkurrencën, cilësinë,

meritokracinë, standardet e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe do ta lidhim më në fund në mënyrë harmonike të

drejtën për arsimim me nevojën e shoqërisë për të ardhmen e brezave të saj, si dhe me kërkesë-ofertën e tregun në përgjithësi dhe atij të punës në veçanti, duke e bërë në këtë mënyrë të garantuar me ligj ëndrrën e çdo familjeje shqiptare për t'i nisur bijtë e vet në atë që presidenti Obama e quan si udhën më të sigurt drejt shtresës së mesme dhe të lartë të shoqërisë.

Është kjo arsyeja se përse përfaqësuesit e opozitës janë shprehur se kjo është një reformë që ata do të donin ta bënin kur të ishim vetë në pushtet, por nuk mundëm. Një dëshirë që e konfirmoi sot në këtë sallë edhe ish-Kryeministri i tyre Berisha, sepse është fakt që arsimit i lartë sot ka shumë probleme, të cilat ligji aktual as nuk i ka zgjidhur, dhe as nuk mund t'i zgjidhë dot sot dhe në të ardhmen.

Meqenëse dikur opozita donte, por nuk e bëri dot, sot bën lojën e dhelprës me rrushin dhe shprehet se nuk është dhe aq i pjekur për dhëmbët e saj. Kur ishte në pushtet kjo opozitë nuk mendoi kurrë për reformimin real të arsimit, por thjesht dhe vetëm për marrëdhëniet klienteliste të saj me aktorët e vjetër dhe të rinj të këtij tregu. Opozita e sotme i ka shfrytëzuar dje kioskat dhe universitetet private që licenoi, si dhe një pjesë të universiteteve shtetërore, si distributor për karburantin e makinës së saj elektorale. Nëse do ta bënte këtë reformë, maxhoranca e djeshme ndoshta nuk do të merrte votat e dëshiruara, por e sigurt ishte se do të hidhte një gur themeli për të mirën e brezave të ardhshëm e atëherë do t'i jepnim të drejtë Xhejms Klarkut kur thotë se një politikan mendon për zgjedhjet e ardhshme, ndërsa një burrë shteti punon për brezat e ardhshëm.

Gjatë orëve të ethshme të miratimit nën për nen të këtij projektligji në komisionin tonë opozita dhe liderët e saj bënë gjithçka për ta penguar miratimin e kësaj reforme, sepse gojë e liga thonë që opozita e donte këtë draft si një kalë për betejën e radhës me mullinjtë e erës që po planifikon për në vjeshtë, kur studentët dhe pedagogët kërkon t'i nxjerrë në rrugë duke ëndërruar që me anë të protestave të tyre të rikthehet në pushtet për t'i mbajtur ata përsëri në moçalin e derisotëm të arsimit të lartë. Është kjo arsyeja se përse pas 19 muajsh nga ngritja e

komisionit me 11 ekspertë të pavarur të arsimit të lartë për këtë reformë, opozita jonë nuk arriti të përgatisë një projektligj alternativ. Kjo është arsyeja se përse opozita jonë sot nuk ka asnjë copë letër ku të tregohen me detaje nenet “e mbrapshta” të këtij ligji e në vend të tyre të propozonte sot nenet e reja. Është kjo arsyeja se përse edhe kritikët më të zjarrtë në botën akademike shqiptare e kanë kuptuar se opozita jonë sot flet vetëm sa për të larë gojën. Është kjo arsyeja se përse nga 500 ditët që po punohet për këtë draft opozita jonë u kujtua për të folur vetëm 5 ditët e fundit. Është kjo arsyeja se përse përfaqësuesit e kësaj opozite në Komisionin e Medias nga 2 muaj diskutime, dëgjesa dhe shqyrtime u kujtua vetëm në 2 ditët e fundit për t'u munduar ta bllokojë me procedurë miratimin e këtij ligji. Opozita do të donte shumë që të ishte ajo sot hartuesja, mbrojtësja dhe miratuesja e këtij ligji, sepse ky ligj do t'i bënte nder çdo partie të të gjithë spektrit politik jo vetëm në Shqipëri. Ndaj është kjo arsyeja se përse kjo maxhorancë do ta shënojë me krenari në librin e historisë së saj këtë reformë. Opozita jonë nuk është e shqetësuar në fakt për ligjin. Ajo sot është e frikësuar për humbjen e identitetit të saj politik, sepse sa ishte në pushtet ajo kurrë nuk ndërmori asnjë reformë të vërtetë strukturore, aq më pak ndonjë reformë të djathtë. Ndaj shqetësohet gjithnjë e më shumë sa herë që maxhoranca jonë reformon sistemin e pensioneve, hap dosjet e Sigurimit të Shtetit, realizon procesin e legalizimit, fut në rrugën e zgjidhjes çështjen e pronave, kompenson dhe rehabiliton ish- të përndjekurit politikë, reformon sistemin arsimor, energjetik, shëndetësor, të drejtësisë dhe të gjithë kolonat e tjera mbi të cilat po ngrihet dhe do të funksionojë nesër shteti ynë modern europian. Diskutimet e pafunda, argumentet nga më të ndryshmet dhe pakuptimësia shembullore e thelbit të këtij ligji kanë shërbyer si një gjethë që i kanë zënë sytë gjithkujt që është i interesuar realisht për të kuptuar se çfarë fshihet në të vërtetë brenda pyllit me 141 nene të këtij ligji.

Pyetjet që unë do të doja t'u jepja përgjigje të thjeshta për ata që kanë ende dilema, janë:

A do të bëhen shtetërore universitetet private? Përgjigja është jo, sepse universitetet nesër e tutje në Shqipëri nuk do të jenë as shtetërore as private, por do të jenë institucione

të arsimit të lartë të financuara me paratë publike ose me paratë private.

Por a do të financohen private me paratë publike? Pra, me paratë e taksave tona, siç thonë disa? Përgjigja është jo. Kjo është një gënjeshtër e djallëzuar. Agjencia Kombëtare e Financimit të arsimit të lartë si një institucion i ri i pavarur është përgjegjëse është për shpërndarjen e fondeve publike sipas politikave të qeverisë në drejtim të grantit të mësimdhënies, bursave të studimit për studentët e shkëlqyer, ata që ndjekin programe me prioritet kombëtar studimi dhe bursat sociale, punës kërkimore – shkencore, mbështetjes financiare për inovacionin dhe mbështetjen e skemës së kredive studentore.

A do të zhduket roli i shtetit në arsimin e lartë? Përgjigja është jo. Sepse nëpërmjet këtij ligji garantohet roli rregullator i shtetit, vendosja e standardeve të cilësisë dhe rregullave të funksionimit të sistemit. Garantohet roli i financuesit të arsimit të lartë dhe roli i ofruesit të drejtpërdrejtë të shërbimit nëpërmjet institucioneve të arsimit të lartë publik.

A e kufizon ky ligj lirinë dhe autonominë universitare? Përgjigja është jo. Sepse ky ligj garanton lirinë akademike, autonominë financiare, autonominë organizative dhe lirinë akademike, autonominë financiare, autonominë organizative dhe përzgjedhjes së personelit në përputhje me ligjin në fuqi. A janë të garantuara standardet dhe cilësia në arsimin e lartë pas kësaj? Përgjigja është: “po”, sepse qeveria do të sigurojë ngritjen e një organizmi të drejtë dhe të pavarur vlerësimi, akreditimi dhe renditje të universiteteve publike dhe jo publike.

Si do të funksionojnë tani e tutje universitetet? Ato do të duhen të drejtohen duke ecur jo mbi një, por mbi dy shina nga struktura akademike dhe ajo administrative e institucionit të arsimit të lartë nëpërmjet drejtimit akademik nga senati dhe kolonës tjetër menaxheriale nga bordi i administrimit.

Risi tjetër e këtij projektligji është forcimi i rolit të departamentit si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies në punën kërkimore shkencore të fakultetit. Ashtu si organizmi shoqëror, familja është qeliza bazë garant e shëndetit të shoqërisë, departamenti kthehet në këtë mënyrë në rolin e funksionit të natyral si qeliza bazë garant e shëndetit dhe eficientës së sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri.

Ne përfaqësuesit e maxhorancës në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik si komisioni përgjegjës për këtë projektligj kemi kënaqësinë t’ju informojmë se kemi punuar me përkushtim dhe përgjegjësi maksimale për të qenë në lartësinë e rëndësisë, që ka kjo reformë për të ardhmen e çdo fëmije që do të diplomohet nesër, për çdo student, për çdo familje shqiptare, për çdo pedagog, punonjës shkencor dhe ndihmës akademik, për secilin nga pjesëtarët e personelit të institucionit të Arsimit të Lartë Publik apo Privat në Republikën e Shqipërisë.

Për 8 javë me radhë, që nga data 5 maj e këtij viti kemi zhvilluar si kurrë më parë në historinë e këtij komisioni seanca të hapura dëgjimore me përfaqësuesit më të lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Komisionit Teknik për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, kemi takuar 22 grupe të ndryshme interesi, kemi dëgjuar 44 perona në procesin e hartimit dhe miratimit të ligjit si aktorë interesi dhe për 35 orë kemi shqyrtuar në parim dhe nën për nën çdo pikë dhe presje të këtij projektligji. Krahas pjesës shumë pozitive të këtij procesi dëgjimi, mbajtjeje shënimesh, pranime të shumë mendimeve, sugjerimeve racionale të grupit të interesit dhe opozitës në komisionin tonë parlamentar, të cilat janë reflektuar në shumicën e rasteve në draftin përfundimtar që do të miratojmë pas pak, ky proces ka pasur edhe anën e vet komike dhe aspak serioze, që shoqëron procese të ngjashme në Shqipëri.

Sa më shumë zhurmë kanë bërë publikisht dhe në media, aq më pak këto zëra të këtij procesi kanë qenë konkrete në sugjerimin e tyre. Sa më shumë kanë folur, aq më pak ose aspak kanë sjellë vërejtje me shkrim, për nene konkrete të përmirësimit të ligjit. Për ta është shumë publik, mediatik dhe parimi “shumë zhurmë për asgjë” ka qenë gjithçka, ndërsa shqetësimi real për vendin ka qenë 0.

Kam frikë se kjo shfaqje u zhvendos sot nëpërmjet opozitës edhe në sallën e këtij parlamenti, ndaj le të bëhemi seriozë dhe t’i japim universiteteve tona dhe të ardhmes së fëmijëve tanë një ligj serioz, që do të ndryshojë rrënjësisht realitetin në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Shqipëri. Ndaj ju ftoj të gjithëve ta votojmë pro.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e rimerr zoti Meta.)

Ilir Meta – Po, zoti Paloka, ju lutem!

Edi Paloka - Zoti Kryetar, ne si opozitë e kemi shprehur mendimin tonë kundër këtij ligji, absolutisht të një ligji, që filloi si pazar, vazhdoi si pazar dhe përfundoi edhe para 10 minutash në fund të atij korridorit si pazar.

Ne pjesë e këtij pazari nuk mund të bëhemi në asnjë lloj forme, kështu që vazhdoni! Mbajeni përgjegjësinë nga fillimi deri në fund bashkërisht siç e bëtë edhe pazarin e fundit! Ne, edhe një herë e them nuk mund t'i vëmë njollë vetes me një ligj të tillë.

Ilir Meta – Atëherë, duke i kërkuar edhe një herë...

(Diskutime nga salla)

Ilir Meta – Ai votohet pasi hyn në fuqi ligji! Atëherë, i falënderojmë për kontributin që dhanë në mendimet e tyre dhe me këtë rast ju kujtoj...

Zoti Balla, ju lutem! Saliun nuk e harron dot njeri, se ai është gjithmonë i pranishëm, kështu që bëhemi gati për të verifikuar kuorumin!

Jeni gati, zoti Ruçi? Hapet votimi me elektronik për verifikimin e prezencës!

Ju lutem, unë kam një defekt këtu! Hapet përsëri votimi!

Me qetësi se duhet të ketë ndonjë defekt!

Atëherë, bëhemi gati edhe një herë, ju lutem! Hapim edhe një herë votimin elektronik për prezencën! Hapet votimi! Del prezencë e frikshme 139, kështu që bëjmë një minutë pushim, ju lutem! Të qëndrojmë në sallë sa të zgjidhim problemin, meqenëse është ligj shumë i rëndësishëm.

Ata të IT-së e humbën ditën e punës, zoti Fino.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dy ditë, po, dje dhe sot.

Sekretaria duhet të numërojë deputetët e pranishëm.

Hapim votimin me karton për prezencën. Ju lutem, mbajeni lart kartonin deri sa të numërojë sekretaria! *(Sekretaria ndërkohë numëron deputetët e pranishëm dhe i konfirmon Kryetarit të Kuvendit se në sallë janë të pranishëm 78 deputetë.)*

Ju lutem, me qetësi!

Janë 78 deputetë të pranishëm. Janë 74 deputetë në sallë së bashku me mua,

Kryeministrin Rama, me zotin Cani dhe me zotin Klosi.

Hapet votimi me karton në parim.

Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Janë 78 deputetë pro.

Votojmë nen për nen sipas variantit integral të përgatitur nga Komisioni Përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Neni 1. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9/1. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kur të zbardhet ligji, ky nen do të marrë numërtimin e duhur në renditje.

Neni 10. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Para se të kalojmë te neni 24 kemi një amendament nga Komisioni i Shëndetësisë. Komisioni i Shëndetësisë propozon riformulimin e pikës 6 të këtij neni. Amendamentin e keni të gjithë përpara.

Zonja Ministre, jemi dakord me këtë amendament?

Lindita Nikolla – Po.

Ilir Meta – Edhe ministrja është dakord.

Kush është dakord me amendamentin? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24, sipas variantit integral. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Para se të kalojmë te neni 27, kemi një tjetër amendament nga Komisioni i Shëndetësisë për këtë nen. Propozohet riformulim i këtij neni. Amendamentin e keni përpara.

Zonja Ministre, jemi dakord me këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Zoti Taulant Balla, jeni dakord?

Taulant Balla – Kam një riformulim. Në paragrafin e dytë shtohet në fund: “Me kërkesë të ministrit përgjegjës për Shëndetësinë”. Ndërsa pika 4 riformatohet: “Këshilli i Ministrave përcakton kriteret dhe procedurat për ngritjen dhe organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare, si edhe kriteret specifike shtesë dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtuesve të shërbimit të tyre. Ministri përgjegjës për Arsimin dhe ministri përgjegjës për Shëndetësinë dërgojnë propozimin përkatës në Këshillin e Ministrave pas specifikimeve të bëra nga Institucioni i Arsimit të Lartë”.

Pika 6 riformatohet si më poshtë: “Në rastet e krijimit të një shërbimi të ri ose të IAL-ve të reja, të cilat kanë strukturë shëndetësore universitare, drejtuesi i shërbimit emërohet nga ministri përgjegjës për Shëndetësinë dhe ministri përgjegjës për Arsimin për një mandat me kohëzgjatje deri në 1 vit kohë, brenda së cilës zhvillohen zgjedhjet e drejtuesit të njësisë kryesore ose përzgjidhet drejtuesi i shërbimit”.

Ilir Meta – Jemi dakord me këtë formulim?

Hedhim në votim këtë amendament. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 28. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 29. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 30. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 31. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 32. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 33. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 34. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 35. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 36. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 37. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 38. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 39. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 40. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 41. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 42. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 43. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Para se të kaloj te neni 44, kemi një tjetër amendament nga Komisioni i Shëndetësisë. Propozohet riformulim i fjalisë së parë të pikës 3. Amendamenti është shpërndarë.

Zonja Ministre, jeni dakord?

(Ndërrhyrje nga salla.)

Urdhëroni?

Zoti Xhafaj, është pjesë e raportit të Komisionit të Shëndetësisë.

Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Lidhur me nenin 44, do të mbajmë variantin e qeverisë.

Ilir Meta – Domethënë, nuk jeni dakord me amendamentin e Komisionit të Shëndetësisë? Ky është thelbi?

Taulant Balla – Po.

Ilir Meta – Po. Atëherë, lidhur me këtë amendament të Komisionit të...?

(Deputeti Vasili ndërhyr pa mikrofon.)

Po, zoti Vasili.

Petrit Vasili – ...këtë amendament edhe përpara dhe patëm dakordësinë që kufizimi që kishte të bënte me këtë pikë, ramë dakord që do të kalonte lidhur me heqjen e kufizimit për doktorët, apo jo?

(Diskutime në sallë.)

Apo nuk folëm ne?

(Diskutime në sallë.)

Ilir Meta – Dakord, një minutë pushim.

Ju lutem, të mos lëvizim!

Është ligj i rëndësishëm, nuk është ligj i lehtë. Kështu që... *(Pas pushimit prej disa sekondash.)*

Taulant Balla – Varianti i qeverisë.

Ilir Meta – Atëherë, amendamenti i Komisionit të Shëndetësisë hidhet në votë për nenin 44. Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

Vazhdojmë me nenin 44. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 45. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 46. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 47. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 48. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 49. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 50. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 51. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 52. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 53. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 54. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 55. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 56. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 57. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 58. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 59. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 60. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 61. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 62. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 63. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 64. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 65. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 66. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 67. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 68. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 69. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 70. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 71. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 72. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 73. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 74. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 75. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 76. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 77. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 78. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 79. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 80. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Përpara se të kalojmë në nenin tjetër, kemi një amendament nga deputetja Vasilika Hysi. Propozohet ndryshim për pikat 2 dhe 3 të variantit integral.

Zonja Hysi, dëshironi të shpreheni?
Ju lutem!

Vasilika Hysi – Shumë shkurt. Amendamenti është shpërndarë.

Kemi bërë vetëm një ndryshim lidhur me provimet në programet e studimeve në fushën e drejtësisë, që shtohen, në kuadër edhe të gjetjeve të Komisionit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë të Reformës në Drejtësi. Ndryshimi konsiston në faktin që rregullat e provimit të shtetit do të organizohen në bazë të rregullave që përcaktohen në ligj.

Iir Meta – Atëherë, hedhim në votim amendamentin e zonjës Hysi. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 80/1, pika “i”. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kur të zbardhet ligji, ky nen do të marrë numërtimin e duhur në renditje.

Neni 81. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 82. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 83. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 84. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 85. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 86. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 87. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 88. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 89. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 90. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 91. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 92. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 93. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 94. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 95. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 96. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 97. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 98. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 99. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 100. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 101. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 102. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 103. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 104. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 105. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 106. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 107. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 108. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 109. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 110. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 111. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 112. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 113. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 114. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 115. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Përpara se të kalojmë në nenin 116, kemi përsëri një amendament të paraqitur nga Komisioni i Shëndetësisë, i përfshirë në raportin që ju është shpërndarë. Atëherë, ky amendament i Komisionit të Shëndetësisë propozon që të hiqet kreu XII, pra nenet 116-121, ku flitet për institucionin publik të pavarur të arsimit të lartë.
Bëhuni gati për votim.
Hedhim në votim me karton amendamentin. Pro? Kundër? Abstenim?
Nuk miratohet.
Vazhdojmë me nenin 116. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.
Neni 117. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 118. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 119. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 120. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 121. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Para se të kalojmë në nenin 122, kemi përsëri një amendament nga zonja Vasilika Hysi për riformulimin e pikës 7 të këtij neni dhe shtimin e pikës 8.
Zonja Hysi, dëshironi të shpreheni?
Ju lutem!
Vasilika Hysi – Bëhet fjalë për caktimin e një rregulli se kur duhet të fillojnë institucionet e arsimit të lartë të ofrojnë programe studimi të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, që i është lënë vitit 2017-2018, dhe detyrimin që brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të bëhen ndryshimet në ligjet e fushave përkatëse të përcaktuara në nenin 80/1 të këtij ligji.
Illir Meta – Po.
Hedhim në votim amendamentin e zonjës Hysi. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Vazhdojmë me nenin 122, pikat nga 1 deri në 6. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 123. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 124. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 125. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 126. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 127. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 128. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Para se të kalojmë te neni 129, kemi përsëri një amendament tjetër nga zonja Vasilika Hysi për paragrafin 3 të këtij neni. Zonja Hysi, ju lutem!
Valentina Hysi – Në këtë amendim, në paragrafin 3, shtohet një fjali: Në numrin e

mandateve sipas kësaj pike përlogariten mandatet e fituara në bazë të ligjit nr. 9741 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim.”

Ilir Meta - Faleminderit!

Atëherë, hedhim në votim amendamentin e zonjës Hysi. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 129, për pikat 1, 2, 4 dhe 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 130. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 131. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 132. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 133. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 134. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 135. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 136. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 137. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 138. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 139. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 140. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 141. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Atëherë, kemi votimin me elektronikë në tërësi.

Ta provojmë me elektronikë, apo me kartonë?

E provojmë me elektronikë, se kartonin s’na e heq njeri.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Me 78 vota pro miratohet edhe në tërësi projektligji.

Faleminderit!

Suksese dhe natën e mirë!

Seancën tjetër e kemi ditën e enjte.

(Seanca u mbyll në orën 02: 30.)

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Musa Ulqini

Kryetari i Kuvendit

Ilir Meta

